



RAPORT PËRFUNDIMTAR **AUDITIMI**

“AUDITIMI I **PËRPUTHSHMËRISË”**

DREJTORIA E SHËRBIMIT **KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

QERSHOR 2020



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(Auditim Përputhshmërie)

- Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Punësimit -

Nr	Përmbatja	Faqe
I.	PERMBLEDHJA	
	EKZEKUTIVE	3- 13
II.	HYRJA	14-14
a.	Objektivat dhe qëllimi.	14-14
b.	Identifikimi i çështjes.....	15-15
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15-15
d.	Përgjegjësitë e audituesve.....	15-15
e.	Kriteret e vlerësimit.....	15-16
f.	Dokumentimi i rezultateve të auditimit.....	16-16
g.	Standardet e auditimit.....	16-17
h.	Praktikat e ndjekura në kryerjete të auditimit.....	17-18
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19-19
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET SIPAS DREJTIMEVE TE ANGAZHIMIT	20-231
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	232-232
VI.	ANEKSE	234-239



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I.a.-Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. nr. 65/2, datë 21.01.2020, i ndryshuar me shkresën nr. 65/3, datë 18.03.2020 në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) sot AKPA , nga data 21.01.2020-15.04.2020, për periudhën nga **01.04.2018 deri më 31.12.2019**, u krye auditimi i përputhshmërisë në SHKP, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. LI
2. R. L
3. J. G
4. A. K
5. K. F
6. E. B
7. V. S

Auditimi u krye i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë SHKP.

I.b-Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi i urdhër shpenzimeve me objekt dieta e udhëtime të brendshme u konstatua se për 23 raste në shumën 557,000 lekë për vitin 2018 dhe 20 raste në shumën 726,000 lekë për vitin 2019, këto shpenzime ishin të pajustificuara. Dokumentacioni shoqërues nuk përmban elementët bazë për vërtetësinë e shërbimeve të kryera si: nënshkrimet e çdo punonjësi që ka kryer shërbimin, përfshirjen në një faturë tatimore mbi një person dhe në raste të përsëritura deri në 13 persona. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: pikën 36 të UMF nr.11 datë.27.12.2011, pikën 3 të Nenit 12 të Ligjit 10296 datë.08.07.2010, dhe VKM 997 dt.10.12.2010, pika 1.			Spektori i Finances në SHKP të marrë masat që në çdo praktikë urdhër- pagesa për shërbime dieta, fatura tatimore të jetë individuale për çdo punonjës dhe të firmosur nga personi përfitues e gjithë praktika shoqëruese.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
2.	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i DRSHPK Shkodër”, konstatohet s’kualifikim i padrejtë i OE “N” shpk, i cili ka patur kapacitete të plota ekonomike dhe teknike, ku duhej të kualifikohej për realizimin e kontratës, e cila ka patur çmimin më të ulët në zbatim të nenit 55 të LPP “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” pika 1/b.Neni 53 pika 4 citon se Ak vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT. Arsyeya e s’kualifikimit janë pasi nuk plotësonte 1 murator me IQT, nga operatori ekonomik gjë nuk do të çenonte objektin e prokurimit pasi rinovimi i certifikimit është thjesht marëdhënie e OE me kompaninë certifikuese, Konstatohet se OE “N”, ka mjaftueshëm punë të ngjashme me nxhinerë ndërtime, ku puna sipas preventivit me 35 m3 “Mur me tullë të lehtësuara dopio deri 3m me llaç përzier M25”, do të realizohej lehtësisht.</p> <p>Në lidhje me pretendimin e KVO, se mungon deklarata mbi tokëzimin dhe nulifikimin e pajisjeve elektrike, sqarohet se ky OE ka paraqitur deklaratën që do u përmbahet specifikimeve teknike dhe projektit, pjesë e së cilës është dhe tokëzimi dhe nulifikimi i pajisjeve elektrike. Ofertat më e leverdishme e “N” shpk me vlerë 6,901,741 Lekë pa TVSH, kanë qenë më efikase për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët dhe Ligjit Prokurimit Publik, neni 53, 55. Pra nëse autoriteti kontraktor do të kishte vlerësuar bazuar çmimit më të ulët dhe Ligjit të Prokurimit Publik, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët. Diferenca e vlerës prej 1,396,030 lekë me TVSH (8,065,100 lekë - 6,901,741 lekë = 1,163,359 lekë x 20%), midis ofertës së “Nika” sh.p.k dhe ofertën fituese të BOE “x konstruktion”&“x. konstruktion”shpk, përbën dëm ekonomik, të shkaktuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me Urdhërin nr.1488/1 datë 22.05.2018 i përbërë nga x, x, x, x, x.</p>			<p>2.1.Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa që të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 1,396,030 lekë.</p>
3.	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”person fizik, me..., me aktivitet Tavernë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 448 datë 12.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, për 1 punonjës. Ky tatimpagues ka lidhur akt marrëveshje me DRT Gjirokastër me nr.prot.132, datë 09.01.2018, sipas të cilës ka detyrime dhe gjoba:në vlerën 185,539 lekë. Mosekzistenca e vërtetimit për shumën totale të detyrimeve në datën 01.08.2018 është mungesë transparence si e tatimpaguesit, por edhe e Drejtorisë Rajonale të Punës në Gjirokastër, e cila ka pranuar këtë fakt duke lënë hapsira për dyshime dhe për mosnjohje të ecurisë së pagesës që ky tatimpagues ka pasur gjatë vitit 2018. Gjithashtu në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrën e Punës Gjirokastër, në datë <u>12.09.2018</u>, subjekti rezulton me detyrime dhe me akt-marrëveshje të pavlefshme juridikisht.</p> <p>Pra nga sa më sipër është vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, ku Komisioni i Miratimit të projekteve nuk duhet të kishte miratuar lidhjen e kontratës me këtë subjekt pasi subjekti rezulton me detyrime dhe nuk ekziston asnjë dokument, urdhërpagese apo konfirmim periodik mujor që të vërtetojë që subjekti ka respektuar kushtet e kontratës duke vepruar në kundërshtim me</p>			<p>3.1.Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa e të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 277,795 lekë, nga subjekti “x”person fizik, me nipt-.....</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar. Për sa më sipër, me veprimet dhe mosveprimet SHKP i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 277,795 lekë.</p>			
4.	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt...., me aktivitet “Shërbime telefonike”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot. 415, datë 12.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë nga grupet e veçanta“ për 37 punonjës dhe sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar”. Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.569, datë 27.12.2019 konfirmon <u>joefektivitetin</u> e këtij projekti i cili është ndërprerë në mars 2019, pasi subjekti nuk ka dorëzuar pagesat për cdo muaj të likuidimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore mbështetur në:</p> <p>-Shkresën e DRT Shkodër me nr.prot.6330/1, datë 04.07.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime tatimore në vlerën 2,739,148 lekë. Konstatohet se në asnjë rast nuk ka një korrespondencë shkresore ndërmjet DRSHKP Shkodër apo SHKP/Drejtori e Përgjithshme me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën mars – shtator 2019 për të cilën subjekti nuk iu është përgjigjur detyrimeve kontraktuale, duke mos zbatuar detyrat funksionale dhe detyrimet kontraktuale në ecurinë e këtyre dy projekteve të përfituara nga ky subjekt dhe duke bërë një raport përfundimtar mbi “<u>efektivitetin</u>” e ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit, <i>me vonesë në dhjetor të vitit 2019.</i></p> <p>Sipas rregullores, Zyra përkatëse e Punësimit dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit brenda dates 10 të muajit pasardhës <i>Tabelën e Ecurisë së Projekteve</i> me fond të konfirmuar nga punonjësi i financës sipas situacionit buxhetor. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit nuk ka masa administrative të ndërmarra në lidhje me mospërbushjen e detyrimeve kontraktuale nga subjekti përgjatë vitit 2019, për fillimin e procedurave për dëmshtëpërblimin e vlerës 1,762,809 lekë të përfitur nga subjekti për periudhën shtator-mars 2019. Nga administrata e SHKP-së është vepruar në kundërshtim me nenin 9 të kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018 “Zgjidhja e Kontratës” Vlera e përfitur padrejtësisht nga subjekti prej 1,762,809 lekë konsiderohet dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të kishin filluar menjëherë procedurat për dëmshtëpërblimin e kësaj vlere. Gjithashtu e gjithë vlera totale e përfitur nga ky subjekt prej <u>5,532,216 lekë</u> sipas Kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, firmosur nga Drejtori i DRSHKP Shkodër konsiderohen të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, pasi janë përdorur pa economicitet, efektivitet dhe eficientë.</p>			<p>Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa e të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 1,762,809 lekë nga subjekti “x” sh.p.k, me nipt-.....</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
5.	<p>Nga auditimi u konstatua se sipas raportimit periodik në MFE për detyrimet e prapambetura të SHKP-së, deri në datë 31.12.2019, nga SHKP u paraqit shkresa me prot 2191/1, datë 11.07.2019 me lëndë “Mbi Raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura”. Në këtë shkresë sektori i buxhetit në SHKP vë në dijeni MFE për detyrimet që SHKP ka ndaj furnitorit “x lidhur me kontratën për ndërtimin e Qendrës së Formimit Profesional (QFP) –Berat. Sipas kësaj shkrese SHKP ka detyrime të pashlyera ndaj “x” shpk, në vlerën prej 67,211,269 lekë. Nisur nga vlera e madhe e detyrimit ku SHKP është debitor dhe nga shpjegimi <u>shumë sipërfaqësor</u> nga sektori i financës, u paraqit domosdoshmëria e auditimit në një periudhë relativisht të gjatë që daton me datën e lidhjes së kontratës për ndërtimin e QFP Berat, datë 07.12.2006. Si rrjedhim u kërkua informacion për dosjen e prokurimit për këtë objekt si dhe arsyet e krijimit të këtij detyrimi të pashlyer ende. Kontrata nr. 3742/1, datë 07.12.2016 midis MMSR, i <u>autorizuar SHKP</u> dhe “x” shpk me objekt “Ndërtim i ri i DFP, Berat. Zbatimi i punimeve ka patur probleme me truallin, gjë që ka sjellë mosmarrjen e lejes së ndërtimit megjithëse është aplikuar dy herë nga ana e projektuesit dhe si rezultat kemi pezullimin e punimeve nga Bashkia Berat. Për këtë fakt, mospajisja me leje zhvillimore dhe ndërtimore, ku kanë qenë në dijeni institucionet shtetërore, tregon një papërgjegjshmëri nga MMSR, por edhe nga i autorizuar në rastin konkret SHKP për zbatimin e kontratës, duke vazhduar një korrespondencë shkresore të gjatë. Në vitin 2016 është realizuar likuidimi pjesor i situacionit nr.1 në shumën 11,844,004 lekë. Në vitin 2017, fondi i çelur për këtë objekt ka qenë vetën 18 mln lekë më të cilin është likuiduar pjesërisht situacioni nr.2.Në vitin 2018 është është parashikuar në PBA, fondi për likuidim të këtij objekti, por si pasojë e procedurës tekniko-ligjore për pajisjen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi, nuk është kryer asnjë likuidim situacionesh të përfunduara. Është paguar 3,043,194 lekë dhe subjekti është pajisur me leje ndërtimi. Me Akt Normativ/2 është kryer pakësimi i fondit të planifikuar për këtë objekt prej 65 mln lekë, dhe si përfundim detyrimi ndaj furnitorit është $96,097,617 - 29,844,004 = 66,253,613$ lekë dhe detyrimi ndaj mbikqyrësit është 958,800 lekë.</p> <p>Pra, AK nuk ka shlyer në vazhdimësi operatorin ekonomik edhe pse nga MFE është çelur fondi për likuidimin e punimeve të kryera, veprim që është në kundërshtim me Kontratën e punimeve me nr. Prot. 3742/1 dt 07.12.2016, <i>Neni 29.5</i>, kushtet e pagesës, sipas <i>nenit 30</i>: Vonesa në bërjen e pagesës dhe në ligjin <i>Nr.48/2014</i> "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" <i>Neni 5</i>: “Llogaritja e Kamatëvonesës”. Mosmarrja në dorëzim e objektit, moslikuidimi dhe mosgritja e grupit të marrjes në dorëzim apo përpjekjes nga Institucioni për të arritur përfundimin e këtij objekti, trajtohet edhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në <i>Neni 87 të tij</i>. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk ka marrë masa për shlyerjen e detyrimeve dhe finalizimin e këtij objekti me rëndësi për zbatimin e politikave shtetërore në fushën e tregut të punës. Ky institucion në bashkëpunim me MMSR, ka çuar në inefficencën e një objekti të papërfunduar dhe të pavendosur në funksion të objektivit kryesor që SHKP ka si qendër formimi profesional, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej 29,844,004 lekë (vlera e paguar e dy situacioneve, pa llogaritur edhe amortizimin e veprës e cila nuk është vënë në funksion).</p>			<p>5.1.Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me MFE të marrin masa me mbikëqyrësin e punimeve, të azhurnojnë gjendjen aktuale të objektit (pasi është i braktisur prej më shumë se 2 vitesh), duke rakorduar zërat e punimeve, volumet e cdo zëri punimi dhe cdo specifikim tjetër që nevojitet për përfundimin e investimit.</p> <p>5.2.Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me MFE, të marrë masa të menjëhershme që të planifikojë buxhetin për shlyerjen e situacioneve të kontratës së punimeve dhe atë të mbikëqyrjes, si dhe të sigurojë fonde shtesë për shtesën e kontratës në vlerën 19,032,382 lekë për përfundimin sa më shpejt të veprës, me parametra teknik të nevojshëm dhe funksional. Mosmarrja e masave nga SHKP dhe MFE për moskolaudimin e objektit, sjell që shuma prej 29,844,004 lekë të përbëjë dëm ekonomik të parikuperueshëm ndaj buxhetit të shtetit, pa përfshirë këtu dëmet ekonomike që i janë shkaktuar operatorit ekonomik, i cili i është dashur të paguajë detyrimet tatimore për situacionet e deklaruara.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
6.	<p>Nga auditimi u konstatua se emërimi i Drejtoreshës së Përgjithshme të SHKP-së është bërë në bazë të urdhërit të Kryeministrit Nr.65, datë 13.04.2018, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit 7995, datë 20.09.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Në dosjet e personelit marrë nga sektori i burimeve njerëzore u konstatua Titullari s,ka qenë pjesë e TND-së dhe ka vazhduar të ushtronte detyrën e tij për një periudhë afër 2-vjeçare pa statusin e nëpunësit civil, në kundërshtim me Ligjin Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndryshuar me Ligjin Nr.178/2014, datë 18.12.2014, neni 28, pika 1,2,3,4 e 5 dhe neni 30 i këtij ligji. i cili shpreh qartë se çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm .</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	<p>1.1Ministria e Financave dhe e Ekonomisë si instiucioni mbikëqyrës, të verifikojë nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit për emërimin si Drejtor i Përgjithshëm i SHKP-së dhe vlefshmërinë e të gjitha veprimeve juridike të kryera nga Titullari për periudhën dy vjeçare gjatë së cilës ai nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil si anëtar i TND-së.</p>
7.	<p>Nga auditimi u konstatua se me ristrukturimin e ministrive, SHKP është në varësi të MFE-së, sipas VKM nr 503, dt 13.9.2017, ndërkohë Rregullorja e Brendshme e SHKP-së, “Për organizimin funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së SHKP-së, miratuar me vendimin nr.29, datë 31.01.2015 të Këshillit Trepalësh Administrativ, e ndryshuar me vendimin nr.3, datë 14.02.2017 të Këshillit Trepalësh Administrativ nuk është përditësuar dhe nuk i është përshtatur ndryshimeve. Sipas rregullores së brendshme aktuale, SHKP vazhdon të jetë në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	<p>2.1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit t’i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për krijimin sa më parë të Këshillit Konsultativ për Punësimin si organi këshillimor që ngrihet pranë SHKP-së për punësimin dhe aftësitë, i cili kryesohet nga Ministri i MFE-së dhe të marrë masa për përgatitjen e rregullores së re “Për organizimin, funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës e AKPA (SHKP) ” duke mirëpërcaktuar funksionet dhe reflektuar ndryshimet si pasojë e implementimit të Ligjit të ri 15/2019, datë 13.03.2019, “Për nxitjen e punësimit”.</p>
8.	<p>a)Nga auditimi u konstatua se për procesin e inventarizimit komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, dhe të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>b) Para fillimit të inventarit nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe i fletë daljes nëpërmjet një procesverbali, veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.</p> <p>c) Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit ka nxjerrë një vlerë totale dhe jo një listë të detajuar, mbi gjendjen fizike të institucionit, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74, 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.</p> <p>-Procesi i inventarizimit ka kaluar afatet e përcaktuara mbi 17 ditë kalendrike pa justifikim apo miratim përkatës nga x SHKP.</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	<p>3.1. Komisioni i inventarizimit, i cili ngrihet çdo vit nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacion, me qëllim verifikimin real të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.</p>
9.	<p>Nga grupi i auditimit u konstatua se për të dy vitet objekt auditimi 2018 dhe 2019, në Planet Strategjike dhe në Planet Vjetore të SAB nuk planifikohet dhe rrjedhimisht nuk auditohet, njësia qendrore ose Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së, megjithëse në nivelin e vlerësimit të riskut kjo njësi parashikohet me risk të lartë.</p> <p>Moskryerja e auditimit të brendshëm të njësisë qendrore e cila është boshti kryesor për mbarëvajtjen dhe përdorimin me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet të njësisë të tjera në varësi është në kundërshtim me nenin 6 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 114/2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin public” i ndryshuar.</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	<p>11.1.Sektori i Auditimit të Brendshëm pranë SHKP të marrë masa që në Planet Strategjike dhe në Planet Vjetore të planifikojë si subjekt auditimi Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së, duke u bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.</p>
10.	<p>Subjekti/përfitues “x.” sh.p.k, me nipt, me aktivitet Fasoneri e adresë Cermë –Divjakë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/95 datë</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET</p>	E LARTE	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>06.09.2018 ka përfituar sipas VKM nr. 47, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, për 10 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 1,724,050 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 10 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me 950,000 lekë, pra rreth 55 % e vlerës totale të financimit. Në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj të cilat ishin në funksion të aktivitetit, por nuk kishte asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e kostos së trajnimit prej 950,000 lekë, e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p> <p>Nga shkresat e dërguara bashkëlidhur observacionit rezultonin pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por jo brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe në ligjin e procedurave tatimore, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së brendshme e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017 Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme si dhe Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka përgjegjësi në monitorimin e zyrës vendore për çdo rajon, veçanërisht në rastet kur subjekti i cili përfiton nga projektet e nxitjes së punësimit, rezultojnë me detyrime pranë administratës tatimore, në momentin e lidhjes së kontratës. Si rrjedhim vlera prej 1,724,050 lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>	<p>NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>		<p>15.1.Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa e të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa ekonomicitet, efektivitet e efikasitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit në vlerën 1,724,050lekë,ngasubjekti“x”sh.p.k.</p>
11.	<p>Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2018 sipas VKM-së nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, janë miratuar 94 projekte në vlerën prej 108,364,387 lekë, nga të cilat <i>subvencion në vlerën prej 73,515,806 lekë</i>. Pra vetëm subvencion është 68 % e vlerës totale të projektit.</p> <p>- Gjatë vitit 2019 për projektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar,nuk ka asnjë miratim por janë të mbartura prej vitit 2018, 87 projekte në vlerën prej 98,225,273 lekë, nga këto <i>subvencion në vlerën prej 61,194,539 lekë</i> ose thënë ndryshe 62 % e vlerës totale të projektit.</p> <p>Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm është konstatuar ky fenomen ku shumica e subvencionit zë peshën specifike të vlerës totale të projektit është lënë rekomandimi që :<i>SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit</i>, nga grupi I auditimit u konstatua se nuk ka ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej 134,710,345 lekë kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan nga grupi I auditimit të KLSH-së, në drejtoritë/zyrat rajonale, faturat e blerjes</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	<p>E LARTE</p>	<p>19.1. SHKP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si ministria përgjegjëse për nxitjen e punësimit dhe që ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për fushën e përgjegjësisë shtetërore, të marrin masa të menjëhershme në përmirësim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, ku të gjejë rregullim fakti që, kostot e subvencioneve shtetërore për blerjen e lëndës së parë të cilat subjekti privat përfitues do t’ia ofrojë punëkërkuarve, gjatë praktikave trajnuese, duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, transparente dhe të specifikuara, sipas elementeve përbërës të saj.</p> <p>19.2.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të subvencionit prej 134,710,345 lekë nga fondet e buxhetit të shtetit pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkuar të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP, mungesa e gjurmës së auditimit në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej 134,710,345 lekë pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>			
12.	<p>Nga auditimi konstatohet se subjekti x, shpk me nipt, me aktivitet në fushën e ndërtimit- në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 944/3 datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, për 83 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, një vlerë financimi prej 15,108,357 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 83 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 9,146,600 lekë ose 61 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 01.09.2018, deri në 20.03.2019. Nga verifikimi i dosjes gjatë periudhës së formim /trajnimit prej 5,8 muaj u konstatua se subjekti ka kryer një largim masiv të punonjësve për periudhën korrik-gusht të vitit 2018, pasi nga numri i punonjësve 116 që kishte para fillimit të projektit normalisht numri i punonjësve në shtator duhet të varioje në: 116+83 (VKM nr.47)= 199 punonjës, por nga verifikimi i listëpagesës në shtator 2018 subjekti ka 132 punonjës të përfshirë ku nga këta 83 punonjës janë nga skema e pu.pa sipas VKM nr.47, pra subjekti ka bërë largim të punonjësve rreth 67 nga punonjësit ekzistentë.</p> <p>Ky largim <i>i pajustificueshëm</i> tregon për një tatimpagues që paraqet risk dhe për këtë DRSHKP e Tiranës duhet menjëherë të njoftonte DRT Tiranë dhe të bashkëpunonte me sektorin e zbatimit në DRT për një monitorim të subjektit dhe të punonjësve të larguar nga ky subjekt me qëllim sigurimin dhe përdorimin me efektivitet, ekonomicitet dhe efikasitet të fondeve që ky tatimpagues do të përfitonte në vijimësi nga buxheti i shtetit për këtë projekt. Kjo është <i>e papranueshme</i> dhe tregon një subjekt me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi ky tatimpagues me largime masive të punonjësve brenda një muaji në periudhën që është duke përfituar projekte të nxitjes së punësimit, mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore si dhe nuk paraqet besueshmëri për plotësimin e objektivit kryesor që këto projekte kanë :Rritjen e numrit të fuqisë punëtore. Pra pavarësisht treguesve të tjerë në dosje ky element është bazë për të vërtetuar efikasitetin e një projekti në kuadër të nxitjes së punëmarrësve. Si rrjedhim fondi prej 15,108,357 lekë është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet</p> <p>2-Subjekti/përfitues “x”sh.p.k.me nipt-....., me aktivitet Rrobaqepësi-fason, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/45 datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 6 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,260,219 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me 1,235,000 lekë, pra rreth 54</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	<p>E LARTE</p>	<p>20.1.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 15,108,357 lekë për subjektin x me nipt ... dhe të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 2,260,219 lekë pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet</p>



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>% e vlerës totale të financimit. Në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj, të cilat ishin në funksion të aktivitetit, por nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën prej 1,235,000 lekë, e përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë. Ajo që konstatohet në vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është se subjekti ka një lëvizje të madhe të numrit të punonjësve sidomos në muajt maj –qershor të vitit 2018, dhe konkretisht në muajin maj ka pasur të siguar 71 punonjës dhe në muajin qershor ka larguar nga skema një numër prej 61 punonjësish. Kjo është e papranueshme dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi është ky tatimpagues në cdo moment mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore dhe njëkohësisht nuk duhet të ishte përfitues i projektit të nxitjes së punëmarrësve pasi ky projekt konsiston në rritje të fuqisë punëtore dhe jo në ulje të saj. Nga ana tjetër subjekti në planin e biznesit të paraqitur shprehet se ka shumë nevojë për rritje të fuqisë punëtore, rritje të qarkullimit total të eksporteve e rrjedhimisht edhe të fitimit që do të realizojë duke dhënë “garanci”, që punonjësit që do të punësojë sipas këtij projekti do të jenë në vazhdimësi të siguar e të punësuar. Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit subjekti nuk rezulton të ketë qenë i suksesshëm. Në verifikimin e listëpagesave të deklaruara on –line gjatë periudhës mars –shtator 2019, ky subjekt ka të punësuar përkatësisht: Mars- 22 punonjës, prill-8 punonjës, maj- 8 punonjës, qershor-8 punonjës, korrik; gusht; shtator vetëm 2 punonjës. Pra subjekti nuk ka qenë efektiv dhe sikurse konstatohet nuk ka mbajtur as për periudhën 6-mujore numrin 50% të punonjësve të miratuar për t’i siguar në listëpagesë. Ndërkohë specialistët shprehen në raportin përfundimtar që programi ka qenë efektiv ashtu sikurse shprehen për të gjithë subjektet! Pra subjekti nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe ky projekt nuk i ka shërbyer qëllimit që ka :</p> <p>Nxitjen dhe rritjen e numrit të fuqisë punëtore në subjektet përfitues. Si rrjedhim fondi prej 2,260,219 lekë është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.</p>			
13.	<p>Nga audtimi u konstatua se Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Përpunim i ullirit, import-export, dhe adresë kryesore të zhvillimit të aktivitetit në Jorgucat-Gjirokastrë, si dhe nipt sekondar Delvinë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 453, datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë nga grupet e veçanta“ për 44 punonjës me kohë zgjatje për <u>1 vit</u>. Përveç dokumenteve të tjerë në dosje është vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me nr.prot.345, datë 17.08.2018 sipas të cilit subjekti ka detyrime në vlerën 502,557 lekë në Tatim Fitimi dhe ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Gjirokastrë me nr.prot. 4674, datë 23.07.2018.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Gjirokastrë, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji. Në dosjen e përfituesit nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë ku subjekti të konfirmojë që ka qenë konform ligjit në kryerjen e pagesave të detyrimeve që ka sipas akt-marrëveshjes (të cituara më sipër).</p>	<p><i>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</i></p>	<p><i>E LARTE</i></p>	<p>21.1.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 6,820,896 lekë për subjektin “x”sh.p.k, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Gjirokastër/ sektorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit, sektorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe Komisionin e miratimit të Projekteve për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrat e Punës.</p> <p>Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme duhet të kryejnë një monitorim periodik të hollësishëm si dhe të kontaktojnë shkresërisht me Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse për të ndjekur ecurinë e pagesave për detyrimet e prapambetura, veprime këto të pakryera në asnjë rast për subjektet me detyrime dhe përfitues të projekteve të nxitjes së punësimit. Si rrjedhim vlera prej 6,820,896 lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>			
14.	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-....., me aktivitet “Ndërtim”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 421, datë 03.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 20 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj; me një vlerë financimi 3,736,960 lekë dhe vlerë subvencionit prej (19,000 lekë/muaj x 20 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 2,204,000 lekë ose 59 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 03.09.2018 deri në 24.02.2019.</p> <p>Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Kukës me nr.prot.1333, datë 05.04.2018. Sipas akt marrëveshjes subjekti ka një shumë detyrimesh të mbetur për të paguar në vlerën 607,513 lekë për një periudhë 20 mujore pra më shumë se 1 vit , sipas planit të pagesës me këste mujorë në vlerën 30,375 lekë .</p> <p>Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 30,375 lekë, sipas akt-marrëveshjes.</p> <p>Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip FëMungojnë urdhërpagesat me vulën e bankës të cilët konfirmojnë derdhjen e detyrimeve mujore në sistemin tatimor. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Mungon Raporti i kontrollit përfundimtar i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku në rastin konkret subjekti duhet të ketë të punësuar një numër prej 10 persona.</p> <p>Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin “, si dhe manualin për MFK-në. Si rrjedhim vlera prej 3,736,960 lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “xi”sh.p.k me nipt-është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>	<p><i>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</i></p>	<p><i>E LARTE</i></p>	<p>22.1.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 3,736,960 lekë për subjektin “x”sh.p.k me nipt-.... pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
15.	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt-...., me aktivitet “Fast-Food, Piceri e bar-kafe”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 71, datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 2 punonjës me kohë zgjatje për <u>5 muaj</u> me një vlerë financimi 312,732 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 2 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me 190,000 lekë ose 61 % e vlerës totale të financuar. Gjithashtu subjekti ka përfituar edhe një projekt të dytë sipas VKM nr.248, datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 70, datë 30.08.2018, për 1 punonjës me vlerë financimi 276,768 lekë.</p> <p>Në dosje është vërtetimi i detyrimeve në kohë reale me nr.prot.362, datë 31.07.2018 marrë nga DRT Dibër, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën 154,309 lekë të pacilësuar së në afarë lloj tatimi duke vepruar në kundërshtim më vërtetimit tip të aprovuara nga DPT .</p> <p>-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00476838, datë 06.08.2018, i cili gjithashtu është me detyrime , gjoba dhe kamatëvonesa në vlerën 102,777 lekë.</p> <p>Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Dibër me nr.prot.2940, datë 31.07.2018, sipas të cilës detyrime dhe gjoba në total në vlerën 207,985 lekë dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj sipas akt-marrëveshjes është 20,000 lekë deri në fund të vitit 2018 i përlogaritur nga Drejtoria e Mbledhjes në DRT Dibër.</p> <p>Gjithashtu respektimi i akt-marrëveshjes nëpërmjet kryerjes së pagesave nga subjekti sipas grafikut të përcaktuar nga DRT është <u>dokumenti bazë</u> i cili duhet të ndihmojë dhe të jetë objekt-monitorimi i SHKP-së, për të ndjekur ecurinë e pagesave dhe respektimin e afatit në derdhjen e tyre të këtij tatimpaguesi i cili është përfitues i dy projekteve me një vlerë financimi nga buxheti i shtetit, në total prej 589,500 lekë. Por SHKP ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.47 Si dhe në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullore së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 20,000 lekë , sipas akt-marrëveshjes.</p> <p>Për sa më sipër Komisioni i miratimit të Projekteve e Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet të kishin miratuar dhënien e këtyre projekteve subjektit i cili ka detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ku për asnjë rast nuk ka të konfirmuar pagesat mujore kusht ky i detyrueshëm për t’u ndjekur nga kjo administratë dhe për të qenë pjesë e dosjes si gjurmë auditimi. Si përfundim fondi prej 589,500 lekë i buxhetit të shtetit është përdorur pa efektivitet, ekonomikitet e efikasitet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.</p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	23.1.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 589,500 lekë për subjektin “x” sh.p.k, me nipt-...., pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.
16.	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt-...., me aktivitet “Projekt dhe zbatim i veprave ndërtimore”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.126/1, datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 7 punonjës me kohë zgjatje për <u>5,8 muaj</u></p>	<p>TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT</p>	E LARTE	



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>me një vlerë financimi 1,231,947 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 7 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 771,400 lekë ose 63 % e vlerës totale të financuar. Në dosje <i>mungon vërtetimi tip</i> për situatën e detyrimeve në kohë reale që marret nga sistemi tatimor, i cili konfirmon gjendjen e detyrimeve në të gjitha llojet e tatimeve, dokument ky i detyrueshëm për t'u paraqitur në dosje dhe për t'u verifikuar më pas nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP për miratimin ose jo të kërkesës së subjektit për të qenë përfitues.</p> <p>Gjithashtu në dosjë është akt-marrëveshja e lidhur nga DRT Shkodër me nr.prot.(e korrigjuar), 4426/1, datë 14.05.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime në vlerë 1,419,192 lekë, të cilat duhet t'i shlyejë në mënyrë periodike mujore me një kësht të përcaktuar prej 60,484 lekë deri në dhjetor të vitit 2019.</p> <p>Në asnjë muaj edhe për më tepër në muajin shtator (dt 11.09.2018) që është kryer miratimi i kontratës për këtë subjekt nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP dhe Drejtori i Përgjithshëm nuk ka asnjë urdhërpagesë që të konfirmojë rregullsinë e këtij tatimpaguesi në derdhjen e detyrimeve, veprim që nuk e ka <i>“penguar”</i> SHKP të kryejë miratimin duke i dhënë fonde padrejtësisht nga Buxheti i Shtetit në vlerën 1,231,947 lekë, një subjekti debitor. Si rrjedhim vlera prej 1,231,947 lekë nga Buxheti i Shtetit, konsiderohen të ardhura të munguara të përfituara padrejtësisht nga subjekti “x”sh.p.k. dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të cituar më sipër nga SHKP, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>			<p>24.1.SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën 1,231,947 lekë për subjektin “x”sh.p.k. pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. nr. 65/1, datë 21.01.2020, i ndryshuar me shkresën nr. 65/2, datë 18.03.2020 në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) nga data 21.01.2020-15.04.2020, për periudhën nga 01.04.2018 deri më 31.12.2019, u krye auditimi i përputhshmërisë në SHKP, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. LI
2. R. L
3. J. G
4. A. K
5. K. F
6. E. B
7. V. S

a) Titulli:

Projektraporti i Auditimit të Përputhshmërisë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP).

b) Marrësi:

Ky Projektraport i adresohet Drejtorit të Përgjithshëm të SHKP -së, Znj. x.

Objektivat e auditimit synojnë:

- Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.
- Dhënie e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:
- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga SHKP, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit si dhe dhënie e rekomandimeve me qëllim dhënie të një sigurie objektive kësaj Drejtorie gjatë veprimtarisë së saj. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Identifikimi i çështjes.

Raporti përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit të këtij institucioni në realizimin e misionit të tij, që buron nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, në bazë të cilës, shërbimet e punësimit përfshijnë veprimtaritë:

- a) e informimit për vendet e lira të punës;
- b) e ndërmjetësimeve për punësim;
- c) e këshillimit dhe orientimit për punë dhe profesion

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit)

Drejtimi i SHKP-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të SHKP -së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu kemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr.154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”;
- ✓ Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”;
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;
- ✓ Udhëzimi Plotësues i MFE nr.7/2 datë 09.07.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- ✓ VKM nr. 128 datë 07.03.2018 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 8 datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, etj.
- ✓ ligji nr.7995, datë 20.09.1995, “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”;
- ✓ VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar,
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;
- ✓ Urdhër i MF nr.89, datë 28.12.2015 “Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njësive Publike” , si edhe udhëzime dhe rregullore të tjera,

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky projekt raport Auditimi.

Standardet e Auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”;

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik,; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar me bankat.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate shtetërore qendrore. Ai është krijuar dhe rregullon veprimtarinë e tij, bazuar në dispozitat e ligjit Nr. 7995, datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit", ndryshuar me Ligjin nr. 8444, datë 21.01.1999, ndryshuar me Ligjin nr.8862 datë 07.03.2002, ndryshuar me Ligjin nr. 9570, datë 03.07.2006, si dhe në Ligjin Nr. 152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”.

Strukturat kryesore dhe kompetencat e tyre rregullohen me Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", ndryshuar me VKM nr. 263 datë 25.05.2000, ndryshuar me VKM Nr. 17, datë 10.01.2003, dhe në nenin 14 të këtij VKM, Urdhrin Nr. 91, datë 28.10.2011“ Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar, me Urdhrin Nr.2 datë 07.01.2014 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar me Urdhrin Nr.111 datë 30.01.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit” të Kryeministrit, si dhe në Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

Administrata e Shërbimit Kombëtar të Punësimit e zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.

1-Këshilli administrativ Trepalësh (KAT) është organi më i lartë vendimmarrës i SHKP. Mandati i anëtarëve të këtij këshilli është trevjeçar dhe miratimi i emërimit të tyre bëhet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Kompetencat dhe detyrat e KAT përcaktohen me vendim të veçantë. KAT funksionon në bazë të Statutit të SHKP, me VKM Nr.42, datë 17.01.1998 ‘ Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit’, ndryshuar me VKM Nr.263, datë 25.05.2000 dhe VKM Nr.17, datë 10.01.2003, me VKM Nr.195, datë 02.04.2014 dhe VKM Nr.107, datë 23.02.2018. Në Kreun IV, Neni 12,13,14 citohet ‘Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i SHKP-së.’ Ai përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit

a. Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë dhe e operacioneve të kryera nga ana e subjektit SHKP Tiranë përgjatë periudhës **01.04.2018 deri më 31.12.2019**.

Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të SHKP -së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit.

b. Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të SHKP -së me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.04.2018 deri më 31.12.2019, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.04.2018 deri më 31.12.2019. Si kufizim i mundshëm gjatë kryerjes së auditimit shënohet situata e krijuar nga pandemia *COVID-19*, gjatë kryerjes së angazhimit në terren, ku mund të ballafaqoheshin qëndrimet dhe diskutoheshin çështjet në kohën e duhur.

c. Metoda e Auditimit: Auditim mbi bazë risku.



IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

DREJTIMET DHE ZBATIMI I PROGRAMIT TE AUDITIMIT

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT


Në zbatim të pikës nr. 1 të Programit të Auditimit “Auditim Përputhshmërie në Shërbimin Kombëtar të Punësimit” (SHKP këtu e në vazhdim), me nr. Prot 65/2, i ndryshuar, datë 18.03.2020. ***“Për auditimin mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, tranferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar. Realizimi i planit të buxhetit. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.***

Në auditimin e kryer në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP këtu e më poshtë), për vitet 2018 dhe 2019 u mbajt parasysh legjislacioni i poshtëshënuar:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”;
- Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”;
- Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”;
- Udhëzimi i MFE nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;
- Udhëzimi Plotësues i MFE nr.7/2 datë 09.07.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”;
- VKM nr. 128 datë 07.03.2018 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”;
- Udhëzimi i MFE nr. 8 datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”;
- Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
- Udhëzimi i MFE nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.


1/a -Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

SKEMA E CIKLIT BUXHETOR VJETOR





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”



Shërbimi Kombëtar i Punësimit është institucion në vartësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka për detyrë të menaxhojë veprimtarinë ekonomike-financiare të institucionit, të administrojë me efikasitet, efektivitet dhe transparencë fondet monetare të vëna në dispozicion, bazuar në parimet e funksionimit të sistemit buxhetor.

Si njësi e qeverisjes së përgjithshme përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në Programin e Qeverisë gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare). Përgatitja e buxhetit vjetor të këtij institucioni është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm ku buxheti vjetor është viti i parë i këtij programi, bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

Hartimi i PBA-ve për periudhën objekt auditimi.

Me shkresën nr. 2617 Prot. datë 15.08.2018 është dërguar nga SHKP, *faza teknike (II)* e PBA për periudhën 2019-2021 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me kërkesat për projektet e investimeve publike duke respektuar afatin për dorëzimin e fazës së dytë, brenda datës **3 Shtator 2018**, sipas Udhëzimit nr. 7/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”

Me shkresën nr. 1418 Prot. Hyrës në SHKP datë 06.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, ka sjellë për zbatim “Mbi dokumentimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, me anë të të cilit kërkohet të përgatiten kërkesat buxhetore së hartimit të PBA për *fazën strategjike (I)* duke përdorur sistemin AFMIS sipas formateve që i bashkëngjiten shkresës. Nga auditimi u konstatua se: institucioni i ka përcjellë kërkesat buxhetore për hartimin e PBA 2020-2022 *faza I*, vetëm elektronikisht, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 28.02.2019 që citon: pika 4: Të gjitha njësitë e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA 2020-2022, përmes sistemit AFMIS dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM.

pika 8/3: ... Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, krahas dorëzimit të kërkesave buxhetore në hard copy në Ministrinë përgjegjëse për financat brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, duhet t'i dërgojnë elektronikisht këto kërkesa.

Me shkresën nr. 2867 Prot. datë 28.08.2019 është dërguar *faza teknike (II)* e PBA 2020-2022 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke respektuar afatin e dorëzimit, deri më datë **2 Shtator 2019**, sipas Udhëzimit nr. 8 datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Drejtuësit e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës dhe raportojnë përpara nëpunësit autorizues për realizimin e objektivave për zbatimin e procedurave të përgatitjes dhe hartimit të kërkesave buxhetore, të cilat lidhen me programin e tyre.

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se është përcaktuar deklarata e politikave të programeve, përshkrimin, qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës, planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve si dhe treguesit faktik për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin në vazhdim si dhe për tre vitet e ardhshme buxhetore, në zbatim të Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” ku citohet:

pika 1/8: “Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë:

- a) misionin e njësisë;*
- b) përshkrimin e programeve;*
- c) paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës;*
- d) planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve;*
- e) treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore;*
- f) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me:*
 - i. koston e plotë të projektit;*
 - ii. vlerën e financiar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;*
 - iii. vlerën e parashikuar për t“u financiar në vitin buxhetor;*
 - iv. vlerën e mbetur për t“u financiar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit...*

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 5 (pesë) nënprograme buxhetore, që janë:

1. Programi “Pagesë papunësie”, është një program që gjen zbatim sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.2013 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr.161 datë 23.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia, mbështeten me të ardhura punëkërkuësit e papunë për një periudhë 1 vjeçare.

Programi “**Nxitja e punësimit**”, është një program i cili nëpërmjet sigurimit të punësimit të përkohshëm ose afatgjatë ndikon në zbutjen e nivelit të papunësisë. SHKP zbaton 7 skema/nënprograme të nxitjes së punësimit duke u mbështetur në VKM e poshtëshënuara:

- a. VKM nr. 27 datë 11.01.2012, i ndryshuar;
- b. VKM nr. 48 datë 16.01.2008, i ndryshuar;
- c. VKM nr. 248 datë 30.04.2014, i ndryshuar;
- d. VKM nr. 199 datë 11.01.2012, i ndryshuar;
- e. VKM nr. 64 datë 27.01.2016;
- f. VKM nr. 47 datë 16.01.2008, i ndryshuar;
- g. VKM nr. 873 datë 27.12.2006, i ndryshuar.

3. Programi “Formimi Profesional”, mbështetet në ligjin nr. 8772, datë 29.3.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. Programi “Administrata Qendrore dhe Lokale e SHKP”, mbështetet në ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

5. Programi “Investimet Buxhetore”, mbështetet në kërkesat e SHKP dhe njësisve të varësisë për rikonceptimin e mjediseve të punës dhe rikonstruktimin e zyrave të punësimit.

Planifikimi i fondeve të Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP për vitet 2018 dhe 2019.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “*fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601)*, llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, të përcaktuar në Vendimin e KM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zv/ministrave,dhe nëpunësve të kategorive të tjera...”, i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “*shpenzime të tjera korrente” (602& 606)*. Parashikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për çdo program, është rikonceptuar duke dhënë informacion mbi kategoritë kryesore të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes.

1/b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

- Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **Nr. 19650/3 Prot. datë 30.01.2018** “Mbi detajimin e fondeve të buxhetit të shpenzimeve korente për vitit 2018” drejtuar SHKP, është bërë çelja e buxhetit dhe detajimi i tij, në zbatim e në mbështetje të ligjit nr. 109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018” si dhe Udhëzimit të MFE Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, e ndarë në programe dhe llogari ekonomike me destinacion tregun e punës. Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, me shkresën Nr. 296 Prot. datë 05.02.2018 ka bërë detajimet e buxhetit të 2018, për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DRSHKP), Zyra Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZVSHKP) dhe Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik (DRFPP). Gjatë vitit janë kryer procedurat e transferimeve, rialokimeve, zbatimit të efekteve të akteve normative si dhe aprovimeve nga ana e MFE për përdorimet e fondit të veçantë.

- Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **Nr. 23016/2 Prot. datë 07.02.2019** “Mbi detajimin e fondeve të buxhetit të shpenzimeve korente për vitit 2019”, drejtuar SHKP, është bërë çelja e buxhetit dhe detajimi i tij, në zbatim e në mbështetje të ligjit nr. 99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019” si dhe Udhëzimit të MFE Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, e ndarë në programe dhe llogari ekonomike me destinacion tregun e punës.Me shkresën Nr. 22760/286 Prot. datë 12.02.2019 dërguar Degës së Thesarit, MFE ka bërë detajimin e llogarisë 231, të buxhetit për vitin 2019. Për Administratën Qendrore të SHKP, fondi prej 53.400.000 lekë do të përdoret për rikonstruksion zyra punësimi dhe qendra formimi profesional. Drejtoria e Përgjithshme e SHKP ka bërë detajimet e buxhetit të 2019, për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DRSHKP), Zyra Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZVSHKP) dhe Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik (DRFPP).Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas pesë programeve të miratuara dhe treguesit përfundimtar të buxhetit të viteve 2018 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

➡ Buxheti i vitit 2018, në total nga 2,058 milion lekë që ishte buxheti i miratuar, është realizuar për 1,228 milion lekë, ose në masën 59.7%. Analizuar me buxhetin e rishikuar, nga 1,299 milion lekë, është realizuar 1,228 milion lekë, ose në masën 94.5%, me një mosrealizim prej -71.1 milion lekë. **Konstatohet se, me nivel të ulët realizimi janë programet “nxitje punësimi” në masën 92%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën -22.6 milion lekë) dhe “pagesë papunësie” në masën 96%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 14.9 milion lekë).**

➡ Buxheti i vitit 2019, në total nga 1,720 milion lekë që ishte buxheti i miratuar, është realizuar për 1,480 milion lekë, ose në masën 86%. Analizuar me buxhetin e rishikuar, nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

1,636 milion lekë, është realizuar 1,480 milion lekë, ose në masën 90.4%. E cila rezulton me një mosrealizim prej -240 milion lekë me treguesit e buxhetit të miratuar, ndërsa krahasuar me treguesit përfundimtar, pas alokimeve e transferimeve të fondeve, masa e mosrealizimit është -156 milion lekë. **Konstatohet se, me nivel të ulët realizimi janë në programet “nxitje punësimi” në masën 86%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën -53 milion lekë) dhe “pagesë papunësie” në masën 95%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën -28 milion lekë).**

Buxheti vjetor dhe treguesit e PBA:

Per vitin 2018

Referuar shpenzimeve për vitin 2018, SHKP ka bërë një parashikim në Planifikimin e Buxhetit Afatmesëm (PBA) për vitin 2018-2020, në vlerën **2,264,833,000 lekë**. Sipas ligjit nr.109/2018 “Për buxhetin e vitit 2018” është miratuar në vlerën **2,057,974,000 lekë**. Referuar Aktit Normativ, shpenzimet kanë patur një rënie në vlerën **-206,859,000 lekë**. Realizimi i shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor rezulton **1,298,648,000 lekë**.

Me ligjin nr.109/2017 “Per Buxhetin e vitit 2018” Shërbimit Kombëtar të Punësimit i janë akorduar fonde sipas programeve të paraqitura si më poshtë:

Tabela nr.1

në mijë lekë

Nr.	Programet	PBA	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor	%
		Viti 2018	Plan Fillestar Viti 2018	Plan i Rishikuar Viti 2018	Ndaj totalit (struktur a)
	Planifikim Menaxhim (Administrata Qendrore e SHKP)	90,304	85,279	62,482	5
	Administrata Lokale ShKP	271,363	276,170	274,723	21
	Nxitje Punësimi	690,000	490,000	281,000	22
	Pagesë Papunësie	600,000	800,000	349,682	27
	Formimi Profesional Publik	253,355	257,494	246,730	19
	Investime Buxhetore	346,811	141,031	76,031	6
	Totali i shpenzimeve	2,251,833	2,049,974	1,290,648	100
	Shpenzimet nga të ardhurat	13,000	8,000	8,000	
	Totali	2,264,833	2,057,974	1,298,648	

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Analiza buxhetore: PBA / Buxheti Vjetor i Miratuar / Buxheti Vjetor i Rishikuar 2018:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Buxheti i akorduar për vitin 2018, fillimisht ishte në shumën **2.057.974.000** lekë dhe ka pësuar ndryshime në pakësim fondi për shumën **-759.326.000** lekë. Këto ndryshime kanë sjellë që buxheti i rishikuar i SHKP për vitin 2018, të jetë në shumën **1.298.648.000** lekë. Në mënyrë të detajuar treguesit përfundimtarë të buxhetit pasqyrohen si më poshtë:

➡ **Janë pakësuar fondet në programin e “Pagesës së Papunësisë”** në shumën - 450.318.000 lekë në buxhetin final ndaj atij fillestar, kjo si pasojë e zbatimit të VKM nr.192, datë 09.03.2016 “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”, sipas të cilit, niveli bazë i pagesës së papunësisë përcaktohet në masën 50% të pagës minimale në shkallë vendi; VKM nr.161, datë 21.03.2018 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, ku trajtimi me pagesë papunësie është e lidhur me kohën e kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore.

➡ **Ka pakësim fondesh në programin e “Administratës Qendrore” dhe “Lokale e SHKP”** në shumën -24.244.000 lekë, sipas Aktive Normative nr. 1, 2 të iniciuar nga ana e MFE në dhjetor të vitit 2018.

➡ **Ka pakësim fondesh në programin e “Nxitjes së Punësimit”** në shumën -209.000.000 lekë, si pasojë e ndryshimeve në bazën ligjore të nxitjes së punësimit. Ky pakësim është bërë me Aktet Normative të MFE.

➡ **Ka pakësim fondesh në programin e “Formimit Profesional “** në shumën -10.764.000 lekë, sipas Aktive Normative nr. 1, 2 të iniciuar nga ana e MFE në dhjetor të vitit 2018.

➡ **Realizimi i treguesve të buxhetit** për vitin 2018 rezulton në masën 92.8% e planit vjetor të akorduar. Në mënyrë të detajuar, sipas institucioneve të varësisë realizimi i treguesve të buxhetit paraqitet si në vijim:

në Qendrat e Formimit Profesional janë në nivelin 97% ;

Administrata Qendrore dhe Lokale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit janë realizuar në nivelin 97% ;

në Programin e Nxitjes së Punësimit janë realizuar në nivelin 92% ;

në Programin e Pagesës së Papunësisë në nivelin 96% ;

si dhe Investime Buxhetore kanë rezultuar në masën 82% .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Tabela nr.2

në lekë

Gr	Kap	Nr.Progr	Nr. Artik	EMERTIMI	PBA 2018	Buxheti 2018	Transferime fondesh	Buxheti i rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca	%
				Administrata Lokale ShKP	271,363,000	276,170,840	-1,447,500	274,723,340	267,484,082	7,239,258	97
10	01	10550	600	Paga	198,255,000	198,432,720	-16,390,000	182,042,720	179,212,003	2,830,717	98
10	01	10550	601	Sigurime Shoqerore	33,108,000	33,138,120	-2,488,000	30,650,120	29,751,732	898,388	97
10	01	10550	602	Mallra e sherbime	40,000,000	44,600,000	17,100,000	61,700,000	58,211,185	3,488,815	94
10	01	10550	606	Ndihme familjare			330,500	330,500	309,162	21,338	94
10	01	10550	603	Nxitje punesimi	690,000,000	490,000,000	-209,000,000	281,000,000	258,371,265	22,628,735	92
10	01	10550	606	Pagese Papunesie	600,000,000	800,000,000	-450,317,600	349,682,400	334,784,437	14,897,963	96
10	01	10550		Administrata Qendrore Sh.KP	90,304,000	85,278,660	-22,796,400	62,482,260	60,814,565	1,667,695	97
10	01	10550	600	Pagat	34,427,000	31,944,000	-1,710,000	30,234,000	30,178,683	55,317	100
10	01	10550	601	Sigurimet Shoqerore	5,627,000	5,334,660	-354,000	4,980,660	4,959,667	20,993	100
10	01	10550	602	Mallra e sherbime	50,250,000	48,000,000	-21,100,000	26,900,000	25,308,615	1,591,385	94
10	01	10550	606	Ndihme familjare			367,600	367,600	367,600	0	100
10	01	10550		Formimi Profesional	253,355,000	257,493,672	-10,764,172	246,729,500	238,683,259	8,046,241	97
10	01	10550	600	Pagat	172,540,000	182,589,600	-13,646,320	168,943,280	164,585,958	4,357,322	97
10	01	10550	601	Sigurimet Shoqerore	28,815,000	30,504,072	-1,346,852	29,157,220	27,713,099	1,444,121	95
10	01	10550	602	Mallra e sherbime	52,000,000	44,400,000	4,000,000	48,400,000	46,167,502	2,232,498	95
10	01	10550	606	Ndihme familjare			229000	229,000	216,700	12,300	95
				Te ardhurat nga QFP	13,000,000	8,000,000		8,000,000	5,260,927	2,739,073	66
10	5	10550	600	Pagat		3,000,000		3,000,000	1,200,000	1,800,000	40
10	5	10550	602	Mallra e sherbime	8,000,000	5,000,000		5,000,000	4,060,927	939,073	81
10	5	10550	231	Investime nga t'ardhura	5,000,000			0	0	0	
10	1	10550		Investime buxhetore	348,121,600	141,031,000	-65,000,000	76,031,000	62,188,614	13,842,386	82
10	01	10550	231	Rikonstruksione	65,000,000	32,455,886	-2000000	30,455,886	20,139,307	10,316,579	66
25	01	10550	231	Ndertimi I QFP nr.4	36,900,000			0		0	
25	01	10550	231	Ndertimi i QFP Berat	85,600,000	67,268,000	-61692886	5,575,114	3,073,194	2,501,920	55
				studim projektim	6,000,000			0			
10	01	10550	231	Ndertim sistemi Leje punesimi	40,000,000	0		0			
10	01	10550	231	Blerje paisje informatike & pasije zyre&studim projektim	31,310,800	0		0			
			231	Rikonstruksion ZP	1,310,800	1,307,114	-1307114	0			
10	01	10550	231	Rikonstruksion ZP	82,000,000	40,000,000		40,000,000	38,976,113	1,023,887	97
				Totali	2,266,143,600	2,057,974,172	-759,325,672	1,298,648,500	1,227,587,149	71,061,351	95

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Nga vlerësimi dhe analiza e të dhënave të tabelës së mësipërme për vitin 2018, konstatohet se:

- ➔ Për programin “Planifikim e Menaxhim” të Administratës Qendrore SHKP, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 60,8 milion lekë ose në masën 71.3 % kundrejt planit fillestar dhe 97% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -1.67 milion lekë.
- ➔ Për programin Administrata Lokale ShKP, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 267 milion lekë ose në masën 96.8% kundrejt planit fillestar dhe 97% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -7.2 milion lekë.
- ➔ Për programin “Nxitje Punësimi”, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 258 milion lekë ose në masën 52.6 % kundrejt planit fillestar dhe 92% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -22.6 milion lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Programin i Nxitjes së Punësimit

Viti 2018

Nr.Artik	EMËRTIMI	Fakt 2017	PBA 2018	Buxheti i miratuar 2018	Transferime	Buxheti i rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca	%
603	Nxitje Punësimi	474,950,989	690,000,000	490,000,000	-209,000,000	281,000,000	258,371,265	22,628,735	92

Nga tabela e mësipërme konstatohet se, realizimi i fondit për vitin 2017 është rreth 475 milion lekë dhe ka diferencë të theksuar të fondeve të parashikuara në PBA 2018, buxhetin fillestar me atë të buxhetit të rishikuar.

Për programin “Pagesë Papunësie”, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 335 milion lekë ose në masën 41.8 % kundrejt planit fillestar dhe 96 % kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -14.9 milion lekë. Konstatohet diferencë e theksuar e fondeve të parashikuara në PBA, buxhetin fillestar me atë të buxhetit të rishikuar.

Për programin “Formimi Profesional Publik”, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 238.7 milion lekë ose në masën 92.7 % kundrejt planit fillestar dhe 97% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -8 milion lekë.

Për programin “Investime publike”, shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 62.2 milion lekë ose në masën 44.1 % kundrejt planit fillestar dhe 82% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -13.8 milion lekë. Konstatohet diferencë e theksuar e fondeve të parashikuara në PBA, buxhetin fillestar me atë të buxhetit të rishikuar, si pasojë e transferimit të fondeve me aktet normative, kryesisht fondi i dhënë për ndërtimin e ri të QRFPP Berat.

Viti 2018

Nr. Artik.	Investimi	PBA	Buxheti	Transferim fondesh	Buxheti i rishikuar	Fakti
231	Ndërtimi i QFP Berat	85,600,000	67,268,000	61,692,886	5,575,114	3,073,194

Per vitin 2019

SHKP për vitin 2019 ka bërë një parashikim në Planifikimin e Buxhetit Afatmesëm për vitin 2019-2021, në vlerën **2,033,400,000** lekë. Referuar ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, është miratuar vlera e fondeve prej **1,720,100,000** lekësh. Efektet e aktit normativ të iniciuar nga ana e MFE kanë sjellë një rënie të shpenzimeve në vlerën **-84,050,000** lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor paraqitet në vlerën **1,636,050,000** lekë. Të detajuara sipas programeve, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1

Të dhënat në mijë lekë

Nr.	Programet	PBA	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor	% ndaj totalit (struktura)	% ndaj realizimit
		viti 2019	Plani fillestar viti 2019	Plani i rishikuar viti 2019		
1	Planifikim Menaxhim (Admin.Qendrore SHKP)	81,329	85,000	57,935	4	98
2	Administrata Lokale SHKP	289,603	308,908	301,151	18	94
3	Nxitje Punësimi	650,000	490,000	403,285	25	86
4	Pagesë Papunësie	500,000	500,000	531,940	33	95



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

5	Formimi Profesional Publik	272,768	274,792	280,338	17	94
6	Investime Buxhetore	231,700	53,400	53,400	3	41
	Totali i shpenzimeve	2,025,400	1,712,100	1,628,050		
1	Shpenzimet nga të ardhurat	8,000	8,000	8,000		54
	Totali	2,033,400	1,720,100	1,636,050	100	90

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Nga tabela konstatojmë se në strukturë:

33% e buxhetit të miratuar për SHKP është planifikuar për Programin e “Pagesës së Papunësisë”; 25% për Programin e “Nxitjes së Punësimit”; 17% për Programin e “Formimit Profesional Publik”; 3% për Programin e “Investimeve Buxhetore”; 22% për Programin “Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit” dhe “Administratën Qendrore të SHKP”.

Analiza buxhetore: PBA / Buxheti Vjetor i Miratuar / Buxheti Vjetor i Rishikuar 2019:

Buxheti i rishikuar për vitin 2019 është **1.636.050.000** lekë dhe në krahasim me buxhetin e miratuar paraqitet me pakësim në shumën **-84,050,000** lekë dhe konkretisht sipas programeve dhe zërave rezultojnë:

Në **Programin e “Pagesës së Papunësisë”**, në buxhetin e rishikuar të vitit 2019, kemi shtim fondi në shumën 31,940,453 lekë në krahasim me buxhetin e miratuar.

Në **Programin “Nxitja e Punësimit”** ka pakësim të ndjeshëm të fondeve në vlerën -86,714,782 lekë, bërë me Aktin Normativ nr. 2 datë 02.10.2019.

Programin i Nxitjes së Punësimit

Viti 2019

Nr.Artik	EMERTIMI	Fakt 2018	PBA 2019	Buxheti i miratuar 2019	Transferime	Buxheti I rishikuar 2019	Fakti 2019	Diferenca	%
603	Nxitje Punësimi	258,371,265	650,000,000	490,000,000	-86,714,782	403,285,218	345,954,482	57,330,736	86

Në zërin 606, **ndihmë familjare**, ka shtim fondi në vlerën 950,000 lekë, ku janë reflektuar efektet nga zbatimi i VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të cilat janë përdorur nga institucioni për trajtimet financiare me rastin e daljes në pension të punonjësve, shpërblimeve për rastet e fatkeqësive familjare dhe operacione të ndryshme, të personelit të drejtorisë së përgjithshme të SHKP dhe të institucioneve në varësi të saj.

Në zërin 600/601, **paga dhe sigurime shoqërore** ka pakësim fondi në shumën -10,000,000 lekë në Administratën Lokale të SHKP.

Në zërin 602, **mallra e shërbime**, ka pakësim fondi në vlerën -27,165,102 lekë në Administratën Qendrore të SHKP dhe shtim fondi në vlerën 1,643,485 lekë për Administratën Lokale të SHKP dhe 5,295,946 lekë për Programin e Formimeve Profesionale.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se **programi është prekur nga Aktet Normative, duke çuar në një rënie të ndjeshme krahasuar me PBA si dhe Buxhetin e miratuar me ligj**. Strukturat drejtuese të SHKP dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA dhe në planifikimin vjetor, mënyrat e llogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

1/c. - Realizimi i planit të buxhetit.

Nivelet e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2018:

Të përmbledhura në zërat kryesorë të shpenzimeve, plani buxhetor dhe realizimi i tij për vitin 2018, paraqitet si më poshtë:

Plani buxhetor dhe realizimi faktik Viti 2018
lekë

Të dhëna në

Nr.	Emërtimi i Programeve	Buxheti i rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca	% ndaj totalit	% e realizimit
1.	Administrata Lokale SHKP	274,723,340	267,484,082	7,239,258	22	97
2.	Administrata Qendrore SHKP	62,482,260	60,814,565	1,667,695	5	97
3.	Formimi Profesional	246,729,500	238,683,259	8,046,241	19	97
4.	Nxitje punësimi	281,000,000	258,371,265	22,628,735	21	92
5.	Pagesë Papunësie	349,682,400	334,784,437	14,897,963	27	96
6.	Investime buxhetore	76,031,000	62,188,614	13,842,386	6	82
7.	Të ardhura dytësore nga QFP	8,000,000	5,260,927	2,739,073		66
	Totali	1,298,648,500	1,227,587,149	71,061,351	100%	95%

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Nga tabela konstatojmë se në strukturë:

27% e buxhetit të shtetit janë planifikuar për Programin e “Pagesës së Papunësisë”;
 27% për Programin “Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit” dhe “Administratën Qendrore të SHKP”;
 21% për Programin e “Nxitjes së Punësimit”;
 19% për Programin e “Formimit Profesional”;
 6% për Programin e “Investimeve Buxhetore”.

➡ **Programi i “Pagesës së Papunësisë”** zbatohet nga Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit në bazë të VKM nr.194, datë 09.03.2016 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”. Fondi është realizuar në masën 96%, ose nga 349,682,400 lekë të akorduara nga buxheti i rishikuar janë shpenzuar 334,784,437 lekë. Gjatë vitit 2018 janë trajtuar mesatarisht me pagesë papunësie 2,050 përfitues me një pagë mesatare 13,600 lekë/muaj. Ky numër është ulur në krahasim me vitin 2017 si pasojë e zbatimit të VKM nr.194 datë 09.03.2016, ku masa e trajtimit lidhet me kohën e kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore.

➡ Fondi për **Programin e “Nxitjes së Punësimit”** është realizuar në masën 92%, ose nga 281,000,000 lekë të akorduara nga buxheti i rishikuar janë shpenzuar 258,371,000 lekë. Gjatë zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit janë punësuar 4808 punëkërkues të papunë, ky numër është më i ulët se në vitin 2017.

Nga analiza e shpenzimeve të buxhetit të programit “Nxitje Punësimi” për vitin 2018, **konstatojmë se disa njësi rajonale paraqiten me tregues më të dobët në realizimin e fondeve, të tilla si:**

DRSHKP Fier me nivel realizimi **90%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -6,625,332 lekë;
DRSHKP Korça me nivel realizimi **88%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -1,606,538 lekë;
DRSHKP Kukësi me nivel realizimi **90%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -933,394 lekë;
DRSHKP Lezhë me nivel realizimi **86%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -2,324,957 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

DRSHKP Shkodër me nivel realizimi **86%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -3,143,825; **DRSHKP Vlorë** me nivel realizimi **57%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -5,946,446 që paraqiten të detajuara në tabelën e poshtëshënuar.

Realizimi në nivel rajonal

Të dhëna në lekë

Programi "Nxitje Punësimi"					
	Institucioni	Plan 2018	Fakt 2018	Diferenca Plan-Fakt	% Plan/Fakt vjetor
1	D.R.Sh.K.P Berat	2,884,285	2,760,660	123,625	96
2	Zyra Vendore Kuçova	0	0	0	
3	Zyra Vendore Skrapar	0	0	0	
4	D.R.Sh.K.P Diber	9,023,419	8,908,391	115,028	99
5	Zyra Vendore Bulqize	0	0	0	
6	Zyra Vendore Mati	0	0	0	
7	D.R.Sh.K.P Durres	21,082,850	20,659,098	423,752	98
8	Zyra Vendore Kruja	0	0	0	
9	D.R.Sh.K.P Elbasan	14,923,912	14,921,113	2,799	100
10	Zyra Vendore Gramsh	0	0	0	
11	Zyra Vendore Librazhd	0	0	0	
12	Zyra Vendore Peqin	0	0	0	
13	D.R.Sh.K.P Fier	69,550,208	62,924,876	6,625,332	90
14	Zyra Vendore Lushnje	0	0	0	
15	Zyra Vendore Mallakas	0	0	0	
16	D.R.Sh.K.P Gjirokaster	10,516,693	10,233,785	282,908	97
17	Zyra Vendore Permet	0	0	0	
18	Zyra Vendore Tepelene	0	0	0	
19	D.R.Sh.K.P Korca	13,020,068	11,413,530	1,606,538	88
20	Zyra Vendore Devoll	0	0	0	
21	Zyra Vendore Kolonja	0	0	0	
22	Zyra Vendore Pogradec	0	0	0	
23	D.R.Sh.K.P Kukesi	9,164,078	8,230,684	933,394	90
24	Zyra Vendore Has	0	0	0	
25	Zyra Vendore Tropoje	0	0	0	
26	D.R.Sh.K.P Lezhe	16,680,251	14,355,294	2,324,957	86
27	Zyra Vendore Lac	0	0	0	
28	Zyra Vendore Mirdite	0	0	0	
29	D.R.Sh.K.P Shkoder	20,811,124	17,667,299	3,143,825	85
30	Zyra Vendore M.Madhe	0	0	0	
31	Zyra Vendore Puke	0	0	0	
32	D.R.Sh.K.P Vlore	13,819,884	7,873,438	5,946,446	57
33	Zyra Vendore Delvine	0	0	0	
34	Zyra Vendore Saranda	0	0	0	
35	D.R.Sh.K.P Tirane	79,523,228	78,423,097	1,100,131	99
36	Zyra Vendore Kavaja	0	0	0	
	Shuma ZP	281,000,000	258,371,265	22,628,735	92

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

➡ Programi i “**Formimit Profesional**” është realizuar në masën 97% në krahasim me planin vjetor, ose nga 246,730,000 lekë të planifikuara janë shpenzuar 238,683,259 lekë. Realizimi i zërit “paga dhe sigurime shoqërore” është përkatësisht në masën 97% dhe 95% , ndërsa zëri “mallra e shërbime” është realizuar në masën 95%. Gjatë vitit 2018 janë trajnuar në 10 Qendrat e Formimit Profesional 8770 kursantë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

→ Programi “Investime Buxhetore” për vitin 2018. Zëri (231), është realizuar në masën 82% në krahasim me planin vjetor, ose nga 76,031,000 lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar, janë shpenzuar 62,188,614 lekë. Më i detajuar ky plan paraqitet në tabelën e poshtëshënuar.

Programi i Investimeve Buxhetore

Të dhëna në lekë

Nr.Artik	EMËRTIMI	Fakt 2017	PBA 2018	Buxheti i miratuar 2018	Transferime	Buxheti i rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca	%
231	Rikonstruksione	3,812,940	65,000,000	32,455,886	-2,000,000	30,455,886	20,139,307	10,316,579	66
231	Ndërtimi i QFP nr.4	54,900,000	36,900,000						
231	Ndërtimi i QFP Berat	18,000,000	85,600,000	67,268,000	-61,692,886	5,575,114	3,073,194	2,501,920	55
231	Studim Projektim		6,000,000						
231	Ndërtim Sistemi Leje punësimi		40,000,000						
231	Blerje pajisje informatike & pasije zyre & studim projektim		30,000,000						
231	Rikonstruksion ZP		83,310,800	41,307,114	-1,307,114	40,000,000	38,976,113	1,023,887	97
	Totali	76,712,940	346,810,800	141,031,000	-65,000,000	76,031,000	62,188,614	13,842,386	

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Nivelet e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2019

Të përmbledhura në zërat kryesorë të shpenzimeve, plani buxhetor dhe realizimi i tij për vitin 2019, paraqitet si më poshtë:

Realizimi i buxhetit në Programe

Të dhëna në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programeve	Buxheti i rishikuar 2019	Fakti 2019	Diferenca	% ndaj totalit	% ndaj realizimit
1	Planifikim e Menaxhim (Admin.Qendrore e SHKP)	57,935	57,031	904	4	98
2	Punësimi nga Zyrat e Punësimit	301,152	282,556	18,596	19	94
3	Nxitje Punësimi	403,285	345,955	57,330	23	86
4	Pagesë Papunësie	531,940	504,163	27,777	34	95
5	Formimi Profesional Publik	280,338	263,660	16,678	18	94
6	Investime Buxhetore	53,400	21,857	31,543	1	41
	Totali i shpenzimeve	1,628,050	1,475,222	152,828		
1	Shpenzimet nga të ardhurave	8,000	4,345	3,655		54
	Totali	1,636,050	1,479,567	156,483	100	90

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Në mënyrë më të detajuar, paraqitet kjo situatë e përgjithshme e fondeve të programuara dhe faktike të shpenzuara sipas programeve:

Plani buxhetor dhe realizimi faktik viti 2019
lekë

Të dhëna në

Nr. Artik	EMËRTIMI	Fakti 2018	PBA 2019	Buxheti i miratuar 2019	Transferime buxhetore	Buxheti i rishikuar 2019	Fakti 2019	Diferenca	%
	Administrata Lokale ShKP	267,484,082	289,603,000	308,908,000	-7,756,515	301,151,485	282,555,661	18,595,824	94
600	Paga	179,212,003	196,746,000	200,378,000	-10,000,000	190,378,000	181,754,715	8,623,285	95



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

601	Sigurime Shoqërore	29,751,732	32,857,000	35,530,000		35,530,000	30,289,734	5,240,266	85
602	Mallra e shërbime	58,211,185	60,000,000	73,000,000	1,643,485	74,643,485	69,942,562	4,700,923	94
606	Ndihmë familjare	309,162			600,000	600,000	568,650	31,350	95
603	Nxitje punësimi	258,371,265	650,000,000	490,000,000	-86,714,782	403,285,218	345,954,482	57,330,736	86
606	Pagesë Papunësie	334,784,437	500,000,000	500,000,000	31,940,453	531,940,453	504,163,033	27,777,420	95
	Administrata Qendrore Sh.K.P	60,814,565	81,329,000	85,000,000	-27,065,102	57,934,898	57,031,270	903,628	98
600	Pagat	30,178,683	31,037,000	30,000,000		30,000,000	29,373,377	626,623	98
601	Sigurimet Shoqërore	4,959,667	5,292,000	5,000,000		5,000,000	4,850,475	149,525	97
602	Mallra e shërbime	25,308,615	45,000,000	50,000,000	-27,165,102	22,834,898	22,757,418	77,480	99.7
606	Ndihmë familjare	367,600			100,000	100,000	50,000	50,000	50
	Formimi Profesional	238,683,259	272,768,000	274,792,000	5,545,946	280,337,946	263,660,143	16,677,803	94
600	Pagat	164,585,958	189,217,000	186,622,000		186,622,000	176,781,892	9,840,108	95
601	Sigurimet Shoqërore	27,713,099	33,551,000	31,170,000		31,170,000	29,702,474	1,467,526	95
602	Mallra e shërbime	46,167,502	50,000,000	57,000,000	5,295,946	62,295,946	56,968,777	5,327,169	91
606	Ndihmë familjare	216,700			250,000	250,000	207,000	43,000	83
	Të ardhurat nga QFP	5,260,927	8,000,000	8,000,000		8,000,000	4,345,373	3,654,627	54
600	Pagat	1,200,000	3,000,000	3,000,000		3,000,000	900,000	2,100,000	30
602	Mallra e shërbime	4,060,927	5,000,000	5,000,000		5,000,000	3,445,373	1,554,627	69
231	Investime buxhetore	62,188,614	231,700,000	53,400,000		53,400,000	21,857,257	31,542,743	41
231	Blerje laboratorë për formim profesional		20,000,000						
231	Rikonstruksione	20,139,307							
230	Studim projektim		1,700,000						
231	Ndërtimi I QFP Berat	3,073,194	82,000,000						
231	Blerje pajisje info & pajisje zyre		70,000,000						
231	Rikonstruksion ZP	38,976,113	58,000,000	53,400,000		53,400,000	21,857,257	31,542,743	41
	Totali	1,227,587,149	2,033,400,000	1,720,100,000	-84,050,000	1,636,050,000	1,479,567,219	156,482,781	90

Burimi: Sektori Financiar, SHKP.

➡ Për Programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” Administrata Qendrore e SHKP,

shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 57 milion lekë ose në masën 67% kundrejt planit fillestar dhe 98 % kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -9 milion lekë. Referuar të dhënave të mësipërme, zëri paga (600) është realizuar në vlerën 29,373,377 lekë kundrejt buxhetit të rishikuar /planifikimit me vlerë 30,000,000 lekë ose 98 %. Sigurimet shoqërore zëri (601) është realizuar në vlerën 4,850,475 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 5,000,000 lekë ose 97%. Nga analiza e zërit 602 shpenzime operative rezulton se sipas PBA, kërkesa e subjektit është 45,000,000 lekë. Fondi i alokuar gjatë vitit është në vlerën 22,834,898 lekë dhe realizimi është në vlerën 22,757,418 lekë ose në masën 99.7%. Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor paraqitet në tabelën e poshtëshënuar:

Realizimi i shpenzimeve operative.

Viti 2019

	Emërtimi	PBA 2019	Realizimi	Realizimi	Kap.VI	
--	----------	----------	-----------	-----------	--------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

			(Kapitulli I +VI)	(Fonde buxhetore)	Sponsori zime	Në %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	45,000,000				
6020100	Kancelari	960,000	479,605	479,605		50%
6020200	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim	360,000	194,299	194,299		54%
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës (tonera)	960,000	711,600	711,600		74%
6020500	Blerje dokumentacioni (Shtypshkrime)	960,000	598,560	598,560		62%
6020900	Materiale të vogla rutine	960,000	900,000	900,000		94%
6022001	Elektricitet	1,500,000	1,067,766	1,067,766		71%
6022002	Uje	600,000	291,726	291,726		49%
6022003	Shërbime telefonike internet	800,000	413,698	413,698		52%
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	560,000	245,736	245,736		44%
6022008	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	4,200,000	3,785,874	3,785,874		90%
6022011	Kosto e trajnimit dhe seminare	600,000	0	0		
6022099	Shërbime të tjera	960,000	0	0		
6023100	Karburant për automjet	1,800,000	1,429,932	1,429,932		79%
6023200	Pjese këmbimi	960,000	647,400	647,400		67%
6023300	Siguracioni	120,000	95,984	95,984		80%
6023900	Shpenzime të tjera transporti	120,000	115,200	115,200		96%
6024100	Dieta administrative, brenda vendit	4,800,000	4,411,270	4,411,270		92%
6024200	Dieta administrative, jashtë shtetit	5,000,000	1,979,161	1,979,161		40%
6025300	Mirembajtje godine	960,000	0	0		
6025400	Mirembajtje paisje kondicioneri	960,000	0	0		
6025500	Mirembajtje e aparateve paisjeve	960,000	0	0		
6026100	Shpenzime për qiramarrje objektësh	120,000	90,000	0	90,000	75%
6025200	shpenzime për mirembajtjen e objekteve specifike	1,908,000	1,908,000	1,908,000		100%
6027400	Shpenzime për ekzekutim të vendimeve, të larguarit nga puna	6,000,000	3,095,977	3,095,977		52%
6029002	Shpenz. për Aktivitete Sociale	960,000	884,800		884,800	92%
6029008	shpenzime për tatime taksa	20,000	15,530	15,530		78%
6029099	shpenzime të tjera materiale	6,892,000	370,100	370,100		5%
	TOTALI	45,000,000	23,732,218	22,757,418	974,800	53%

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Në llogarinë shpenzime operative, zëri “shpenzime për qiramarrje objektësh”, vlera 90,000 lekë është sponsorizuar nga Shoqëria x. Po kështu, zëri “shpenzime për aktivitete sociale” vlera 884,800 lekë nuk është realizuar nga fondet e buxhetit të shtetit. por nga Shoqëria x t në vlerën 98,000 lekë dhe nga kontributi i punonjësve për tërmetin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

26 Nëntorit 2019, në vlerën 786,800 lekë. Shoqëria x ka sponsorizuar për buxhetin e vitit 2019, për SHKP vlerën 188,000 lekë.

→ **Për Programin “Administrata Lokale SHKP”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 283 milion lekë ose në masën 91.5 % kundrejt planit fillestar dhe 94 % kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -18.6 milion lekë. Fondet e miratuara për këtë program janë realizuar për zërin “paga” 95%, zëri “sigurime shoqërore” është 85% dhe zëri “mallra e shërbime” 94%.

→ **Programi “Pagesë Papunësie”** zbatohet nga Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit në bazë të VKM nr. 223 datë 19.04.2006 “Për Pagesën e të Ardhurës nga Papunësia” ndryshuar me VKM nr. 194 datë 09.03.2016 ku masa e trajtimit lidhet ngushtësisht me kohën e kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore. Për vitin 2019 shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 504 milion lekë ose në masën 100% kundrejt planit fillestar dhe 95% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -27.8 milion lekë. Numri i pjesëmarrësve që janë trajtuar me pagesë papunësie është mesatarisht 2,871 persona.

→ **Për Programin “Formimi Profesional Publik”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 264 milion lekë ose në masën 96% kundrejt planit fillestar dhe 94% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -16.7 milion lekë. Realizimi i zërit “paga dhe sigurime shoqërore” është në masen 95% , ndërsa zëri “mallra e shërbime” është 91%. Gjatë vitit 2019 janë trajnuar në 10 Qendrat e Formimit Profesional 8.818 kursantë të cilët janë punëkërkues të papunë klientë të Zyrave të Punës.

→ **Për Programin e “Nxitjes së Punësimit”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 346 milion lekë ose në masën 70.6% kundrejt planit fillestar dhe 86% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe me një diferencë prej -57.3 milion lekë. Për këtë program janë mbështetur 2589 punëkërkues të papunë, nga 1700 që ka qenë numri i riplanifikuar për vitin 2019. Këto fonde janë alokuar për projekte sipas:

-VKM nr. 27 datë 11.01.2012 “Për programin e Nxitjes së Punësimit të femrave nga grupet e veçanta”;

-VKM nr. 48 datë 16.01.2008 “Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”;

-VKM nr. 248, datë 30.04.2014 “Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”;

-VKM nr. 199 datë 11.01.2012 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”;

-VKM nr. 64 datë 27.01.2016 “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”;

-VKM nr. 47 datë 16.01.2008 “Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”;

-VKM nr. 873 datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.

Nga analiza e shpenzimit të buxhetit për këtë program, **konstatohet se në shumën e mosrealizimeve prej 57 milion lekë, disa njësi rajonale paraqiten me tregues më të dobët në realizimin e fondeve të tilla si:**

DRSHKP Berat me nivel realizimi **79%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -2,261,927 lekë;

DRSHKP Elbasan me nivel realizimi **83%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -5,101,786 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

DRSHKP Fier me nivel realizimi **76%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -19,702,753 lekë; **DRSHKP Gjirokastrë** me nivel realizimi **87%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -4,136,985 lekë; **DRSHKP Lezhë** me nivel realizimi **75%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -6,098,262 lekë; **DRSHKP Shkodër** me nivel realizimi **83%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -7,051,974 lekë; **DRSHKP Vlorë** me nivel realizimi **61%**, ose me mosrealizim të fondeve prej -8,730,114 që paraqiten të detajuara në tabelën e poshtëshënuar.

Realizimi në nivel rajonal

Të dhëna në lekë

Programi "Nxitje punësimi"					
	Institucioni	Plan 2019	Fakt 2019	Diferenca Plan-Fakt	% Plan-Fakt vjetor
1	D.R.Sh.K.P Berat	10,563,267	8,301,340	2,261,927	79
2	Zyra Vendore Kucova				
3	Zyra Vendore Skrapar				
4	D.R.Sh.K.P Diber	18,067,883	17,491,171	576,712	97
5	Zyra Vendore Bulqize				
6	Zyra Vendore Mati				
7	D.R.Sh.K.P Durres	35,110,385	34,079,429	1,030,956	97
8	Zyra Vendore Kruja				
9	D.R.Sh.K.P Elbasan	29,871,982	24,770,196	5,101,786	83
10	Zyra Vendore Gramsh				
11	Zyra Vendore Librazhd				
12	Zyra Vendore Peqin				
13	D.R.Sh.K.P Fier	81,145,204	61,442,451	19,702,753	76
14	Zyra Vendore Lushnje				
15	Zyra Vendore Mallakas				
16	D.R.Sh.K.P Gjirokastrë	32,457,832	28,320,847	4,136,985	87
17	Zyra Vendore Permet				
18	Zyra Vendore Tepelene				
19	D.R.Sh.K.P Korça	22,960,682	22,945,860	14,822	100
20	Zyra Vendore Devoll				
21	Zyra Vendore Kolonja				
22	Zyra Vendore Pogradec				
23	D.R.Sh.K.P Kukesi	18,895,040	17,452,490	1,442,550	92
24	Zyra Vendore Has				
25	Zyra Vendore Tropoje				
26	D.R.Sh.K.P Lezhe	24,166,576	18,068,314	6,098,262	75
27	Zyra Vendore Lac				
28	Zyra Vendore Mirdite				
29	D.R.Sh.K.P Shkoder	42,621,324	35,569,350	7,051,974	83
30	Zyra Vendore M.Madhe				
31	Zyra Vendore Puke				
32	D.R.Sh.K.P Vlore	22,600,215	13,870,101	8,730,114	61
33	Zyra Vendore Delvine				
34	Zyra Vendore Saranda				



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

35	D.R.Sh.K.P Tirane	64,824,828	63,642,933	1,181,895	98
36	Zyra Vendore Kavaja				
	Shuma ZP	403,285,218	345,954,482	57,330,736	86

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

➡ **Për Programin “Investime buxhetore”**, në zërin (231) janë parashikuar 53,400,000 lekë, të cilat do të përdoren vetëm për rikonstruksione të Zyrave të Punësimit dhe të Qendrave Profesionale, sipas Shkresës Nr. 22760/286 Prot. datë 12.02.2019 me detajimin e fondeve nga MFE, dërguar Degës së Thesarit. Këto fonde janë realizuar në vlerën 21,857,257 lekë ose në masën 41% kundrejt buxhetit të rishikuar. Diferenca e mosrealizimit të fondeve është -31.5 milion lekë. Të analizuara sipas objekteve, investimet paraqiten si më poshtë:

Nr.	Investime buxhetore	Plani 2019	Fakt 2019	%
	Rikonstruksione ZP & QFP	53,400,000		
1.	Rikonstruksion QFP Durrës		8,324,197	16
2.	Rikonstruksion ZP Tropojë		1,021,506	2
3.	Rikonstruksion ZP Kukës		1,493,443	3
4.	Rikonstruksion ZP Berat		9,368,843	17
5.	Rikonstruksion ZP Malësi e Madhe		1,649,268	3
	Totali	53,400,000	21,857,257	41

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Raportet e monitorimit të buxhetit në SHKP.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Auditim mbi saktësinë e hartimit dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, mbi saktësinë e realizimit të produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiorë dhe në vlerë.

Për vitin 2018

Me shkresën Nr. 386 Prot. datë 01.02.2019 SHKP ka dërguar në MFE, Raportin Vjetor të Monitorimit të Buxhetit për vitin 2018. Ky raport i përmban formatet standarde të monitorimit të buxhetit duke paraqitur në relacion ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar në nivel programi apo artikulli, ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë. Por nga auditimi u konstatua se ky raport në paraqitjen e informacionit ka mangësi të cilat përcaktohen në Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ku citohet:

Pika 4 nënpika 49 Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucioni konsiston në:

Paraqitjen e informacionit sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzim duke:

- Plotësuar një listë të përmbajtjes së raportit të monitorimit;*
- Paraqitur “Hyrje”, ku të jepet një përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit;*
- Shoqëruar formatet e përcaktuara me një relacion shpjegues për çdo program, si edhe një relacion përmbledhës për ministrinë/institucionin*
- ... Aty ku është e aplikueshme, raporti të shoqërohet me një opinion të auditimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm (KLSH) të dhënë për këtë qëllim;*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

- Publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo institucioni.

Nga auditimi u konstatua se janë hartuar dhe dërguar në MFE, brenda afateve, raportet periodike 3, 4, 6 dhe 8 mujore të monitorimit mbi realizimin e buxhetit, konstatohet se ka gjetur zbatim Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku citohet:

Neni 65 Monitorimi: “Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm”.
pika 3, nënpika 3.2... Raportet e katërmujorit dhe tetëmuorit duhet të dorëzohen te njësia përgjegjëse për monitorimin, në Ministrinë e Financave deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj; 30 Shtator; ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm.

Nga auditimi i detajuar i raportit të monitorimit 8 mujor, konstatohet mungesa e informacionit shtesë që ka të bëjë me parashikimin e realizimit të pritshëm deri në fund të vitit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ku citohet:

pika 3, nënpika 42 Raporti i monitorimit i 8 mujorit kërkon edhe një informacion shtesë që ka të bëjë me një parashikim të realizimit të pritshëm deri në fund të vitit si dhe për produktet edhe për shpenzimet.

Për vitin 2019

Me shkresën Nr. 416 Prot. datë 31.01.2020 SHKP ka dërguar në MFE, Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2019. Nga auditimi u konstatua se janë hartuar raporte periodike 4 dhe 8 mujore të monitorimit mbi realizimin e buxhetit për SHKP. Konstatohen të njëjtat mangësira në raportet e monitorimit të vitit 2019, ashtu si të vitit 2018. Mungojnë argumentat e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Anekset e raporteve nuk janë të firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Gjithashtu mungon publikimi i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të SHKP.



1/ç. – Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

Për vitin 2018, SHKP ka parashikuar dhe mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 6,234,481 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Tabela nr.1

Të ardhura, viti 2018

Kodi Inst.	Klasifikimi buxhetor	Përshkrimi	Shuma e trashëguar nga viti i mëparshëm	Shuma e Arkëtuar	Pjesa e Institucionit	Rritje autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1010179	7111021	Të ardhura nga lincsimet		1,020,000	0	0	1,020,000	0
1010179	7113010	Të ardhura nga lejet e punës		3,520,000	0	0	3,520,000	0
1010179	7207010	Sponsorizime		1,694,481	1,694,481			0
1010179	4665100	Në ruajtje	2,755,000					
1010179	7780100	Kthime						
Totali			2,755,000	6,234,481	1,694,481	0	4,540,000	0

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Referuar të dhënave të mësipërme, të ardhurat dytësore për vitin 2018, janë krijuar nga dhënia e:

- lincsimet e bizneseve të ndryshme në vlerë 1,020,000 lekë (tarifa 1,000 lekë/biznes);
- lejeve të punës për të huaj në vlerën 3,520,000 lekë (tarifa 6,000 lekë/hera e parë, 3,000 lekë rinovim leje, 10,000 lekë leje e përhershme);
- sponsorizime të ndryshme në vlerën 1,694,481 lekë;
- në ruajtje, vlera 2.755.000 lekë, të ardhura cash nga një inkubator biznesi.

Vlera 4,540,000 lekë është derdhur në buxhet, vlera 1,694,481 lekë është përdorur nga institucioni për trajnime, në qendrat e formimit profesional në rrethe.

Për vitin 2019, SHKP ka parashikuar dhe mbledhur të ardhura dytësore në vlerën 5,561,997 lekë.

Tabela nr.2

Të ardhura, viti 2019

Kodi Inst.	Llog. ekonomike	Pershkrimi	Shuma e trashëguar nga viti i mëparshëm	Arkëtime mujore	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1010179	7111021	Të ardhura nga lincsimet		120,000	1,290,000			1,290,000	
1010179	7113010	Të ardhura nga lejet e punës		305,000	2,730,000			2,730,000	
1010179	7207010	Sponsorizime			723,212	723,212	723,212	0	
1010179	4665100	Në ruajtje	2,755,000						2,755,000
1010179	7207013	Donacion nga punonjësit për tërmetin		786,800	786,800.00	786,800	786,800	0	
1010179	7115500	Penalitet kamatëvonesë			31,985	0		31,985	
		TOTALI		1,211,800	5,561,997	1,510,012	1,510,012	4,051,985	2,755,000

Burimi: Sektori Financiar, SHKP

Referuar të dhënave të mësipërme, të ardhurat dytësore për vitin 2019, janë krijuar nga dhënia e:

- lincsimet e bizneseve të ndryshme në vlerë 1,290,000 lekë;
- lejeve të punës për të huaj në vlerën 2,730,000 lekë;
- sponsorizime të ndryshme në vlerën 723,212 lekë;
- në ruajtje, vlera 2.755.000 lekë, të ardhura cash nga një inkubator biznesi;
- donacion nga punonjësit e institucionit për tërmetin e 26 Nëntorit 2019, në vlerën 786,800 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

- penalitet kamatëvonesë ndaj një biznesi në vlerën 31,985 lekë.
 Vlera 4,051,985 lekë është derdhur në buxhet, vlera 723,212 lekë është përdorur nga institucioni për trajnime, në qendrat e formimit profesional në rrethe.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër, pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020, është dërguar observacioni nga AKPA me nr.prot.183/54 date 04.06.2020 për pikën nr. 1 të Programit të Auditimit, ku shprehet se: Rekomandimi është pranuar nga ana e SHKP(AKPA).

Zbatimi i vendimeve të gjykatës.

Për periudhën objekt auditimi SHKP ka ekzekutuar **16 vendime gjyqësore me vlerë 7,903,037 lekë** për ish-punonjësit e saj, të cilët kanë qenë të punësuar në bazë të Ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Të detajuara paraqiten të dhënat në tabelën e poshtëshënuar:

Tabela nr.1

Në lekë

N r	Emër Mbiemër	Shuma totale	Shuma e përfituar nga punonjësi	Kosto e zyrës përmbartimore	Vendimi i formës së prerë	Data e Likuidimit
1	x	585,250	564,250	21,000	Vendimi nr. 4353 (86-2018-4923), date 27.11.2018	21.05.2019
2	x	836,690	836,690		Vendim nr.75, date 23.01.2019 i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	21.05.2019
3	x	762,317	680,640	81,677	Vendim nr.125, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Apelit Korçë	20.08.2019
4	x	147,600	12,000	27,600	Vendim nr.4377, datë 04.12.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	15.10.2019
5	x	764,120	682,250	81,870	Vendim nr. 857, datë 07.10.2010 i Gjykatës së Apelit Vlorë	28.10.2019
6	x	Pagesë e kryer në vitin 2017	Pagesë e kryer në vitin 2017	36,000	Vendimi nr.116 (823), date 25.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.	19.04.2018
7	x	87,220	87,220		Vendimi nr.90, datë 19.01.2018 të Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	25.04.2018
8	x	3,000	3,000		Vendimi nr.464, datë 09.02.2017 të Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	25.04.2018
9	x	638,187	569,810	68,377	Vendimi 1472 (86-2018-1679), datë 10.04.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tirane	18.09.2018
10	x	624,680	557,750	66,930	Vendimi Nr.591, datë 15.02.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	18.09.2018
11	x	66,000	48,000	18,000	Rekurs nga pala paditese dhe Kunder-rekurs nga SHKP, data 10.04.2018, me nr. 975 prot.	18.09.2018
12	x	599,726	599,726		Vendimi nr. 2039, datë 17.05.2018, i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	18.09.2018
13	x	624,624	557,700	66,924	Vendimi nr.1660, datë 19.04.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tirane	18.09.2018
14	x	258,490	258,490		Vendimi nr. 20-201-464/212, datë 22.05.2018 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër	19.09.2018
15	x	1,177,490	1,177,490		Vendimi nr.286, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Apelit Korçë	21.11.2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

1					Vendimi Nr.3303, datë 25.09.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	11.01.2019
6	x	64,600	64,600			
1		627,04			Vendimi nr.317, datë 21.11.2018 i Gjykatës Administr. të Apelit Tiranë	11.01.2019
7	x	3	559,860	67,183		
	Totali	7,903,037	7,367,476	535,561		

Burimi: Sektori Juridik & Sektori Financiar, SHKP

Nga analiza e tabelës konstatohet: 11 vendime të ekzekutuara me vlerë totale **4,807,060 lekë** që i përkasin vitit 2018 dhe 5 vendime të ekzekutuara me vlerë totale **3,095,977 lekë** për vitin 2019.

Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, SHKP i ka kryer pagesat:

- o në **7 raste**, nëpërmjet ekzekutimit vullnetar dhe
- o në **9 raste**, me urdhër ekzekutimesh të lëshuara nga përmbaruesit privatë.

Nga auditimi konstatohet se, për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore nga ana e institucionit janë paguar kosto shtesë për zyrat përmbarimore, e cila për periudhën objekt auditimi paraqitet në vlerën **535,561 lekë**, shumë kjo që konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit. Gjithashtu konstatohet se, institucioni nuk ka një fond të planifikuar për proceset gjyqësore të cilat nuk kanë marrë formën e prerë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, Neni 29 “Projektbuxheti vjetor”, ku përcaktohet:

Pika 1/a;c.përmban dokumentacionin bazë: a) fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale; c) një tabelë përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tre vitet e ardhshme.

U verifikuan me zgjedhje të rastësishme, zbatimi i vendimeve të gjykatës ku SHKP (pala e paditur), duhet të derdhë shumën në llogari të paditësve. Për ish-punonjësen x gjykata në vendimin e saj, ka kërkuar pagesë me këste brenda 6 muajve nga data që vendimi ka marrë formë të prerë. Pagesa është bërë me urdhër ekzekutimi të lëshuar nga përmbaruesi privat. Institucioni e ka kryer menjëherë pagesën me fondin e planifikuar në zërin “shpenzime të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore” dhe në zbatim të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kreu IX,” ku citon:

Neni 65 “Detyrimi për ekzekutimin e vendimit”. Pika 1 Vendimi përfundimtar i gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë, dhe vendimi për sigurimin e padisë vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor me kërkesën e kreditorit.
Neni 66 “Ekzekutimi i detyrueshëm”. Pika 2 Tarifa për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor nuk parapaguhet nga kreditori. Shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifa për vënien në ekzekutim, konsiderohen pjesë e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat gjykata shprehet në vendimin e saj përfundimtar. Ato llogariten nga përmbaruesi gjyqësor dhe paguhen nga debitori.

Ndërsa për rastin e ish-punonjësit Romir Frashëri, pagesa është kryer vullnetarisht nga institucioni, në marrëveshje midis dy palëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër, pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020, është dërguar observacioni nga AKPA me nr.prot.183/54 date 04.06.2020 për pikën nr. 1 të Programit të Auditimit, ku shprehet se: Rekomandimi është pranuar nga ana e SHKP(AKPA).

Titulli i Gjetjes 1	Mosdërgimi i fazës së I të PBA 2020-2022, në MFE me shkresë zyrtare.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, me shkresën nr. 1418 Prot. Hyrës në SHKP datë 06.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, ka sjellë për zbatim “Mbi dokumentimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, me anë të të cilit kërkohet të përgatiten kërkesat buxhetore së hartimit të PBA për <i>fazën strategjike (I)</i> duke përdorur sistemin AFMIS sipas formateve që i bashkëngjiten shkresës. Institucioni nuk i ka përcjellë kërkesat buxhetore për hartimin e PBA 2020-2022 <i>faza I</i> , në rrugë shkresore.
Kriteri :	Udhëzimi nr. 8 datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”.
Ndikimi/Efekti	Dërgimi vetëm në mënyrë elektronike mund të sillte humbje/mosmarrje të dokumentit nga drejtoria përgjegjëse në MFE, e për pasojë tejkalim afatesh dorëzimi.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia	E Mesme.

Titulli i Gjetjes 2	Analizë të monitorimit të shpenzimeve buxhetore
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, në raportet e monitorimin mungon relacioni shpjegues që tregon mospërputhjen e treguesve të realizuar me planin, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Veprime në kunsërshtim me pikën 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, - Në raportet e monitorimin për 8- mujor mungon informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar. Veprime në kunsërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, Anekset e raporteve nuk janë të firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Gjithashtu mungon publikimi i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare
Kriteri :	Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”
Ndikimi/Efekti	Mos monitorimi i saktë çon në planifikim jo real të fondeve buxhetore Mos firmosja e dokumentit riskon që dokumenti mund të përdoret nga persona të paautorizuar. Mos publikimi i raporteve në faqen zyrtare të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	institucionit ndikon në mungesën e transparencës së institucionit.
Shkaku:	Planifikim të dobët të fondeve buxhetore. Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia	E Mesme.

Titulli i Gjetjes 3:	<i>Pagesat e gjyqëfituesve</i>
Situata:	Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi janë paguar nga buxheti i shtetit shuma prej 7,903,037 lekë. Nga auditimi u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, në 9 raste pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga SHKP, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat. duke rënduar buxhetit.e shtetit me kosto shtesë për tarifatat përmbarimore. në shumën prej 535,561 lekë.
Kriteri:	Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Rritja e kostove duke rënduar buxhetin e shtetit
Shkaku:	Mos planifikimi i fondeve që në fazat e PBA-së, për proceset të cilat janë në procese gjyqësore.
Rëndësia:	I mesëm

2.MBI ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE NË SHËRBIMIN KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në zbatim të pikës nr. 2 të Programit të Auditimit “Auditim Përputhshmërie në Shërbimin Kombëtar të Punësimit” (SHKP këtu e në vazhdim), me nr. Prot 65/2, i ndryshuar, datë 18.03.2020, u shqyrtuan pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP), dokumentacionet si më poshtë:

1) Rregullorja e Brendshme e SHKP-së, “Për organizimin ,feksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së SHKP-së”, miratuar me vendimin nr.29, datë 31.01.2015 të Këshillit Trepalësh Administrativ, e ndryshuar me vendimin nr.3, datë 14.02.2017 të Këshillit Trepalësh Administrativ.

2) VKM Nr.42, datë 17.01.1998 ‘ Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit’, ndryshuar më VKM Nr.263, datë 25.05.2000 dhe VKM Nr.17, datë 10.01.2003, me VKM Nr.195, datë 02.04.2014 dhe VKM Nr.107, datë 23.02.2018.(KAT)-Mbështetur në ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

3) Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

4) Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” është nxjerrë Urdhri nr.2, datë 07.01.2014 i Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhin nr 91, datë 28.10.2011 të Kryeministrit “Për miratinin e strukturës dhe të organikës së SHKP, të ndryshuar”, mbi bazën e të cilit është kompozuar struktura, organika, organizimi dhe i brendshëm si për DP të SHKP ashtu dhe për Drejtoritë Rajonale dhe Zyrrat Vendore të saj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3 “*Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.* Në kuadër të kryerjes së auditimit, u vendosën në dispozicion strukturat për periudhën në auditim, komunikimi me DAP, vendime për organikën, dosjet e personelit, listëpagesat e deklaruara si fizikisht por edhe në mënyrë elektronike, aksesit në sistemin CATS të institucionit etj.

Nga auditimi i ushtruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, u konstatua se:

Administrata e Shërbimit Kombëtar të Punësimit është një shërbim publik autonom, i cili e zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.

1-Këshilli administrativ Trepalësh (KAT) është organi më i lartë vendimmarrës i SHKP. Mandati i anëtarëve të këtij këshilli është trevjeçar dhe miratimi i emërimit të tyre bëhet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Kompetencat dhe detyrat e KAT përcaktohen me vendim të veçantë. KAT funksionon në bazë të Statutit të SHKP, me VKM Nr.42, datë 17.01.1998 ‘ Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit’, ndryshuar me VKM Nr.263, datë 25.05.2000 dhe VKM Nr.17, datë 10.01.2003, me VKM Nr.195, datë 02.04.2014 dhe VKM Nr.107, datë 23.02.2018. Në Kreun IV, Neni 12, 13,14 citohet ‘Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i SHKP-së.’ Ai përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.

Sipas nenit 13 të Statutit të SHKP :Këshilli mbledhet, të paktën, 4 (katër) herë në vit dhe mbledhja e këshillit thirret dhe drejtohet nga kryetari i këshillit administrativ, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të SHKP-së. Nga sa më sipër rezulton se për vitin 2018 janë kryer 4 mbledhje, por për vitin 2019 u konstatua që KAT nuk është mbledhur asnjëherë duke mos kryer dhe ushtruar asnjë nga detyrat dhe kompetencat e tij që konsistojnë në:

- Shqyrtimin e projekteve e akteve ligjore a nenligjore që do të propozohen në lidhje me veprimtarinë e SHKP dhe zbatimin e legjislacionit të punësimit, punës dhe formimit profesional, si dhe rregullore të tjera për veprimtarinë e SHKP;
- Miratimin e rregulloreve të organizmit dhe funksionimit dhe rregulloren financiare .
- Miratimin e bilancit, raportit vjetor, projektbuxhetit për vitin në vazhdim
- Vendosjen për investimet e fondeve
- Vendosjen për kontrata dhe marrëveshje më të rëndësishme të SHKP sipas rregullores përkatëse etj.

Aktualisht sistemi i institucioneve të varësisë të SHKP funksionon në tre nivele, Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit e Zyrat Vendore të Punësimit, dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik të cilat në total kanë një numër punonjësish prej 429 persona të organizuar si vijon:

- Drejtoria e Përgjithshme 36 punonjës
- 12 Drejtori Rajonale të Punësimit 171 punonjës
- 24 Zyra Vendore të Punësimit 112 punonjës
- 10 Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik 110 punonjës

2-U konstatua se rregullorja e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2018 dhe asaj 2019. Si rrjedhojë sipas rregullores së brendshme të saj, SHKP vazhdon të jetë në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ku ndërkohë gjatë vitit ushtrimor të programit të auditimit 2018 dhe 2019 SHKP është në varësi të Ministrisë së Financave dhe e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Ekonomisë. Gjithashtu në nenin 9 të rregullores, ka të parashikuar funksione për “përgjegjës të sektorit”, u konstatua që në strukturë nuk ka një pozicion pune të specifikuar për “përgjegjës të sektorit”, duke veçuar vetëm “sektorin e Financës”, i cili e ka si pozicion të tillë pune, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion. dhe referuar VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3, citohet se:

“Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.”.

pra, sa më sipër cituar mund të themi se ky zinxhir vendimmarrës dhe komunikimi në respektimin e hierarkisë nuk është i plotësuar ndaj dhe çënohen sistemet e kontroleve të brendshme. Bazuar ne Nenin 4, të rregullores së brendshme të SHKP-së, struktura kryesore dhe kompetencat e tyre rregullohen me :

3-Struktura e administratës qendrore me Ligjin Nr.152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”, Statusin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e statusit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar, si dhe në urdhërin Nr.91, datë 28.10.2011 “Për miratimin e stukturës dhe të Organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i ndryshuar.

2-Struktura e Administratës rajonale dhe vendore me Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Statusin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e statusit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar, si dhe në urdhërin Nr.91, datë 28.10.2011 “Për miratimin e stukturës dhe të Organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i ndryshuar.

-Mbi dispozitat ligjore për pagat e punonjësve, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dosjet personale për secilin punonjës.
- Listë prezencat në punë.
- Listëpagesat dhe libri i pagave për periudhën ushtrimore të vitit 2018 dhe 2019.
- Tabela e realizimit të numrit të punonjësve dhe fondin e pagave.
- Vlerësimet 6-mujore të punonjësve për periudhën ushtrimore të vitit 2018 dhe 2019.

1.Emërimi i Drejtoreshës së Përgjithshme të SHKP-së është bërë në bazë të urdhërit të Kryeministrit Nr.65, datë 13.04.2018 me Nr.1036 Prot, datë 13.04.2018 “ Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit 7995, datë 20.09.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Në dosjet e personelit marrë nga sektori i burimeve njerezore u konstatua se data e fillimit të marrëdhënies së punës së Titullarit është **13.04.2018**, ndërsa data e marrjes **së statusit të Nëpunësit Civil është 21.01.2020**. Pra nga sa më sipër Titullari i Përgjithshëm ka vazhduar të ushtrojë detyrën e tij për një periudhë afër 2-vjeçare pa statusin e nëpunësit civil, në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.152/2013 “ Për Nëpunësin Civil”, ndryshuar me Ligjin Nr.178/2014, datë 18.12.2014 ku në nenin 28, citohet se :

1.Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND-në në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe nëpunësit e nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, si dhe për çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

3.Vlerësimi i kandidatëve për pranimin në programin e formimit të thelluar për TND-në në ASPA bëhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, i krijuar sipas nenit 31 të këtij ligji.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

4. Vetëm kandidatët e vlerësuar mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit të konkursit kombëtar, sipas radhës së renditjes dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND, sipas planit vjetor, pranohen të kryejnë studimet në programin e formimit të thelluar për TND-në.

5. Kandidatët, që përfundojnë formimin e thelluar, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, në bazë të renditjes përfundimtare.

Si dhe në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, ku citohet se:

2. Plotësimi i një vendi të lirë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore mund të bëhet vetëm me një anëtar të TND-së. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020, dërguar nga AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me sa më sipër, ju shpreheni se:

1-Ju vëmë në dijeni se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ngritur Këshillin Konsultativ për Punësimin dhe AKPA ka dërguar kërkesën për organizimin e mbledhjes së tij (shkresa me nr. 1331 prot. datë 29.05.2020). 2- Përveç sa është shpjeguar e sqaruar edhe në Observacionin lidhur me Akt-Konstatimet, legjislacioni i nëpunësit civil përcakton saktë etapat dhe hapat që duhen ndjekur për sa i përket procedurave të emërimit dhe ligjshmërisë së nëpunësit TND. Për sa kohë Drejtori i Përgjithshëm e SHKP si nëpunës civil i ka ndjekur dhe zbatuar në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi, gjujkojme se nuk është detyra dhe përgjegjësia e tij tju sqaroj në lidhje me gjetjen tuaj.

1-Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me KAT dhe shpjegimet që ju jepni shprehin të njëjtin opinion me grupin e auditimit të KLSH-së, dhe është e qartë edhe për ju mosefektiviteti në punën tuaj i ardhur si pasojë e mungesës prej një viti të KAT-it i cili ishte organi më i lartë vendimmarrës. Moskrijimi i Këshillit Konsultativ për Punësimin ende në mars të vitit 2020 është përgjegjësi e Ministrisë së Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministrit përgjegjës, të cilën e kemi qartësuar edhe në rekomandimin e lënë në projekt-raport.

2-I njëjti qëndrim është edhe për rregulloren e Institucionit.

3-Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

-Observacioni i dërguar në lidhje me emërimin e Titullarit të Përgjithshëm, nuk pranohet për të njëjtat argumente dhe bazë ligjore të cituara në projekt raport dhe raportin e auditimit.

4.DP/SHKP ka 36 pozicione pune të miratuara. Më konkretisht, përveç pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm janë, **6 punonjës** në Drejtorinë e Programeve dhe Integrimit në Tregun e Punës; **6 punonjës** në Drejtorinë e Shërbimeve të Punësimit dhe Migracionit; **5 punonjës** në Drejtorinë e Informacionit të Tregut të Punës, **12 punonjës** në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, **3 punonjës** në Sektorin e Financës dhe **3 punonjës** në Sektorin e Auditimit të Brendshëm.

Bazuar në dosjet personale të punonjësve u konstatua që pozicioni i punës së punonjësve përputhet me kualifikimin e tyre.

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

legjislationit në fuqi si CV, diplomë, listë notash, çertifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, çertifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj.

Në SHKP, për periudhën objekt auditimi, nga auditimi i dosjeve u konstatua se :

a) Në 90 % të dosjeve të gjithë dokumentacionet ishin fotokopje të panoterizuara .

b) Dosjet personale të nëpunësve janë administruar duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit, nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumentave.

5. Nga auditimi i dokumenteve për pagat e punonjësve të DP SHKP Tiranë, rezulton se për llogaritjet janë bërë në përputhje me bazën ligjore, VKM nr. 545, date 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit” të ndryshuar. ***Nga testet me zgjedhje në lidhje me llogaritjen e pagave dhe caktimin e kategorive të përfitimit, nuk u konstatuan parregullsi.***

6. Nga auditimi i listëpagesave të disa periudhave për administratën e DP të SHKP Tiranë u konstatua se përgatitja e tyre është mbështetur në listë prezencat mujore, të plotësuara nga cdo drejtori apo sektor. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj të paraqitur nga cdo drejtori apo sektor dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Listëpagesat dhe përmbledhëset e pagave janë nënshkruar, nga Përgjegjësi i Sektorit Financiar dhe nga Drejtori i Përgjithshëm. Bashkëlidhur janë listë prezencat dhe urdhrat e brendshëm të drejtuesit të institucionit. Listë pagesat e punonjësve dhe ndarja e pagesave është bërë sipas bankave të nivelit të dytë. Çdo veprim u gjet i finalizuar me një pasqyrë përmbledhëse të pagave si dhe me numrin e punonjësve faktik mujor.

7- U konstatua që libri i pagave, për periudhën objekt auditimi, është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, në të cilin janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shitesa e ndalesa deri në pagën neto.

8. Nga auditimi rezulton se, në SHKP për vitin 2018 fondi i pagave është realizuar në masën 100%, dhe për vitin 2019 në masën 98%.

9- U konstatua që për vitin 2019 janë dy vende vakante pune, duke filluar nga 3-mujori i fundit i vitit 2019.

Institucioni për periudhën objekt auditimi nuk ka tejkaluar numrin e punonjësve të planifikuar për çdo vit kalendarik. Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërme për vitin 2018 dhe 2019 ka ardhur si rezultat i mosplotësisht të numrit të punonjësve, të cilët për arsye shëndetësore janë paguar nga sigurimet shëndetësore në periudha të vecanta të vitit.

Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave.

Tabela .1

000/lekë

Nr	VITI	Nr, Punonjsve		Fondi i pagave		% realizimit
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	
1	2018	36	36	31,944,000	30,178,683	100
2	2019	36	36	30,000,000	29373377	98



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

a) Nga auditimi rezulton se, në SHKP fondi i veçantë, për periudhën e vitit 2018 objekt auditimi është akorduar me vlerë në total **367.600 lekë për dy raste ,nga ku rasti i parë për punonjës in x (kompensim për largim nga shërbimi civil) me vlerën 317,600 lekë dhe rasti i dytë për punonjës in x (ndihmë e menjëhershme,rast sëmundjeje) me vlerën 50,000 lekë , dhe konstatohet se shuma është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr. 826, datë 05.12.2011.**

b)Për periudhën 2019 objekt auditimi, **konstatohet** që fondi i vecantë është akorduar me vlerën totale **50,000 lekë, për punonjës in x (ndihmë e menjëhershme,rast sëmundjeje)**.Për akordimin dhe përdorimin e këtij fondi janë marrë miratimet nga ana e institucionit pranë Ministrisë së Financave.

Në analizë, realizimi i fondit të veçantë,(si për dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, dalje në pension apo ndihma për fatkeqësi) paraqitet si më poshtë:

Tabela .2

Nr.	EMERTIMI	Viti 2018			Viti 2019		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	30,234	30,179	99.82	30,000	29,373	97.91
2	Sig. Shoqërore -601	4,981	4,960	99.58	5,000	4,850	97.00
3	Fondi i veçantë						
3/a	Bonus karburanti						
3/b	Shpërblim për punë të mirë						
3/c	Shpërblim në fund të vitit						
3/d	Për sëmundje				50	50	100
3/e	Për fatkeqësi						
3/f	Për pension						
3/g	Për aktivitete						
	Kompensim per humbje statusi nepunesi civil	368	368	100			

Burimi: Sektori i Finances, SHKP

10-Gjatë periudhës së auditimit, në SHKP u vu në zbatim struktura e re e institucionit me urdhrin e Kryeministrit Nr.172, datë 24.12.2019 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.”, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003,“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili ka urdhëruar që :

1-Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive në nivel qendror të jetë **90** .

2-Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të jetë gjithsej **482**.

3-Urdhëri nr.91, datë 28.10.2011, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4-Më tej me ndryshimet në organikën dhe strukturën e drejtorisë qendrore dhe drejtorive rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, etj.

Struktura dhe organika e re e *Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive* ka në përbërje të saj 9 drejtori , nga ku:

1-Drejtoria e Programeve Aktive dhe Pasive të Tregut të Punës, me 12 punonjës, e cila ka 3 sektorë në përbërje të saj:

a)Sektori i Shërbimeve të Punësimit (4 punonjës); b)Sektori i Programeve aktive dhe pasive të TP(4 punonjës); c) Sektori i Migracionit dhe Marrëdhënieve të punës(3 punonjës)

2-Drejtoria e Menaxhimit të AFP, me 11 punonjës, e cila ka 2 sektorë në përbërje të saj:

a)Sektori i Koordinimit të Ofruesve dhe Zbatimit të Programeve të AFP-së (me 6 punonjës);b)Sektori i Licensimit dhe Monitorimit të Ofruesve Privatë të AFP-së (me 4 punonjës).

3-Drejtoria e Bashkëpunimit me Punëdhënësit, me 8 punonjës, e cila ka 2 sektorë në përbërje të saj:

a)Sektori i Bashkëpunimit me Punëdhënësit Për Punësimin dhe Aftësitë, (me 4 punonjës);b)Sektori i Zbatimit dhe Monitorimit të Fondit Social të Punësimit (3 punonjës).

4-Drejtoria e Planifikimit dhe Performancës,me 17 punonjës, e cila ka 3 sektorë në përbërje të saj:

a)Sektori i Planifikimit dhe i Projekteve (5 punonjës);b)Sektori i Informacionit të Tregut të Punës (4 punonjës);c)Sektori i Sistemit të Performancës të PATP-ve dhe AFP-së (7 punonjës).

5-Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, me 12 punonjës, e cila ka 4 sektorë në përbërje të saj:

a)Sektori i Burimeve Njerëzore (5 punonjës);b)Sektori Juridik (4 punonjës);c)Sektori i Mirëmbajtjes dhe Shërbimeve Mbështetëse (8 punonjës);d)Sektori i Arkiv/Protokollit (3 punonjës).

6-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (5 punonjës)

7-Drejtoria e Auditimit (5 punonjës)

8-Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun (5 punonjës)

9-Drejtoria e Prokurimeve (5 punonjës).

Gjatë periudhës së auditimit si dhe nisur nga situata e krijuar nga *COVID-19*, ende nuk ka filluar ndarja e detyrave esipas funksioneve të reja .

Titulli i Gjetjes:1	Emërimi në detyrë i Titullarit të Përgjithshëm në kundërshtim me Ligjin 152/2013, I ndryshuar me Ligjin nr.178/2014 datë 18.12.2014 “Për statusin e nëpunësit civil”.
Situata:	a)Nga auditimi u konstatua se emërimi i Drejtoreshës së Përgjithshme të SHKP-së është bërë në bazë të urdhërit të Kryeministrit Nr.65, datë 13.04.2018 me Nr.1036 Prot, datë 13.04.2018 “ Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit 7995, datë 20.09.1995, “Për nxitjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	<p>punësimit”, i ndryshuar. Në dosjet e personelit marrë nga sektori i burimeve njëzore u konstatua se data e fillimit të marrëdhënies së punës së Titullarit është 13.04.2018, ndërsa data e marrjes së statusit të Nëpunësit Civil është 21.01.2020. Pra nga sa më sipër Titullari i Përgjithshëm ka vazhduar të ushtrojë detyrën e tij për një periudhë afër 2-vjeçare pa statusin e nëpunësit civil, në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.152/2013 “ Për Nëpunësin Civil”, ndryshuar me Ligjin Nr.178/2014, datë 18.12.2014 ku në nenin 28, pika 5 <i>Kandidatët, që përfundojnë formimin e thelluar, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, në bazë të renditjes përfundimtare, si dhe Titullari ka ushtuar funksioni drejtues në kundërshtim me nenin 30 që citon se: Plotësimi i një vendi të lirë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore mund të bëhet vetëm me një anëtar të TND-së. Çdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.</i></p>
Kriteri :	Ligjin 152/2013, I ndryshuar me Ligjin nr.178/2014 datë 18.12.2014 “Për statusin e nëpunësit civil”; LIGJ Nr. 7995 Date 20.9.1995 “Per nxitjen e punësimit” (ndryshuar me Ligjin Nr. 8444, date 21.0.1.1999, me ligjin Nr. 8862 date 7.03.2002 dhe me ligjin 9570 date 3.7.2006.
Ndikimi/Efekti	Ushtrimi i funksionit publik për një periudhë 2- vjeçare, pa pasur tagrin e nëpunësit të një niveli të lartë drejtues.
Shkaku:	Emërimi në detyrë i Titullarit të Përgjithshëm në kundërshtim me Ligjin 152/2013, I ndryshuar me Ligjin nr.178/2014 datë 18.12.2014 “Për statusin e nëpunësit civil”.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes:2	Mospërditësimi i rregullores së brendshme të SHKP dhe mospërckatimi i zinxhirit hierarkik në kryerjen e detyrave funksionale.
Situata:	<p>a)Nga auditimi u konstatua se me ristrukturimin e ministrive, SHKP është në varësi të MFE-së.Ndërkohë Rregullorja e Brendshme e SHKP-së, “Për organizimin ,funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së SHKP-së, miratuar me vendimin nr.29, datë 31.01.2015 të Këshillit Trepalësh Administrativ, e ndryshuar me vendimin nr.3, datë 14.02.2017 të Këshillit Trepalësh Administrativ, nuk është përditësuar me këtë ndryshim. Si rrjedhojë sipas rregullores së brendshme të saj, SHKP vazhdon të jetë në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.</p> <p>b)Sipas rregullores aktuale, në nenin 9 të saj, ka të parashikuar funksione për “përgjegjës sektori, por në strukturë ekzistuese (për periudhën në auditim) nuk ka një pozicion pune të specifikuar për “përgjegjës të sektorit”, duke veçuar vetëm “sektorin e Financës”, i cili e ka si pozicion të tillë pune, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave në cdo drejtori duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe joefikasitet në punën e kryer..</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Kriteri :	VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3 “ <i>Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</i>
Ndikimi/Efekti	Mosefincencë dhe efektivitet në veprimet e kryera nga administrata.
Shkaku:	Zinxhiri vendimmarrës dhe komunikimi në respektimin e hierarkisë nuk është i plotësuar ndaj dhe çënohen sistemet e kontroleve të brendshme.
Rëndësia	E Lartë.

3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE DHE MONETARE

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet , bankës dhe arkës në lek dhe valutë u konstatua se:

Veprimet e kryera me bankën janë kryer me urdhër shpenzimi dhe janë regjistruar në vazhdimësi kronologjikisht në ditarët përkatës.

Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga personat urdhërues dhe zbatues, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohet qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues.

Urdhër shpenzimet janë të nënshkruar në rregull sipas përcaktimeve ligjore, nga NA Zj.Elira x dhe NZ zj.x.

Veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe “Dokumentimi i vlerave monetare”.

Nëpërmjet bankës janë kryer likuidimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ujë, energji, pagesat ndaj furnitorëve për kontratat e nënshkruara për furnizime dhe shërbime, shpenzime për udhëtime e dieta, etj.

U audituan me zgjedhje urdhër shpenzime të objektit shërbim i brendshëm dieta, pagesa të shërbimit postar, të OSHEE, dhe Ujësjesit, kryer gjatë vitit në periudhën nën auditim.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar, grupi i auditimit ka konstatuar parregullësi në dokumentacionin shoqëruar dhe justifikues i likuidimeve të kryera në total 43 raste për vitin 2018-2019 të cilët paraqiten si më poshtë:

1. Urdhër shpenzimi nr. 239, datë 02/10/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve **për shërbim i brendshëm diete** që i përkasin muajit shtator 2018 në vlerë **270,820 lekë**. Pagesat janë kryer bazuar autorizimeve të ndryshme sipas programeve të punës.

Shërbimi i mbështetur në autorizimin me nr. 2999/2 prot. Datë 13/09/2018, bashkëlidhur listpagesës ka këto dokumentacione justifikues:

Fatura tatimore shitje me nr. 206, pagesë e taksës rrugore Milot-Morinë, datë 17/09/2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Fatura tatimore nr. 164,166 si dhe kuponat tatimore bashkëngjitur lëshuar më datë. 21/09/2018, nga subjekti x shpk, për akomodim fjetje **4 netë x 3000 lekë** me tvsh.

U konstatua se:

Faturat tatimore nr. 164 me vlerë **12,000 lekë**, Nr 166 me vlerë **12,000 lekë**, nuk janë firmosur nga nëpunësit e SAB, x, x. Veprim jo në përputhje me kuadrin rregullator përkatës i cili do citohet në rubrikën e gjetjes. Vlera në total **24,000 lekë**.

Me shkresë nr. 3066 prot datë. 18/09/2018, Program pune në rajonin Pogradec, Korçë nga data. 26/09/2018 deri më 29/09/2018, dhe personat që do marrin pjesë. Më pas ka dalë urdhër shërbimi i detajuar dhe intenerari i lëvizjes. Grupi i punës i përbërë nga: **x, x, x, x, x, x si dhe shoferi x.**

Në urdhër shërbim konstatohet një devijim nga programi i punës në të cilin nuk ishte parashikuar qyteti Përmet, ku për këtë shërbim janë trajtuar me diete punonjësit e mësipërm. Në faturën tatimore të shitjes me nr.1069 datë.27/09/2019 lëshuar nga subjekti “Hotel-x” në vlerë **21,000 lekë** në total nuk ka asnjë firmë në faturën tatimore për që vërteton këtë shërbim. Fatura tatimore nr.643 dt.28/09/2018 lëshuar nga OE x shpk në rubrikën blerësi në emrin e (x), ndonëse i referohet **zj. x** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse. Ndërsa fatura tatimore e shitjes me **nr.953** ka mbivendosje pasi është lëshuar po me datë 28/09/2018 nga subjekti, x shpk në Pogradec, e vërtetuar dhe me kuponin tatimor bashkëlidhur, ku për këtë shërbim fatura duhej të ishte e dt.**29/09/2018** mbas marrjessë shërbimit akomodim. Vlera e faturës tatimore të shitjes është në vlerën **3000 lekë** për një natë akomodim.

Fatura tatimore e shitjes me **nr.642** lëshuar nga subjekti x në rubrikën blerësi në faturë, emri i personit (x) që ka marrë këtë shërbim nuk korrespondon me listën e grupit të punës ndonëse i referohet dhe i është paguar, nëpunësit zbatues të SHKP x. Vlera e faturës **3000 lekë** për një natë akomodim. Rezulton se dhe për nëpunësit e më poshtëm ka mbivendosje lidhur me shërbim e marrë po në të njëjtën ditë në qytetin e Pogradecit, lëshuar nga subjekti x shpk. Emrat e punonjësve dhe nr i faturave tatimore përkatëse vijnë si më poshtë.

- 1) **x.** Fatura tatimore nr.954 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- 2) **x.** Fatura tatimore nr.955 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- 3) **x.** Fatura tatimore nr.957 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- 4) **x.** Fatura tatimore nr.958 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- 5) **x.** Fatura tatimore nr.959 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**

Në total janë likuiduar 78,000 lekë.

Urdhër shpenzimi nr. 268, datë 22/10/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt: **shërbim i brendshëm diete** që i përkasin muajit shtator 2018 në vlerë **209,000 lekë**.

Janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së me shërbim, brenda vendit mbështetur në programin nr.3338 datë. 05/10/2018 për arsye pune në rajonin Fier. Zj/ x specialiste në DSHB pranë SHKP. Data e nisjes datë. 10/10/2018 deri më 12/10/2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.14 dt.12/10/2018 e lëshuar nga subjekti Hotel x ka bashkëlidhur. *Konstatohet se nuk është konfirmuar me firmë nga nëpunësja e mësipërme për kryerjen e këtij shërbimi.* Vlera e faturës **6,000 lekë**.

Për shërbimin e kryer në Tropojë, bazuar në programin nr.3455 prot, më dt.15/10/2018 ku është përcaktuar intenerari i lëvizjes, nisja nga Tirana më dt 16/10/2018 – mbërritja në Tropojë më dt.16/10/2018. Nisja nga Tropoja më dt.18/10/2018 mbërritja në Kukës më dt.18/10/2018. faturat tatimore të shitjes të lëshuara me dt. 18/10/2018 nga subjekti x rezultojnë të jenë të pa firmosura dhe vetem me një kupon tatimor me nr. 00000009, i cili është përmbledhës, Arsye e cila na jep siguri të kufizuar në kryerjen e këtij shërbimi në rrethin e Tropojës. Ndërsa ato të akomodimit në Kukës janë të firmosura nga secili punonjës dhe me kupona të vecantë për secilën faturë tatimore në mënyrë të rregullt dhe që japin siguri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

të arsyeshme për kryerjen e veprimeve. Emrat e punonjësve dhe numrat e faturave tatimore vijnë si më poshtë.

- 1) x, fatura tatimore nr. 15 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë**
- 2) x, fatura tatimore nr.16 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë**.
- 3) x, fatura tatimore nr.20 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë**.

Në total janë likuiduar 24,000 lekë.

3. Urdhër shpenzimi nr. 220, datë.13/09/2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, shërbim i brendshëm diete që i përkasin muajit gusht- shtator 2018 në vlerë **121,000 lekë**.

Janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së me shërbim, brenda vendit mbështetur në programin nr.2480 datë.03/08/2018, autorizim nr. 2480/1, dt.03.08.2018, program pune nr.2820 dt.30/08/2018, program pune nr.2791 dt.29/08/2018, autorizim nr.2791/1 dt.29/08/2018, autorizim nr.2820/1 dt.30/08/2018.

U konstatua se:

Për shërbimin në rajonin Shkodë–Mirditë sipas programit nr.2480 datë.03/08/2018, evidentohen fatura tatimore shitje të lëshuara nga subjekti “x” për shërbimin akomodim (fjetje), të pa firmosura nga nëpunësit si vijon.

- 1)x, fatura tatimore nr.54 dt.10/08/2018 në vlerë **6,000 lekë**.
- 2) x, fatura tatimore nr.53 dt.10/08/2018 në vlerë **6,000 lekë** për dy netë akomodim.

Në total **12,000 lekë**.

4. Urdhër shpenzimi nr.149, datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **19,500 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohen fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuara për nëpunësit si vijon.

x Fat.nr.52 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë**.

x Fat.nr.51 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë**.

5. Urdhër shpenzimi nr.150, datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **6,500 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohen fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuar për nëpunësin si vijon.

x faturë tatimore nr.50 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë**.

6. Urdhër shpenzimi nr.151 datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **3,000 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohet fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuar për titullarin e SHKP **Zj. x**, faturë tatimore nr.48 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë**.

U konstatua se: Për USH nr. **149,150,151** pagesa është kryer për datën **16.06.2018 ditë e shtunë**. Në kundërshtim me VKM 997/ 2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”. **Në total janë likuiduar 15,000 lekë.**

7. Urdhër shpenzimi nr.122 datë 29.05.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **21,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr.1427/1 dt.17.05.2018 dhe programit nr.1239 dt.30.04.2018 në rajonin Berat. Faturat tatimore për akomodim janë lëshuar më dt.26.05.2018 e cila sipas kalendarit rezulton ditë e shtunë.

Fatura tatimore nr. 28 për nëpunësin x në vlerë **3,000 lekë**, fatura tatimore nr. 508 për **Zj. x** në vlerë **3,000 lekë**.

U konstatua se:

Nëpunësit të cilët figurojnë në autorizimin për këtë shërbim janë paguar në kundërshtim me VKM 997 dt.10.12.2010 pika 1. Punonjësit e njëjtit të qeverisjes së përgjithshme, të cilët



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit.

Vlera totale 11,000 lekë. E ndarë 6,000 lekë fjetje + 5,000 lekë dietë.

8. Urdhër shpenzimi nr.112 datë 14.05.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **16,500 lekë**, bazuar në programin me nr.1254/1 dt.02.05.2018 të angazhimit për auditim në datat 3-4 maj 2018 në DRP Gjirokastrë. Fatura tatimore është lëshuar më dt.05.05.2018 ditë e shtunë. Ndonëse programi është përcaktuar më datë 3 dhe 4, nëpunësi duhej trajtuar vetëm për një natë fjetje sipas përcaktimeve ligjore me VKM 997 dt.10.12.2010 pika 1. *Punonjësit e njësisve të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit.*

Pika 3. Për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, punonjësit i përballohen shpenzimet e mëposhtme: a) Dietë ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet: i) në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës; ii) në masën 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë.

9. Urdhër shpenzimi nr. 222 datë, 13.09.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** për muajin shtator në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 2791, dt.29.08.2018, në rajonin e Beratit.

U konstatua se: Fatura tatimore nr.77 dt. 08.09.2018 për 2 netë akomodim si dhe urdhër shërbimi nuk janë firmosur nga përfituesi i këtij shërbimi, titullar i institucionit **zj.x**

10. Urdhër shpenzimi nr. 230,231,232 datë. 21.09.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **11,000 lekë për secilin urdhër shpenzimi**, bazuar në programin e punës nr.2892, dt.06.09.2018, takime pune në rajonin Dibër. Faturat tatimore të shitjes, me nr 96,98,99 për këtë shërbim janë të modelit të thjeshtë pa tvsh.

U konstatua se: Mbas verifikimit në faqen e QKB rezultoi se subjekti që ka lëshuar këtë faturë ushtron veprimtari Bar-Kafe dhe nuk rezulton të ketë aktivitet për akomodim apo hoteleri. Bazuar mbi këto fatura janë kryer pagesat për, **Zj. x** titullar i SHKP si dhe për punonjësin **x** dhe **x** specialiste në SHKP.

11. Urdhër shpenzimi nr.241 datë 02.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3065, dt.18.09.2018 në rajonin Kukës.

U konstatua se:

Fatura tatimore **nr.159** dt.21.09.2018 lëshuar nga subjekti akomodues **x** shpk, nuk është firmosur nga nëpunësi që është paguar për këtë shërbim dhe konkretisht **zj. x** titullar i SHKP.

12. Urdhër shpenzimi nr.252, datë, 09.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **21,000 lekë në total**, bazuar në programin e punës nr.3299, dt.02.10.2018, takime pune në rajonin Shkodër, Malësi e Madhe nga data 03.10.2018 deri më 06.10.2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.18 dt.04.10.2018 lëshuar nga subjekti akomodues **x** me Nipt..... ka të bashkëlidhur kuponat tatimorë të datës 05.10.2018 me nr. 8,9,10 në shumën **9,000 lekë total**. Fatura nuk korespondon me datën e prerjes së kuponit tatimor. Nuk është e firmosur nga përfituesi i paguar për këtë shërbim, **zj. x** titullar i SHKP-së. Poashtu llogaritja për tre netë me faturë të datës 04.10.2018 dhe kupon të datës 05.10.2018 e bëjnë këtë veprim të pajustificuar për pagesë. Fatura tatimore dhe kuponi duhet të kenë të njëjtën datë dhe ti përkasin datës 06.10.2018 sipas programit të punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

13. Urdhër shpenzimi nr.253 datë, 09.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **21,000 lekë** në total, bazuar në programin e punës nr.3299, dt.02.10.2018, takime pune në rajonin Shkodër, Malësi e Madhe nga data 03.10.2018 deri më 06.10.2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.20 dt.04.10.2018 lëshuar nga subjekti x me Nipt..... ka të bashkëlidhur kuponat tatimorë të datës 05.10.2018 me nr. 14,15,16 në shumën **9,000 lekë total**. Fatura nuk korespondon me datën e prerjes së kuponit tatimor. Nuk është e firmosur nga përfituesi i paguar për këtë shërbim, shoferi i SHKP-së x. Poashtu llogaritja për tre netë me faturë të datës 04.10.2018 dhe kupon të datës 05.10.2018 e bëjnë këtë veprim të pajustificuar për pagesë. Fatura tatimore dhe kuponi duhet të kenë të njëjtën datë dhe ti përkasin datës 06.10.2018 sipas programit të punës.

14. Urdhër shpenzimi nr.291 datë. 09.11.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Shërbim i brendshëm* në vlerë **192,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3877 dt.31.10.2018 në rajonin Shkodër-Pukë si dhe në programin me nr 3583 dt.29.10.2018 në rajonin Korçë-Pogradec-Kolonjë. Urdhër shërbimi për rrethin e Pukës ka përcaktuar datat 05.11.2018 si mbërritje dhe dt.07.11.2018 si kthim.

U konstatua se: Fatura e thjeshtë tatimore me nr. 32 e lëshuar nga subjekti akomodues x me nipt. ka të përmbledhur emrat e personave të cilët supozohet të jenë akomoduar në këtë njësi akomodimi. Emrat e nëpunësve figurojnë në një faturë të vetme ku asnjëri prej tyre nuk ka firmosur për të vërtetuar marrjen e këtij shërbimi.

15. Urdhër shpenzimi nr.292 datë.14.11.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3917 dt.06.11.2018 vizitë pune në rajonin Gjirokastrë nga dt.08.11.2018 deri më dt.10.11.2018. Fatura tatimore nr.134 lëshuar nga subjekti më dt.09.11.2018 nga subjekti akomodues x, ka bashkëlidhur kuponin tatimorë nr.2 të lëshuar me dt.09.11.2018.

U konstatua se: Në përshkrimin e faturës ka 4 netë akomodim për titullarin e SHKP dhe shoferin x. Ka mospërputhje me datat e planifikuara të shërbimi datën e lëshimit dhe firmën e punonjësve.

16. Urdhër shpenzimi nr.293 datë 14.11.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **77,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3917 dt.06.11.2018 vizitë pune në rajonin Gjirokastrë nga dt.08.11.2018 deri më dt.10.11.2018. Fatura tatimore nr.1248 lëshuar nga subjekti më dt.09.11.2018 nga subjekti Hotel x shpk, ka bashkëlidhur kuponin tatimorë nr.2 të lëshuar me dt.09.11.2018.

U konstatua se: Në përshkrimin e faturës ka mospërputhje në përshkrim, datat e planifikuara të shërbimit, datën e lëshimit dhe firmat e punonjësve të cilët janë paguar për këtë shërbim. Sipas listëpagesës për këtë shërbim janë paguar, **x, x, x, x**.

17. Urdhër shpenzimi nr. 305 datë 21/11/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **308,000 lekë**.

Bazuar në programin e punës nr.3963 dt.12/11/2018, vizitë pune në rajonin e Korçës nga dt.14/11/2018 deri më dt.17/11/2018. Janë përcaktuar për këtë shërbim 26 punonjës të SHKP. Sipas listëpagesës për këtë shërbim është paguar titullari i SHKP **zj. x** në shumën **16,500 lekë** për tre ditë-netë shërbim.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes nr.30 dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.4, lëshuar nga subjekti x Korçë, fatura tatimore ka të listuar 13 emra punonjësish të përmbledhur për 3 netë akomodim dhe vlera në faturë dhe kupon paraqitet e përmbledhur në total e jo e ndarë për secilin punonjës. Në rubrikën blerësi, nuk ka firmë që konfirmon fjetjen në këtë njësi shërbimi akomoduese.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

28. Urdhër shpenzimi nr. 306 datë 21/11/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **308,000 lekë**.

Bazuar në programin e punës nr.3963 dt.12/11/2018, vizitë pune në rajonin e Korcës nga dt.14/11/2018 deri më dt.17/11/2018. Janë përcaktuar për këtë shërbim 26 punonjës të SHKP.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes **nr.30** dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.4, lëshuar nga subjekti x. Fatura ka të listuar 13 emra punonjësish për 3 netë akomodim dhe vlera në faturë dhe kupon paraqitet e përmbledhur në total e jo e ndarë për secilin punonjës. Në rubrikën blerësi, nuk ka firma të punonjësve, emrat e të cilëve vijojnë si më poshtë.

x, x, x, x, x, x, x, x, x, x, x, x, x.

Fatura tatimore e shitjes **nr.786** dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.21, lëshuar nga subjekti x shpk. Fatura tatimore ka vetëm një emër punonjësi, x dhe paraqitet në vlerën **90,000 lekë** total. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit ka listë pagesën dhe fotokopje të fatures **nr.786** me emra të punonjësve të cilët janë paguar për shërbimin.

Emrat e punonjësve në fotokopjet e faturës tatimore nr.786 janë mbivendosur me stilolaps për efekt pagese. Emrat e punonjësve që nuk konfirmojnë shërbimin janë, **x, x, x, x, x, x, x, x.**

19. Urdhër shpenzimi nr. 352 datë 24.12.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm* në vlerë **39,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018, me objekt, takime pune në zyrat e punësimit Has, Tropojë dhe Kukës parashikuar nga dt. 17.12.2018 deri më dt.20.12.2018. Sipas listëpagesës janë paguar për këtë shërbim dy punonjës, **x** dhe **x**. Bashkëlidhur urdhërshpenzimit, fatura tatimore me nr.12 dhe nr 13 lëshuar më dt.20.12.2018 si dhe kuponat nr.12 dhe 13.

U konstatua se:

Faturat tatimore të lëshuara nga subjekti x shpk, njësi akomodimi në qytetin e Kukësit, nuk janë të firmosura nga punonjëset e mesipërme për ti dhënë vërtetësi marrjes apo kryerjes së këtij shërbimi.

20. Urdhër shpenzimi nr. 353 datë. 24.12.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm* në vlerë **21,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018 me objekt, takime pune në zyrat e punësimit Has, Tropojë dhe Kukës parashikuar nga dt. 17.12.2018 deri më dt.20.12.2018. Sipas listëpagesës është paguar për këtë shërbim titullari i SHKP, **zj. x** në shumën **21,000 lekë**. Bashkëlidhur urdhërshpenzimit, fatura tatimore me nr.11 lëshuar më dt. 20.12.2018 si dhe kuponi tatimor nr.12

U konstatua se:

Faturat tatimore e lëshuar nga subjekti “x” shpk, njësi akomodimi në qytetin e Kukësit, nuk është e firmosur nga titullari i SHKP për ti dhënë vërtetësi marrjes apo kryerjes së këtij shërbimi. Vlera në total e faturës tatimore është **9,000 lekë** .

21. Urdhër shpenzimi nr.355 datë. 24.12.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **244,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018 në rajonin Kukës, programit nr. 4493 dt.17.12.2018 në rajonet Fier, Vlorë, dhe programit nr.4533 dt.19.12.2018, në rajonin e Përmetit.

U konstatua se:

Për këto shërbime evidentohet se disa fatura tatimore kanë parregullësi, për nëpunësit si vijon.

Fatura nr.1244 dt.21.12.2018 e pa firmosur nga nëpunësi **x** në vlerë **6,000 lekë**.

Fatura nr.308, dt.25.12.2018, **x** në vlerë **6,000 lekë**, fatura nr.311 për punonjësen **x** në vlerë **6,000 lekë**, fatura nr.310 për nëpunësin **x** në vlerë **6,000 lekë** nuk korespondojnë me datën e kryerjes së shërbimit i cili sipas urdher shërbimit fillon me dt.19.12.2018 dhe mbaron me dt.21.12.2018.

Banka 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

1. Urdhër shpenzimi nr.12 datë 29.01.2019 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **181,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr.23 dt.04.01.2019 me objekt, vizita pune e monitorim mbi rikonstruksionet e kryera në zyrat e punësimit Gramsh, Lushnjë, Kucovë dhe Fier nga data 08.01.2019 deri më 10.01.2019. Programit të punës nr.162 datë 17.01.2019 me objekt takime pune, vizita monitoruese të planit të investimeve për vitin 2018 në Fier, Përmet, Kolonjë, Korçë dhe ZP Pogradec nga data 21.01.2019 deri më datë.24.01.2019. Në listëpagesë figurojnë 8 punonjës të cilët janë trajtur me diete në këto shërbime.

U konstatua se:

Në shërbimin e kryer në Përmet fatura tatimore e shitjes me nr.12 lëshuar më dt. 23.01.2019 nga subjekti “x”, ka bashkëlidhur kuponin tatimor nr.1 i printuar më dt.22.01.2019 në vlerë **54,000 lekë** total për akomodim. Fatura ka të renditur 9 punonjës si vijon, **x, x, x, x, x, x, x, x, x**. Në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë të përmbledhur emrat e punonjësve në një faturë të vetme me tre firma në fund. Kuponi tatimorë nuk përputhet me datën e faturës si dhe ka vetëm një cmim për 1 dhomë hoteli në vlerë të përgjithshme **54,000 lekë**. Bashkëlidhur ka po të njëjtën faturë tatimore të fotokopjuar të pa firmosur në rubrikën blerësi, fakt që na jep siguri të arsyeshme që firmat janë hedhur në një kohë tjetër dhe jo në vend, **fakt i cili na jep siguri të arsyeshme për kryerje fiktive të këtij shërbimi.**

2.Urdhër shpenzimi nr.27 dhe 28 datë 14.02.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **77,000 lekë** në total, bazuar në programin e punës nr.387 dt.01.02.2019 me objekt, kryerjen e vizitave monitoruese në rajonin Berat, Kucovë, Skrapar. Afati i parashikuar i kryerjes së shërbimit, nga dt.04.02.2019 deri më dt.06.02.2019. Sipas listë pagesave janë paguar nëpunësit si vijon, **x, x, x, x, x**.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.38 lëshuar nga subjekti **x** Kucovë në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë të përmbledhur emrat e punonjësve në një faturë të vetme, poashtu dhe në kuponin tatimor ka përshkrim cmim vetëm për një dhomë hoteli në vlerë të përgjithshme **54,000 lekë**. Elementët dhe parregullësitë e hasura japin siguri të arsyeshme për mos kryerjen e plotë të shërbimit, më saktë akomodimin.

3. Urdhër shpenzimi nr.45 datë. 07.03.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në autorizimin nr.494/1 dt.12.02.2019 me objekt, takime pune në rajonin e Vlorës.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes me nr.1111/46 me nr serial. 711182722 lëshuar më datë.01.03.2019 nga subjekti akomodues Hotel x nuk është e firmosur nga **zj. x**, titullar i SHKP, nuk konfirmon fjetjen në këtë njësi akomoduese.

4. Urdhër shpenzimi nr.46 datë. 07.03.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në autorizimin nr.494/1 dt.12.02.2019 me objekt, takime pune në rajonin e Vlorës.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes me nr.1111147 me nr serial. 711182723 lëshuar më datë.01.03.2019 nga subjekti akomodues Hotel x nuk është e firmosur nga **zj. x** nuk konfirmon fjetjen në këtë njësi akomoduese.

Vlera prej **6,000 lekë** në total për dy netë fjetje.

5. Urdhër shpenzimi nr. 65 datë. 02.04.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **297,000 lekë**, **Urdhër shpenzimi nr.66** datë. 02.04.2019 likujduar në vlerë **33,000 lekë** si dhe **Urdhër shpenzimi nr.67**, datë. 02.04.2019 likujduar në vlerë **66,000 lekë janë** bazuar në programet e punës nr.936 dt.20.03.2019 programit nr.936/1 dt.20.03.2019, në rajonet Kukës, Lezhë, Dibër, autorizimit nr.936/2, me objekt kryerjen e analizave vjetore të punës në rajonin Gjirokastër, Korçë programit nr.811 dt.07.03.2019, vizita monitorimi në rajonin Kukësit , ZP Has e Tropojë. Program nr.875 datë.13.03.2019 në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

rajonet Fier, Berat, Vlorë. Janë trajtuar me dietë punonjës sipas listëpagesës në këto urdhër shpenzimi.

U konstatua se: Faturat tatimore e shitjes me nr. 254 datë.29.03.2019 lëshuar nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim, nuk është firmosur nga punonjësja **x**. Vlera e faturës **6,000 lekë** është e pa konfirmuar me firmë. Më poshtë paraqiten emrat e punonjësve dhe faturat tatimore të cilat paraqesin të njëjtën parregullësi.

1. x, Fatura nr.29 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë**. Fatura nr.255 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 416 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

x, fatura nr 253 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

3. x, fatura nr.23 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.271 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor. Fatura nr. 1111185 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

4. x, fatura nr.28 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.272 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 1111185 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

5. x, Fatura nr.273 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.16 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

6. x, Fatura nr.268 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.18 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

7. x, Fatura nr.269 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

8. x, Fatura nr.15 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

9.x, Fatura nr.13 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues x shpk, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.60 lëshuar më datë. 28.03.2019 nga subjekti akomodues x shpk, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

10. x, Fatura nr.19 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues x shpk, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.61 lëshuar më datë. 28.03.2019 nga subjekti akomodues x, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

11. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues x, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues x, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 63 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues x në Vlorë, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.21 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti x në Bulqizë, me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.28 lëshuar më datë.30.03.2019 nga subjekti **Hotel x** në Gjirokastër me vlerë **6,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë.

12.x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues x **Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues x, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr.26 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti x në Bulqizë me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.251 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr. 1111187 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

13. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues x **Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 416 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues x, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

14. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues x **Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

15. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues x **Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

16. x, Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues x, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor po ashtu përmbledhës. Fatura nr.252 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.27 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti x në Bulqizë, me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr. 1111187 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

6. Urdhër shpenzimi nr. 93 datë. 03.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **22,000 lekë** për **1** punonjës. Shërbimi është kryer bazuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

programin nr. 1279 dt.18.04.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.26.04.2019-27.04.2019 dhe programit nr.1168 dt.11.04.2019 me destinacion Rajonin e Kukësit, Has, Tropojë nga dt.16.04.2019-18.04.2019, programit nr.1198 dt.15.04.2019 me destinacion rajonin e Korçë-Pogradec.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. Serial -72888733 dt.18.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues x shpk Kukës për dy netë fjetje, në vlerë 6,000 lekë nuk është e firmosur. Fatura me nr.162 dt.24.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues x, Pogradec është përmlledhëse me 7 emra dhe e pa firmosur. Fatura me nr.246 dt.27.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk, Shkodër nuk është firmosur. Faturat e mësipërme nuk janë firmosur nga Zj. x, titullar i SHPK.

7. Urdhër shpenzimi nr.94 datë 03.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **udhëtim i brendshëm** në shumën **55, 000** lekë, bazuar në programin e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019 si dhe programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **3** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.335 dt.27.04.2019 nga subjekti x në rrethin e Fierit rezulton të jetë fotokopje bashkëlidhur urdhër shpenzimit. Fatura nuk përputhet me datën e kuponave tatimor nr, 006, 007, 008, të cilët janë prerë një ditë më parë dhe jo sipas datës së faturës tatimore. Fatura tatimore në rubrikën përshkrimi i mallit ose i shërbimit ka emrat e 6 punonjësve të renditur dhe rezultojnë të gjithë në një faturë të vetme, veprim që bie ndesh me rregulla e përcaktime ligjore. Fatura nuk është firmosur nga nëpunësja x për të vërtetuar fjetjen. Vlera e faturës është **6,000 lekë**.

8. Urdhër shpenzimi nr.111 datë 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm** në shumën **440,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1377 me destinacion Kukës, Has, Tropojë nga data. 02.05.2019-04.05.2019, programit nr.1378 dt.30.04.2019 me destinacion rajonet Vlorë, Berat, Fier nga dt.06.05.2019-08.05.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019 me destinacion rajonin e Vlorës nga dt.13.05.2019-15.05.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **17** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me **nr.415** dt.14.05.2019 lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk për dy netë akomodim, fatura tatimore me **nr.21** lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x Skrapar më dt. 29.05.2019, fatura tatimore e shitjes **nr.02** lëshuar nga subjekti akomodues x shpk Kukës më dt.04.05.2019 për dy netë fjetje, nuk janë firmosur nga **zj. x**, Zv/Drejtor i Përgjithshëm i SHKP. Fatura tatimore **nr. 30** lëshuar nga subjekti akomodues x në Korçë për dy netë fjetje, nuk është firmosur nga nëpunësja x. Vlera e faturës është **6,000 lekë**.

Fatura me **nr.446** lëshuar më dt.08.05.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** Vlorë.

1) Fatura në rubrikën emri i blerësit ka emrin e institucionit dhe jo të personit që i lëshohet. 2) Në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë shkruar emrat e **13** nëpunësve të përmbledhur në një faturë të vetme.

3) Në rubrikën blerësi ku duhet të jetë emër mbiemër dhe firma e personit i cili merr mallin ose shërbimin ka **9** nënshkrime pa emra.

4) Bashkëlidhur ka dhe fotokopje të faturës **nr.446** të cilat i janë bashkëlidhur urdhër shërbimeve për secilin punonjës i cili është trajtuar me dietë. Fotokopjet e fatures tatimore të cilat janë bashkëlidhur për cdo urdhërshpenzim nuk kanë emër mbiemër apo nënshkrim në rubrikën blerësi, ndryshe nga fatura origjinale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

5) Kuponi dhe fatura tatimore e shitjes kanë mos përputhje në data, kuponit tatimor është prerë më datë. 07.05.2019 dhe jo më dt.08.05.2019 sic duhej. Nisur nga konstatimi i parregullsive të sipërcituara, grupi i auditimit identifikon se ka elementë (mashtrimi, falsifikimi) të mjaftueshëm për ta trajtue si çështje të vecantë në këtë program auditimi.

9. Urdhër shpenzimi nr.112 datë 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **44,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1377 me destinacion Kukës, Has, Tropojë nga data. 02.05.2019-04.05.2019, pogramit nr.1378 dt.30.04.2019 me destinacion rajonet Vlorë, Berat, Fier nga dt.06.05.2019-08.05.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019 ne rajonin Dibër. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, është paguar nëpunësi x për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore nr.10 dt.11.05.2019 është lëshuar nga subjekti akomodues “x”, Dibër. Fatura është fotokopje, e pa firmosur dhe përmbledhëse në numër personash, nuk është e specifikuar ashtu sic duhet për personin i cili paguan për shërbimin që merr. Kuponi tatimor me **nr. 4** është fotokopje dhe ka cmim total e nuk ka tregues se për çfarë është kryer pagesa. Fatura tatimore e shitjes **nr.6** dt.10.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues “ x” shpk për një natë fjetje, është fotokopje dhe jo e firmosur nga nëpunësi të cilit i është urdhëruar pagesa për këtë shërbim. Fatura tatimore e shitjes nr.416 dt.14.05.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “Hotel x” për dy netë akomodim, nuk është firmosur.

10. Urdhër shpenzimi nr.113 datë. 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **22,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1377 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, është paguar për këto shërbime titullari i SHKP, **Zj. x**.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes nr. 20 dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur. Vlera e faturës **6,000 lekë**.

Fatura tatimore e shitjes **nr. 01** dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur. Vlera e faturës **6,000 lekë**.

Shuma prej **12,000 lekë** për këto shërbime është e pajustificuar.

11. Urdhër shpenzimi nr.114 datë. 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **88,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. nr. 1377 dt. 02.05.2019-04.05.2019, pogramit nr.1378 dt.30.04.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **3** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes nr. 24 dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur nga nëpunësi x. Vlera e faturës **6,000 lekë**. Fatura tatimore e shitjes nr. 54 dt.14.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur nga nëpunësi x. Vlera e faturës **6,000 lekë**. Fatura tatimore e shitjes nr. 417 dt.14.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetje nuk është e firmosur. Vlera e faturës **6,000 lekë**.

12.Urdhër shpenzimi nr.124 datë. 07.06.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në shumën 27,500 lekë, bazuar në programin e punës nr.1634 dt.21.05.2019, me objekt angazhim auditimi i plotë në zyrën vendore të SHKP Kolonjë.

U konstatua se:

Sipas listpagesës së dërguar në thesar dhe faturës tatimore nr.4000 lëshuar më dt.31.05.2019 nga subjekti akomodues x, vërehet se shuma për 4 netë fjetje është 6,000 lekë në total me cmim 1,500 lekë nata.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

13. Urdhër shpenzimi nr.138 datë. 27.06.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.1292 dt.19.04.2019 në rrethin e Beratit e Skraparit.

U konstatua se:

Në programin e punës është përcaktuar rrethi i Beratit e Skraparit, nga dt.06.06.2019 deri më 08.06.2019. Në urdhër shërbim vërehet ndryshim i destinacionit nga rrethi i Beratit në atë të Gjirokastrës. Fatura tatimore me nr.21 lëshuar më dt.08.06.2019 nga subjekti akomodues Hotel x, nuk është e firmosur nga zj. x, konkretisht titullar i institucionit.

14. Urdhër shpenzimi nr.159 datë 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **55, 000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019 si dhe programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019. Sipas listëpagesës janë paguar 4 nëpunës për shërbimet e kryera.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 x shpk Pukë me nr nipti. K69215305M.... për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse, si dhe e pa firmosur nga punonjësit në listëpagesë.

15. Urdhër shpenzimi nr.160 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **178,640 lekë** për **9** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019, programin nr. 1840 dt.12.06.2019 me destinacion rajonin e Dibrës nga dt.26.06.2019-28.06.2019, programit nr. 2118 dt. 08.07.2019 në rajonin e Korçës.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 H.T.P shpk Pukë me nr nipti. për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse me 12 emra punonjësish, si dhe e pa firmosur nga punonjësit në listapagesë.

16. Urdhër shpenzimi nr.161 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **11,000 lekë** për **1** punonjës. Shërbimi është kryer bazuar programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 x shpk Pukë me nr nipti. për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse me **12** emra punonjësish, e pa firmosur nga punonjësit apo punonjësi i cili është paguar.

17. Urdhër shpenzimi nr.161 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **33,000 lekë** për **1** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019, programit nr. 2118 dt. 08.07.2019 në rajonin e Korçës, programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. 425 dt.28.06.2019 për **2** netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk Vlorë, me nipt. ..., fatura tatimore nr.641 dt.13.07.2019 për 2 netë akomodim lëshuar x Shpk me nipt. ... dhe fatura tatimore e shitjes me nr. 463 lëshuar më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 x shpk Pukë me nr nipti. ... për 2 netë akomodim nuk janë të firmosura nga zj. x, titullar i SHKP. Shuma totale prej **18,000** lekë është e pajustificuar.

18. Urdhër shpenzimi nr.172 datë. 15.08.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **132,000 lekë** për **9** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1889 dt.17.06.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec dhe programin nr.2354 dt. 18.07.2019 me destinacion rajonet, Fier, Vlorë e Gjirokastrë.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. 2551 dt.02.08.2019 për **2** netë akomodim ëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Pogradec, me nipt. ... në vlerë **6,000 lekë** për dy netë fjetje, nuk është firmosur nga **zj. x**, zv/drejtor i përgjithshëm i SHKP. Fatura tatimore nr.460 dt.24.07.2019 për 2 netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Fier, me nipt. ... në vlerë **6,000 lekë**, nuk është firmosur nga **zj. x**.

19. Urdhër shpenzimi nr.173 datë. 15.08.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **22,000 lekë** për **1** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1889 dt.17.06.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec dhe programin nr.2354 dt. 18.07.2019 me destinacion rajonet, Fier, Vlorë e Gjirokastrë.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. 453 dt.24.07.2019 për **2** netë akomodim ëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Fier, me nipt. ... në vlerë **6,000 lekë**, nuk është firmosur nga **zj. x**. Fatura tatimore nr.936 dt.01.08.2019 për 2 netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x”, me nipt. ... në vlerë **6,000 lekë**, nuk është firmosur nga **zj. x**. Shuma totale prej **12,000** lekë është e pajustificuar.

20. Urdhër shpenzimi nr.217-218 datë. 08.10.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **132,000 lekë** në total për **8** nëpunës të SHKP. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 2921 dt.02.09.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.209 dt.03.10.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “x” me nipt. ... është përmbledhëse për të gjithë punonjësit së bashku. Fatura nuk është firmosur nga të gjithë personat të cilët presupozohet të kenë kryer fjetjen. Emrat e nëpunësve që nuk kanë firmosur janë: **x, x, x, x, x, x**. Shuma në total prej **99,000 lekë** është e pajustificuar.

11. Urdhër shpenzimi nr.245 datë. 07.11.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **137,500 lekë** për **8** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 3489 dt.11.10.2019, program nr.3240/5 dt.04.10.2019, program nr.3512 dt.14.10.2019.

U konstatua se:

Për shërbimin në qytetin e Përmetit, fatura tatimore e shitjes me nr.44 dt.10.10.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” me nipt. ... është përmbledhëse dhe jo e lëshuar për secilin nga nëpunësit. Fatura me nr.44 nuk është firmosur nga nëpunësit që supozohet të kenë marrë këtë shërbim. Fatura nr.198 dt.28.10.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “x”, për dy netë fjetje, për datat.25.10.2019 dhe. 26.10.2019.

Referuar kalendarit të vitit 2019 dhe përkatësisht datave 25-26.10.2019, rezulton se data 26.10.2019 ka qënë ditë e shtunë dhe jo ditë pune zyrtare. Fatura po ashtu është përmbledhëse dhe jo e lëshuar për secilin punonjës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, sqarojmë se: *Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim observacionin e dërguar pas projekt raportit.*

Theksojmë se: Shkeljet e konstatuara për periudhën e audituar, mungesa e nënshkrimit të faturave tatimore ku sipas jush është harresë nga punonjësit të cilët janë trajtuar me dietë keni ngritur pikëpyetje nga ana juaj mbi bazën ligjore mbi të cilën mbeshtetet shkelja. Sqarojmë dhe po ju pasqyrojmë qartazi se gjetja mbështetet në Pikën. 36 të Udhëzimit Nr. 30 datë. 27.12.2011 ndryshuar ku është përcaktuar se:

"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve". Proces verbali i mbajtur më dt.22.04.2020 ku 27 punonjës pas mangësive të konstatuara nga grupi i auditimit kanë firmosur faturat tatimore, veprim që nuk ka efekt prapaveprues dhe si i tillë nuk ndryshon qëndrimin e grupit të auditimit por përforcon argumentat e gjetjes.

Observacioni juaj pranohet për pjesën e konsideruar nga grupi i auditimit Dëm ekonomik, por duhet të zbatohet me korrektësi Udhëzimi Nr. 30 datë. 27.12.2011 ndryshuar.

b. Saktësia dhe rregullariteti e veprimeve të kryera në magazinë.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për 6 mujorin e parë 2018 dhe 6 mujori i dytë i vitit 2019. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.

Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30, datë. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i vitit 2018:

Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur sa më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Me urdhrin nr. 4362, Prot. Datë. 06.12.2018 të drejtoreshës së përgjithshme të SHKP, Zj. Elira Demiraj, është ngritur Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të DP së SHKP, i përbërë nga punonjësit si më poshtë.

- X
- X
- X
- X
- X

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me shkresën nr. 4362/1, datë 30.12.2018, Komisioni i inventarizimit të aktiveve ka informuar Drejtoreshën e Përgjithshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve të brendshme mbi rezultatet e inventarizimit. Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasi të fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile. Është verifikuar gjendja fizike dhe kontabël si dhe nuk ka rezultuar asnjë diferencë, por janë evidentuar pajisje dhe oriendi që nuk e kryejnë më funksionin e tyre.

Kanë paraqitur përshkrimin e aktiveve si më poshtë.

Inventari I mjeteve kryesore gjithsej:

Gjendja në kontabël në vlerën **125, 871,405 lekë**

Gjendja në fizike në vlerën **125, 871, 405 lekë**

Nga të cilat:

Aktive të qëndrueshme të trupëzuara:

Gjendja në kontabël në vlerën **120,471,720 lekë**

Gjendja në fizike në vlerën **120,471,720 lekë**

Aktive qarkulluese:

Gjendja kontabile në vlerë **5,399,685 lekë**

Gjendja fizike në vlerë **5,399,685 lekë**

Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit ka konstatuar aktive të dëmtuara dhe jashtë funksionit në shumën **1,261,808 lekë**, ku prej të cilave rezultojnë të jenë:

Aktive të qëndrueshme **1,022,097 lekë**

Aktive qarkulluese **239,710 lekë**

U konstatua se:

Para fillimit të procesit të inventarizimit nuk janë fiksuar numrat e fletë hyrjes dhe fletë daljeve, dhe nuk është dyllosur magazina sipas përcaktimeve të pikës nr **83 të Umf nr. 30/2011 është e përcaktuar se:**

Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.

Procedura e sipërcituar në këtë paragraf është e nevojshme për kryerjen me seriozitet e rregullshmëri procesin e inventarizimit të pronës shtetërore. **Veprim i cili nuk është kryer e pasqyruar në këtë informacion.**

- Me datën **12.03.2019**, ka dalë urdhri i **Zv/Drejtorit të Përgjithshëm me nr.4362/2**, në bazë të cilit është ngritur komisioni për kryerjen e procesit të asgjësimit të aktiveve të DP të SHKP-së të vlerësuara si jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve 2018 sipas Informacionit Nr.4362/1 prot., datë. 30.12.2018, i përbërë nga:

- X
- X



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

- X
- X
- X

-Me datën 19.03.2019 komisioni i asgjësimit të aktiveve, i ngritur sipas urdhrit të DP me nr. 4362/3, kanë mbajtur p/v për kryerjen e procesit të asgjësimit të aktiveve. Pjesë e këtij procesverbali janë fotot e mjeteve dhe pajisjeve që janë asgjësuar.

Për vitin 2018 konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti apo në çdo proces të inventarizimit të kryer për periudhën objekt auditimi. Në shkelje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, “*çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

-Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve ***nuk është hartuar raporti për inventarizimin e karburantit te SHKP për vitet 2018, 2019***, në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues*”. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit.

-Procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk jep informacion të plotë për të dhënat e aktiveve, sic përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr.30, që përcakton se “*ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit e të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfundim bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale*”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.

-Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, që sanksionon se, Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve :

- a. kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;
- b. kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;
- c. kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit,
- d. kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t’i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktiviteti të ngjashëm.
- e. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;
- f. kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;
- g. kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;
- h. kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Inventarizimi i aktiveve duke qenë se është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, i cili kryhet për të vërtetuar **saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre**, që kryhet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues sipas procedurave të miratuara me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar, nuk është marrë me seriozitetin e duhur nga këto nëpunës, pasi:

-Komisionet e kryerjeve të inventarizimeve fizike **nuk kanë përpiluar raportet lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës**, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, **siç cilëson pika 85/ c e Udhëzimit.**

-Nga auditimi konstatohet se nga SHKP janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive për të cilat ka një akt-vlerësimi i mbajtur më dt.31.12.2018 nga specialisti i fushës së IT x i cili ka kryer një vlerësim të disa pajisjeve si, printer, monitor PC, njësi qendrore, etj. Referuar këtij proces verbali pajisjet e klasifikuara si jo funksionale dhe të pariparueshme janë terhequr nga komisioni për tu asgjësuar.

Dokumentacioni lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit ka parregullësi e mangësi në paraqitjen dokumentare e sasiore.

1- Vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre.

2-Materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj.

3- Janë shoqëruar me fotot përkatëse një pjesë e këtyre aktiveve në gjendje fillestare e përfundimtare të njëjtë, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

Inventarizimi i vitit 2019.

Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur sa më poshtë vijon:

- Me urdhrin nr. 4436 prot, datë 18.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm znj. x, është ngritur Komisioni i inventarizimit vjetor të aktiveve dhe detyrimeve të SHKP, me 3 punonjës x, x dhe x, duke filluar nga data **18.12.2019** deri më datë. **20.01.2019**. Komisioni I inventarizimit para fillimit të procesit ka fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletë daljeve dhe më pas ka filluar procesin e inventarit.

- Me raportin nr. 258/1, datë. **07.02.2020**, Komisioni i inventarizimit të aktiveve ka informuar Drejtoin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse mbi rezultatet e inventarizimit. Nga komisioni i inventarizimit, janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile. Është verifikuar gjendja fizike dhe kontabël si dhe nuk ka rezultuar asnjë diferencë.

-Kanë paraqitur përshkrimin e aktiveve si më poshtë.

Inventari i mjeteve kryesore gjithsej:

Gjendja kontabël në vlerën **123,705,225 lekë.**

Gjendja fizike në vlerën **123,705,225 lekë**

Nga të cilat:

Aktive të qëndrueshme të trupëzuara:

Gjendja kontabël në vlerën **123,705,225 lekë**

Gjendja në fizike në vlerën **123,705,225 lekë**

Aktive qarkulluese:

Gjendja kontabël në vlerë **5,759,387 lekë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Gjendja fizike në vlerë **5,759,387 lekë**

U konstatua se:

Procesi i inventarizimit ka kaluar afatet e përcaktuara mbi **17** ditë kalendarike pa justifikim apo miratim përkatës nga NA i SHKP.

Gjatë kqyrjes së kartelave të inventarit, kartela e aktiveve afatgjata me vlerë kontabile **19,190,942 lekë**, në përgjegjësi materiale të nëpunësve x dhe x rezultoi e pa firmosur nga këta nëpunës. Fakt i cili nuk është reflektuar apo arsyetuar në raportin drejtuar titullarit të SHKP. Kartela e zyrës së IT në përgjegjësi të x dhe x me vlerë kontabile **678,483 lekë** rezultoi e parregullt pasi këta punonjës nuk janë pjesë e organikës së SHPK, duke ju referuar listpagesave dhe emrave të nëpunësve paraqitur nga zyra e burimeve njerëzore. Komisioni inventarizimit ka konstatuar se disa nga punonjësit kanë nga dy kompjutera në ngarkim pasi kanë marrë të rinj. Më tej komisioni ka rekomanduar magazinimin apo transferimin e tyre në institucione të tjera të varësisë.

Grupi auditimit gjykon se nuk ka gjetur zbatim plotësisht Umf.nr. 11 datë. 27.12.2011.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP, dërguar me shkresë nr.183/41 Prot. Datë. 23.04.2020 si dhe shkresës nr.65/3 prot. Datë.27.04.2020 në KLSH, mbi Akt-Konstatimin **nr.9** sqarojmë se: *Së pari subjekti i audituar ka observuar jashtë afatit 7 ditor. Gjithsesi grupi i auditimit ka marrë në konsideratë situatën aktuale krijuar nga Covid-19 e cila ka prekur vendin tonë. Disa nga shkresat bashkëlidhur këtij observacioni nuk i është vënë në dispozicion gjatë kohës së auditimit. Grupi i auditimit pasi u njoh me materialin e dërguar vlerëson se: Merret parasysh pjesërisht observacioni mbi paraqitjen e inventarit të karburantit si dhe argumentimin shkresor të shtyrjes së procesit të inventarizimit. Nuk merret parasysh procesi i asgjësimit pasi nuk është kryer sipas përcaktimeve ligjore të cituara në gjetje, ku është lënë dhe rekomandimi përkatës.*

Titulli i Gjetjes: 1	<i>Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet , bankës dhe arkës në lekë dhe valutë.</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatuan parregullësi në dokumentacionin shoqëruar dhe justifikues të likuidimeve të kryera në total 43 raste për vitin 2018-2019 të cilët paraqiten si më poshtë:</p> <p><u>1. Urdhër shpenzimi nr. 239, datë 02/10/2018,</u> është kryer likuidimi i shpenzimeve për shërbim i brendshëm diete që i përkasin muajit shtator 2018 në vlerë 270,820 lekë. Pagesat janë kryer bazuar autorizimeve të ndryshme sipas programeve të punës.</p> <p>Shërbimi i mbështetur në autorizimin me nr. 2999/2 prot. Datë 13/09/2018, bashkëlidhur listpagesës ka këto dokumentacione justifikues:</p> <p>Fatura tatimore shitje me nr. 206, pagesë e taksës rrugore Milot-Morinë, datë 17/09/2018.</p> <p>Fatura tatimore nr. 164,166 si dhe kuponat tatimore bashkëngjitur lëshuar më datë. 21/09/2018, nga subjekti x shpk, për akomodim fjetje 4 netë x 3000 lekë me tvsh.</p> <p><u>U konstatua se:</u></p> <p>Faturat tatimore nr. 164 me vlerë 12,000 lekë, Nr 166 me vlerë 12,000 lekë, nuk janë firmosur nga nëpunësit e SAB, x, x. <u>Veprim jo në përputhje me kuadrin rregullator përkatës i cili do citohet në rubrikën e</u></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

gjetjes.

Me shkresë nr. 3066 prot datë. 18/09/2018, Program pune në rajonin Pogradec, Korçë nga data. 26/09/2018 deri më 29/09/2018, dhe personat që do marrin pjesë. Më pas ka dalë urdhër shërbimi i detajuar dhe intenerari i lëvizjes. Grupi i punës i përbërë nga: **x, x, x, x, x, x si dhe shoferi x.**

Në urdhër shërbim konstatohet një devijim nga programi i punës në të cilin nuk ishte parashikuar qyteti Përmet, ku për këtë shërbim janë trajtuar me diete punonjësit e mësipërm. Në faturën tatimore të shitjes me nr.1069 datë.27/09/2019 lëshuar nga subjekti “Hotel-x” në vlerë **21,000** lekë në total nuk ka asnjë firmë në faturën tatimore për që vërteton këtë shërbim. Fatura tatimore nr.643 dt.28/09/2018 lëshuar nga OE Grand Korxca shpk në rubrikën blerësi në emrin e x, ndonëse i referohet **zj. x** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse. Ndërsa fatura tatimore e shitjes me **nr.953** ka mbivendosje pasi është lëshuar po me datë 28/09/2018 nga subjekti, x shpk në Pogradec, e vërtetuar dhe me kuponin tatimor bashkëlidhur, ku për këtë shërbim fatura duhej të ishte e dt.**29/09/2018** mbas marrjessë shërbimit akomodim. Vlera e faturës tatimore të shitjes është në vlerën **3000 lekë** për një natë akomodim.

Fatura tatimore e shitjes me **nr.642** lëshuar nga subjekti x shpk në rubrikën blerësi në faturë, emri i personit x që ka marrë këtë shërbim nuk korrespondon me listën e grupit të punës ndonëse i referohet dhe i është paguar, nëpunësit zbatues të SHKP x. Vlera e faturës **3000 lekë** për një natë akomodim. Rezulton se dhe për nëpunësit e më poshtëm ka mbivendosje lidhur me shërbim e marrë po në të njëjtën ditë në qytetin e Pogradecit, lëshuar nga subjekti x shpk. Emrat e punonjësve dhe nr i faturave tatimore përkatëse vijnë si më poshtë.

- x.** Fatura tatimore nr.954 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- x.** Fatura tatimore nr.955 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- x.** Fatura tatimore nr.957 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- x.** Fatura tatimore nr.958 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**
- x.** Fatura tatimore nr.959 dt.28/09/2018 **Vlera 3,000 lekë**

Në total janë likuiduar 78,000 lekë.

2.Urdhër shpenzimi nr. 268, datë 22/10/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt: **shërbim i brendshëm diete** që i përkasin muajit shtator 2018 në vlerë **209,000 lekë.**

Janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së me shërbim, brenda vendit mbështetur në programin nr.3338 datë. 05/10/2018 për arsye pune në rajonin Fier. Zj/ x specialiste në DSHB pranë SHKP. Data e nisjes datë. 10/10/2018 deri më 12/10/2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.14 dt.12/10/2018 e lëshuar nga subjekti Hotel x ka bashkëlidhur. *Konstatohet se nuk është konfirmuar me firmë nga nëpunësja e mësipërme për kryerjen e këtij shërbimi.* Vlera e faturës **6,000 lekë.**

Për shërbimin e kryer në Tropojë, bazuar në programin nr.3455 prot, më dt.15/10/2018 ku është përcaktuar intenerari i lëvizjes, nisja nga Tirana më dt 16/10/2018 – mbërritja në Tropojë më dt.16/10/2018. Nisja nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Tropoja më dt.18/10/2018 mbërritja në Kukës më dt.18/10/2018. faturat tatimore të shitjes të lëshuara me dt. 18/10/2018 nga subjekti x rezultojnë të jenë të pa firmosura dhe vetem me një kupon tatimor me nr. 00000009, i cili është përmbledhës, Arsye e cila na jep siguri të kufizuar në kryerjen e këtij shërbimi në rrethin e Tropojës. Ndërsa ato të akomodimit në Kukës janë të firmosura nga secili punonjës dhe me kupona të vecantë për secilën faturë tatimore në mënyrë të rregullt dhe që japin siguri të arsyeshme për kryerjen e veprimeve. Emrat e punonjësve dhe numrat e faturave tatimore vijnë si më poshtë.

4) x, fatura tatimore nr. 15 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë**

5) x, fatura tatimore nr.16 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë.**

6) x, fatura tatimore nr.20 dt.18/10/2018 në vlerë **6,000 lekë.**

Në total janë likuajduar 24,000 lekë.

3. Urdhër shpenzimi nr. 220, datë.13/09/2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, shërbim i brendshëm diete që i përkasin muajit gusht- shtator 2018 në vlerë **121,000 lekë.**

Janë dërguar me shërbim jashtë qendrës së me shërbim, brenda vendit mbështetur në programin nr.2480 datë.03/08/2018, autorizim nr. 2480/1, dt.03.08.2018, program pune nr.2820 dt.30/08/2018, program pune nr.2791 dt.29/08/2018, autorizim nr.2791/1 dt.29/08/2018, autorizim nr.2820/1 dt.30/08/2018.

U konstatua se:

Për shërbimin në rajonin Shkodër–Mirditë sipas programit nr.2480 datë.03/08/2018, evidentohen fatura tatimore shitje të lëshuara nga subjekti “x” për shërbimin akomodim (fjetje), të pa firmosura nga nëpunësit si vijon.

1) x, fatura tatimore nr.54 dt.10/08/2018 në vlerë **6,000 lekë.**

2) x, fatura tatimore nr.53 dt.10/08/2018 në vlerë **6,000 lekë** për dy netë akomodim.

Në total **12,000 lekë.**

4. Urdhër shpenzimi nr.149, datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **19,500 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohen fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuara për nëpunësit si vijon.

x Fat.nr.52 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë.**

x Fat.nr.51 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë.**

5. Urdhër shpenzimi nr.150, datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **6,500 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohen fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuar për nëpunësin si vijon.

x faturë tatimore nr.50 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë.**

6. Urdhër shpenzimi nr.151 datë 22.06.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **3,000 lekë bazuar** në programin e punës nr.1239 dt.30/04/2018 dhe programit nr.1239/1 dt.01/06/2018. Për shërbimin në rajonin Diber evidentohet fatura tatimore shitje për akomodim të lëshuar për titullarin e SHKP Zj. x, faturë tatimore nr.48 dt.17.06.2018 në vlerë **3,000 lekë.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

U konstatua se: Për USH nr. **149,150,151** pagesa është kryer për datën **16.06.2018** ditën e shtunë. Në kundërshtim me VKM 997/ 2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”. Në total janë likuiduar **15,000 lekë**.

7. Urdhër shpenzimi nr.122 datë 29.05.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **21,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr1427/1 dt.17.05.2018 dhe programit nr.1239 dt.30.04.2018 ne rajonin Berat. Faturat tatimore për akomodim janë lëshuar më dt.26.05.2018 e cila sipas kalendarit rezulton ditë e shtunë.

Fatura tatimore nr. 28 për nëpunësin x në vlerë **3,000 lekë**, fatura tatimore nr. 508 për Zj. x në vlerë **3,000 lekë**.

Vlera totale 11,000 lekë. E ndarë 6,000 lekë fjetje + 5,000 lekë dietë.

8. Urdhër shpenzimi nr.112 datë 14.05.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **16,500 lekë**, bazuar në programin me nr.1254/1 dt.02.05.2018 të angazhimit për auditim në datat 3-4 maj 2018 në DRP Gjirokastër. Fatura tatimore është lëshuar më dt.05.05.2018 ditë e shtunë. Ndonëse programi është përcaktuar më datë 3 dhe 4, nëpunësi duhej trajtuar vetëm për një natë fjetje sipas përcaktimeve ligjore me VKM 997 dt.10.12.2010 pika 1. Punonjësit e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përbalimin e shpenzimeve të shërbimit.

Pika 3. Për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, punonjësit i përballohen shpenzimet e mëposhtme: a) Dietë ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet: i) në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës; ii) në masën 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë

9. Urdhër shpenzimi nr. 222 datë, 13.09.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** për muajin shtator në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 2791, dt.29.08.2018, në rajonin e Beratit.

U konstatua se: Fatura tatimore nr.77 dt. 08.09.2018 për 2 netë akomodim si dhe urdhër shërbimi nuk janë firmosur nga përfituesi i këtij shërbimi, titullar i institucionit **zj. x**.

Në vlerë **6,000 lekë** total, e pafirmosur në rubrikën blerësi.

10. Urdhër shpenzimi nr. 230,231,232 datë. 21.09.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **11,000 lekë** për secilin urdhër shpenzimi, bazuar në programin e punës nr.2892, dt.06.09.2018, takime pune në rajonin Dibër. Faturat tatimore të shitjes, me nr 96,98,99 për këtë shërbim janë të modelit të thjeshtë pa tvsh.

U konstatua se: Mbas verifikimit në faqen e QKB rezultoi se subjekti që ka lëshuar këtë faturë ushtron veprimtari x dhe nuk rezulton të ketë aktivitet për akomodim apo hoteleri. Bazuar mbi këto fatura janë kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

pagesat për, **Zj. x** titullar i SHKP si dhe për punonjësën **x** specialiste në SHKP. **11. Urdhër shpenzimi nr.241** datë 02.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3065, dt.18.09.2018 në rajonin Kukës.

U konstatua se:

Fatura tatimore **nr.159** dt.21.09.2018 lëshuar nga subjekti akomodues **x** shpk, nuk është firmosur nga nëpunësi që është paguar për këtë shërbim dhe konkretisht **zj. x** titullar i SHKP.

12.Urdhër shpenzimi nr.252, datë, 09.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **21,000 lekë në total**, bazuar në programin e punës nr.3299, dt.02.10.2018, takime pune në rajonin Shkodër, Malësi e Madhe nga data 03.10.2018 deri më 06.10.2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.18 dt.04.10.2018 lëshuar nga subjekti akomodues **x** me Nipt.... ka të bashkëlidhur kuponat tatimore të datës 05.10.2018 me nr. 8,9,10 në shumën **9,000 lekë total**. Fatura nuk korespondon me datën e prerjes së kuponit tatimor. Nuk është e firmosur nga përfituesi i paguar për këtë shërbim, **zj. x** titullar i SHKP-së. Po ashtu llogaritja për tre netë me faturë të datës 04.10.2018 dhe kupon të datës 05.10.2018 e bëjnë këtë veprim të pajustificuar për pagesë. Fatura tatimore dhe kuponi duhet të kenë të njëjtën datë dhe ti përkasin datës 06.10.2018 sipas programit të punës.

13. Urdhër shpenzimi nr.253 datë, 09.10.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në vlerë **21,000 lekë** në total, bazuar në programin e punës nr.3299, dt.02.10.2018, takime pune në rajonin Shkodër, Malësi e Madhe nga data 03.10.2018 deri më 06.10.2018.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.20 dt.04.10.2018 lëshuar nga subjekti **x** me Nipt.... ka të bashkëlidhur kuponat tatimore të datës 05.10.2018 me nr. 14,15,16 në shumën **9,000 lekë total**. Fatura nuk korespondon me datën e prerjes së kuponit tatimor. Nuk është e firmosur nga përfituesi i paguar për këtë shërbim, shoferi i SHKP-së **x**. Po ashtu llogaritja për tre netë me faturë të datës 04.10.2018 dhe kupon të datës 05.10.2018 e bëjnë këtë veprim të pajustificuar për pagesë. Fatura tatimore dhe kuponi duhet të kenë të njëjtën datë dhe ti përkasin datës 06.10.2018 sipas programit të punës. Vlera e faturës tatimore në shumën **9,000 lekë**.

14. Urdhër shpenzimi nr.291 datë. 09.11.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **Shërbim i brendshëm** në vlerë **192,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3877 dt.31.10.2018 në rajonin Shkodër-Pukë si dhe në programin me nr 3583 dt.29.10.2018 në rajonin Korcë-Pogradec-Kolonjë. Urdhër shërbimi për rrethin e Pukës ka përcaktuar datat 05.11.2018 si mbërritje dhe dt.07.11.2018 si kthim.

U konstatua se: Fatura e thjeshtë tatimore me nr. 32 e lëshuar nga subjekti akomodues me nipt. ka të pëmbledhur emrat e personave të cilët supozohet të jenë akomoduar në këtë njësi akomodimi. Emrat e nëpunësve figurojnë në një faturë të vetme ku asnjëri prej tyre nuk ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

firmosur për të vërtetuar marrjen e këtij shërbimi. Vlera e faturës në total **42,000 lekë**.

15. Urdhër shpenzimi nr.292 datë.14.11.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3917 dt.06.11.2018 vizitë pune në rajonin Gjirokastër nga dt.08.11.2018 deri më dt.10.11.2018. Fatura tatimore nr.134 lëshuar nga subjekti më dt.09.11.2018 nga subjekti akomodues Halit Hadëri, ka bashkëlidhur kuponin tatimorë nr.2 të lëshuar me dt.09.11.2018.

U konstatua se: Në përshkrimin e faturës ka 4 netë akomodim për titullarin e SHKP dhe shoferin x. Ka mospërputhje me datat e planifikuara të shërbimit datën e lëshimit dhe firmën e punonjësve. Vlera e faturës **12,000 lekë**.

16. Urdhër shpenzimi nr.293 datë 14.11.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **77,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.3917 dt.06.11.2018 vizitë pune në rajonin Gjirokastër nga dt.08.11.2018 deri më dt.10.11.2018. Fatura tatimore nr.1248 lëshuar nga subjekti më dt.09.11.2018 nga subjekti Hotel x shpk, ka bashkëlidhur kuponin tatimorë nr.2 të lëshuar me dt.09.11.2018.

U konstatua se: Në përshkrimin e faturës ka mospërputhje në përshkrim, datat e planifikuara të shërbimit, datën e lëshimit dhe firmat e punonjësve të cilët janë paguar për këtë shërbim. Vlera e faturës tatimore në total **30,000 lekë**, për punonjësit si vijon, **x, x, x,**

17. Urdhër shpenzimi nr. 305 datë 21/11/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **308,000 lekë**.

Bazuar në programin e punës nr.3963 dt.12/11/2018, vizitë pune në rajonin e Korcës nga dt.14/11/2018 deri më dt.17/11/2018. Janë përcaktuar për këtë shërbim 26 punonjës të SHKP. Sipas listëpagesës për këtë shërbim është paguar titullari i SHKP **zj. x** në shumën **16,500 lekë** për tre ditë-netë shërbim.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes nr.30 dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.4, lëshuar nga subjekti x Korcë, fatura tatimore ka të listuar 13 emra punonjësish të përmbledhur për 3 netë akomodim dhe vlera në faturë dhe kupon paraqitet e përmbledhur në total e jo e ndarë për secilin punonjës. Në rubrikën blerësi, nuk ka firmë që konfirmon fjetjen në këtë njësi shërbimi akomoduese. *Në total vlera e faturës 9,000 lekë.*

28. Urdhër shpenzimi nr. 306 datë 21/11/2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **308,000 lekë**.

Bazuar në programin e punës nr.3963 dt.12/11/2018, vizitë pune në rajonin e Korcës nga dt.14/11/2018 deri më dt.17/11/2018. Janë përcaktuar për këtë shërbim 26 punonjës të SHKP.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes **nr.30** dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.4, lëshuar nga subjekti x. Fatura ka të listuar 13 emra punonjësish për 3 netë akomodim dhe vlera në faturë dhe kupon



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

paraqitet e përmbledhur në total e jo e ndarë për secilin punonjës. Në rubrikën blerësi, nuk ka firma të punonjësve, emrat e të cilëve vijnë si më poshtë.

x, x, x, x, x, x, x, x, x, x.

Vlera e faturës tatimore në total **117,000 lekë.**

Fatura tatimore e shitjes **nr.786** dt.17/11/2018 bashkëlidhur kuponin tatimor nr.21, lëshuar nga subjekti x shpk. Fatura tatimore ka vetëm një emër punonjësi, **x** dhe paraqitet në vlerën **90,000 lekë** total. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit ka listë pagesën dhe fotokopje të fatures **nr.786** me emra të punonjësve të cilët janë paguar për shërbimin.

Emrat e punonjësve në fotokopjet e faturës tatimore nr.786 janë mbivendosur me stilolaps për efekt pagese. Emrat e punonjësve që nuk konfirmojnë shërbimin janë, **x, x, x, x, x, x, x, x.** Shuma prej **89,000 lekë.**

19. Urdhër shpenzimi nr. 352 datë 24.12.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm* në vlerë **39,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018, me objekt, takime pune në zyrat e punësimit Has, Tropojë dhe Kukës parashikuar nga dt. 17.12.2018 deri më dt.20.12.2018. Sipas listëpagesës janë paguar për këtë shërbim dy punonjës, **x** dhe **x**. Bashkëlidhur urdhërshpenzimit, fatura tatimore me nr.12 dhe nr 13 lëshuar më dt.20.12.2018 si dhe kuponat nr.12 dhe 13.

U konstatua se:

Faturat tatimore të lëshuara nga subjekti x Grup shpk, njësi akomodimi në qytetin e Kukësit, nuk janë të firmosura nga punonjëset e mesipërme për ti dhënë vërtetësi marrjes apo kryerjes së këtij shërbimi. Vlera në total e dy faturave **18,000 lekë** .

20. Urdhër shpenzimi nr. 353 datë. 24.12.2018, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *Udhëtim i brendshëm* në vlerë **21,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018 me objekt, takime pune në zyrat e punësimit Has, Tropojë dhe Kukës parashikuar nga dt. 17.12.2018 deri më dt.20.12.2018. Sipas listëpagesës është paguar për këtë shërbim titullari i SHKP, **zj. x** në shumën **21,000 lekë**. Bashkëlidhur urdhërshpenzimit, fatura tatimore me nr.11 lëshuar më dt. 20.12.2018 si dhe kuponi tatimor nr.12

U konstatua se:

Faturat tatimore e lëshuar nga subjekti “x” shpk, njësi akomodimi në qytetin e Kukësit, nuk është e firmosur nga titullari i SHKP për ti dhënë vërtetësi marrjes apo kryerjes së këtij shërbimi. Vlera në total e faturës tatimore është **9,000 lekë** .

21. Urdhër shpenzimi nr.355 datë. 24.12.2018 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **244,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.4465 dt.14.12.2018 në rajonin Kukës, programit nr. 4493 dt.17.12.2018 në rajonet Fier, Vlorë, dhe programit nr.4533 dt.19.12.2018, në rajonin e Përmetit.

U konstatua se:

Për këto shërbime evidentohet se disa fatura tatimore kanë parregullësi, për nëpunësit si vijon.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Fatura nr.1244 dt.21.12.2018 e pa firmosur nga nëpunësi x në vlerë **6,000 lekë**.

Fatura nr.308, dt.25.12.2018, x në vlerë **6,000 lekë**, fatura nr.311 për punonjësen x në vlerë **6,000 lekë**, fatura nr.310 për nëpunësin x në vlerë **6,000 lekë** nuk korespondojnë me datën e kryerjes së shërbimit i cili sipas urdher shërbimit fillon me dt.19.12.2018 dhe mbaron me dt.21.12.2018.

Banka 2019.

1. Urdhër shpenzimi nr.12 datë 29.01.2019 është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **181,500 lekë**, bazuar në programin e punës nr.23 dt.04.01.2019 me objekt, vizita pune e monitorim mbi rikonstruksionet e kryera në zyrat e punësimit Gramsh, Lushnjë, Kucovë dhe Fier nga data 08.01.2019 deri më 10.01.2019. Programit të punës nr.162 datë 17.01.2019 me objekt takime pune, vizita monitoruese të planit të investimeve për vitin 2018 në Fier, Përmet, Kolonjë, Korçë dhe ZP Pogradec nga data 21.01.2019 deri më datë.24.01.2019. Në listëpagesë figurojnë 8 punonjës të cilët janë trajtur me diete në këto shërbime.

U konstatua se:

Në shërbimin e kryer në Përmet fatura tatimore e shitjes me nr.12 lëshuar më dt. 23.01.2019 nga subjekti “**Hotel x**”, ka bashkëlidhur kuponin tatimor nr.1 i printuar më dt.22.01.2019 në vlerë **54,000 lekë** total për akomodim. Fatura ka të renditur 9 punonjës si vijon, **x, x, x, x, x, x, x, x, x**. Në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë të përmbledhur emrat e punonjësve në një faturë të vetme me tre firma në fund. Kuponi tatimorë nuk përputhet me dt e faturës si dhe ka vetëm një cmim për 1 dhomë hoteli në vlerë të përgjithshme **54,000 lekë**. Bashkëlidhur ka po të njëjtën faturë tatimore të fotokopjuar të pa firmosur në rubrikën blerësi, fakt që na jep siguri të arsyeshme që firmat janë hedhur në një kohë tjetër dhe jo në vend.

Shuma totale e faturës **54,000 lekë**

Urdhër shpenzimi nr.27 dhe 28 datë 14.02.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **77,000 lekë** në total, bazuar në programin e punës nr.387 dt.01.02.2019 me objekt, kryerjen e vizitave monitoruese në rajonin Berat, Kucovë, Skrapar. Afati i parashikuar i kryerjes së shërbimit, nga dt.04.02.2019 deri më dt.06.02.2019. Sipas listë pagesave janë paguar nëpunësit si vijon, **x, x, x, x, x**.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.38 lëshuar nga subjekti **x** Kucovë në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë të përmbledhur emrat e punonjësve në një faturë të vetme, po ashtu dhe në kuponin tatimor ka përshkrim cmim vetëm për një dhomë hoteli në vlerë të përgjithshme **54,000 lekë**. Elementët dhe parregullësitë e hasura japin siguri të arsyeshme për mos kryerjen e plotë të shërbimit, më saktë akomodimin.

3. Urdhër shpenzimi nr.45 datë. 07.03.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në autorizimin nr.494/1 dt.12.02.2019 me objekt, takime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

pune në rajonin e Vlorës.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes me nr.1111/46 me nr serial. 711182722 lëshuar më datë.01.03.2019 nga subjekti akomodues Hotel x nuk është e firmosur nga **zj. x**, titullar i SHKP, nuk konfirmon fjetjen në këtë njësi akomoduese.

Vlera **6,000 lekë** në total .

4. Urdhër shpenzimi nr.46 datë. 07.03.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **11,000 lekë**, bazuar në autorizimin nr.494/1 dt.12.02.2019 me objekt, takime pune në rajonin e Vlorës.

U konstatua se: Fatura tatimore e shitjes me nr.1111147 me nr serial. 711182723 lëshuar më datë.01.03.2019 nga subjekti akomodues Hotel x nuk është e firmosur nga zj. x nuk konfirmon fjetjen në këtë njësi akomoduese.

Vlera prej **6,000 lekë** në total

5. Urdhër shpenzimi nr. 65 datë. 02.04.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm diete* në vlerë **297,000 lekë**, **Urdhër shpenzimi nr.66** datë. 02.04.2019 likujduar në vlerë **33,000 lekë** si dhe **Urdhër shpenzimi nr.67**, datë. 02.04.2019 likujduar në vlerë **66,000 lekë janë** bazuar në programet e punës nr.936 dt.20.03.2019 programit nr.936/1 dt.20.03.2019, në rajonet Kukës, Lezhë, Dibër, autorizimit nr.936/2, me objekt kryerjen e analizave vjetore të punës në rajonin Gjirokastër, Korçë programit nr.811 dt.07.03.2019, vizita monitorimi në rajonin Kukësi , ZP Has e Tropojë. Program nr.875 datë.13.03.2019 në rajonet Fier, Berat, Vlorë. Janë trajtuar me dietë punonjës sipas listëpagesës në këto urdhër shpenzimi.

U konstatua se: Faturat tatimore e shitjes me nr. 254 datë.29.03.2019 lëshuar nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim, nuk është firmosur nga punonjësja **x**. Më poshtë paraqiten emrat e punonjësve dhe faturat tatimore të cilat paraqesin të njëjtën parregullësi.

1. x, Fatura nr.29 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë**. Fatura nr.255 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x** Kucovë, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 416 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor po ashtu përmbledhës.

2.x, fatura nr 253 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues Hotel x për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

3. x, fatura nr.23 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.271 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x** **Kucovë**, për një



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor. Fatura nr. 1111185 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

4. x, fatura nr.28 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë në me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.272 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 1111185 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

5. x, Fatura nr.273 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.16 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

6. x, Fatura nr.268 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.18 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

7. x, Fatura nr.269 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

8. x, Fatura nr.15 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

9. x, Fatura nr.13 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.60 lëshuar më datë. 28.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë

10. x, Fatura nr.19 lëshuar më datë. 12.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.61 lëshuar më datë. 28.03.2019 nga subjekti akomodues **x shpk**, për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

11. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

me firmë. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 63 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **x** në Vlorë, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr.21 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë, me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.28 lëshuar më datë.30.03.2019 nga subjekti **Hotel x** në Gjirokastër me vlerë **6,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë.

1-x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës. Fatura nr.26 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.251 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura nr. 1111187 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

13. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor po ashtu përmbledhës. Fatura nr. 416 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

14. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

15. x, Fatura nr.49 lëshuar më datë. 20.03.2019 nga subjekti akomodues **x Kucovë**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor poashtu përmbledhës.

16. x, Fatura nr. 415 lëshuar më datë. 21.03.2019 nga subjekti akomodues **x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë. Fatura është përmbledhëse me emrat e personave dhe me një kupon tatimor po ashtu përmbledhës. Fatura nr.252 lëshuar më datë. 29.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** për dy netë akomodim në vlerë **6,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr.27 lëshuar më datë.26.03.2019 nga subjekti **x** në Bulqizë, me vlerë **3,000 lekë** e pakonfirmuar me firmë. Fatura nr. 1111187 lëshuar më datë. 22.03.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x**, për një natë akomodim në vlerë **3,000 lekë** e pa konfirmuar me firmë.

6. Urdhër shpenzimi nr. 93 datë. 03.05.2019, është kryer likuidimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **22,000** lekë për **1** punonjës. Shërbimi është kryer bazuar programin nr. 1279 dt.18.04.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.26.04.2019-27.04.2019 dhe programit nr.1168 dt.11.04.2019 me destinacion Rajonin e Kukësit, Has, Tropojë nga dt.16.04.2019-18.04.2019, programit nr.1198 dt.15.04.2019 me destinacion rajonin e Korçë-Pogradec.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. Serial -72888733 dt.18.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues x shpk Kukës për dy netë fjetje, në vlerë 6,000 lekë nuk është e firmosur. Fatura me nr.162 dt.24.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues x, Pogradec është përmledhëse me 7 emra dhe e pa firmosur. Fatura me nr.246 dt.27.04.2019 lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk, Shkodër nuk është firmosur. Faturat e mësipërme nuk janë firmosur nga Zj. x, titullar i SHPK.

7. Urdhër shpenzimi nr.94 datë 03.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *udhëtim i brendshëm* në shumën **55, 000** lekë, bazuar në programin e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019 si dhe programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **3** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr.335 dt.27.04.2019 nga subjekti x në rrethin e Fierit rezulton të jetë fotokopje bashkëlidhur urdhër shpenzimit. Fatura nuk përputhet me datën e kuponave tatimor nr, 006, 007, 008, të cilët janë prerë një ditë më parë dhe jo sipas datës së faturës tatimore. Fatura tatimore në rubrikën përshkrimi i mallit ose i shërbimit ka emrat e 6 punonjësve të renditur dhe rezultojnë të gjithë në një faturë të vetme, veprim që bie ndesh me rregulla e përcaktime ligjore. Fatura nuk është firmosur nga nëpunësja x për të vërtetuar fjetjen.

8. Urdhër shpenzimi nr.111 datë 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **440,000** lekë, bazuar në programin e punës nr. 1377 me destinacion Kukës, Has, Tropojë nga data. 02.05.2019-04.05.2019, pogramit nr.1378 dt.30.04.2019 me destinacion rajonet Vlorë, Berat, Fier nga dt.06.05.2019-08.05.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019 me destinacion rajonin e Vlorës nga dt.13.05.2019-15.05.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **17** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me **nr.415** dt.14.05.2019 lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk për dy netë akomodim, fatura tatimore me **nr.21** lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x Skrapar më dt. 29.05.2019, fatura tatimore e shitjes **nr.02** lëshuar nga subjekti akomodues x shpk Kukës më dt.04.05.2019 për dy netë fjetje, nuk janë firmosur nga **zj. x**, Zv/Drejtor i Përgjithshëm i SHKP. Fatura tatimore **nr. 30** lëshuar nga subjekti akomodues x në Korçë për dy netë fjetje, nuk është firmosur nga nëpunësja x. Fatura me **nr.446** lëshuar më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

dt.08.05.2019 nga subjekti akomodues **Hotel x** Vlorë.

1) Fatura në rubrikën emri i blerësit ka emrin e institucionit dhe jo të personit që i lëshohet. 2) Në rubrikën përshkrimi i mallit ose shërbimit janë shkruar emrat e **13** nëpunësve të përmbledhur në një faturë të vetme.

3) Në rubrikën blerësi ku duhet të jetë emër mbiemër dhe firma e personit i cili merr mallin ose shërbimin ka **9** nënshkrime pa emra.

4) Bashkëlidhur ka dhe fotokopje të faturës nr.446 të cilat i janë bashkëlidhur urdhër shërbimeve për secilin punonjës i cili është trajtuar me dietë. Fotokopjet e fatures tatimore të cilat janë bashkëlidhur për cdo urdhërshpenzim nuk kanë emër mbiemër apo nënshkrim në rubrikën blerësi, ndryshe nga fatura origjinale ku paraqitet e firmosur, fakt ky që tregon firmosjen jo në vend por në një kohë të mëvonshme.

5) Kuponi dhe fatura tatimore e shitjes kanë mos përputhje në data, kuponit tatimor është prerë më datë. 07.05.2019 dhe jo më dt.08.05.2019 sic duhej.

9. Urdhër shpenzimi nr.112 datë 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **44,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1377 me destinacion Kukës, Has, Tropojë nga data. 02.05.2019-04.05.2019, programit nr.1378 dt.30.04.2019 me destinacion rajonet Vlorë, Berat, Fier nga dt.06.05.2019-08.05.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019 në rajonin Dibër. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, është paguar nëpunësi x për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore nr.10 dt.11.05.2019 është lëshuar nga subjekti akomodues “x”, Dibër. Fatura është fotokopje, e pa firmosur dhe përmbledhëse në numër personash, nuk është e specifikuar ashtu sic duhet për personin i cili paguan për shërbimin që merr. Kuponi tatimor me **nr. 4** është fotokopje dhe ka cmim total e nuk ka tregues se për çfarë është kryer pagesa. Fatura tatimore e shitjes **nr.6** dt.10.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues “x” shpk për një natë fjetje, është fotokopje dhe jo e firmosur nga nëpunësi të cilit i është urdhëruar pagesa për këtë shërbim. Fatura tatimore e shitjes nr.416 dt.14.05.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “Hotel x” për dy netë akomodim, nuk është firmosur.

10. Urdhër shpenzimi nr.113 datë. 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **22,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1377 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, është paguar për këto shërbime titullari i SHKP, **Zjx.**

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes nr. 20 dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur. Vlera e faturës **6,000 lekë**.

Fatura tatimore e shitjes **nr. 01** dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur.

11. Urdhër shpenzimi nr.114 datë. 30.05.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, *shërbim i brendshëm* në shumën **88,000 lekë**,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

bazuar në programin e punës nr. nr. 1377 dt. 02.05.2019-04.05.2019, programit nr.1378 dt.30.04.2019 si dhe programin nr.1292 dt.19.04.2019. Sipas listëpagesës së dërguar në bankë, janë paguar **3** nëpunës për këto shërbime.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes nr. 24 dt.29.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur nga nëpunësi x. Vlera e faturës **6,000 lekë**. Fatura tatimore e shitjes nr. 54 dt.14.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetjen nuk është e firmosur nga nëpunësi x. Vlera e faturës **6,000 lekë**. Fatura tatimore e shitjes nr. 417 dt.14.05.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” për dy netë fjetje nuk është e firmosur. Vlera e faturës **6,000 lekë**.

12.Urdhër shpenzimi nr.124 datë. 07.06.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **shërbim i brendshëm diete** në shumën 27,500 lekë, bazuar në programin e punës nr.1634 dt.21.05.2019, me objekt angazhim auditimi i plotë në zyrën vendore të SHKP Kolonjë.

U konstatua se:

Sipas listëpagesës së dërguar në thesar dhe faturës tatimore nr.4000 lëshuar më dt.31.05.2019 nga subjekti akomodues x, vërehet se shuma për 4 netë fjetje është 6,000 lekë në total me cmim 1,500 lekë nata. Bazuar nga të dhënat e listëpagesës dhe faturës tatimore, konstatohet se nëpunëses së NJAB x, i janë paguar **6,000 lekë** më shumë se vlera faktike e paraqitur në faturë.

13. Urdhër shpenzimi nr.138 datë. 27.06.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **udhëtim i brendshëm** në shumën **11,000 lekë**, bazuar në programin e punës nr.1292 dt.19.04.2019 në rrethin e Beratit e Skraparit.

U konstatua se:

Në programin e punës është përcaktuar rrethi i Beratit e Skraparit, nga dt.06.06.2019 deri më 08.06.2019. Në urdhër shërbim vërehet ndryshim i destinacionit nga rrethi i Beratit në atë të Gjirokastrës. Fatura tatimore me nr.21 lëshuar më dt.08.06.2019 nga subjekti akomodues Hotel x, nuk është e firmosur nga zj. x, konkretisht titullar i institucionit.

14. Urdhër shpenzimi nr.159 datë 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, **udhëtim i brendshëm** në shumën **55, 000 lekë**, bazuar në programin e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019 si dhe programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019. Sipas listëpagesës janë paguar 4 nëpunës për shërbimet e kryera.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 x shpk Pukë me nr nipti. ... për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse, si dhe e pa firmosur nga punonjësit në listëpagesë të cituar : **x, x, x, x**.

15. Urdhër shpenzimi nr.160 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

shpenzimeve me objekt, ***udhëtim i brendshëm*** në shumën **178,640** lekë për **9** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019, programin nr. 1840 dt.12.06.2019 me destinacion rajonin e Dibrës nga dt.26.06.2019-28.06.2019, programit nr. 2118 dt. 08.07.2019 në rajonin e Korcës.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x 1900 x shpk Pukë me nr nipti. ... për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse me 12 emra punonjësish, si dhe e pa firmosur nga punonjësit në listëpagesë :**x, x, x, x, x, x**

16. Urdhër shpenzimi nr.161 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, ***udhëtim i brendshëm*** në shumën **11,000** lekë për **1** punonjës. Shërbimi është kryer bazuar programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019.

U konstatua se:

Fatura tatimore me nr.463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x shpk Pukë me nr nipti. ... për dy netë akomodim. Në rubrikën nr.1 ku përshkruhet malli ose shërbimi, janë paraqitur emrat e punonjësve të SHKP-së si dhe datat e akomodimit. Fatura tatimore e shitjes është fotokopje dhe përmbledhëse me **12** emra punonjësish, e pa firmosur nga punonjësit apo punonjësi i cili është paguar.

17. Urdhër shpenzimi nr.161 datë. 22.07.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, ***udhëtim i brendshëm*** në shumën **33,000** lekë për **1** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1937 dt.20.06.2019 me destinacion rrethin e Vlorës, nga dt.26.06.2017-28.06.2019, programit nr. 2118 dt. 08.07.2019 në rajonin e Korcës, programin nr. 2282 dt.15.07.2019 me destinacion rajonin e Shkodrës nga dt.15.07.2019-17.07.2019.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. 425 dt.28.06.2019 për **2** netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x shpk Vlorë, me nipt., fatura tatimore nr.641 dt.13.07.2019 për 2 netë akomodim lëshuar x Shpk me nipt. ... dhe fatura tatimore e shitjes me nr. 463 lëshuar më dt.17.07.2019 nga subjekti akomodues x shpk Pukë me nr nipti. ... për 2 netë akomodim nuk janë të firmosura nga zj. x, titullar i SHKP. **18. Urdhër shpenzimi nr.172** datë. 15.08.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, ***shërbim i brendshëm*** në shumën **132,000** lekë për **9** punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1889 dt.17.06.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec dhe programin nr.2354 dt. 18.07.2019 me destinacion rajonet, Fier, Vlorë e Gjirokastër.

U konstatua se:

Fatura tatimore e shitjes me nr. 2551 dt.02.08.2019 për **2** netë akomodim ëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Pogradec, me nipt. ... në vlerë **6,000 lekë** për dy netë fjetje, nuk është firmosur nga zj. x,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>zv/drejtor i përgjithshëm i SHKP. Fatura tatimore nr.460 dt.24.07.2019 për 2 netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Fier, me nipt. ... në vlerë 6,000 lekë, nuk është firmosur nga zj. x</p> <p>19. Urdhër shpenzimi nr.173 datë. 15.08.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, <i>shërbim i brendshëm</i> në shumën 22,000 lekë për 1 punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 1889 dt.17.06.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec dhe programin nr.2354 dt. 18.07.2019 me destinacion rajonet, Fier, Vlorë e Gjirokastrë.</p> <p><u>U konstatua se:</u></p> <p>Fatura tatimore e shitjes me nr. 453 dt.24.07.2019 për 2 netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel x” Fier, me nipt. ... në vlerë 6,000 lekë, nuk është firmosur nga zj. x. Fatura tatimore nr.936 dt.01.08.2019 për 2 netë akomodim lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” Pogradec, me nipt. ... në vlerë 6,000 lekë, nuk është firmosur nga zj. x.</p> <p>20. Urdhër shpenzimi nr.217-218 datë. 08.10.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, <i>shërbim i brendshëm</i> në shumën 132,000 lekë në total për 8 nëpunës të SHKP. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 2921 dt.02.09.2019 me destinacion rajonin Korce-Pogradec.</p> <p><u>U konstatua se:</u></p> <p>Fatura tatimore e shitjes me nr.209 dt.03.10.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “x” me nipt. është përmbledhëse për të gjithë punonjësit së bashku. Fatura nuk është firmosur nga të gjithë personat të cilët presupozohet të kenë kryer fjetjen. Emrat e nëpunësve që nuk kanë firmosur janë: x, x, x, x, x, x.</p> <p>11. Urdhër shpenzimi nr.245 datë. 07.11.2019, është kryer likuidimi i shpenzimeve me objekt, <i>shërbim i brendshëm</i> në shumën 137,500 lekë për 8 punonjës. Shërbimet janë kryer bazuar në programet e punës nr. 3489 dt.11.10.2019, program nr.3240/5 dt.04.10.2019, program nr.3512 dt.14.10.2019.</p> <p><u>U konstatua se:</u></p> <p>Për shërbimin në qytetin e Përmetit, fatura tatimore e shitjes me nr.44 dt.10.10.2019, lëshuar nga subjekti akomodues Hotel “x” me nipt. ... është përmbledhëse dhe jo e lëshuar për secilin nga nëpunësit. Fatura me nr.44 nuk është firmosur nga nëpunësit që supozohet të kenë marrë këtë shërbim. Fatura nr.198 dt.28.10.2019 lëshuar nga subjekti akomodues “x”, për dy netë fjetje, për datat.25.10.2019 dhe. 26.10.2019.</p> <p>Referuar kalendarit të vitit 2019 dhe përkatësisht datave 25-26.10.2019, rezulton se data 26.10.2019 ka qënë ditë e shtunë dhe jo ditë pune zyrtare. Fatura poashtu është përmbledhëse dhe jo e lëshuar për secilin punonjës.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe “Dokumentimi i vlerave monetare”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Ndikimi/Efekti:	Mos hartimi i gjurmës së auditimit, ka krijuar hapësirë në kryerjen e veprimeve jo në përputhje të kuadrit ligjor e financiar, mbi likuidimin e urdhërshpenzimeve për dieta e shërbime, duke shkaktuar dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	Sektori i Finances në SHKP të marrë masat që në çdo praktikë urdhërpagesa për shërbime dieta, fatura tatimore të jetë individuale për çdo punonjës dhe të firmosur nga personi përfitues e gjithë praktika shoqëruese.

Titulli i Gjetjes: 2	<i>Inventarizimi i pronës shtetërore.</i>
Situata:	<p>Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:</p> <p><u>Inventarizimi i vitit 2018:</u></p> <p>Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur sa më poshtë vijon: Para fillimit të procesit të inventarizimit nuk janë fiksuar numrat e fletë hyrjes dhe fletë daljeve, dhe nuk është dyllosur magazina sipas përcaktimeve të pikës nr 83 të UMF nr. 30/2011 është e përcaktuar se: Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një procesi verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.</p> <p>Procedura e sipërcituar në këtë paragraf është e nevojshme për kryerjen me seriozitet e rregullshme procesin e inventarizimit të pronës shtetërore. Veprimi i cili nuk është kryer e pasqyruar në informacionin drejtuar titullarit. . Nuk është kryer inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti apo në çdo proces të inventarizimit të kryer për periudhën objekt auditimi. Në shkelje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, “<i>çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.</i></p> <p>-Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve <i>nuk është hartuar raporti për inventarizimin e karburantit të SHKP për vitet 2018, 2019,</i> në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues</i>”. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>krijimit të aktivitetit.</p> <p>-Procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk jep informacion të plotë për të dhënat e aktiveve, sic përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr.30, që përcakton se “<i>ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit e të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale</i>”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Dokumentacioni lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit ka parregullësi e mangësi në paraqitjen dokumentare e sasiore.</p> <p><i>1- Vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre.</i></p> <p><i>2-Materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj.</i></p> <p><i>3- Janë shoqëruar me fotot përkatëse një pjesë e këtyre aktiveve në gjendje fillestare e përfundimtare të njëjtë, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.</i></p> <p><u>Inventarizimi i vitit 2019.</u></p> <p>Procesi i inventarizimit ka kaluar afatet e përcaktuara mbi 17 ditë kalendarike pa justifikim apo miratim përkatës nga NA i SHKP.</p> <p>Gjatë kqyrjes së kartelave të inventarit, kartela e aktiveve afatgjata me vlerë kontabile 19,190, 942 lekë, në përgjegjësi materiale të nëpunësve x dhe x rezultojnë e pa firmosur nga këta nëpunës. Fakt i cili nuk është reflektuar apo arsyetuar në raportin drejtuar titullarit të SHKP. Kartela e zyrës së IT në përgjegjësi të x dhe x me vlerë kontabile 678,483 lekë rezultojnë e parregullt pasi këta punonjës nuk janë pjesë e organikës së SHKP, duke ju referuar listpagesave dhe emrave të nëpunësve paraqitur nga zyra e burimeve njerëzore. Komisioni inventarizimit ka konstatuar se disa nga punonjësit kanë nga dy kompjutera në ngarkim pasi kanë marrë të rinj. Më tej komisioni ka rekomanduar magazinimin apo transferimin e tyre në institucione të tjera të varësisë.</p>
Kriteri:	UMF nr.30, datë. 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe “Dokumentimi i vlerave monetare”.
Ndikimi/Efekti:	Mos kryerja e veprimeve jo në përputhje të kuadrit ligjor duke mos i dhënë rëndësinë e duhur procesit të inventarizimit ka ekspozuar mundësinë e efekteve negative në Buxhetin e Shtetit.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarit.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	Komisioni i inventarizimit, i cili ngrihet çdo vit nga Titullari i Institucionit të SHKP-së të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.

Nëpunësi zbatues të kryejë rregullimin e kartelave rast pas rasti për punonjësit actual dhe ata të larguar duke dokumentuar saktë lëvizjet e brendshme të cdo aktiviteti sipas personave, të cilëve u ngarkohet dhe vendodhjen e tyre (sipas zyrave).

-Pajisjet e zyrave të paraqiten në cdo kartelë me llojin, tipin, numërin serial të secilës pajisje në mënyrë që lëvizja, nxjerrja jashtë përdorimit apo ndonjë procesi tjetër me qëllim verifikimin lehtësisht në cdo proces kontrolli nga auditi I brendshëm ose i jashtëm.

Kartelat duhet të firmosen nga të gjithë nëpunësit pa përjashtim gjatë procesit të inventarizimit duke i dhënë rëndësinë e duhur që mbart procesi I inventarizimit dhe përgjegjësia që bie mbi secilin anëtar apo nëpunës I cili ka aktive në ngarkim.

Procesi i asgjësimit të shoqërohet me fotot përkatëse të aktiveve në gjendje fillestare e përfundimtare, duke e faktuar asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit dhe eliminimin e dyshimeve të arsyeshme mbi kryerjen e këtij procesi sipas përcaktimeve ligjore në **Udhëzimin nr.30 datë.27.12.2011** e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

4. PËRPUTHSHMËRIA LIGJORE NË PLANIFIKIM DHE NË REALIZIMIN E PROKURIMIT TË FONDEVE PUBLIKE PËR MALLRA, PUNË DHE SHËRBIME TË REALIZUARA NGA AUTORITETI PËR PERIUDHEN 01.04.2018 DERI 31.12.2019

Në zbatim të pikës nr. 4, të Programit të Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, u kontaktua se:

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, SHKP për vitin **2018** janë kryer 32 procedura prokurimi, me vlerë 73,693,496.78 lekë me tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor SHKP, për vitin **2019** janë kryer 12 procedura prokurimi, me vlerë 29,183,236 lekë me tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, SHKP), për vitin **2018 (për periudhën 01.04.2018 deri 30.12.2018)** janë kryer 32 procedura prokurimi, me vlerë 73 693 496, 78 lekë me tvsh.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2018 (për periudhën **01.04.2018 deri 30.12.2019**) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2018 SHKP
Prokurime gjithsej	32 procedura
Vlera totale (me TVSH)	73 693 496, 78
Procedura të hapura	0
Procedura kërkesë për propozim	14
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	170
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	41



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit të kryera nga ky AK, u ushtrua bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik si dhe në aktet ligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, si dhe sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit 65/1 Prot, datë 21.01.2020, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së.

- Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar.
- Argumentimi dhe përlllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime.
- Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrat të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.
- Auditimi mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Mbi hartimin e nevojave, hartimi dhe dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike:

a. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike.

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

Tabela-Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.

	Emërtimi	Regjistri i parashiki pa tvsh	Regjistri i realizimit me tvsh
I	Sipas procedurave		
1	Procedura të kryera	93,444,200	68,651,740.2
2	Shtesa kontratash	0	0
3	Blerje të vogla	6,196,800	5,041,756.58
	Totali	99,641,000	73,693,496,78

Gjatë vitit 2018, DPSHKP nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, SHKP), për vitin **2019** deri në datën 31.1.2019 janë kryer 12 procedura prokurimi, me vlerë **29,183,236.14** lekë me tvsh.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2019 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2019 SHKP
Prokurime gjithsej	12 Proçedura
Vlera totale (me TVSH)	29,183,236. 14
Procedura të hapura	1
Procedura kërkesë për propozim	3
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	93
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	33

Mbi hartimin e nevojave, hartimi dhe dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike:

Tabela-Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	Emërtimi	Regjistri i parashiki pa tvsh	Regjistri i realizimit me tvsh
I	Sipas procedurave		
1	Procedura të kryera	35,320,000	25,190,690. 59
2	Shtesa kontratash	-	-
3	Blerje të vogla	5,500.000	3,992,545. 55
	Totali	40,820,000	29,183,236. 14

Gjatë vitit 2019, DPSHKP nuk ka realizuar kontratat shtesë .

Nga përzgjedhja e dosjeve të prokurimit , deri në 01.03.2020, është konstatuar se :

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin " *Rikonstruksioni i DRSHKP Shkodër* ", konstatohet se :

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i DRSHKP Shkodër 2018			
1. Urdhër Prokurimi Nr 1488 prot. Datë 22.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit	3.2 Komisioni i Shqyrtimit ankesave nr. 2183/1 prot. Datë 13.07.2018	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1488/1 datë 22.05.2018
ëLloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	x x x	x, x x.	x, x, x x
5. Fondi Limit (pa tvsh) 10,968,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 8,065,100 lekë		7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,902,900 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 04.06.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 13 b) S’kualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 7 OE
11. Ankimime AK- ka nr2183 prot. Datë 13.07.2018. KPP- Nuk ka	1ëPërgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 2183/3 prot. Datë 18.07.2018		
b. Zbatimi i Kontratës Punëve			
14. Lidhja e kontratës 24.08.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 9,678,120 lekë		

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP nr. 1488 prot. Datë 22.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 10,968,000 lekë pa TVSH, me objekt “Rikonstruksioni i DRSHKP Shkodër”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x.

Me urdhrin nr. 1488/1 datë 22.05.2018, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga x, x, x, x dhe x.

- Në dosjen e prokurimit nuk disponohet procesverbali i hartimit të kriterëve kualifikuese ku nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

- Nga Ak në pikën 2.3.3.d është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë një mjek të përgjithshëm (te vertetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se:*

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".

-Nga Ak në pikën 2.3.3.f është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të disponojë një Ekspert MKZ, (te vertetuar me kontrate pune të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndertimit., diplomë, çertifikata perkatese), e cila nuk është argumentuar nga njësia e prokurimit.

- Nga AK në pikën 2.3.3.a është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) periudha (Prill 2017 - Prill 2018), e cila nuk është argumentuar në përputhje me volumin dhe objektin e prokurimit.

- Me shkresën nr. 1488/3 datë 23.05.2018, njoftohen për pjesmarrje në tender OE, "x"shpk, "x"shpk, "x"shpk, "x"shpk, "x"shpk.

- Me urdhrin e titullarit nr. 1488/4 prot. Datë 01.06.2018, njoftohet pezullimi i procedurës së prokurimit publik, pasi APP ka njoftuar me e-mail, rishikime të DST.

APP ka vënë në vëmendje pikën 2.3.3.e, ku është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, (**me përvojë pune mbi 5 vjet**) të përfshirë në licensën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera pune dhe se autorizon Autoritetin Kontraktor.

Këtu sqarohet se punimet deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt bazuar Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2018 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

- Me urdhërin e titullarit nr. 1488/5 prot. Datë 01.04.2018, hiqet pezullimi i procedurës, pasi u rishikuar kërkesat kualifikuese nga njësia e prokurimit, në lidhje me drejtuesin teknik.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 13 OE me ofertat si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“XS”	6,253,967	S'kualifikuar
2	“X”	6,901,741	S'kualifikuar
3	“X”	6,963,108	S'kualifikuar
4	“X”	7,377,846	S'kualifikuar
5	“X” & “X”	8,065,100	Kualifikuar
6	“X”	8,068,625	S'kualifikuar
7	“X”	8,602,372	kualifikuar
8	“X”	9,119,909	kualifikuar
9	“X”	9,391,657	kualifikuar
10	“X”	9,479,077	kualifikuar
11	“X” sh.p.k. & “X”	9,623,594	kualifikuar
12	“X”	10,199,863	kualifikuar
13	“X”	Pa ofertë	S'kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.
2. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.
3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.
4. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.
5. Operatori Ekonomik “” sh.p.k.
6. Operatori Ekonomik “” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk paraqiti ofertë ekonomike si dhe të gjithë dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi

- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika c – Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:, **1 murator;**

Dëshmia e kualifikimit e sigurimit teknik për muratorin është e pavlefshme, afati i vlefshmërisë ka përfunduar më datë 01.05.2018.

- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.8 “Operatori Ekonomik duhet të deklarojë paraprakisht se do të bëjë tokëzimin dhe nulifikimin e të gjithë pajisjeve elektrike në kantier si vincat, elektrobetonierat” të Dokumentave Standarte të Tenderit dhe konkretisht :

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën se paraprakisht do të bëjë tokëzimin dhe nulifikimin e të gjithë pajisjeve elektrike në kantier si vincat, elektrobetonierat.

Në lidhje me s’kualifikimin e këtij operatori ekonomik, konstatohet se bazuar në LPP **neni 53** pika 4 citon se: “*Ak vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korigjohen pa prekur përmbajtjen e saj*”, Nga AK duhej të merrte parasysh ofertën ekonomikisht më të ulët, bazuar cmimit më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

të ulët, pasi arsyet e s’kualifikimit nuk do të ndikonin në realizimin me sukses të kontratës. Lidhur me OE “x”shpk, konstatohet se ky operator ekonomik, plotëson plotësisht kapacitet ekonomike dhe teknike për të realizuar me sukses kontratën e punimeve. Kualifikimi i tij bazuar në vlerësimin e cmimit më të ulët do të sillte mirëpërdorim të findeve publike, bazuar në LPP, me oferta më e leverdishme për AK.

Në zbatim të nenit **55 të LPP** Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese pika 1/b citohet:

Oferta fituese duhet të jetë, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvritimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.

3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi -Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3. “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika b - Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) periudha (Prill 2017 - Prill 2018), kjo e vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën (Prill 2017 - Prill 2018). Liste pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025 a) për periudhën (Prill 2017 - Prill 2018). Të konfirmuara nga Administrata Tatimore.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik për periudhën Prill 2017 – Prill 2018 një numër i caktuar punëmarësish, të njëjtit persona, deklarohen si punësime rishtazi çdo muaj.

Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, si dhe konfirmimit nga institucioni kompetent në bazë të ligjit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklaratime të rregullta dhe punësime të rregullta, duke mos plotësuar kriterin për një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave.

- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika f. – Operatori Ekonomik duhet të disponojë një Ekspert MKZ, (të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit, diplomë, çertifikata përkatëse).

Mungonte kontrata e punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit dhe diploma për Ekspertin e MKZ.

4. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi Oferta ekonomike e paraqitur nuk është e rregullt.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në ofertë të gjithë zërat e preventivit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit. Në preventivin e paraqitur munojnë pajisjet. (Pajisjet elektrike dhe të kondicionimit, pajisjet MNZ dhe pajisjet hidroteknike).

5. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3. “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika b



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) periudha (Prill 2017 - Prill 2018), kjo e vërtetuar me:
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën (Prill 2017 - Prill 2018)
- Liste pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025 a) për periudhën (Prill 2017 - Prill 2018). Të konfirmuara nga Administrata Tatimore.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik për periudhën Prill 2017 – Prill 2018 një numër i caktuar punëmarësish, të njëjtit persona, deklarohen si punësime rishtazi çdo muaj.

Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, si dhe konfirmimit nga institucioni kompetent në bazë të ligjit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklarime të rregullta dhe punësime të rregullta, duke mos plotësuar kriterin për një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave.

6. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k. Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3. “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika b ***Për sa trajtuar më sipër***, konstatohet dëme ekonomike të shkaktuara buxhetit të shtetit, ku OE “x”shpk ka patur kapacitete të plota ekonomike dhe teknike për realizimin e kontratës e cila, duhej të kishte parim cmimin më të ulët.

Ofertat më e leverdishme e “x”;, me vlerë 6,901,741 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për SHKP, në përputhje me parimet e economicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Mos plotësimi i pikave në raportin e KVO, nga operatori ekonomik nuk do të cenonte objektin e prokurimit pasi rinovimi i certifikimit është thjeshtë marëdhënie e OE me kompaninë certifikuese, jo se specialistët kanë nuk dinë të realizojnë punën e tyre, të kryer edhe më parë. Kontratohet se Oe “x”, ka mjaftueshëm punë të ngjashme me nxhinierë ndërtimi, ku puna sipas preventivit me 35 m³ “Mur me tulle të lehtësuara dopio deri 3m me llaç perzier M25”, do të realizohej lehtësisht.

Në lidhje me pretendimin se mungon deklarata mbi tokëzimin dhe nulifikimin e pajisjeve elektrike, sqarohet seky OE ka paraqitur deklaratën që do u përmbahet specifikimeve teknike dhe projektit, pjesë e së cilës është dhe tokëzimi dhe nulifikimi i pajisjeve elektrike.

Po ashtu OE ka paraqitur edhe një plan organizimi të punës, ku përfshihen në brendësi se ky proces pune do kryhet nga ana tyre.

Pra nëse autoriteti kontraktor do të kishte vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët.

Diferenca e vlerës prej **1,396,030 lekë me TVSH** (8,065,100 lekë - 6,901,741 lekë = 1,163,359 lekë x 20%), midis ofertës së “x” sh.p.k dhe ofertën e BOE “x”&“x”shpk, **përbën dëm ekonomik, të shkaktuar nga vlerësimi i ofertave.**

ëNga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksioni i DRSHKP Fier** ", konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

1. Urdhër Prokurimi Nr 3151 prot. Datë 21.09.2018	3.1 Njësia e Prokurimit x x x	3.2 Komisioni i Shqyrtimit ankesave .	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1488/1 datë 22.05.2018 x x x x
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,844,180 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 7,722,477 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,121,703 lekë	
8. Data e hapjes së tenderit Data 04.10.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 21 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 16 OE	
11. Ankimime	1ëPërgjigje Ankesës nga AK		
b. Zbatimi i Kontratës Punëve			
14. Lidhja e kontratës 02.11.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 9,266,972 lekë		

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP nr. 3151 prot. Datë 21.09.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 11,844,180 lekë pa TVSH, me objekt “Rikonstruksioni i DRSHKP Fier”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x. Me urdhrin nr. 1488/1 datë 22.05.2018, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga x, x, Pranvera Shehu, x dhe x.

- Në dosjen e prokurimit nuk disponohet procesverbali i hartimit të kriterëve kualifikuese ku nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

- Nga Ak në pikën 2.3.3.b është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë një mjek të përgjithshëm (të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV).

Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte vendosur si kriter kualifikues. Kërkesa e mjekut të ndermarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” konstatohet se:

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, **shfuqizohet.**

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

- Nga Ak në këtë procedurë prokurimi nuk është kërkuar Operatori Ekonomik duhet te disponoje nje Ekspert MKZ, (te vertetuar me kontrate pune te vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit., diplomë, çertifikata perkatese), sic është kërkuar në DST për object prokurimi “ Rikonstruksioni I DRSHKP Shkodër, ku konstatohet përdorim i dy sandardëve të ndryshme.

- Nga AK në pikën 2.3.3.a është kërkuar që Operatori ekonomik duhet te kete një punësim mesatar mujor i të paktën 24 (njëzet e pesë) personave, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) periudha (Prill 2017 - Prill 2018), e cila nuk është argumentuar në përputhje me volumin dhe objektin e prokurimit.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“x	9,931,577	Kualifikuar
2	x	10,735,746	Kualifikuar
3	x	9,922,932	Kualifikuar
4	x	9,276,470	Kualifikuar
5	x	9,237,984	Kualifikuar
6	x	8,936,730	Kualifikuar
7	x	Pa oferte	S'kualifikuar
8	x	8,442,166	kualifikuar
9	x	8,148,530	kualifikuar
10	x	7,722,477	Kualifikuar/ Fituesi
11	x	9,703,143	kualifikuar
12	x	8,957,863	kualifikuar
13	x	9,472,612	Kualifikuar
14	x	8,847,249	Kualifikuar
15	x	8,793,703	Kualifikuar
16	x	9,187,415	Kualifikuar
17	x	9,531,598	Kualifikuar
18	x	9,873,157	S'kualifikuar
19	x sh.p.k.	10,963,802	Kualifikuar
20	x sh.p.k.	9,696,442	Kualifikuar
21	x” sh.p.k.	8,498,414	Kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk paraqiti ofertë ekonomike si dhe të gjithë dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit pasi:

Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, makineritë” të Dokumentave Standarte të Tenderit dhe konkretisht:

Pika b - Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën 24 (njëzet e katër) punonjësve, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) për periudhën (Qershor 2018 - Gusht 2018), kjo e vërtetuar me: Listë pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025 a) për periudhën (Qershor 2018 - Gusht 2018).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se për operatorin ekonomik për periudhën Qershor 2018 - Gusht 2018 një numër i caktuar punëmarësish, të njëjtit persona, deklarohen si punësime rishtazi çdo muaj. Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklarime të rregullta dhe punësime të rregullta, duke mos plotësuar kriterin për një punësim mesatar mujor i të paktën 24 (njëzet e katër) punonjësve për periudhën (Qershor 2018 - Gusht 2018).

Duke iu referuar procedurës së mësipërme Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k. me vlerë prej 7,722,477 lekë.pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin “Rikonstuksion i pjesshem i DRFPP Durres”, konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rikonstuksion i pjesshem i DRFPP Durres 2018</i>		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 11,704,550 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 6,863,330 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,841,220 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data 19. 11. 2018	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 23 b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 20 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP kryhet prokurimi i fondit prej 11,704,550 lekë pa TVSH, me objekt “Rikonstuksion i pjesshem i DRFPP Durres”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga x, x, x, x, x.

- Në DST mbi kriteret kualifikuese nuk janë argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- Nga Ak në pikën 2.3.3 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te disponoje nje mjek te pergjithshem (te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV).

Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë ne stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim te VKM nr. 742, date 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se:*

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".

- Nga Ak në këtë procedurë prokurimi nuk është kërkuar Operatori Ekonomik duhet te disponoje nje Ekspert MKZ, (te vertetuar me kontrate pune te vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit., diplomë, çertifikata perkatese), sic është kërkuar në DST për object prokurimi “ Rikonstruksioni I DRSHKP Shkodër, ku konstatohet përdorim i dy sstandardeve të ndryshme.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	x	6,863,330	Kualifikuar/ Fituesi
2	x	6,883,975	Kualifikuar
3	x	6,985,086	Kualifikuar
4	x	7,100,019	Kualifikuar
5	x.	7,111,039	Kualifikuar
6	x	7,416,439	Kualifikuar
7	x	7,490,690	Kualifikuar
8	x	7,499,358	kualifikuar
9	x'	7,500,000	kualifikuar
10	x	7,582,326	kualifikuar
11	"x"	7,686,192	kualifikuar
12	x	7,795,357	kualifikuar
13	x	7,906,444	Kualifikuar
14	x	7,923,455	Kualifikuar
15	x	8,343,814	Kualifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

16	x		8,404,149	Kualifikuar
17	x		8,636,933	Kualifikuar
18	x		8,951,973	Kualifikuar
19	x		9,262,839	Kualifikuar
20	x		10,001,010	Kualifikuar
21	x		Pa ofertë ekonomike	S’Kualifikuar
22	x		10 158 688	S’Kualifikuar
23	x SHPK		10 590 220	S’Kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k.

3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k,

S’kualifikimet e mësipërme u konstatuan në përputhshmeri me LPP dhe të DST.

Informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, se oferta e paraqitur, me vlerë 6,863,330 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksion i DRSHKP Kukes**", konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rikonstruksion i DRSHKP Kukes, 2018</i>		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
Afati kohor për ekzekutimin e kontratës 30 ditë		
4. Fondi Limit (pa tvsh) 5.998.845 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 3,627,675 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,371,170 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data 1ë10. 2018	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 15 b) S’kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 16 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Në DST mbi kriteret e vecanta kualifikuese kërkohet si në cdo procedurë e realizuar prokurimi kërkohen:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.3 Për kapacitetin teknik (punë të ngjashme, licensa profesionale, Staf i kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet, makineritë).

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit Duke iu referuar procedurës, informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, se oferta me vlerë 3,627,675 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme, e cila është **me cmimin më të ulët.**

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksion i ZVP Pogradec**", konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rikonstruksion i ZVP Pogradec, 2018</i>		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës 60 ditë	x	x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 5,445,467 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 3,265,910 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,179,557 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data : 10.09.2018	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 13 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 11 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Në DST mbi kriteret e vecanta kualifikuese kërkohet si në cdo procedurë e realizuar prokurimi kërkohen:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.3 Për kapacitetin teknik (punë të ngjashme, licenca profesionale, Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet, makineritë).

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit Duke i referuar procedurës, informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, se oferta me vlerë 3,265,910 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme, e cila është **me cmimin më të ulët.**

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksion i ZVSHKP Kucove**", konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion i ZVSHKP Kucove, 2018		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
Afati kohor për ekzekutimin e kontratës 30 ditë	x	x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 4,326,933 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,808,451 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,518,482 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data : 19.10.2018	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 16 b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 12 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Në DST mbi kriteret e vecanta kualifikuese kërkohet si në cdo procedurë e realizuar prokurimi kërkohen:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.3 Për kapacitetin teknik (punë të ngjashme, licenca profesionale, Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet, makineritë).

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit Duke i referuar procedurës, informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, se oferta me vlerë 2,808,451 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme, e cila është **me cmimin më të ulët.**

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksion i ZVSHKP Tropoje**" konstatohet:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rikonstruksion i ZVSHKP Tropoje, 2018</i>		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
Afati kohor për ekzekutimin e kontratës 30 ditë	x	
4. Fondi Limit (pa tvsh) 4,293,000 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,591,004 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,701,996 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data : 08.10.2018	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 4 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Në DST mbi kriteret e vecanta kualifikuese kërkohet si në cdo procedurë e realizuar prokurimi kërkohen:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.3 Për kapacitetin teknik (punë të ngjashme, licenca profesionale, Staf kryesor e mbeshtetës, punonjesit, çertifikimet, makineritë).

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit Duke iu referuar procedurës, informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, se oferta me vlerë 2,591,004 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme, e cila është **me cmimin më të ulët**.

Nga sa më sipër për 4 procedurat e prokurimit:

1. Rikonstruksion i DRSHKP Kukës, me hapje të tenderit datë 12.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë.

ëRikonstruksion i ZVP Pogradec, me hapje të tenderit datë **10.09.2018** dhe afat zbatimi të kontratës 60 ditë.

3. Rikonstruksion i ZVP Kucovë, me hapje të tenderit datë 19.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë.

4. Rikonstruksion i ZVP Tropojë, me hapje të tenderit datë 08.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë.

Konstatohet se është shpallur fitues OE “x” shpk, i cili ka pasur ofertat më të ulëta, por ky operator ka ofertuar në tenderin për rikonstruksionin e ZVP Tropojë, Kukës dhe Kucovë, ku ka pas punë në proces për rikonstruksionin e ZVP Pogradec.

Kontratat e rikonstruksionit, janë të shpërndara në hapësira gjeografike të largëta (në Kukës, Pogradec, Kucovë, Tropojë), me të njëjtin dokumentacion financiar dhe teknik dhe të njëjtat mjete.

Pra nga shpallja fitues e këtij operatori ekonomik në shum kontrata edhe pse është me cmimin më të mirë ekonomik, por riskoheshin punimet dhe nga AK, ky OE duhej të skualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë, të njëjtin dokumentacion, për rikonstruksione punimesh në hapësira të largëta gjeografike.

Gjithashtu nga ky operator janë realizuar një sër deklatash si Deklarata mbi kontratat e lidhura apo ne proces, Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe Deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, por nuk plotësohet asnjëra prej tyre, pasi mjetet janë të angazhuara në kontratën e rikonstruksionin e ZVP Pogradec.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin **“Rikonstrukcion i D.R. të SHKP Berat”** konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rikonstrukcion i D.R. të SHKP Berat, 2019</i>		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 13,044,007 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 7,999,994 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,044,013 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data 29/07/2019 ndryshuar sipas shtojcës më datë 05/08/2019.	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 22 b) S'kualifikuar 14 OE, c) Kualifikuar 8 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP kryhet prokurimi i fondit prej 13,044,007 lekë pa TVSH, me objekt “x të SHKP Berat”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga x, x, x, x, x.

- Në DST mbi kriteret kualifikuese nuk janë argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: *“Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

- Nga Ak në pikën 2.3.3 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë një mjek të përgjithshëm (te vertetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV). Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” konstatohet se: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet.*

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- Nga AK në pikën 2.3.3.b, është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën **35** punonjësve, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) për periudhën (Prill 2019- Maj 2019 - Qershor 2019), e cila nuk është argumentuar në përputhje me volumin dhe objektin e prokurimit.

Gjithashtu me shtocjën nr. 1 datë 02.07.2019, ndryshohet ky kriter duke e kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën **25** punonjësve, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) për periudhën (Prill 2019- Maj 2019 - Qershor 2019), e cila përsëri nuk është argumentuar.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	x	10,402,839	S'Kualifikuar
2	x	9,964,184	S'Kualifikuar
3	“x”	9,260,276	Kualifikuar
4	“x”	8,782,916	S'Kualifikuar
5	x	7,999,994	Kualifikuar/ Fituesi
6	“x	8,936,034	S'Kualifikuar
7	“x”	7,917,098	S'Kualifikuar
8	“x”	9,700,000	kualifikuar
9	“x”	8,416,481	S'kualifikuar
10	“x”	9,125,560	kualifikuar
11	“x”	Pa ofertë	S'kualifikuar
12	“x”	9,057,363	kualifikuar
13	“x”	7,987,176	S'Kualifikuar
14	“x”	9,091,808	S'Kualifikuar
15	“x”	10,406,997	S'Kualifikuar
16	“x”	10,393,800	Kualifikuar
17	“x”	12,593,517	Kualifikuar
18	“x”	10,243,450	S'Kualifikuar
19	“x”	9,966,722	S'Kualifikuar
20	“x”	11,005,654	S'Kualifikuar
21	“x”	10,833,011z	S'Kualifikuar
22	“x”	10,541,737	Kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk permbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të veçanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikistë; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019). Dy punonjësit x dhe x, kanë dëshmi kualifikimi për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Punëtor ndërtimi dhe jo për specialist ndërtimi. Të gjithë personat e punësuar të kërkuar në pikën e mësipërme: muratori x, elektrikisti x, hidrauliku x, bojaxhiu x dhe punëtorët e ndërtimit x dhe x, rezultojnë me nga një ditë pune në listëpagesat e muajit prill, maj, qershor 2019. Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklarime të rregullta dhe punësime të rregullta.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik mungon vetdeklarimi sipas Shtojcës 8 që:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialist ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019 - Qershor 2019). Operatori ekonomik nuk dëshmon se ka të punësuar një specialist ndërtimi me kontratë pune dhe dëshminë përkatëse të kualifikimit (x dhe x kanë dëshmi kualifikimi për karpentier).

4. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019). Operatori Ekonomik ka vetëm 1 elektrikist sipas kriterëve të kërkuara pasi elektrikisti x dhe elektrikilisti x mungojnë në listëpagesat e muajve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

të kërkuar. ëNë dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik mungon shtojca 8/1 “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”.

5. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

1.Operatori ekonomik x shpk, nuk ka paraqitur një deklaratë të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e x (pika 2.3.3/b, paragrafi i tretë i kriterëve të vecanta)

Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë). Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën (Prill 2019- Maj 2019 - Qershor 2019), shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune e vlefshme; Diplomë;

por një deklaratë në të cilën ka listuar 15 persona, të cilët i deklaroi si Drejtues Teknikë.

Deklarimi konsiderohet i pasaktë pasi liston pothuaj të gjithë drejtuesit teknikë që janë në licencën e shoqërisë (8 inxhinierë të ndryshëm) si dhe staf tjetër teknik të mesëm e specialistë të tjerë, që nuk përmbushin kriterin e përcaktuar.

Në deklaram vërehen mospërputhje:

-x, inxhinier gjeolog (i pa specifikuar në kërkesat e Autoritetit Kontraktor), deklaruar si drejtues teknik, është në licencën e shoqërisë por nuk figuron në listëpagesat e muajve prill-maj-qershor.

-x, me diplome bachelor për inxhinier elektrik nuk figuron në licencën e shoqërisë, operatori e ka paraqitur si staf i kualifikuar me dëshmi kualifikimi për elektrikist, duke plotësuar në këtë mënyrë vetëm kriterin e përcaktuar për këtë qëllim.

-x dhe x, të listuar si drejtues teknike nuk figurojnë në licencën e shoqërisë. Janë kontraktuar dhe paraqesin dëshmi kualifikimi si specialistë të fushave përkatëse dhe gjenden edhe në listëpagesat e shoqërisë.

Punonjësit e tjerë:

-x - specialist termoteknik, - x - specialist termoteknik, - x - specialist instalator termoteknik dhe - x - specialist instalator termoteknik, nuk janë të deklaruar në listë pagesat e shoqërisë për muajt Prill-Maj - Qershor 2019 dhe as në licencë.

ëOperatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. 2.3.3.a Operatori Ekonomik të ketë në stafin drejtues minimumi: 1 (një) inxhinier ndertimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019 – Qershor 2019). Për secilin duhet të paraqiten: - Kontratë e vlefshme e punës. –Diploma.

-Mungon inxhinieri elektrik. (Inxhinieri x është inxhinier i diplomuar në radioelektronik. Nuk ka diplomë për inxhinier elektrik).

6. Operatori Ekonomik “x” sh.a.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.a. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik.

Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin drejtues minimumi: 1 (një) inxhinier ndertimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019 – Qershor 2019). Për secilin duhet të paraqiten: - Kontratë e vlefshme e punës. –Diploma.

-Mungon Inxhinieri Mekanik

-Inxhinieri Hidroteknik x ka kontratë pune dhe rezultoi i deklaruar në listëpagesa nga 16 maji 2019. Nuk figuron në listëpagesat e muajit prill.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Inxhinieri Elektrik x ka kontratë pune dhe rezultoi i deklaruar në listëpagesa nga 16 maji 2019. Nuk figuron në listëpagesat e muajit prill. Operatori ekonomik nuk paraqet licencën paraardhëse për të verifikuar ndryshimin e drejtuesit teknik.

7. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

8. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush piken 2.3.3/b (paragrafi i dyte) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik.

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikistë; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019 – Qershor 2019).

-Nga verifikimi rezultoi se: operatori ekonomik nuk paraqet dy specialistë ndërtimi por vetëm një, (x). x i deklaruar si specialist ndërtimi është mekanik.

-Në listëpagesat e muajit (prill 2019 – maj 2019 – qershor 2019), x, bojaxhi, deklarohet i punësuar 2 ditë cdo muaj, x dhe x, të punësuar me nga 5 ditë cdo muaj. Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se keto deklarime nuk konsiderohen të rregullta.

9. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik.

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019).

-Mungon një specialist ndërtimi pasi x ka IQT si murator/ karpenter dhe kontratën e punës nuk e ka në përputhje me kualifikimin.

10. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

lëshuar nga Institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialiste ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019).

-Operatori ekonomik nuk plotëson kushtin për punësimin e dy elektricistëve për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019), specialisti elektrikist x – në muajin prill 2019 është deklaruar i punësuar 5 ditë pune, në muajin Maj 2019 nuk figuron në listë pagesë dhe në muajin qershor 2019 figuron për 18 ditë pune.

11. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019). Punonjësi i deklaruar si bojaxhi- x, nuk është i deklaruar në listë pagesat e periudhës (Prill 2019 – Maj 2019 - Qershor 2019).

12. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i parë) Dëshmi për fuqine punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar mujor i të paktën 25 (Njëzetë e pesë) punonjësve, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) për periudhën (Prill 2019- Maj 2019 - Qershor 2019), kjo e vërtetuar me: Listë pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025 a) për periudhën (Prill 2019 - Maj 2019 - Qershor 2019). Operatori ekonomik nuk e plotëson kriterin e punësimit të 25 punonjësve. Nga verifikimi i listë pagesave figuron se janë të deklaruar 31 punonjës nga të cilët vetëm 12 janë me ditë të plota pune, të gjithë të tjerët janë me deklarime 2 ose 3 ditë pune.

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019- Qershor 2019). Operatori ekonomik ka paraqitur një specialist ndërtimi, x dëshmia e kualifikimit të të cilit nuk paraqet afatin e vlefshmerisë, faqen e dytë; Të gjithë specialistet: x - teknik ndërtimi, x - elektrikist, x, x, x, x, x, rezultojnë me nga 2 ose 3 ditë pune në listëpagesat e muajit prill, maj, qershor 2019. Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, këto deklarime nuk konsiderohen të rregullta.

13. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, makineritë. Operatori ekonomik te kete ne stafin drejtues minimum:1 (një) inxhinier ndertimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listepagesën e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 - Maj 2019 - Qershor 2019). Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë e vlefshme e punës, Diploma. x, e cila ka lidhur kontratë si inxhinierë ndërtimi, nuk figuron në Licencën e operatorit ekonomik x shpk. Ndërsa për Inxhinierët x, x, x, nga listepagesat rezulton janë të deklaruar dhe paguar sigurimet shoqërore për periudhën (Prill 2019 - Maj 2019 - Qershor 2019) me vetëm nga 3 ditë pune në cdo muaj.

Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, keto deklarime nuk konsiderohen të rregullta.

14. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i parë) Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshem për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuar nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 specialistë ndërtimi; 2 elektrikiste; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2019 – Maj 2019 - Qershor 2019).

Ka paraqitur informacion të pasaktë (të rremë) lidhur me listpagesat e muajit prill (kopje e modifikuar e listepagesave të muajit shkurt), e vertetuar kjo edhe me dokumentin L01326020F - 30-07-2019 të paraqitur nga operatori ku deklarimi i kontributeve për punonjesit në muajin prill është 0 lekë. Gjithashtu nga verifikimet e bëra në portalin e-Albania, për pagimin e kontributeve për individë, për gjithë stafin teknik rezulton se mungon deklarimi i muajit prill. Specialistet e kërkuar dhe të deklaruar kanë dokumentacion të parregullt: Bojaxhiu x (H31119047K), elektrikistët x (J00410160E) dhe x (G50128042O), paraqesin të njejtin dokument si faqe të dytë të dokumentit që vërteton certifikimin për Dëshmine e Kualifikimit të Sigurimit Teknik. Kontratat e punës së elektrikistëve dhe të bojaxhiut janë të parregullta, faqja e dytë e kontratës së punës rezulton e modifikuar. Hidrauliku x (G41020084Q) dhe muratori x (H80225038B) kanë paraqitur të njejtin dokument të faqes së dytë në Dëshmine e Kualifikimit të Sigurimit Teknik. Nuk paraqet Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik për dy specialistë ndërtimi por për dy suvatues. Njeri prej tyre, x (I60104059G), faqen e dytë të dëshmisë së kualifikimit e ka të njejtë me atë të paraqitur për bojaxhiun dhe elektrikistët. x, muratori x dhe hidrauliku x janë të punësuar me nga një ditë dy muajt e fundit.

Referuar procedurës, informohet se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “x” & “x” sh.p.k, me një vlerë të përgjithshme prej 7,999,994 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Më datë 26.08.2019, është paraqitur ankesa pranë Autoritetit Kontraktor nga Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Nga Autoriteti Kontraktor i është kthyer përgjigje, duke e refuzuar ankesën, më datë 02.09.2019.

Më datë 09.09.2019, është paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Nga Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin 663/2019, i është kthyer përgjigje, duke refuzuar ankesën.

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin “Rehabilitimi i zyrave ekzistuese të DR të ShKP Durrës dhe përshtatje e tyre për kurse trajnimi” konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i zyrave ekzistuese të DR të ShKP Durrës dhe përshtatje e tyre për kurse trajnimi, 2019		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 9,982,287 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 5,829,120 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,153,167 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data 07/10/2019	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 28 b) S’kualifikuar 11 OE, c) Kualifikuar 17 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP kryhet prokurimi i fondit prej 9,982,287 lekë pa TVSH, me objekt “Rehabilitimi i zyrave ekzistuese të DR të ShKP Durrës dhe përshtatje e tyre për kurse trajnimi”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga x, x, x, x, x.

-Në DST mbi kriteret kualifikuese nuk janë argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

- Nga Ak në 2.3.7 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë një mjek të përgjithshëm (të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV). Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.*

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

Në fund të kushteve të vecanta citohet se :

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Gjithashtu OE pjesëmarrës duhet të plotësojnë shtojcën 10 “*Deklaratë mbi Kontratat e lidhura dhe/ose në proces*”. Deklarata ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	x	5,829,120	Kualifikuar
2	x	5,999,920	Kualifikuar
3	x	6,814,682	Kualifikuar
4	x	6,943,630	Kualifikuar
5	x	6,994,640	Kualifikuar
6	x	7,264,360	Kualifikuar
7	x	7,734,623	Kualifikuar
8	x	7,977,430	Kualifikuar
9	x	7,985,829	Kualifikuar
10	x	8,000,000	Kualifikuar
11	x	8,151,139	Kualifikuar
12	x	8,254,016	Kualifikuar
13	x	8,384,620	Kualifikuar
14	x	8,454,980	Kualifikuar
15	x	8,487,346	Kualifikuar
16	x	8,489,520	Kualifikuar
17	x	8,957,625	Kualifikuar
18	x	7,627,470	S'Kualifikuar
19	x	6,228,435	S'Kualifikuar
20	x	6,877,795	S'Kualifikuar
21	x	7,937,604	S'Kualifikuar
22	x	7,902,605	S'Kualifikuar
23	x	7,074,150	S'Kualifikuar
24	x	Pa oferte	S'Kualifikuar
25	x	7,879,850	S'Kualifikuar
26	x	6,868,705	S'Kualifikuar
27	x	6,854,270	S'Kualifikuar
28	x	7,500,330	S'Kualifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

ëOperatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

4. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

5. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

6. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

7. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të vecanta:

-Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

8. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të vecanta:

-Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.5 të kriterëve të vecanta.

9. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

-Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

10. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit pika 1/a
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.4:
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur stafin drejtues
- Operatori ekonomik nuk permbush piken 2.3.5 të kriterëve të vecanta.
- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të vecanta.
- Operatori Ekonomik duhet të disponoje një mjek të përgjithshëm (të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Urdhër mjeku).
- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të vecanta.
- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca9):
- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta.

11. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të vecanta:
- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.5 të kriterëve të vecanta.
- Nuk plotësonte kriterin e kërkuar sipas pikës 2.3.4 të kriterëve të vecanta.

Duke iu referuar procedurës, informohet Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “x” & “x sh.p.k”, se oferta e paraqitur, me një vlerë 5,829,120 leke pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23. 10. 2019.

Procedura e prokurimit më datë 30.10.2019, ka patur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor dhe më datë 04.11.2019, nga Autoriteti Kontraktor është kthyer përgjigje, duke e refuzuar ankesën.

10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin “Rikonstruktion i Z.V. te SHKP Malesi e Madhe” konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruktion i Z.V. te SHKP Malesi e Madhe”, 2019		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për Propozim”	2 Njësia e Prokurimit x x x	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave x x x x x
4. Fondi Limit (pa tvsh) 6,367,195 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 4,002,910 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,364,285 lekë
7. Data e hapjes së tenderit Data 08/07/2019	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 12 b) S’kualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 6 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të SHKP kryhet prokurimi i fondit prej 9,982,287 lekë pa TVSH, me objekt “Rikonstruktion i Z.V. te SHKP Malesi e Madhe”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga x, x, x. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga x, x, x, x, x.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- Në DST mbi kriteret kualifikuese nuk janë argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

- Nga Ak në 2.3.3 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të disponojë një mjek të përgjithshëm (të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV). Mjek i ndermarrjes (një).

Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndermarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.*

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me hapjen e ofertave dhe sipas njoftimit të fituesit elektronikisht, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	x	4,002,910	Kualifikuar
2	x	4,166,692	Kualifikuar
3	x	4,308,261	Kualifikuar
4	x	4,618,093	Kualifikuar
5	x	5,534,608	Kualifikuar
6	x	5,689,719	Kualifikuar
7	x	4,264,685	S'Kualifikuar
8	x	4,290,112	S'Kualifikuar
9	x	3,925,126	S'Kualifikuar
10	x	4,530,666	S'Kualifikuar
11	x	4,642,073	S'Kualifikuar
12	x	4,438,723	S'Kualifikuar

KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

1. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. 2.3.3.a Operatori Ekonomik të ketë në stafin drejtues minimumi: 1 (një) inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e shoqërisë dhe në listepagesën e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë e vlefshme e punës. Diploma. Në dokumentacionin e paraqitur inxhinieri i ndërtimit x nuk figuron në listepagesat e muajit mars. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 specialist ndërtimi; 1 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Specialisti i ndërtimit x, muratori x, elektrikisti x, hidrauliku x, bojaxhiu x rezultojnë me nga një ditë pune në listepagesat e muajit mars, prill dhe maj.

Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklarime të rregullta dhe punësime të rregullta.

Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 specialist ndërtimi; 1 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Operatori ekonomik ka paraqitur dy specialistë muratorë. x nuk figuron në listepagesat e muajve mars – prill 2019, për muratorin tjetër x nuk paraqitet një dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik e dukshme për të vlerësuar vlefshmërinë e saj.

3. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. 2.3.3.a Operatori Ekonomik të ketë në stafin drejtues minimumi: 1 (një) inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e shoqërisë dhe në listepagesën e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë e vlefshme e punës. Diploma, Inxhinieri elektrik x nuk figuron në listepagesat e muajit maj 2019.

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 specialist ndërtimi; 1 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjës të mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Specialisti hidraulik x nuk figuron në listpagesat e muajit mars 2019.

4. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 specialist ndërtimi; 1 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjës të mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Specialisti murator x dhe x nuk figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën mars, prill, maj 2019. Operatori ekonomik nuk dëshmon se ka të punësuar një specialist ndërtimi me kontratë pune dhe dëshminë përkatëse të kualifikimit (x dhe x kanë dëshmi kualifikimi për karpentier).

5. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i parë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 20 (njëzetë) punonjësve, (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues teknik dhe jo drejtues teknik) për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019), kjo e vërtetuar me: - Listë pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025 a) për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin për një punësim mesatar prej 20 të punësuar në tre muajt e fundit. Nga verifikimi i listë pagesave figuron se vetëm 18 punonjës janë të punësuar me kohë të plotë, pjesa tjetër e stafit është e punësuar me vetëm 1 ditë pune. Në zbatim të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe Udhëzimit nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi se nuk konsiderohen deklarime të rregullta dhe punësime të rregullta,

6. Operatori Ekonomik “x” sh.p.k.

Dokumentacioni i operatorit ekonomik “x” sh.p.k. rezultoi se nuk ishte konform legjislacionit dhe kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/a të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. 2.3.3.a Operatori Ekonomik të ketë në stafin drejtues minimumi: 1 (një) inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mekanik; të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë dhe në listpagesën e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Për secilin duhet të paraqiten: - Kontratë e vlefshme e punës. Diploma. Në dokumentacionin e paraqitur inxhinieri i ndërtimit x paraqet deklaratë noteriale për të vërtetuar se është i njejt person me x, e diplomuar si inxhinier elektrik. Dokumenti i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

paraqitur nuk është konform kërkesave ligjore (vendim gjykate ose dokument i leshuar nga gjendja civile).

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3/b (paragrafi i dytë) të kriterëve të vecanta për kapacitetin teknik. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij minimalisht punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Institucionet e autorizuara nga legjislacioni në fuqi për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 1 specialist ndërtimi; 1 elektrikist; 1 murator; 1 bojaxhi; 1 hidraulik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Mars 2019 - Prill 2019 – Maj 2019). Për specialistin e ndërtimit, x, kontrata e punës e lidhur me 01.01.2019 është e parregullt, pasi personi në periudhën para marsit ka qenë i përfshirë si pjesëmarrës në program nxitje punësimi, i cili përfundon në 13 mars 2019. Gjithashtu në kontratat e punës të lidhura nga operatori ekonomik me x, paga e deklaruar në kontratë është me e ulët se paga minimale ligjore dhe kontrata e punës e lidhur me x rezulton me pagë minimale 24,000 lekë në muaj, nuk është në përputhje me legjislacionin aktual.

Referuar procedurës, informohet Operatorin Ekonomik “x” sh.p.k, me një vlerë 4,002,910 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Më datë 25.07.2019 dhe 29.07.2019 pranë Autoritetit Kontraktor kanë paraqitur ankesë tre operatorë ekonomikë. Autoriteti Kontraktor u ka kthyer përgjigje nga më datë 31.07.2019 dhe 02.08.2019.

Më datë 13.08.2019, është paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP ka nxjerë Vendimin Nr. 666/2019 Prot, më datë 16.10.2019, të ardhur në Autoritetin Kontraktor me shkresën Nr. 2710/5 datë 18.10.2019.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 2/Kapitulli “Masa shperblimi dëmi” sqarojmë se:

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Në lidhje me pretendimin e skualifikimit të OE “x”shpk ku AK do të kishte riskun mundshëm të mospërmbushjes me sukses të objektit, sqarojmë se arsyet e skualifikimit nuk përbejnë asnjë element madhor për mosgarantimin apo mospërfundimin e kontratës në tërësi. Kujtojmë rastin e OE “x” shpk i cili është shpallur fitues në disa tendera, arriti të përfundojë kontratat. OE “x”shpk, konstatohet se plotëson plotësisht kapacitet ekonomike dhe teknike për të realizuar me sukses kontratën e punimeve. Kualifikimi i tij bazuar në vlerësimin e cmimit më të ulët do të sillte mirëpërdorim të fondeve publike, bazuar në LPP, me oferta më të leverdishme për AK, rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me pretendimin e licensës profesionale të OE “x”shpk, sqarojmë se kapaciteti ekonomik e teknik për realizimin e punëve, nuk kërkon vetëm licensën profesionale por edhe shumë elementë të tjerë si punëtorja, makineritë dhe mjetet, eksperiencën etj. Rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë.

- ❖ Në zbatim të programit të auditimit të cituar më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, kërkoi raportimin periodik si dhe detyrimet e prapambetura të SHKP-së , deri në datë 31.12.2019. Nga SHKP u paraqit shkresa me prot 2191/1, datë 11.07.2019 me lëndë “Mbi Raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Në këtë shkresë sektori i buxhetit në SHKP vë në dijeni MFE për detyrimet që SHKP ka ndaj furnitorit “x “ lidhur me kontratën për ndërtimin e Qendrës së Formimit Profesional (QFP) – Berat. Nga auditimi u konstatua se:

SHKP ka detyrime të pashlyera ndaj “ x “shpk, në vlerën prej **67,211,269 lekë**. Në shkresën drejtuar MFE, SHKP kryen këtë shpjegim në lidhje me detyrimin e akumuluar:

*Kontrata për ndërtimin e QFP Berat është lidhur në datë 07.12.2006 me afat përfundimi 07.06.2017, (6 muaj). Në vitin 2016 është likuajduar pjesor situacioni nr.1 në shumën 11,844,004 lekë. Në vitin 2017, fondi i çelur për këtë objekt ka qenë vetën 18 mln lekë më të cilin është likuajduar pjesërisht situacioni nr.ëNë vitin 2018 u çel fondi për likuajdim të këtij objekti por si pasojë e procedurës tekniko ligjore pasi rezulton që objekti nuk ka pasur leje ndërtimi, është punuar për pajisjen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi. Është paguar 3,043,194 lekë dhe subjekti është pajisur me leje ndërtimi. Me AN2 është kryer pakësimi i fondit të planifikuar për këtë objekt prej 65 mln lekë, dhe si përfundim detyrimi ndaj furnitorit është **96,097,617- 29,844,004 = 66,253,613 lekë**. Detyrimi ndaj mbikqyrësit është 958,800 lekë. Ende nuk është zhvilluar procedura për caktimin e kolaudatorit.*

Nisur nga vlera e mësipërme dhe nga shpjegimi shumë sipërfaqësor nga SHKP, u paraqit domosdoshmëria e auditimit në një periudhë relativisht të gjatë që daton me datën e lidhjes së kontratës për ndërtimin e QFP Berat, datë 07.12.2006. Si rrjedhim u kërkua informacion për dosjen e prokurimit për këtë objekt, arsyet e krijimit të këtij detyrimi të pashlyer ende dhe për këtë u krye kronologjia e shkresave të cituara në vijim:

-Procedura e prokurimit të QFP Berat, daton me shkresën me nr. 92/5 Prot. datë 11.02.2016, e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2016, për shpenzime kapitale”. Bashkëngjitur shkresës është *formati excel*, fondi për rikonstruksionin e QFP Berat në vlerën 27.000.000 lekë.

-SHKP i drejtohet MSR me shkresën nr. 995 Prot. datë **21.04.2016**, kërkesë për fillimin e procedurave të prokurimit për objektet:

- 1- Rikonstruksioni për DRFPP Berat, fondi prej 27.000.000 lekë me TVSH.
- 2- Rikonstruksioni për DRFPP Dibër, fondi prej 8.000.000 lekë me TVSH.
- 3- Rikonstruksioni për DRFPP Kukës, fondi prej 8.000.000 lekë me TVSH.

Ku të përcaktohen saktë objektet që do vihen në dispozicion për të ushtruar aktivitetin, DRFPP Berat, Dibër e Kukës.

Dokumentat që vërtetojnë gjendjen e pronësisë.

-SHKP i dërgon MSR me shkresën nr.1876 Prot. datë 21.06.2016 “Informacion mbi transferimin e fondit të investimeve alokuar për SHKP”, ku paraqet argumenta dhe mbështet kërkesën e dërguar në MSR me nr.1690 Prot. datë 06.06.2016 për nevojat e ndryshimit të fondit të investimeve:

- Fondi prej 27.000.000 lekë i parashikuar për rikonstruksionin e DRFPP Berat dhe fondi prej 8.000.000 lekë për rikonstruksionin në QF Kukës, **nuk mund të prokurohen pasi këto prona nuk janë ende në administrim të SHKP**. Duke patur parasysh situatën dhe kohën e pamjaftueshme në dispozicion, ky fond do të përdoret pjesërisht për rikonstruksion e DRFPP të tjera.

-SHKP i dërgon MMSR shkresën nr. 2521/1 Prot. datë 17.08.2016, “Mbi realizimin e investimeve nga SHKP si dhe me shkresën nr.**3106 Prot. datë 10.10.2016** “Informacion mbi tregun e punës në qarkun Berat”, institucioni i paraqet MMSR-së, arsyet meshifra konkrete për qarkun Berat, numrin e lartë të papunësisë, numrin e shkollave profesionale që ky qark ka, duke parë të domosdoshme dhe kërkuar krijimin e institucionit “Drejtoria Rajonale e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Formimit Profesional Publik Berat”, që të përfshijë të gjitha shkollat profesionale, pasi kjo është një nga objektivat e vendosura nga SHKP për vitin 2016.

Në vijimësi SHKP dërgon në MSR me shkresën nr.3167 Prot. datë 14.10.2016 me kërkesën për miratimin “Për transferim fondi buxhetor”, në zërin investime, për hapjen e QFP Berat e parashikuar edhe në projekt-buxhetin e 2016, pasi shprehet se investimi i parashikuar për rikonstruksionin e QFP Dibër nuk mund të kryhet, në bazë të akt-ekspertizës së kryer nga Instituti i Ndërtimit nr.410/2 dt.14.10.2016.

-SHKP dërgon në MMSR me shkresën nr. 3020/4 Prot. datë 14.10.2016 “Kërkesë për mbështetje” ku citohet se: për rikonstruksionin e DRFPP Berat, në zbatim të ligjit për prokurimin publik dhe miratimin e rregullave të prokurimit publik, projekti është dhuruar nga një shoqëri projektuese, me kontratë dhurimi sipas normave ligjore në fuqi. Në pamundësi të kapaciteteve të specialistëve të fushës përkatëse kërkon që procedura të kryhet nga specialistë të MMSR.

(Bashkëlidhur Kontrata nr.3020/5 datë 14.10.2016 Për dhurim projekti me objekt “Rikonstruksion i DFPP Berat”, shoqëria “x”. Fletore Zyrtare. Udhëzim i MSR nr.23 datë 27.10.2016. Ndërtim i ri i QFP Berat.)

-MMSR me shkresën nr.7260 Prot. datë 06.12.2016 “Autorizim për lidhje kontrate” drejtuar SHKP-së, informon për zhvillimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt “Ndërtimin e QFP Berat” me fitues operatorin ekonomik “x” shpk dhe vlerë të ofertës 80,081,347.5 lekë pa tvsh ose 96,097,617 lekë me tvsh ku bashkëlidhur kësaj shkresë janë :

- Urdhër prokurimi me nr.237 datë 27.10.2016 protokolluar ne SHKP me nr.6344 Prot. datë 27.10.2016
- Njoftimi i Kontratës nr.6344/2 Prot. datë 27.10.2016
- Miratimi i procedurës së prokurimit nr 6344/4 Prot. datë 02.12.2016
- Raporti përmbledhës nr.6344/3 Prot. datë 02.12.2016

Gjithashtu në shkresë citohet se pavarësisht se procedurat e prokurimit janë kryer nga MMSR, **autorizohet Autoriteti në rastin konkret SHKP, për lidhjen e kontratës me subjektin fitues sipas kërkesave të këtij të fundit.**

(Bashkëlidhur Kontrata nr. 3742/1 datë 07.12.2016 midis MMSR, i autorizuari SHKP dhe “x” shpk me objekt Ndërtim i ri i DFP, Berat.

-Urdhri nr.238 datë 27.10.2016 Prot. në SHKP me nr.6344/1 datë 27.10.2016 “për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave” për prokurimin e ndertimit të QFP Berat.

- Autorizimin për lidhje kontrate” nga MMSR me nr.7261/6 Prot datë 13.1.2016 për procedurën me vlerë të vogël, “Mbikëqyrje ndërtim i ri për QFP, Berat”, operatori fitues “x” shpk me vlerë 799.000 lekë pa tvsh,

-Urdhri i prokurimit nr.7261/1 Prot. datë 06.12.2016 – koha e mbikqyrjes 6 muaj.

Miratimi i procedurës së prokurimit nr.7261/5 Prot. datë 13.12.2016

-Kontratë mbikqyrje nr.3742/3 Prot datë 13.12.2016 ndërmjet MMSR, i autorizur SHKP dhe “x” shpk.

- Është kryer Akt –Dorëzimi i sheshit të ndërtimit, ku konstatohet se sheshi i ndërtimit është i lirë dhe shoqëria “x” shpk e merr në dorëzim për realizimin e punimeve sipas kontratë së sipërmarrjes me nr.prot 3742/1, datë 07.12.2016 lidhur mes SHKP të autorizuar nga MMSR për objektin në fjalë dhe investitori është SHKP i cili e ka miratuar dorëzimin e sheshit të punimeve.

- “Relacion mbi fillimin e punimeve” dërguar nga “x”shpk për MMSR me nr.M129/06 Prot datë 15.12.2016. Ndër të tjera, shoqëria mbikqyrëse kërkon mbështetjen e MMSR për të negociuar me pronarin e një banese, që ti priset muri i avllisë , për të bërë të mundur hyrjen e makinerive të rënda në shesh- punim, e më pas muri të rindërtohet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Situacion pjesor nr.1 për “Ndërtim i ri i QFP Berat”, me vlerën totale 12.000.000 lekë, e vulosur nga “x” shpk dhe “x” shpk.

-Urdhër-shpenzimi nr.330 datë 29.12.2016 kryer nga SHKP për përfituesin “x” shpk për ndërtimin e QFP Berat, në vlerën 11.244.004 lekë ku është mbajtur garancia 5% (-600.000 lekë) të vlerës totale të situacionit të 1, prej 12.000.000 lekësh . (fatura tatimore e lëshuar nga “x” shpk me nr serial.36765168 dt.28.12.2016 vlera 12.000.000 lekë, sipas situacionit).

- Studimi Gjeologjik me nr. 8 prot datë 06.01.2017, kryer nga ing. i “x” shpk.

- Urdhër-shpenzimi nr. 76 datë 23.03.2017 kryer nga SHKP për “x” shpk për ndërtimin e QFP Berat, në vlerën 17.100.000 lekë ku është mbajtur garancia 5% (-900.000 lekë) të vlerës totale të situacionit të 2, prej 18.000.000 lekësh. (fatura tatimore e lëshuar nga “x” shpk me nr.5 dt.28.02.2017 vlera 18.922.316 lekë me tvsh sipas situacionit).

- Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve nr. 814 prot. Datë 16.03.2017 drejtuar SHKP, në lidhje me objektin “Ndërtim i Qendrës së Formimit Profesional në Berat” konstatohet se ekzistojnë disa problematika teknike të pazgjidhura ende në projekt. Nga mbikëqyrësi kërkohet shqyrtimi dhe zgjidhja e këtyre problematikave teknike.

- Me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKP-së, nr. 1065 prot. Datë 11.04.2017, drejtuar shoqërisë projektuese “x”, kërkohet zgjidhja e problemeve teknike në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve për të mos pasur pengesa të mëtejshme të punimeve.

-Më datë 18.04.2017, dërgohet në SHKP, relacioni dhe project-preventivi për punime shtesë, për zgjidhjet teknike të projektit. Në relacion sqarohet se mbikëqyrësi në bashkëpunim me projektuesin, kanë realizuar studim të detajuar teknik të cilët kanë hartuar tabelën e lëvizjeve të punimeve nga librezat e masave mbi llogaritjet faktite të veprës. Në bashkëpunim me studion projektuese, përveç projektit konstruktiv të themeleve të hartuar nga shoqëria “A.V.E consulting”, që në muajin janar 2017, është dhënë zgjidhje konstruktive e planit të themeleve, u hartuan dhe projektet përkatëse për punimet shtesë për sistemimin e ambienteve të jashtme, mbledhjen e ujrave të bardha, punimet hidrosanitare dhe elektrike.

Kryerja e punimeve të mesipërme bën që objekti të jetë me parametra teknik të nevojshëm dhe funksional.

Për volumnin e këtyre punimeve u hartua preventivi për punimet shtesë, që arrin vlerën prej **19,032,382 lekë me tvsh**, të cilat kërkojnë burime financimi shtesë për funksionimin normal të këtij objekti.

-Në zbatim të Kodit të procedurës administrative nga MMSR me shkresën nr.702 Prot. datë 06.03.2017 autorizon shoqërinë “x” shpk, për kryerjen e procedurave të nevojshme për marrjen e Lejes Zhvillimore –ndërtimore në Bashkinë Berat.

-SHKP i dërgon “Kërkesë për përcaktimin pronësie” MMSR me nr.1071 Prot. 14.04.2017 ku kërkon kopje të dokumentacionit të pronësisë me të dhëna të sakta për pronarin, në mënyrë që të merret kërkesa për leje zhvillimi, kërkuar nga Bashkia Berat.

-SHKP i dërgon shkresë me nr.prot 1073, datë 11.04.2017, ku kërkon fonde në investime “Për blerje kabinetesh për DRFPP” në vlerën 48.138.096 lekë.

-MMSR i kthen përgjigje SHKP me nr.2287/1 Prot.09.05.2017 për mosmiratim fondi, pasi objekti për të cilin kërkohet fond nuk ka qenë miratuar në fondet e akorduara në zërin ‘investime’ për vitin 2017.

-SHKP ribën kërkesë në MMSR me nr.1073/2 Prot. datë 10.05.2017 për fonde në investime “Për ndërtimin e ri të DRFPP nr.4 Tiranë dhe QFP Berat, përkatësisht për QFP Berat në vlerën 66.200.000 lekë dhe për DRSHKP nr.4 Tiranë në vlerën 36.850.000 lekë, të kërkuara nga SHKP në projekt-buxhetin e vitit 2017 në zërin “investime”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Sipas kontratës fillestare afati i kryerjes së punimeve nga data e fillimit ka qenë deri në **15 qershor 2017**. Subjekti kontraktor kërkon shtyrje të afatit të kësaj kontrate me shkresën me **nr.prot 10ëdatë 02.06.2017**, për arsyet e cituara më poshtë:

- 1) moskryerja në kohë e studimit gjeologjik
- 2) spostimi i linjave elektrike nëntokësore të tensionit
- 3) **pezullimi i punimeve nga INU Berat për mungese leje ndërtimi në datë 01.03.2017.**

-Nisur nga kërkesa e subjektit, SHKP dërgon në MMSR informacionin me nr.1919. prot. datë 28.06.2017 ku kërkon për shqyrtim kërkesën e “x” shpk për shtyrje afati kontrate dhe kërkesë për likuidim, pasi SHKP nuk disponon fonde për realizimin e kësaj kontrate. (shoqëruar me dok. përkatës si dhe fatura nr.17 datë 31.05.2017 me vlerën 14.004.000 lekë me tvsh) të situacionit të 3.

- Në “Informacionin mbi procesin e investimit të ndërtimit të ri të DRFPP Berat” që drejtuesi i SHKP dërgon në MMSR me nr. 2119 Prot. datë 13.07.2017, rendit procedurat dhe hapat që janë ndjekur në këtë investim. Duke bërë një pasqyrim të dokumentave që janë përgatitur (i kemi cituar më lart), pretendon se SHKP i është akorduar fondi prej 27.000.000 lekë në buxhetin e 2016, për ristrukturim të QFP Berat, ndërsa MMSR, ka shpallur prokurim të hapur për ndërtim të ri të DRFPP Berat. Në fund, duke qenë se SHKP nuk ka fond për të shlyer pagesat e operatorit fitues “x” shpk, **thekson se nuk ka kompetenca dhe përgjegjësi për të vazhduar procedurat e mëtejshme për këtë object.**

Ajo çfarë konstatohet është se që në fillim të zbatimit të kësaj kontrate problem thelbësor ka qenë fillimi i procedurës së prokurimit pa pasur pronësinë e truallit ku do të kryhej investimi, gjë që ka sjellë mosmarrjen e lejes së ndërtimit megjithëse është aplikuar dy herë nga ana e projektuesit dhe si rezultat kemi pezullimin e punimeve nga Bashkia Berat në 1 mars 2017. Pra për këtë fakt, pasojat e të cilit i shkaktojnë subjektit fitim të munguar për punë të kryera, dhe kur nga ana tjetër për mospasjen e lejes zhvillimore dhe ndërtimore kanë qenë në dijeni të dy institucionet shtetërore, tregon një papërgjegjshmëri nga MMSR por edhe nga i autorizuari në rastin konkret SHKP për zbatimin e kontratës, dukë lënë në “mëshirë të fatit” dhe duke vazhduar një korrespondencë shkresore pa fund nëpërmjet të cilave secili kërkon të shmangë përgjegjësinë që i takon sipas ligjit. (Bashkia Berat me shkresën nr.6081/6 datë 20.12.2018 ka dhënë lejen e ndërtimit për zhvilluesin SHKP, në të cilën lejon ndërtimin e objektit QFP Berat. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë 6 mujore nga data e fillimit të punimeve. Afati i fillimit të punimeve është deri në **1 vit** nga data e lëshimit të kësaj leje.)

Sikurse citohet edhe në kthim përgjigjen e MMSR me shkresën me nr.prot.3503/1, datë 30.06.2017, por nisur edhe nga gjithë kronologjia e shkresave të cituara arrijmë në përfundimin se:

E vlerësojmë të pajustificueshme mungesën e seriozitetit dhe zvarritjen që SHKP i krijon kontraktorit në shlyerjen e situacioneve me shprehjen se: **nuk ka kompetenca dhe përgjegjësi për të vazhduar procedurat e mëtejshme për këtë objekt,** pasi sipas nenit 7 të Kreut I të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: MMSR është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë **procedurës së prokurimit** që nga njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të fituesit në Sistemin elektronik të prokurimeve, si dhe organi qendror blerës është përgjegjës për kryerjen e prokurimit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga **vetë autoriteti kontraktor në këtë rast SHKP,** e reflektuar kjo nëpërmjet kontratës me nr. prot 3742/1, datë 07.12.2016. Mjeti ligjor i përdorur nëpërmjet të cilit **SHKP vepron si AK është shkresa e MMSR me nr.prot 3742 , datë 06.12.2016 , ku autorizohet**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

për të lidhur kontratën përkatëse si dhe marrjen e masave për zbatimin e saj ligjor dhe atë financiar.

SHKP si palë e kësaj kontrate ka të gjithë detyrimin ligjor për respektimin e saj si dhe detyrime që rrjedhin nga lidhja e saj pasi kontrata e lidhur rregullisht mes palëve ka forcën e ligjit dhe ajo detyron palët jo vetëm për sa është parashikuar në atë, por edhe të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Pra lidhur me problemin e parashtruar për mungesë fondesh që SHKP parashtron në shkresë AK është përgjegjës për prokurimin me fonde publike sipas nenit 12 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe sipas pikës 4 të nenit 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, SHKP duhet ta ketë përcaktuar fondin e nevojshëm për t’u prokuruar me të cilin ka operuar MMSR për efekt të realizimit të kësaj procedure prokurimi. Nëse SHKP, ka problematika lidhur me çështje buxheti për likuiditetet e nevojshme në terma të përgjithshëm kjo është një çështje tërësisht e ndryshme lidhur me likuidimin për zbatimin e kontratave të prokurimit publik, për të cilat **SHKP** ka paraqitur një fond të mirëpërcaktuar përpara zhvillimit të kësaj procedure prokurimi.

- Bashkëlidhur kërkesa e operatorit me nr.2413 Prot. hyrës datë 18.08.2017.

-SHKP i dërgon mbikqyrësit të punimeve “x” shpk, “Kthim përgjigje” me nr.2656/1 Prot. datë 29.09.2017 për moskompetencë në shlyerjen e faturës së punimeve të situacionit të 6 me vlerë 12.509.640 lekë dhe e informon për mos ekzistencën e MMSR dhe varësinë ndaj MFE, ku shprehet në pritje të udhëzimeve nga kjo ministri për zgjidhjen e problemit.

Sqarim: Duke qenë që SHKP, me ristrukturimin e minsitrive është në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë prej shtator 2017, korrespondenca shkresore për problemin në fjalë vazhdon me këtë ministri.

-SHKP i dërgon “x” shpk dhe “x” shpk, për dijeni MFE, shkresën “Kthim përgjigje” me nr.2675/1 datë 26.10.2017 ku thekson se Autoriteti Kontraktor (MMSR) që ka kryer procedurën për prokurim dhe procedurën e mbikqyrjes së punimeve duhet të kryejë edhe procedurën e prokurimit të kolaudimit të punimeve, ndërkohë MMSR ka zhvilluar vetëm dy të parat.

-Në shkresën “Kthim përgjigje” me nr.3282/1 Prot. datë 12.12.201 të SHKP ndaj mbikqyrësit të punimeve “x” shpk i cili kërkon në mënyrë të përsëritur likuidim punimesh SHKP së dhe MFE-së, me shkresën me nr.prot 219, datë 09.11.2017. institucioni citon të njëjtin justifikim duke treguar moskompetencat e tij për shlyerjen e pagesave të punimeve ne investimin e DRFPP Berat.

Në vijimësi SHKP i dërgon Institutit të Teknologjisë së Ndërtimit me shkresën nr.1302 Prot. datë 07.05.2018, kërkesën për kryerjen e Oponencës Teknike për objektin e ndërtuar DRFPP Berat, në zbatim të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” i ndryshuar si edhe të Urdhrit nr.187 datë 08.10.2014 “Për Kryerjen e Oponencës Teknike për projektet e veprave të ndërtimit.”

Instituti i Ndërtimit në varësi të MIE i kthen përgjigje SHKP me shkresën nr.1623/10 Prot. hyrës në SHKP datë 07.06.2018 për vlerësimin e zbatimit nga ana e institutit, të të gjithë procedurave ligjore dhe zbatimit të procedurës së ndërtimit të objektit “Ndërtimi i ri i DRFPP Berat.

Pra nga sa më sipër MMSR dhe SHKP para nënshkrimit të kontratës dhe para dorëzimit të sheshit të ndërtimit, duhej t’i kishin siguruar operatorit lejen zhvillimore dhe atë të ndërtimit, për mos të sjellë pasojat me efekt negativ financiar si për subjektin ashtu edhe për buxhetin e shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Drejtori i Përgjithshëm, i SHKP, znj.x, dërgon memo konfidenciale ministrit të MFE me nr.4661 Prot. datë 28.12.2018 ku pasi i bën një kronologji të shkurtër të investimit në ndërtimin e ri të DRFPP Berat, i paraqet kërkesën për revokimin e urdhrave:

- Autorizim për lidhje Kontrate me nr.3742 Prot. datë 06.12.2016 dhe

- Autorizim për lidhje Kontrate me nr.3742/2 Prot. datë 13.12.2016 të ish Ministrit të MMSR.

-Dhe vazhdimin e ndjekjen e procedurave për realizimin e investimit DRFPP Berat, nga strukturat e prokurimit të MFE-së, pasi SHKP nuk ka kapacitetet e burimeve njerëzore për të ndjekur këtë investim, **veprim ky i pajustificuar pasi SHKP është palë në kontratën e nënshkruar për mbikqyrjen e objektit me shoqërinë x, shpk.**

-Operatori “x” shpk vazhdon dërgimin e shkresave (shkresa me nr.prot.67, datë 27.03.2018, dhe shkresa me nr.prot 114, dt 23.05.2018) dhe nr.prot.1508, datë 24.05.2018 të SHKP-së, për dijeni MFE, me object për likuidim punimesh. Konkretisht nga mbikqyrësi i punimeve janë dorëzuar në SHKP situacionet si më poshtë:

1-Situacioni . Nr.1, fat.tatimore nr.38, datë 28.12.2016, vlera 12,000,000 lekë.

2-Situacioni . Nr.2, fat.tatimore nr.5, datë 28.02.2017, vlera 18,922,316 lekë.

3-Situacioni . Nr.3, fat.tatimore nr.17, datë 31.05.2017, vlera 14,004,000 lekë.

4-Situacioni . Nr.4, fat.tatimore nr.18, datë 30.06.2017, vlera 24,014,820 lekë.

5-Situacioni . Nr.5, fat.tatimore nr.20, datë 28.07.2017, vlera 6,363,000 lekë.

6-Situacioni . Nr.6, fat.tatimore nr.21, datë 30.08.2017, vlera 12,509,640 lekë.

7-Situacioni përfundimtar, fatura tatimore nr.23, datë 29.09.2017, vlera 8,282,697 lekë.

Për sa më sipër janë likuiduar nga AK, situacionet. Nr.1 në vlerë 12 mln lekë dhe vlera 17,844,004 për situacionin nr.2, në mars të vitit 2017.

Pra AK nuk ka shlyer në vazhdimësi operatorin ekonomik edhe pse nga MFE është çelur fondi për likuidimin e punimeve të kryera, veprim që është në kundërshtim me Kontratën e punimeve me nr.prot 3742/1 dt 07.12.2016, **Neni 29.5**, kushtet e pagesës ku shprehet se :

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Sipas **nenit 30**: Vonesa në bërjen e pagesës citohet se:

30.1 Shpërblimi per dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pësuar nje dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Bazuar në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5: “Llogaritja e Kamatëvonesës”, subjekti ka të drejtë të kërkojë përveç detyrimeve edhe shlyerjen e kamatëvonesave. Norma bazë e interesit për lekun, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës është: Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Gjithashtu mosmarrja në dorëzim e objektit, moslikuidimi dhe mosngritja e grupit të marrjes në dorëzim apo përpjekjes nga Institucioni për të arritur përfundimin e këtij objekti, trajtohet edhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Neni 872, ku citohet se: Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm pa fajin e sipërmarrësit ose të porositesit, por pasi porositesi është në vonesë për marrjen e veprës në dorëzim, ky detyrohet t'i paguajë sipërmarrësit vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Pra, vlera e kontratës e palikujduar për 5 situacionet e cituara më sipër në vlerë **67,211,269 lekë** me TVSH, duhej të paguhej sipas kushteve të kontratës brenda 30 ditëve, pra deri me 01.09.2017 . Referuar njoftimeve për shtyp të Bankës së Shqipërisë nga data e fillimit të detyrimit deri më datë 06.06.2018 llogaritet 1.25 % (norma interesit) + 8% = 9.25%. Nga 06.06.2018 sipas njoftimeve të BSH llogaritet me 1%(norma interesit) + 8% = 9% dhe vazhdon të jetë e njëjtë aktualisht (1%).

Nga data 01/09/2017 deri më datë 01.01.2020 janë 852 ditë të vonuara. Duke e llogaritur me 9 %, Përqindja ditore është (9 % / 365 ditë për 1 vit) = 0.000246, % e kamatës për ditë të vonuara. Për vlerën 67,211,269 në 852 ditë të vonuara është 0.000246 ditë x 67,211,269 lekë x 852 ditë, sjell kamatëvonesën në vlerën **14,086,944 lekë me TVSH e cila përbën dëm ekonomik** për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, nëse nuk merren masa të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve dhe finalizimin e këtij objekti me rëndësi për zbatimin e politikave shtetore në fushën e tregut të punës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, sigurimin e mundësive për qasje të barabartë të individëve në zonat urbane rurale si dhe përmirësimin e gamës së programeve aktive të tregut të punës dhe shtrirjes gjeografike të zbatimit të tyre. E njëjta situatë vlen edhe për kontratën e mbikëqyrjes nr. 3742/3 Prot datë 13.12.2016 për shërbimin e mbikëqyrjes.

Gjithashtu me veprimet dhe mosveprimet e tij, ky institucion në bashkëpunim me MFE, ka çuar në ineficencën e një objekti të papërfunduar dhe të pavendosur në funksion të objektivit kryesor që SHKP ka si qendër formimi profesional, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej **29,844,004 lekë** (vlera e paguar e dy situacioneve, pa llogaritur edhe amortizimin e veprës e cila nuk është vënë në funksion).

Sa më sipër, SHKP në bashkëpunim me MFE të marrë masa të menjëhershme që të planifikojë buxhetin për shlyerjen e situacioneve të kontratës së punimeve dhe atë të mbikëqyrjes, si dhe të sigurojë fonde shtesë për shtesën e kontratës në vlerën 19,032,382 lekë për përfundimin sa më shpejt të veprës, me parametra teknik të nevojshëm dhe funksional.

Nëse nuk merren masa për të përfunduar objektin, shuma prej 29,844,004 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik të parikuperueshëm ndaj buxhetit të shtetit, pa përfshirë këtu dëmet ekonomike që i janë shkaktuar operatorit ekonomik, i cili i është dashur të paguajë detyrimet tatimore për situacionet e deklarauara.

SHKP në bashkëpunim me MFE të marrin masa me mbikëqyrësin e punimeve, të azhurnojnë gjendjen aktuale të objektit (pasi është i braktisur prej më shumë se 2 vitesh), duke rakorduar zërat e punimeve, volumet e cdo zëri punimi dhe cdo specifikim tjetër që nevojitet për përfundimit e investimit.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020, dërguar nga AKPA me nr.prot.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 1/Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menxhimin me ekonomicitete, efieciencë dhe efektivitet të fondeve publike” sqarojmë se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Rekomandimi është pranuar nga SHKP (AKPA).

Titulli i gjetjes: 1	Mbi kriteret kualifikuese në Procedurat e Prokurimit.
Situata:	<p>Janë audituar 10 procedura kontrata pune. Në DST mbi kriteret kualifikuese nuk janë argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.</p> <p>- Nga Ak është kërkuar që Operatorët Ekonomik duhet të disponojë një mjek te pergjithshem (te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, Urdher mjeku, CV). <u>Mjek i ndermarrjes (një).</u></p> <p>Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë ne stafin e tij <u>mjekun e shoqërisë</u>, në zbatim te VKM nr. 742, date 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues. <i>Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.</i></p> <p><i>Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë.</i></p>
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018), Neni 61, Pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Zvogëlim i konkurrencës, në kundërshtim me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.
Shkaku:	Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore.
Rëndësia:	E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Titulli i gjetjes nr. 2	Mbi vlerësimet në Procedurat e Prokurimit.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit të punëve u konstatua se është shpallur fitues OE “x” shpk, me oferta ekonomike më të ulëta, por ky operator ka ofertuar paralelisht në disa procedura tenderimi dhe ka pas punë në proces. Procedurat ku ky operator ka marrë pjesë dhe shpall fitues janë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Rikonstruksion i DRSHKP Kukes, me hapje të tenderit datë 12.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë.2. Rikonstruksion i ZVP Pogradec, me hapje të tenderit datë 10.09.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 60 ditë.3. Rikonstruksion i ZVP Kucovë, me hapje të tenderit datë 19.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë.4. Rikonstruksion i ZVP Tropojë, me hapje të tenderit datë 08.10.2018 dhe afat zbatimi të kontratës 30 ditë. <p>Kontratat e rikonstruksionit, janë të shpërndara në hapësira gjeografike të largëta (në Kukës, Pogradec, Kucovë, Tropojë), me të njëjtin dokumentacion financiar, teknik me të njëjtin staf dhe mjete.</p> <p>Pra nga shpallja fitues e këtij operatori ekonomik në shum kontrata edhe pse është <u>me cmimin më të mirë ekonomik</u>, riskoheshin punimet.</p> <p>Nga AK, OE “x” shpk duhej të skualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë, të njëjtin dokumentacion, për rikonstruksione punimesh në hapësira të largëta gjeografike dhe të njëjta deklarata si ajo mbi kontratat e lidhura apo në proces, si deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku nuk plotësohet asnjëra prej tyre, pasi mjetet janë të angazhuara në kontratën e rikonstruksionit e ZVP Pogradec.</p>
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018).
Ndikimi/Efekti:	Risk për zbatim dhe realizimin e kontratave publike, në kundërshtim me parimet e legjislacionit të prokurimit publik.
Shkaku:	Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE, jo në përputhje me përcaktimet ligjore.
Rëndësia:	I lartë

Titulli i gjetjes nr. 3	Mbi auditimin e vlerësimeve të ofertave në Procedurat e Prokurimit
Situata:	<p>Nga auditimi i Rikonstruksioni i DRSHKP Shkodër, konstatohen dëme ekonomike të shkaktuara buxhetit të shtetit, ku OE “x”shpk ka patur kapacitete të plota ekonomike dhe teknike për realizimin e kontratës e cila, duhej të kishte parim cmimin më të ulët. Ofertat më e leverdishme e “x” shpk me vlerë 6,901,741 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kritereve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Mos plotësimi i pikave në raportin e KVO, nga operatori ekonomik nuk do të cenonte objektin e prokurimit pasi rinovimi i certifikimit është thjeshtë marrëdhënie e OE me kompaninë certifikuese, jo se specialistët nuk e realizojnë punën e tyre, të kryer edhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>më parë. Kontratohet se OE “x”, ka mjaftueshëm punë të ngjashme me nxhinierë ndërtimi, ku puna sipas preventivit me 35 m³ “Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me llaç perzier M25”, do të realizohej lehtësisht. Në lidhje me pretendimin se mungon deklarata mbi tokëzimin dhe nulifikimin e pajisjeve elektrike, sqarohet se ky OE ka paraqitur deklaratën që do u përmbahet specifikimeve teknike dhe projektit, pjesë e së cilës është dhe tokëzimi dhe nulifikimi i pajisjeve elektrike. Po ashtu OE ka paraqitur edhe një plan organizimi të punës, ku përfshihen në brendësi se ky proces pune do kryhet nga ana tyre. Pra nëse autoriteti kontraktor do të kishte vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët. Diferenca e vlerës prej 1,396,030 lekë me TVSH (8,065,100 lekë - 6,901,741 lekë = 1,163,359 lekë x 20%), midis ofertës së “x” sh.p.k dhe ofertën e BOE “x”&“x”shpk, përbën dëm ekonomik, të shkaktuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me Urdhërin nr.1488/1 datë 22.05.2018 i përbërë nga x, x, x, x, x.</p>
Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018).
Ndikimi/Efekti:	Dëme ekonomike të shkaktuar nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.
Shkaku:	Autoriteti Kontraktor ka s’kualifikuar padrejtësisht OE me cmim më të ulët.
Rëndësia:	I lartë

Titulli i gjetjes nr. 4	Kontrata nr. 3742/1 datë 07.12.2016 me objekt “Ndërtim i ri i DFP, Berat”.
Situata:	Kontrata nr. 3742/1 datë 07.12.2016 midis MMSR, <i>i autorizuari SHKP</i> dhe “x” shpk me objekt “Ndërtim i ri i DFP, Berat. Zbatimi i punimeve ka patur probleme me truallin, gjë që ka sjellë mosmarrjen e lejes së ndërtimit megjithëse është aplikuar dy herë nga ana e projektuesit dhe si rezultat kemi pezullimin e punimeve nga Bashkia Berat. Për këtë fakt, mospasja e lejes zhvillimore dhe ndërtimore ku kanë qenë në dijeni institucionet shtetërore, tregon një papërgjegjshmëri nga MMSR por edhe nga i autorizuari në rastin konkret SHKP për zbatimin e kontratës, dukë lënë në “mëshirë të fatit” dhe duke vazhduar një korrespondencë shkresore të gjatë. Bashkia Berat me shkresën nr.6081/6 datë 20.12.2018 ka dhënë lejen e ndërtimit për zhvilluesin SHKP, në të cilën lejon ndërtimin e objektit QFP Berat. MMSR dhe SHKP nuk kanë siguruar lejen zhvillimore dhe të ndërtimit para nënshkrimit të kontratës dhe para dorëzimit të sheshit të ndërtimit, veprime të cilat kanë sjellë pasoja me efekte negative financiare si për subjektin ashtu edhe për buxhetin e shtetit. Ndërkohë, në vitin 2016 është likuiduar pjesor situacioni nr.1 në shumën 11,844,004 lekë. Në vitin 2017, fondi i çelur për këtë objekt ka qenë vetën 18 mln lekë më të cilin është likuiduar pjesërisht situacioni nr.ëNë vitin 2018 u çel fondi për likuidim të këtij objekti por si pasojë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>procedurës tekniko-ligjore pasi rezulton që objekti nuk ka pasur leje ndërtimi, është punuar për pajisjen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi. Është paguar 3,043,194 lekë dhe subjekti është pajisur me leje ndërtimi. Me AN2 është kryer pakësimi i fondit të planifikuar për këtë objekt prej 65 mln lekë, dhe si përfundim detyrimi ndaj furnitorit është 96,097,617 - 29,844,004 = 66,253,613 lekë dhe detyrimi ndaj mbikqyrësit është 958,800 lekë.</p> <p>Më datë 18.04.2017, dërgohet në SHKP, relacioni dhe projekt-preventivi për punime shtesë, për zgjidhjet teknike të projektit. Mbikëqyrësi në bashkëpunim me projektuesin, kanë hartuar tabelën e levizjeve të punimeve nga librezat e masave mbi llogaritjet faktite të veprës. Në bashkëpunim me studion projektuese, përveç projektit konstruktiv të themeleve të hartuar nga shoqëria “x”, që në muajin janar 2017, është dhënë zgjidhje konstruktive e planit të themeleve, u hartuan dhe projektet përkatëse për punimet shtesë për sistemimin e ambienteve të jashtme, mbledhjen e ujrave të bardha, punimet hidrosanitare dhe elektrike. Kryerja e punimeve të mesipërme bën që objekti të jetë me parametra teknik të nevojshëm dhe funksional. Për volumet e këtyre punimeve u hartua preventivi për punimet shtesë, që arrin vlerën prej 19,032,382 lekë me tvsh, të cilat kërkojnë burime financimi shtesë për funksionimin normal të objekti. Pra, AK nuk ka shlyer në vazhdimësi operatorin ekonomik edhe pse nga MFE është çelur fondi për likuidimin e punimeve të kryera, veprim që është në kundërshtim me Kontratën e punimeve me nr. Prot. 3742/1 dt 07.12.2016, <i>Neni 29.5</i>, kushtet e pagesës, sipas <i>nenit 30</i>: Vonesa në bërjen e pagesës dhe në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5: “Llogaritja e Kamatëvonesës”. Mosmarrja në dorëzim e objektit, moslikuidimi dhe mosngritja e grupit të marrjes në dorëzim apo përpjekjes nga Institucioni për të arritur përfundimin e këtij objekti, trajtohet edhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në <i>Neni 87</i> Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nuk ka marrë masa për shlyerjen e detyrimeve dhe finalizimin e këtij objekti me rëndësi për zbatimin e politikave shtetërore në fushën e tregut të punës. E njëjta situatë vlen edhe për kontratën e mbikëqyrjes nr. 3742/3 Prot datë 13.12.2016 për shërbimin e mbikëqyrjes. Ky institucion në bashkëpunim me MMSR, ka çuar në ineficencën e një objekti të papërfunduar dhe të pavendosur në funksion të objektivit kryesor që SHKP ka si qendër formimi profesional, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej 29,844,004 lekë (vlera e paguar e dy situacioneve, pa llogaritur edhe amortizimin e veprës e cila nuk është vënë në funksion).</p>
Kriteri:	Ligji Nr.7995, dt 20.9.1995, “Për nxitjen e Punësimit” i ndryshuar, VKM Nr. 42 dt. 17.1.1998, “Per miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos përfundim i veprës, duke shkaktuar efekte ekonomike negative dhe risqe të larta për dëme ekonomike.
Shkaku:	Autoriteti Kontraktor nuk ka marrë masa për shlyerjen e detyrimeve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	finalizimin e objektit.
Rëndësia:	I lartë

5. MBI AUDITIMIN E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË PËRFTUARA NGA BUXHETIT I SHTETIT, PËR NXITJEN E PUNËSIMI

Në zbatim të pikës nr. 5, të Programit të Auditimit “Auditim Përputhshmërie në Shërbimin Kombëtar të Punësimit” (SHKP këtu e në vazhdim), me nr. Prot 65/2, i ndryshuar, datë 18.03.2020, u shqyrtuan pranë kësaj Drejtorie dokumentacionet përkatëse dhe u fokusuan në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të ligjit nr.7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, si dhe në disa VKM të ndryshme, të cituar si vijon :

1-Rregullorja e Brendshme e SHKP -së, “Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit”, miratuar me vendimin nr.1, dt 25.06.2018, të KAT.

2-VKM nr.27 ”Për programimin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta.

3-VKM nr.28 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi I nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta.

4-VKM nr.248 “Për programimin e nxitjes së personave me aftësi të kufizuar”.

5-VKM nr.199 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë të rinj.”

6-VKM nr.64 ”Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë kërkuar statusin e jetimit”.

7-VKM nr .47 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”.

8-VKM nr .873 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuësit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit.

9-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

10-Vendimet e KAT (Këshillit Administrativ Trepalësh), për periudhën në auditim (prill 2018- dhjetor 2019).

11-Dosjet e miratimit të projekteve me dokumentet përkatës të dorëzuara nga zyrat rajonale.

Përfitimet sipas Vendimeve

- VKM Nr. 27, datë 11.1.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, i ndryshuar;

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuëset e papuna të rregjistruara pranë Zyrave të Punësimit, gra kryefamiljare apo vajza nëna, të cilat kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç. Punëkërkuëset e papuna përfitojnë financim deri në gjashtë paga në masën 115 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë, si dhe në muajin e njëmbëdhjetë e dymbëdhjetë të kontratës 12-mujore. Për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkuës të papunë pjesëmarrës në program financim mujor në masën 100 përqind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 12 muaj.

- VKM Nr. 47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar;

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program të gjithë punëkërkuësit e papunë të rregjistruar pranë Zyrave të Punësimit që kërkojnë të kualifikohen profesionalisht nëpërmjet punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Punëkërkuessit e papunë përfitojnë financim 50% të pagës minimale në shkallë vendi për periudhën e formimit nëpërmjet punës me një kohëzgjatje deri në 6 muaj, në varësi të fushës së aktivitetit. Financim për kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë në masën e përcaktuar nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore, për periudhën e formimit.

Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkuess të papunë pjesëmarrës në program subvencion, në masën 19.000 lekë për çdo muaj formim.

- VKM Nr.48, datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të pu.pa, në vështirësi”, i ndryshuar;

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuessit e papunë të rregjistruar pranë Zyrrave të Punësimit, nga grupet e veçanta si: jetimë, kryefamiljarë të vetëm me fëmijë në ngarkim, persona me aftësi të kufizuara etj. Punëkërkuessit e papunë përfitojnë financim katër paga në masën 100 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë, të gjashtë si dhe në muajin e njëmbëdhjetë e dymbëdhjetë të kontratës 12-mujore. Për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkuess të papunë pjesëmarrës në program financim mujor në masën 100 përqind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 12 muaj.

- VKM Nr.199, datë 11.1.2012 “Per masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë të rinj”, i ndryshuar;

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuessit e papunë të rinj, të diplomuar me arsim të lartë në nivelin “Bachelor” apo “Master”, nën moshën 30 vjeç, të rregjistruar pranë Zyrrave të Punësimit. Punëkërkuessit e papunë përfitojnë financim 100% të pagës minimale në shkallë vendi për periudhën 3 mujore të formimit. Financim për kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë në masën e përcaktuar nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore për periudhën e formimit. Financim katër paga në masën 25.000 lekë, në muajin e tretë e të katërt dhe në muajin e tetë e të nëntë të kontratës 15 mujore të punësimit. Për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkuess të papunë pjesëmarrës në program financim mujor në masën 100 përqind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), për pagën 25.000 lekë, për 9 muaj, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 15 muaj.

- VKM Nr. 248, datë 30.04.2014 “Per programin e nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar;

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuessit e papunë, persona me aftësi të kufizuara, të rregjistruar pranë Zyrrave të Punësimit.

Programi i nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuara, mund të aplikohet si dy programe:

A- Formim nëpërmjet punës, ose

B- Punësim

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuessit e papunë, persona me aftësi të kufizuara, të rregjistruar pranë Zyrrave të Punësimit.

Në Shërbimin Kombëtar të Punësimit kjo VKM ka gjetur zbatim vetëm në formën e punësimit. Për programin e punësimit, punëkërkuessit e papunë përfitojnë financim në masën 100 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, për 6 muajt e parë të kontratës së punës. Financim në masën 50 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, për 6 muajt e dytë të kontratës së punës.

Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkuess të papunë pjesëmarrës në program financim mujor në masën 100 përqind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënsit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 12 muaj. Gjithashtu, një financim për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës deri në masën 100.000 lekë, por jo më shumë se 200.000 lekë nëse punëson më shumë se 2 persona. Punëdhënësi duhet të paraqesë një projekt për këtë përshtatje.

- VKM Nr. 873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për pu.pa, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, i ndryshuar.

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuesit e papunë të rregjistruar pranë Zyra të Punësimit, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit, në 24 muajt e fundit. Punëkërkuesit e papunë përfitojnë financim 100 përqind të nivelit bazë të pagesës së papunësisë. Kohëzgjatja e programit deri në 6 muaj. Gjithashtu, përfitojnë financim për kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë në masën e përcaktuar nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore për gjithë periudhën e praktikës profesionale.

- VKM Nr. 64, datë 27.01.2016, “Për Programin e Nxitjes së Punësimit të të Rinjve që kanë fituar Statusin e Jetimit”.

Kanë të drejtë për të përfituar nga ky program punëkërkuesit e papunë të rinj, nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit, të rregjistruar pranë Zyra të Punësimit.

Punëkërkuesit e papunë përfitojnë financim 100 përqind të pagës minimale në shkallë vendi për periudhën 3 mujore të formimit. Financim për kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë në masën e përcaktuar nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore për periudhën e formimit. Financim mujor në masën 100 përqind të pagës minimale në shkallë vendi, për 9 muajt e parë dhe në masën 50 përqind të pagës minimale në shkallë vendi për 6-mujorin pasardhës të kontratës 21 mujore të punësimit. Për muajt e tjerë financon punëdhënësi. Punëdhënësit përfitojnë për çdo punëkërkues të papunë pjesëmarrës në program subvencion, në masën 10.000 lekë për periudhën 3 mujore të formimit. Financim mujor në masën 100 përqind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënsit), për 9 muaj, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 21 muaj.

- ❖ Në kuadër të kryerjes së auditimit, u vendosën në dispozicion Dosjet e miratimit të projekteve me dokumentet përkatës të dorëzuara nga zyrat rajonale për vitet 2018-2019 në formë shkresore dhe elektronike, kontratat e miratuara nga Komisioni i Projekteve, urdhër xhirimet, listëpagesat e subjekteve, vendimet e KAT, etj.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, u konstatua se:

Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Punësimit me njësitë e varësisë, kanë për mision, përmbushjen e të drejtës së të gjithë shtetasve rezidentë në Shqipëri për formim profesional, riaftësim në punë dhe për punësim fitimprurës nëpërmjet shërbimeve të punësimit dhe pjesëmarrjes në programet shtetërore të tregut të punës. Gjatë auditimit, mbi aplikimin, vlerësimin e përfitimit, lidhjen e kontratës dhe monitorimin e projekteve të nxitjes së punësimit të realizuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DPSHKP), përgjatë viteve, 2018 dhe 2019, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligjit nr.7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, si dhe në disa VKM të ndryshme, të cituara më sipër.

Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në kuadër të programit të Nxitjes së Punësimit, ka mundësuar realizimin e projekteve me qëllim nxitjen e punësimit apo ripunësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë, suvencionimit për punësim, hapjes së vendeve të reja të punës, praktikave profesionale etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Për vitin 2018 nga Buxheti i Shtetit u akordua fondi prej 281,000,000 milion lekë i rishikuar sipas aktit normativ 1 dhe 2 nga MFE , për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit. Nga ky fond, 119.031.278 lekë ishte fondi për 220 projekte të filluara nga viti 2017. Fondi i disponueshëm për projekte të reja për vitin 2018 ishte 370.965.722 lekë. Për vitin 2019 nga Buxheti i Shtetit u akordua fondi prej **490.000.000 milion lekë** për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit. Nga ky fond, **119.031.278 lekë** ishte fondi për 220 *projekte të filluara nga viti 2017*. Fondi i disponueshëm për projekte të reja për **vitin 2018 ishte 370.965.722 lekë.**

Nga auditimi u konstatua se:

- **për personat fizikë**, aplikimi dhe miratimi realizohet pranë Zyrove Rajonale të Punësimit.
- **për personat juridikë**, pas aplikimit pranë Zyrove rajonale të punësimit, miratimi i projekteve bëhet në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP dhe miratohet nga Komisioni i miratimit të Projekteve i ngritur sipas urdhrit nr.2062, datë 05.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm znj. x, i përbërë nga 5 anëtarë dhe Kryetare znj.x (Drejtor i Funksioneve Mbështetëse) ku në përfundim të procesit të vlerësimit është realizuar lidhja e Kontratës Tip (*Kontratë e mësimi të profesionit/trajnitimit*), midis Drejtorit të Përgjithshëm me subjektin privat/ punëdhënësin. Sipas kontratës, pjesa e monitorimit i është deleguar drejtorive/zyrave rajonale të punësimit.

Mbështetur në objektivat dhe treguesit e monitorueshëm për vitin 2018 si dhe situatën e tregut lokal të punës, duke u nisur nga analiza e të gjithë targeteve të punëkërkesve të papunë të rregjistruar, Zyrat e Punësimit sipas SHKP-së kanë planifikuar nevojat për mbështetje me programe të nxitjes së punësimit mbi të cilat është bërë detajimi i fondit.

1-Ajo që konstatohet është se asnjë parashikim i kryer për tregun e punës nga zyrat e punës rajonale dhe vendore nuk është i dokumentuar me shkresë përcjellëse duke krijuar një situatë jokorrekte nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme të cilët shprehen se për detajimin e buxhetit janë nisur nga analiza e të gjithë targeteve të punëkërkesve të papunë të rregjistruar. Pra SHKP duhet të dokumentonte shkresërisht nga çdo zyrë pune dhe drejtori rajonale analizën e të gjithë targeteve të punëkërkesve të papunë të rregjistruar duke krijuar një databasë konkret dhe të aksesueshëm nga të gjithë palët për t'u kuptuar . Kjo do të sillte transparencë për ne si auditues të jashtëm në detajimin e saktë në përputhje me nevojat e parashikuara nga Zyrat e Punësimit sipas grupeve të veçanta që synuan të mbështesin. Kjo është në kundërshtim me Rregulloren nr.1789/2 datë 25.06.2018, miratuar dhe ndryshuar nga KAT (Këshilli Administrativ Trepalësh) me vendim nr.1, dt 25.06.2018, neni 1, pika 1.2, ku citohet se:

Zyrat e punës duhet të planifikojnë nevojat për mbështetje me programe të nxitjes së punësimit mbështetur në objektivat dhe treguesit e monitorueshëm të çdo viti si dhe në situatën e tregut lokal të punës, duke specifikuar grupet e veçanta sipas kriterëve të programeve të nxitjes së punësimit.

Sistemi i pikëzimit për vitin 2018 është zbatuar veç për çdo Zyrë Punësimi sipas fondit të akorduar dhe 80% të vlerësimit çdo subjekt aplikues e ka marrë nga dosja që ai ka dorëzuar dhe vetëm 20% nga komisioni i vlerësimit.

Të gjitha këto ndryshime si dhe planifikimi i fondit i ndarë sipas Zyrove të Punësimit janë miratuar në mbledhjen e parë të Këshillit Administrativ Trepalësh me Vendimin Qarkullues Nr. 1. datë 25.06.2018. Me shkresat nr. 1948 Prot, dhe nr. 1949 Prot, datë 27.06.2018, janë njoftuar të gjitha Zyrat e Punësimit për fondin e vënë në dispozicion dhe afatin e aplikimit për të gjithë subjektet e interesuar.

-Afati i aplikimeve për vitin 2018 ka qenë në intervalin e datave : **03.07.2018 deri në datë 03.08.2018**. Gjatë muajit gusht janë shqyrtuar dosjet e paraqitura dhe është bërë miratimi i tyre nga Komisioni i Miratimit të Projekteve të nxitjes së punësimit i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën me nr.prot 2062, datë 05.07.2018. Është mbajtur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

proces-verbali nr.1 me nr.prot 2778/3, datë 29.08.2018, ku të pranishëm kanë qenë Komisioni i Miratimit të Projekteve të nxitjes së punësimit, i përbërë nga 5 anëtarë me Kryetare znj.x (Drejtor i Funksioneve Mbështetëse dhe Zv/Drejtor). Ky komision ka shqyrtuar projektet për subjektet sipas sistemit të pikëzimit si dhe **ka për detyrë të monitorojë zbatimin e të gjitha projekteve të nxitjes së punësimit që janë në zbatim**. Ajo që konstatohet është se afati i aplikimeve është realizuar në *gjashtëmujorin e dytë të vitit buxhetor* dhe rrjedhimisht miratimi ka dashur përafërsisht 1 muaj kohë duke sjellë që për të gjithë subjektet përfitues të miratohen dhe të lëvrohen fondet në shtator të vitit buxhetor në rastin konkret të vitit 2018. Ndërkohë sipas **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar : *Kohëzgjatja e programit të trajnimit është më shumë se 6 muaj për të gjitha profesionet, fakt ky që sjell në shtrirjen e të gjithë projekteve përtej vitit buxhetor, kur paralelisht në planifikimin e buxhetit është përcaktuar që këto projekte duhet të përfundojnë me buxhetin e vitit 2018. Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve është e vlefshme deri në 31 dhjetor , afati i të cilës korrespondon me mbylljen e vitit buxhetor*. Ky është veprim i përsëritur nga SHKP, pasi i njëti problem shfaqet për një periudhe tre-vjeçare 2017-2018-2019, dhe konkretisht:

-Për vitin 2018, **për programin “Nxitje Punësimi”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 258 mln lekë lekë, ose në masën 52,7 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe 92% kundrejt buxhetit të rishikuar prej 281 mln lekë, pra me një diferencë prej -22,6 milionë lekë. (paraqitur në tab.1).

-Për vitin 2019, **për programin “Nxitje Punësimi”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 345,9 mln lekë, ose në masën 70 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe 86 % kundrejt buxhetit të rishikuar prej 403 mln lekë, pra me një diferencë prej -57 milionë lekë. (paraqitur në tab.2)

Realizimi i programit të nxitjes së punësimit për vitin 2018.

Tabela.nr.1

Nr.Programit	EMERTIMI	Fakt 2017	PBA 2018	Buxheti i miratuar 2018	transferime	Buxheti I rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca	%
10550	Nxitje punësimi	474,950,989	690,000,000	490,000,000	-209,000,000	281,000,000	258,371,265	22,628,735	92

Realizimi i programit të nxitjes së punësimit për vitin 2019.

Tabela.nr.2

Nr.Programit	EMERTIMI	Fakt 2018	PBA 2019	Buxheti i miratuar 2019	transferime	Buxheti I rishikuar 2019	Fakti 2019	Diferenca	%
10,550	Nxitje punësimi	258,371,265	650,000,000	490,000,000	-86,714,782	403,285,218	345,954,482	57,330,736	86

Pra për periudhën objekt auditimi (2018-2019), konstatohet një realizim i ulët i programeve për **“Nxitje Punësimi”** përkatësisht me një diferencë prej -22 mln lekë për vitin 2018 dhe diferencë prej 57 mln lekë për vitin 2019, në krahasim kjo me buxhetin e rishikuar, pasi me atë të planifikuar nga SHKP diferenca e mosrealizimit është shumë e madhe. Sipas përcaktimeve të legjislacionit mbi sistemin buxhetor, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme që zbatojnë më shumë se një program buxhetor, drejtues programi konsiderohet menaxheri i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

nivelit më të lartë në varësi direkte nga *nëpunësi autorizues*, dhe përgjegjës për sa më lart janë nëpunësi autorizues znj x si dhe *Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të programit* të cilët raportojnë përpara nëpunësit autorizues, për hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Anëtarët e ekipit të menaxhimit të programit janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore, të cilat lidhen me programin e tyre, përfshirë këtu punën që kërkohet për të detajuar:

- *Deklaraten e Politikës së Programit;*
- *Produktet e programit; dhe*
- *Aktivitetet e programit.*

Veprimet dhe mosveprimet e tyre e nëpunësit autorizues dhe *Ekipit të Menaxhimit të programit* janë në kundërshtim me pikën 45, të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr 23 datë 22.11.2016 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem*”, i cili përcakton se, “*Drejtuesit e programeve kanë përgjegjësi për propozimin e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit të tyre, për t’u miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Titullari si Kryetar i këtij grupi*”.

Në tabelën nr.3 jepen të detajuara zbatimi i programeve për vitin 2018 dhe realizimi i fondeve të ndarë sipas VKM-ve:

Tabela nr.3.

VKM	Projekte të mbartura nga 2017		Projekte të reja 2018		TOTALI			
	Projekte	Pjesëmarres	Projekte	Pjesëmarres	Projekte	Pjesëmarres	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor	Financimi në fakt sipas situacioneve të konfirmuara nga thesari
27	4	4	10	26	14	30	715,834	434,708
47	11	300	94	1338	105	1638	163,255,823	150,485,217
48	155	936	169	1287	324	2223	81,863,379	78,237,314
64	1	1	1	1	2	2	379,360	298,725
199	13	14	14	20	27	34	2,978,684	2,537,677
248	35	49	48	59	83	108	9,513,649	8,750,012
873	1	11	110	498	111	509	16,674,807	15,620,111
162	0	0	13	264	13	264	2,722,210	2,007,501
Shp. Operativ					0		4,504	
TOTALI	220	1315	459	3493	679	4808	278,108,250	258,371,265

Pra konstatohet se projekte të mbartura nga viti 2017 janë 220 dhe numri i pjesëmarrësve është 1315 ndërsa për vitin 2018 numri i projekteve është më i lartë 459 dhe numri i pjesëmarrësve është 3493. Fondet më të mëdha nga buxheti i shtetit janë financuar për VKM nr .47 në vlerën 150 mln lekë dhe për VKM nr.48 në vlerën 78 mln lekë përkatësisht për 105 projekte për VKM nr.47 dhe për 324 projekte për VKM nr.48.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Për vitin 2019, treguesit e realizimit për programet e nxitjes së punësimit paraqiten në tabelën nr.4.

Tabela nr.4.

VKM	Projekte te mbartura nga 2018			Projekte te reja 2019			TOTALI			Financimi ne fakt sipas situacioneve te konfirmuara nga thesari
	Projekte	Pjesemarrjes	Fond i konfirmuar	Projekte	Pjesemarrjes	Fond i konfirmuar	Projekte	Pjesemarrjes	Fondi i konfirmuar per vitin buxhetor	
27	10	26	3,228,919				10	26	3,228,919	2,238,239
47	87	1,143	101,921,350				87	1,143	101,921,350	98,225,273
48	167	1,282	178,229,169				167	1,282	178,229,169	170,902,813
64	0	0	16,008				0	0	16,008	16,008
199	14	20	2,643,492				14	20	2,643,492	2,392,436
248	47	58	11,297,143				47	58	11,297,143	11,137,471
873	11	23	1,116,638	231	1,356	48,576,624	242	1,379	49,693,262	45,099,867
162	11	197	3,556,521	22	1,233	18,209,510	33	1,430	21,766,031	15,942,375
TOTALI	347	2,749	302,009,240	253	2,589	66,786,134	600	5,338	368,795,374	345,954,482

Në total konstatohet një rritje e realizimit në vlerë për programet e nxitjes së punësimit për vitin 2019 në masën 345,9 mln lekë, dhe në vazhdimësi vlerat më të larta në financim janë për VKM nr.47 dhe VKM nr.48 përkatësisht 98 mln dhe 170,9 mln .Gjithashtu financimet e kryera për VKM nr.47 dhe VKM nr.48 janë të miratuara ose të mbartura nga viti 2018 pasi për vitin 2019 nuk ka asnjë project të nxitjes së punësimit përse i përket këtyre dy vendimeve të cilët kanë qenë vendimet me rëndësinë më të madhe në politikat e nxitjes së punësimit të SHKP-së.

Ky ndryshim rrjedh si rezultat i miratimit të Ligjit të ri **Nr. 15/2019, datë 13.03.2019** “Për Nxitjen e Punësimit”. Sipas këtij ligji në nenin 15 citohet se:

...Këshilli Konsultativ për Punësimin është organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale, si dhe institucioneve shtetërore. Këshilli kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 11 anëtarë ...për një mandat 3-vjeçar.

5. Këshilli Konsultativ për Punësimin ushtron kompetencat e mëposhtme: a) diskuton çështjet që lidhen me shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit; b) nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale për çështjet e nxitjes së punësimit; c) këshillon lidhur me mënyrën e përdorimit të Fondit Social të Punësimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. 8 6. Rregulla më të detajuara për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Punësimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pra ligji i ri, krijon **Këshillin Konsultativ për Punësimin** me tagër e funksion këshillimor në vend të **Këshillit Administrativ Trepalësh** që sipas legjislacionit të mëparshëm, ishte organi administrativ më i lartë me tagër vendimarrës. Ndërkaq për sa i përket rolit të Këshillave Vendore Trepalësh për vendimmarrje në procesin e programeve të nxitjes së punësimit Ligji i Ri “Për nxitjen e punësimit” nuk ka asnjë referencë ligjore. Pra për vitin 2019 nuk ka pasur **Këshill Administrativ Trepalësh**.

Në nenin 23, pika 4, përcaktohet se: “Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji”.

Në nenin 24, citohet se ;

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 14, pika 3, të këtij ligji. ëNgarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 5; nenit 11, pika 4; nenit 12, pikat 3 dhe 5; nenit 15, pika 6; nenit 19, pika 3; dhe nenit 21, pika 6, të këtij ligji. 3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive që, brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji.

Për sa më sipër, referuar VKM-ve për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, konkretisht ku shprehet që:

“...Mënyra e organizimit, vlerësimit të projekteve dhe funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve, përcaktohen me rregullore të Këshillit Administrativ Trepalësh...” apo “...çdo zyrë punësimi i paraqet projektet Këshillit Vendor Trepalësh për të shqyrtuar dhe vlerësuar dobinë sociale ekonomike të tyre...”, KAT apo KVT kanë pasur rol vendimarrës në zbatimin e projekteve të nxitjes së punësimit.

Sipas sektorit juridik , 6 nga VKM e zbatuara në vitin 2018, janë në kundërshtim me Ligjin e Ri Nr. 15/2019, datë 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

Nga sa më sipër SHKP (Drejtoria e Programeve dhe Integritetit në Tregun e punës) bashkë me Titullarin e Përgjithshëm kanë kërkuar interpretim në MFE me shkresën nr.prot. 1693, datë 28.05.2019, për zbatimin e vendimeve të programeve për punësimin vetëm për dy vendime që sipas SHKP nuk janë në kundërshtim me parashikimet e Ligjit të Ri të miratuar, dhe konkretisht

- **VKM nr.873**, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.
- **VKM nr.162**, datë 21.03.2018 “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”. Kjo kërkesë e SHKP është miratuar nga Ministri i MFE me shkresë nr.prot 10074/1 , datë 10.06.2019, duke shprehur dakortësinë me propozimin e kryer si dhe duke sugjeruar që të rezervohen fonde për programet që targetojnë grupe të veçanta, duke qenë se paketa e re e programeve të nxitjes së punësimit do të miratohet katërmujorin e fundit të vitit 2019.

Aktualisht ende në mars të vitit 2020 nuk ka asnjë paketë ligjore të miratuar nga Ministri përgjegjës për programet e nxitjes së punësimit veprime këto që çenojnë Misionin dhe veprimtarinë e SHKP-së, i cili është:

Përmbushja e të drejtës së të gjithë shtetasve rezidentë në Shqipëri për formimin profesional, riaftësimin për punë dhe për punësim fitimprurës nëpërmjet shërbimeve të punësimit dhe pjesëmarrës në programet shtetërore të tregut të punës.

Pra SHKP duke ulur maksimalisht numrin e programeve të nxitjes së punësimit, për vitin 2019 dhe rrjedhimisht edhe për vitin 2020, nuk ka përmbushur objektivat e saj që janë:

Të zbatohen politikat shtetërore të punësimit nëpërmjet :zgjerimit të gamës së programeve të nxitjes së punësimit, zhvillimit të sistemit të formimit profesional në nivel kombëtar, rajonal/vendor me synim kualifikimin dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës; si dhe mbështetjen e tyre me të ardhura.

Për vitin 2019, janë kryer transfertat për pakësimin e fondeve të programeve të nxitjes së punësimit: e para u krye për llogari të programit të pagesës së papunësisë për shumën 40.000.000 leke me shkresën nr. 3549/1 prot, dhe e dyta për llogari të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, për shumën 26.714.782 lekë miratuar me VKM 825 datë 18.12.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Gjithashtu, nga auditimi i strukturës organike të institucionit të SHKP, u konstatua se, për vitet buxhetore 2018 dhe vitin 2019, ka funksionuar sipas Urdhërit Nr.2, datë 07.01.2014 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.91, datë 28.10.2011 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, dhe Urdhrit nr.111, datë 31.01.2018, ku në organikë janë vetëm 2(dy) specialistë për nxitjen e punësimit pranë Drejtorisë të Programeve të Integritimit në Tregun e Punës. Sipas rregullores së brendshme së Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP-së, miratuar nga KAT me vendim nr.31, datë 14.02.2017, Neni 14,”Specialistët për programet e nxitjes së punësimit” pika 4 dhe pika 7, citohet se:

4.Specialisti për programet e nxitjes së punësimit, ndjek realizimin e treguesve të monitorueshëm të programeve të nxitjes së punësimit, evidenton problematikat e veçanta në realizimin e tyre si dhe jep mendime për përmirësim sipas rajoneve.

7.Ndjek zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet kontrolleve, evidencave dhe ecurisë së tyre.

Nga monitorimi i punës së kësaj drejtorie u konstatua se mungon kontrolli dhe monitorimi i ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit. Për periudhën në auditim është kryer vetëm një kontroll nga kjo drejtori sipas Urdhrit të DP. Nr.09,datë 25.06.2019, në referencë të rregullores për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT , në datë 25.06.2018. Nga kontrolli i kryer është mbajtur akt konstatimi me nr.prot.1999/1, datë 15.10.2019 për 79 subjekte përfitues në gjithë territorin.

Mangësitë e konstatuara nga grupi i punës në zyrat e punës, konsistojnë në targetimin e punëkërkuësve të papunë (pu.pa) të përzgjedhur në program, për mënyrën e financimit dhe dokumentacionin e paraqitur si dhe në plotësimin e dosjeve të programeve të nxitjes së punësimit.

a)Ajo që ne konstatojmë si grup auditimi është se në këtë akt konstatimi shkruhet në *përgjithësi* ndërkohë që fusha e shtrirjes së kontrollit ka qenë e madhe dhe numri i subjekteve të kontrolluara 79, dhe nuk ka për asnjë rast të konstatuar fillim të procedurave për ndërprerjen e financimit të programeve edhe pse në mangësitë e cituara shprehen që mungojnë dokumentet justifikues për pagesën e kontributeve mujore, veprime në kundërshtim me nenin 12, të rregullores me nr.prot.1789/2, datë 25.06.2018, ku citohet se:

12.1.1 *Subjekti dorëzon pranë punonjësve të nxitjes së punësimit, dokumentat si më poshtë (për muajin paraardhës):*

Listëprezencën e pjesëmarrësve në program;listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore;dokumentin përkatës bankar që konfirmon derdhjen e pagës dhe kontributeve sipas pikës b)Ky dokumentacion duhet të dorëzohet mundësisht para dates 18 të çdo muaji në mënyrë që brenda datës 20 specialistët e nxitjes në bashkëpunim me ata te financës te përgatisin dokumentacionin financiar që paraqiten pastaj për likuidim në institucionet e thesarit të shtetit.

Në rast se subjekti dorëzon dokumentat e lartpërmendura, në datën 20 e deri në 2 muaj më pas atëherë përgjegjësia për penalitetet përkatëse të parashikuara nga legjislacioni tatimor është e subjektit. Pas kalimit të afatit prej 2 muaj fillojnë procedurat e ndërprejes së financimit për programin. Në të gjitha rastet ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

b)Nga ky aktkonstatim nuk jepet asnjë element konkret për asnjë subjekt përfitues, ku të përshkruhen hollësisht hapat e ndjekur që në momentin e miratimit të projekteve dhe në monitorimin që zyrat përkatëse kanë kryer sipas rregullores të sipërcituar për çdo muaj.

c)Nuk është trajtuar në akt-konstatim për asnjë rast problematikat që kanë subjektet me akt-marrëveshje, pra subjektet që kanë pasur detyrime pranë organit tatimor në momentin e miratimit të projektit nga Komisioni i projekteve në SHKP. Monitorimi i kryerjes së pagesave ndaj detyrimeve të prapambetura dhe atyre koherente nga subjektet të cilat janë me akt-marrëveshje duhet të ishte i dokumentuar në Drejtorinë e përgjithshme për çdo muaj dhe jo të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

monitorohej vetëm nga zyrat e punës, **pasi këta përfitues paraqesin risk të vazhdueshëm dhe nuk zbatojnë kushtet e akt-marrëveshjeve.**

d) Nuk trajtohet konkretisht se sa efektive kanë qenë këto programe dhe konkretisht sipas VKM nr.47, detyrim i subjektit aplikues është që pas përfundimit të formimit në punë, ka për detyrë të realizojë punësimin e 50% të punëkërkuesve të papunë, me kontratë të rregullt pune për një periudhë 6-mujore. Ky fakt shoqërohet vetëm me një raport përfundimtar nga zyrat e punës në të cilin shkruhet që ky detyrim është plotësuar dhe nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës që është listëpagesa e subjektit e deklaruar on-line në sistemin C@TS brenda datës 20 të çdo muaji e cila vërteton se sa nga pu.pa janë të punësuar nga subjekti përfitues.

Nga auditimi i njëpasnjëshëm i dosjeve të përfituesve të programeve të nxitjes së punësimit që gjenden në SHKP si dhe nga faktet e mësipërme arrijmë në konkluzionin që për periudhën në auditim mungon “kontrolli i brendshëm” i cili ka rëndësi maksimale pasi ai garanton se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive të sektorit publik është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të njësive publike. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “,I ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 si dhe nenin 24, ku citohet se:

18. "Kontrolle pas faktit" janë kontrolle të herëpashershme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit, sipas një plani apo në vijim të një kërkesë. Kontrollet pas faktit verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike.**24.Monitorimi: Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përfitimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi individuale sipas funksioneve Grupi i punës që ka kryer monitorimin i përbërë nga 9 anëtarë me kryetar znj x (Drejtorë e Drejtorisë së programeve dhe integritetit në tregun e punës), si dhe Titullari I Përgjithshëm znj x.

II- Nga auditimi u konstatua se:

Gjatë vitit 2018 sipas VKM-së nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, janë miratuar 94 projekte, shuma e konfirmimit është në vlerën prej 108,364,387 lekë, nga këto subvencion në vlerën prej 73,515,806 lekë. Pra vetëm subvencion është 68 % e vlerës totale të projektit.

-Gjatë vitit 2019 për projektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, nuk ka asnjë miratim por janë të mbartura prej vitit 2018, **87 projekte** shuma e konfirmimit është në vlerën prej 98,225,273 lekë, nga këto subvencion në vlerën prej 61,194,539 lekë. Pra vetëm subvencion është 62 % e vlerës totale të projektit.

Një përmbledhje e subvencioneve të përfituara nga subjektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” i ndryshuar, për secilin rajon dhe për periudhën objekt auditimi (2018-2019) jepet në Aneksin nr. 4 dhe Aneksin nr. 5, bashkëlidhur këtij Projekt Auditimi. (*Burimi i të dhënave, SHKP, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*)

Për të kuptuar qartë termin subvencion sqarojme se sipas VKM-së nr. 47, datë 16.01.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë” i ndryshuar, është përcaktuar se përfitues të këtij programi janë punëkërkues të papunë, të cilëve SHKP,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

nëpërmjet zyrave rajonale të punësimit, u financon, përveç pagesave, edhe shumën 19.000 lekë si tarifë me bazë koston për çdo muaj trajnimi deri në 6 muaj.

Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm është konstatuar ky fenomen ku shuma e subvencionit zë peshën specifike në vlerën totale të projektit dhe është lënë rekomandimi që :SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit, nuk ka rezultuar të ketë ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej 134,710,345 lekë kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan drejtoritë/zyrat rajonale faturat e blerjes me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Gjithashtu këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkuar të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej 134,710,345 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 2/Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve shpreheni se :

Sqarojmë se Raporti përfundimtar i grupit të Auditimit të KLSH-së të vitit 2018, ka ardhur tek ne në fund të muajit shtator 2018. (Nr.679/7 datë 29.09.2018). Në këtë raport është rekomanduar që: “SHKP, në bazë të rolit që ka sipas Ligjit të Nxitjes së Punësimit: a. Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë MFE si Ministria përgjegjëse për nxitjes e punësimit dhe që ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për fushën e përgjegjësisë shtetërore, për përmirësimin e VKM 47, ku të gjejë rregullim fakti që, kostot e subvecncioneve shtetërore për blerjen e lëndës së parë të cilat subjekti privat do ti ofroje punëkërkuarëve, duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, transparente dhe të specifikuara, sipas elementëve pëpërës të saj.”

Pra është e qartë se nuk është detyra jonë për sa jemi ngarkuar është të propozojë për ndryshim VKM 47, dhe ne nuk mund të mos zbatonim VKM 47 sepse do të gjykohehim për mos zbatim të VKM nr. 47 të Programit të Nxitjes për gjashtëmuajorin e dytë 2018.

Në bazë të këtij rekomandimi të shprehur që në Projekt Raportin e KLSH, SHKP ka nisur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Shkresë nr. 2292/7 datë 06.09.2018 duke propozuar kërkesën për ndryshimin e VKM Nr. 47. MFE është shprehur se ka filluar puna për ndryshimin e bazës ligjore, theksojmë se kishte filluar procesi për konsultimin e Ligjit të Ri Nxitjes së Punësimit. Në muajin mars 2019, u miratua Ligji i Nxitjes së Punësimit që bëri të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

mundur shfuqizimin e VKM 47 dhe hapjen e procesit të rishikimit të VKM të reja të Programeve të Nxitjes.

Dhe për vitin 2019 sipas VKM 47 nuk është filluar asnjë program i ri.

Ne kemi qenë pjesë e grupeve të punës të ngritura pranë Ministrisë për hartimin e VKM të reja. VKM Nr 17, datë 15.01.2020 si dhe draft rregullorja e hartuar i kanë marrë parasysh rekomandimet e lëna nga grupi i KLSH-së dhe në këtë kuadër e kemi përmbushur rekomandimin e lënë më parë për ndryshimin e VKM Nr. 47.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP,(AKPA), “Drejtoria e Programeve dhe Integritimit në tregun e punës” dërguar me shkresë nr. 183/54 date 04.06.2020, për gjetjen nr.2, **Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve, risqarojmë se :**

Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm është konstatuar ky fenomen ku shumica e subvencionit zë peshën specifike në vlerën totale të projektit dhe është lënë rekomandimi që :SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit, **nuk ka rezultuar** të ketë ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej **134,710,345 lekë** kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan drejtoritë/zyrat rajonale faturat e blerjes me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Gjithashtu këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkuar të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej 134,710,345 lekë pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet. Gjithashtu përgjegjësi për këtë menaxhim ka Ministria e Financës dhe e Ekonomisë si ministria përgjegjëse në propozimin e akteve nënligjore që nuk kanë kryer në kohë ndryshimet e dhura megjithë kërkesat e paraqitura nga ju .

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr.9 “Masat organizative”.

Në lidhje me gjetjen 9/ Drejtoria e Integritimit dhe nxitjes së punësimit është shprehur se:

SHKP jo vetëm e ka përmirësuar, por e ka ndryshuar rrënjësisht procedurën e planifikimit dhe shpërndarjes së fondit, duke synuar detajimin e saktë dhe transparent të tij në përputhje me nevojat e parashikuara nga Zyrat e Punësimit sipas grupeve të veçanta që secila prej tyre synoi të mbështesë. Ajo që Drejtoria e Përgjithshme e SHKP futi si risi në vitin 2018 është se shpërndarjen e fondit për çdo ZP e ka bërë bazuar në nevojat e raportuara nga cdo Zyrë Punësimi, pikërisht të identifikuar bazuar në këto analiza.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Nevojat janë kërkuar dhe raportuar sipas “Udhëzuesit për planifikimin e punëkërkuësve të papunë që do të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit”, miratuar në KAT, sipas një tabele tip të hartuar dhe dërguar nga ana jonë, e cila përmban detajimin e numrit të punëkërkuësve të papunë që kanë nevojë për tu mbështetur me programet e nxitjes së punësimit, sipas grupeve të vecanta dhe sipas kriterëve të programeve në zbatim. Kjo tabelë e planifikimit të nevojave për tu mbështetur me programe nga Zyrat e Puësimit ka qenë gjithashtu pjesë e paketës së miratuar në KAT për programet e nxitjes së punësimit. (Bashkëlidhur udhëzuesi për planifikimin e punëkërkuësve të papunë që do të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit dhe Propozimet mbi paketën e dokumentacionit në zbatim të VKM dhe ndarja e fondit).

Theksojmë që në vitet e kaluara ndarja e fondit bëhej vetëm për subjektet persona fizikë dhe për praktikant profesionalë të studentëve të sapodiplomuar. Pjesa tjetër e fondit ishte e përqëndruar në SHKP dhe shpërndahej në bazë të aplikimeve të paraqitura për subjektet persona juridikë sipas rezultateve të dala nga sistemi i pikezimit. Kjo bënte që fondi të shpërndahej sipas nevojave të subjekteve dhe jo nevojave të punëkërkuësve që ishin të rregjistruar në Zyrat e Punësimit. Meqënëse subjektet e mëdha ushtrojnë aktivitetin në qarqet Tiranë, Durrës, Fier edhe pjesa më e madhe e fondit përqëndrohej në këto rajone, ndërkohë numri i punëkërkuësve të papunë nga targete të vështira në këto rajone në raport me numrin e punëkërkuësve të papunë të regjistruar në total ishte më i vogël se kërkesat e subjekteve.

Në vitin 2018, shpërndarja e gjithë fondit sipas nevojave të secilit rajon dhe jo vetëm në numra por edhe në tipologjinë e targeteve të mbështetur, bëri që numri i përfituesve nga grupet e vecanta të rritej në krahasim me vitet e mëparshme, duke bërë të mundur arritjen e targeteve të vendosura në kuadër të Budget support from EU, dhe si rrjedhojë përfitimin e këtij fondi nga MFE. Ju bëjme me dije se për vitin 2020, gjithë procedura e shpërndarjes së fondit është e parashikuar në rregulloren e zbatimit. Drejtoria Rajonale në bashkëpunim me Zyrat Vendore planifikon shpërndarjen e fondit nisur nga nevojat e punëkërkuësve të papunë. Cdo planifikim i miratuar në Drejtorinë Rajonale do të niset në drejtorinë e përgjithshme të AKPA-S.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP,(AKPA), “Drejtoria e Programeve dhe Integritet në tregun e punës” dërguar me shkresë nr. **183/54 date 04.06.2020**, për gjetjen nr.9, risqarojmë se

Në lidhje me pikën e unifikimit të procesve të punës dhe sistemit të pikëzimit observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë, veprim i reflektuar në projektraport. Ajo që ne kemi konstatuar është mungesa e reflektimit në mënyrë shkresore e trajtimit të kërkesave të punëkërkuësve të papunë dhe shqyrtimeve nga zyrat rajonale përkatëse. Gjithashtu si rezultat i vakumit ligjor të krijuar në mars të vitit 2019, ku përgjegjësia është e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka sjellë mungesë dhe shuarje të fondeve të buxhetit të shtetit për vitin 2019 në lidhje me nxitjen e punësimit, duke bërë që mos të realizohet objektiv kryesor që ky institucion ka.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar në AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr.10 “Masat organizative”.

Për vitin 2018 ka qenë Këshilli Administrativ Trepalësh organi më i lartë vendimarrës, i cili në mbledhjen e parë të vitit miraton ndërmjet shumë aktiviteteve edhe planifikimin dhe shpërndarjen e fondit sipas Zyrave të Punësimit. **Shërbimi Kombëtar i Punësimit sipas**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Rregullores për “Funksionimin e KAT për Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, neni 4 pika 2, kishte të drejtë vetëm të propozonte mbledhjen e KAT.

Procedura për aplikimin e programevetë nxitjes së punësimit duhet të fillonte me miratimin e shpërndarjes së fondit nga ky organ. Kryetari i KAT, i cili thërret dhe drejton mbledhjen është Ministri i MFE. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të SHKP(AKPA) mbledhja e KAT u mundësua vetëm në 25 qershor dhe procedura u miratua me Vendimin Qarkullues Nr. 1.datë 25.06.2018 (Bashkëlidhur kërkesat që janë bërë nga SHKP në vazhdimësi në kohë të ndryshme për miratimin e mbledhjes së KAT).

Menjëherë pas këtij vendimi, SHKP me shkresat nr.1948 Prot, dhe nr.1949 Prot, datë 27.06.2018, njoftoi të gjitha Zyrat e Punësimit dhe APP për fondin e vënë në dispozicion dhe afatin e aplikimit për të gjithë subjektet e interesuar.

Theksojmë se sipas Rregullores për “Funksionimin e KAT për Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, neni 4 pika 2, thirrja dhe drejtimi i mbledhjes së KAT është kompetencë e ministrit përgjegjës për punësimin dhe aftësite ndërkohë që njoftimet tona janë bërë gjithmonë në kohën e duhur.

Ndërsa përsa i përket konstatimit tuaj për kohëzgjatjen e programeve, ju bëjmë me dije se programet me VKM 47 shtrihen për një kohëzgjatje maksimumi 5.8 muaj sipas fushave të zbatimit, por asnjëherë nuk e kalojnë këtë afat. Ndërsa VKM 27, 48, 199, 248, 64 janë programe me kohëzgjatje 12 muaj apo më shumë dhe nuk kanë asnjëherë mundësi të mbyllen brenda vitit buxhetor pavarësisht datës së fillimit të projektit. Në planifikimet e buxhetit ne si institucion gjithmonë e marrim parasysh këtë fakt.

Gjithashtu, sipas parashikimeve në të gjitha VKM, Kontratat tip lidhen vetëm për vitin buxhetor për të cilin është miratuar projekti. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës lidhet një kontratë shtesë (amendament). Pra, VKM e parashikojnë normalisht vazhdimin dhe mbartjen e projektit për vitin pasardhës dhe ky element është konform bazës ligjore. Në të gjitha VKM e programeve të nxitjes së punësimit, VKM 47, neni 18; VKM 48, neni 15 etj, citohet si vijon “Ndërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor, për të cilin është miratuar projekti. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë, në përputhje me fondet e miratuara atë vit”.(Bashkëlidhur një shembull VKM 47).

Konkluzioni nga provat dhe faktet sa më sipër është që Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si Institucion ekzekutiv i politikave të punësimit të hartuara nga Ministria përgjegjëse për çështet e punësimit dhe Qeveria, ka zbatuar me përpikmëri bazën ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP,(AKPA), “Drejtoria e Programeve dhe Integritimit në tregun e punës” dërguar me shkresë nr. **183/54 date 04.06.2020**, për gjetjen nr.10, risqarojmë se

Në lidhje me afatin e aplikimeve në gjashtëmujorin II të vitit fiskal, ne ndajmë të njëtin opinion që edhe ju theksoni ku përgjegjësi kryesor ka KAT dhe normalisht Ministri i Ministrisë i cili realizon këto mbledhje në funksion të mbarëvajtjes dhe të plotësisht të objektivave që SHKP (AKPA) ka . Kështu që qëndrimi jonë mbetet i njëjtë dhe është reflektuar në rekomandim pikërisht përgjegjësia që ka pasur KAT dhe që do të ketë Këshilli Konsultativ për Punësim në vijimësi sipas Ligjit të ri 15/2019.

Përsa i përket realizimeve dhe mosrealizimeve të programeve të nxitjes së punësimit,sipas planifikimit shifrat flasin vetë dhe komentet nuk janë të nevojshme.Për gjithë vitin 2019 numri i programeve të nxitjes së punësimit është ulur ndjeshëm dhe kjo është përgjegjësi e MFE për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

mungesë të udhëzimeve dhe paketave ligjore në kuadër të funksionimit të Ligjit të ri 15/2019, datë 13.03.2019.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar në AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr.12,13 “Masat organizative”, shpreheni se:

Me angazhimin për të rritur performancën e programeve të nxitjes së punësimit në vazhdim, SHKP (AKPA) ka evidentuar dhe marrë masa konkrete për përmirësimin e të gjithë sistemit të zbatimit dhe monitorimit të Programeve të nxitjes, kjo duke marrë parasysh bazën e re ligjore si dhe përmirësimin dhe rritjen e numrit të punonjëse sipas strukturës së re. Konkretisht:

- Në rregulloret e reja të programeve të nxitjes së punësimit për vitin 2020, sistemi i monitorimit është parashikuar në tre nivele: nivel vendor, nivel rajonal dhe nivel qendror, që do të ndjekin dhe trajtojnë gjithë zbatimin e këtyre programeve, me kalendare të përcaktuara monitorimi dhe detyra të ndara dhe specifikuar qartë. (Bashkangjitur VKM 17, datë 15.01.2020 si dhe Draft Rregullorja e programeve të nxitjes së punësimit).
- Në zbatim të VKM për krijimin e AKPA-s të dhe strukturës së remiruar në 26 dhjetor 2019 tashmë në AKPA, është një sektor i vecantë për trajtimin e programeve të nxitjes së punësimit me 4 (katër) specialistë, në varësi të Drejtorisë së Programeve Aktive dhe Pasive në Tregun e Punës, drejtori që kordinon punën edhe me Zyrat e Punësimit. Në këtë mënyrë ndërtohet një linjë vertikale e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.
- Si edhe ju e keni konstatuar për vitet buxhetore 2018-2019, referuar Urdhërit Nr.2, datë 07.01.2014 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.91, datë 28.10.2011 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, dhe Urdhrit nr.III, datë 31.01.2018, në organikën e Drejtorisë të Programeve të Integritimit në Tregun e Punës kanë qënë vetëm 2(dy) specialistë për programet e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Programeve dhe Integritimit në Tregun e Punës, drejtori që nuk kishtë në varësi Zyrat e Punës, duke e vështirësuar linjën hierarkike.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP, (AKPA), “Drejtoria e Programeve dhe Integritimit në tregun e punës” dërguar me shkresë nr. **183/54 date 04.06.2020**, për gjetjen nr.12,13, grupi i auditimit të KLSH-së mban të njëtin qëndrim pasi edhe ju keni sjellë të njëjtët argumentë për të cilët jemi shprehur në raportin përfundimtar të auditimit.

Sipas rregullores së brendshme së Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP-së, miratuar nga KAT me vendim nr.31, datë 14.02.2017, Neni 14, “Specialistët për programet e nxitjes së punësimit” pika 4 dhe pika 7, citohet se:

Specialisti për programet e nxitjes së punësimit, ndjek realizimin e treguesve të monitorueshëm të programeve të nxitjes së punësimit, evidenton problematikat e veçanta në realizimin e tyre si dhe jep mendime për përmirësim sipas rajoneve.

Ndjek zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet kontrolleve, evidencave dhe ecurisë së tyre.

Nga monitorimi i punës së kësaj drejtorie u konstatua se mungon kontrolli dhe monitorimi i ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit. Për periudhën në auditim është kryer vetëm një kontroll nga kjo drejtori sipas Urdhrit të DP. Nr.09, datë 25.06.2019, në referencë të rregullores për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në datë 25.06.2018. Nga kontrolli i kryer është



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

mbajtur akt konstatimi me nr.prot.1999/1, datë 15.10.2019 për 79 subjekte përfitues në gjithë territorin. Observacioni juaj në lidhje me këtë pikë nuk pranohet pasi është reflektuar qartë përgjegjësia juaj si në akt-konstatim por edhe në projekt.Gjithashtu vlerësojmë ndryshimet që ju reflketoni në observacion si në strukturë ashtu edhe në rregullore të cilat nuk janë për periudhën në të cilën ne kemi audituar por janë për vazhdimësinë

*Në lidhje me vlerën prej 134,710,345 lekë nuk i konsiderojmë dëm ekonomik sikurse ju shpreheni në observacion, por përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë, dhe risqarojmë: **Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm** është konstatuar ky fenomen ku shuma e subvencionit zë peshën specifike në vlerën totale të projektit dhe është lënë rekomandimi që :SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit, **nuk ka rezultat** të ketë ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej **134,710,345 lekë** kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan drejtoritë/zyrat rajonale faturat e blerjes me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Gjithashtu këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkues të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej 134,710,345 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë.*

- ❖ Për verifikimin e efektshmërisë së projekteve të nxitjes së punësimit, grupi i auditimit të KLSH-së, realizoi disa verifikime të dosjeve të subjekteve përfitues të cilët shtrijnë aktivitetet e tyre ekonomike në territorin administrativ nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit: Tiranë, Fier , Lushnjë, etj .

Në DRSHPK-Tiranë verifikimet janë realizuar në datat 13.02.2020-14.02.2020, në prani të ish-punonjësës së sektorit të nxitjes së punësimit zj.Elfrida Fsufi dhe Drejtorit të DRSHPK Tiranë znj. Julinda Gjonja .

Në lidhje me dosjet e verifikuara të subjekteve/ përfituese, paraqesim në vijim problematikat e konstatuara :

1.Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-K41416033P, me aktivitet në fushën e ndërtimit në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 995/3 datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 70 punonjës me kohë zgjatje prej 5,8 muaj, me një vlerë financimi 12,741,988 lekë dhe vlerë subvencionit prej (19,000 lekë/muaj x 70 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **7,714,000 lekë** ose 60% e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 01.09.2019 deri në 24.02.2019.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit.
- Formularët F1 dhe F2.
- Plani i Biznesit.
- Ekstrakti Historik i kompanisë.
- vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale i datës 27.07.2018, marrë nga e-albania, sipas të cilit subjekti nuk kishte detyrime.
- Informacion për numrin e fuqisë punëtore , listëpagesa e muajit qershor 2018, printuar nga deklarimi on-line i subjektit në sistemin C@TS, ku janë të punësuar 151 punonjës, fakt ky që tregon për një subjekt me aftësi paguese të larta dhe historik të rregullt tatimor.
- kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.
- amendament kontrate me nr.prot 995/7, datë 03.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit nr.47, Kontrata me nr.prot.995/3, datë 30.08.2018 ,pas akordimit të fonndeve të buxhetit të shtetit për vitin 2019.

Nga verifikimi i dosjes u konstatua se nuk kishte shkelje të afateve gjatë periudhës së formim /trajnimit prej 5,8 muaj si në dorëzimin e listëpagesave dhe të urdhërpagesave përkatëse që konfirmonin derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo muaj.Gjithashtu u krye verifikimi i punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku rezultoi që subjekti e kishte plotësuar këtë kusht duke punësuar një numër rreth 40 persona. Në dosje është raporti përfundimtar me nr.prot .995/8, datë 25.09.2018, i cili nga verifikimet e njëpasnjëshme në dosjet e përzgjedhura , rezulton që kanë një format standart.

Ajo që konstatohet në këta format është mënyra e përgjithshme e raportimit, duke mos dhënë asnjë siguri për punën e kryer nga specialistët e nxitjes së punësimit si dhe efektivitetin e këtyre financimeve. Sikurse do të pasqyrohet në vijim si për subjektet që kanë mangësi në aspektin procedural të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së ashtu edhe për përfitues që nuk janë konstatuar parregullsi, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit shprehen në të njëjtën mënyrë duke cituar se:

Programi është realizuar mjaft mirë dhe ka pasur një ecuri shumë të mirë!!

Ky raport nuk përmban emrin e konceptuesit por vetëm firmën e Drejtorit të Zyrës së punës Përkatëse, **duke mos pasur gjurmë auditimi e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to.** Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e njësisë pra nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues si dhe janë në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin “, si dhe manualin për MFK-në.

2.Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-L53231604V, me aktivitet “Fason, prerje, qepje, prodhim e paketim të veshjeve për burra, gra dhe fëmijë”, në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 1000/3 datë 07.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 34 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj, me një vlerë financimi 5,592,189 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 34 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **3,230,000 lekë** ose 58 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 15.09.2018. deri në 15.02.2019.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit.
- Formularët F1 dhe F2.
- Plani i Biznesit.
- Ekstrakti Historik i kompanisë.
- vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale si dhe i deklarimit të pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore të datës përkatësisht 01.08.2018 dhe 30.07.2018, marrë nga e-albania, sipas të cilit subjekti nuk kishte detyrime.
- Informacion për numrin e fuqisë punëtore, listëpagesa e muajit qershor 2018, printuar nga deklarimi on-line i subjektit në sistemin C@TS, ku janë të punësuar 337 punonjës.
- kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.
- amendament kontrate me nr.prot 1000/18, datë 03.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit nr.47, Kontrata me nr.prot.1000/3, datë 1000/3 datë 07.09.2018, pas akordimit të fondeve të buxhetit të shtetit për vitin 2019.

Nga verifikimi i dosjes u konstatuan diferenca në pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore krahasuar këto me shumën e deklaruar sipas listëpagesave on-line dhe konkretisht:

a) Periudha shtator 2018, deklaruar dhe paguar me 18.10.2018 në vlerë 2,706,799 lekë me një diferencë 83,903 lekë nga vlera e deklaruar 2,790,702 lekë. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 26.09.2018 nga grupi i kontrollit I përbërë prej tre persona :

x, x, x

b) Periudha tetor 2018, deklaruar në vlerë 2,951,150 lekë me 14.11.2018 dhe paguar me 15.11.2018 në vlerë 2,781,799 lekë me një diferencë 169,351 lekë nga vlera e deklaruar. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 09.10.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

c) Periudha nëntor 2018, deklaruar në vlerë 2,975,963 lekë me 11.12.2018 dhe paguar në dy data, përkatësisht në 11.12.2018 dhe në 20.12.2018 me vlerë 2,806,390 lekë me një diferencë 169,573 lekë nga vlera e deklaruar. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 07.11.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

d) Periudha dhjetor 2018, deklaruar në vlerë 2,925,192 lekë me 17.01.2019 dhe paguar në datë, 18.01.2019 me vlerë 2,768,235 lekë me një diferencë 156,957 lekë nga vlera e deklaruar. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 05.12.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

e) Periudha janar 2019, deklaruar në vlerë 2,889,359 lekë me 18.02.2019 dhe paguar në datë, 18.02.2019 me vlerë 2,690,000 lekë me një diferencë 199,359 lekë nga vlera e deklaruar. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 07.01.2019 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

f) Periudha shkurt 2019, deklaruar në vlerë 3,008,037 lekë me 07.03.2019 dhe paguar në datë, 18.03.2019 me vlerë 2,458,000 lekë me një diferencë 550,037 lekë nga vlera e deklaruar. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 06.02.2019 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

Pra subjekti për të gjithë periudhën e trajnimit ka kryer pagesa pjesore të detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, e si rrjedhim ka marrë penalitete dhe kamatëvonesa të vazhdueshme.

Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 17. Nga verifikimi I listëpagesave online për periudhën mars –shtator 2019, u konstatua se në muajin mars -17 të punësuar:

Prill- 13

korrik-13



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Maj- 14

gusht-13

Qershor -14

Në raport përfundimtar me nr.prot.1000/20, datë 29.10.2019 të mbajtur nga specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit për efektivitetin e programit , janë shprehur se numri i pu.pa të punësuar ka qenë 19 kur efektivisht ky numër ka variuar nga 13-14 pu.pa pra 38-40 % e totalit.

Si në çdo raport përfundimtar konstatohet fenomeni i shprehjes :

Programi ka ecur mjaft mirë!!!

Pra nuk shprehet realiteti sipas verifikimit dhe numrit real të punonjësve që kanë qëndruar në skemën e sigurimeve shoqërore pavarësisht arsyeve objektive apo subjektive të largimit të tyre.

3. Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k, me nipt J78311921L, me aktivitet në fushën e ndërtim-prodhimit, në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 1024/3 datë 07.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 50 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, një vlerë financimi prej 9,029,640 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 50 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **5,510,000 lekë** ose 61 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 15.09.2018. deri në 15.03.2019.

*Përsa i përket zbatimit të rregullores së zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale si dhe i deklarimit të pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore të datës përkatësisht 03.08.2018 , marrë nga e-albania, sipas të cilit subjekti nuk kishte detyrime.

-Informacion për numrine fuqisë punëtore, listëpagesa e muajit qershor 2018, printuar nga deklarimi on-line i subjektit në sistemin C@TS, ku janë të punësuar 259 punonjës.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.

-amendament kontrate me nr.prot 1024/8, datë 03.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.47, Kontrata me nr.prot. 1024/3 datë 07.09.2018, pas akordimit të fondeve të buxhetit të shtetit për vitin 2019.

Nga verifikimi i listëpagesave , urdhërpagesave dhe procesverbaleve nuk u konstatuan se ka shkelje të afateve gjatë periudhës së formim /trajnitimit prej 5,8 muaj si në dorëzimin e listëpagesave dhe të urdhërpagesave përkatëse që konfirmonin derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo muaj.

Në raportet e monitorimit të mbajtur nga specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit, përveçse janë standart me një përshkrim shumë sipërfaqësor të situatës, *nuk ka asnjë njoftim shkresor nga subjekti për largimin e pu.pa-ve gjatë periudhës së formim/trajnitimit.*

Në dosje është raporti përfundimtar me nr.prot .1024/9 datë 16.10.2019, i cili shprehet se:

Ecuria e programit ka qenë shumë e mirë dhe numri i pu.pa të punësuar pas përfundimit të programit është 25.

Nga verifikimi i listëpagesave për muajt mars, qershor, gusht, shtator 2019, rezulton që prej fillimit të kushtit numri i pu.pa-ve kanë qenë jo 25 punonjës por 23 pra subjekti ka mbajtur 46 % dhe jo 50% sikurse shprehen specialistët përkatës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

4.Subjekti/përfitues “x ”sh.p.k, me nipt J66926804L, me aktivitet në fushën e ndërtimit- në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 944/3 datë 30.08.2018, ka përfutuar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 83 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, një vlerë financimi prej 15,108,357 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 83 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **9,146,600 lekë** ose 61 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 01.09.2018. deri në 20.03.2019.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale si dhe i deklarimit të pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore të datës 24.07.2018 , marrë nga e-albania, sipas të cilit subjekti nuk kishte detyrime.

-Informacion për numrin e fuqisë punëtore, listëpagesa e muajit qershor 2018, printuar nga deklarimi on-line i subjektit në sistemin C@TS, ku janë të punësuar 102 punonjës.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.

-amendament kontrate me nr.prot 944/6, datë 03.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit nr.47, Kontrata me nr.prot. 944/3 datë 30.08.2018 , pas akordimit të fondeve të buxhetit të shtetit për vitin 2019.

Nga verifikimi i dosjes gjatë periudhës së formim /trajnitimit prej 5,8 muaj si në dorëzimin e listëpagesave dhe të urdhërpagesave përkatëse që konfirmonin derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo muaj, u konstatua se:

-Periudha shtator 2018, deklaruar me 11.10.2018 në vlerë 341,119 lekë dhe paguar në të njëjtën vlerë në datë 15.10.2018. Proces-verbali rradhës është mbajtur më 24.09.2018 nga grupi i kontrollit i përbërë prej tre persona :

1. x

2. x

3. x

Ajo që konstatohet është se subjekti ka kryer një largim masiv të punonjësve për periudhën korrik-gusht të vitit 2018, pasi nga numri i punonjësve 116 që kishte para fillimit të projektit normalisht numri i punonjësve duhet të variojë në shtator në : $116 + 83$ (VKM nr.47)= 199 punonjës, por nga verifikimi i listëpagesës në shtator 2018 subjekti ka 132 punonjës të përfshirë ku nga këta 83 punonjës janë nga skema e pu.pa sipas VKM nr.47, pra subjekti ka bërë largim të punonjësve rreth 67 nga punonjësit ekzistentë.

Ky largim ***i pajustificueshëm*** tregon për një tatimpagues që paraqet risk, dhe për këtë DRSHKP e Tiranës duhet menjëherë të njoftonte DRT Tiranë dhe të bashkëpunonte me sektorin e zbatimit në DRT për një monitorim të subjektit dhe të punonjësve të larguar nga ky subjekt me qëllim sigurimin dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve që ky tatimpagues do të përfutonte në vijimësi nga buxheti i shtetit për këtë projekt. Kjo është ***e papranueshme*** dhe tregon një subjekt me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi është objekt i një tatimpaguesi i cili në cdo moment mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore dhe njëkohësisht nuk duhet të ishte përfutues i projektit të nxitjes së punëmarrësve pasi ky projekt konsiston **në rritje të fuqisë punëtore dhe jo në ulje të saj dhe për më tepër kaq të konsiderueshme duke të dhënë pamjen e një subjekti që kërkon të mbyllet dhe jo të zhvillojë aktivitetin e tij.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Periudha tetor 2018, deklaruar dhe paguar në vlerë 447,128 lekë me 15.11.2018 . Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 29.10.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

-Periudha nëntor 2018, deklaruar dhe paguar në vlerë 431,284 lekë me 12.12.2018. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 26.11.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

-Periudha dhjetor 2018, deklaruar dhe paguar në vlerë 472,087 lekë me 15.01.2019. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 24.12.2018 nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

-Periudha janar 2019, deklaruar dhe paguar në vlerë 419,985 lekë me 12.02.2019. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 23.01.2019, nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

-Periudha shkurt 2019, deklaruar dhe paguar në vlerë 571,645 lekë me 12.03.2019. Proces-verbali i rradhës është mbajtur më 25.02.2019, nga grupi i kontrollit më të njëjten përbërje.

Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 4ëNga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qenë efektiv pasi kanë qenë të punëuar mesatarisht 43-44 pu.pa.Numri total i punonjësve në gusht 2019 sipas listëpagesës on-line është 148 punonjës.

Në dosje është raporti përfundimtar me nr.prot .944/7 datë 25.09.2019, i cili shprehet në lidhje me efektivitetin e programit të nxitjes së punësimit.

Për këtë mbajnë përgjegjësi Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP, Drejtori i DRSHKP Tiranë, pasi nuk kanë kryer një verifikim të hollësishëm të ecurisë së këtij subjekti në momentin e miratimit të Kontratës.

-Komente dhe shpjegime të DRSHKP-së, Tiranë, dërguar me shkresë me nr.prot 183/27; datë 21.04.2020 dhe protokolluar me KLSH nr 65/3 datë 27.04.2020, në lidhje me akt-konstatimin nr.2

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

*Observacioni juaj në lidhje me raportin përfundimtar mbi të cilin ne kemi konstatuar mangësi dhe mungesë të gjurmës së auditimit është një përgjegjësi e cila në vijimësi i takon **Këshillin Konsultativ për Punësimin me tagër e funksion këshillimor në vend të Këshillit Administrativ Trepalësh,***

të rishikojë standartet e këtij formati, për të cilën kemi lënë rekomandim.

Në **DRSHKP-Fier-Lushnjë**, verifikimet janë realizuar në datat 17.02.2020-21.02.2020 , në prani të punonjësës së sektorit të nxitjes së punësimit zj. zj.x dhe zj.x dhe Drejtorit të DRSHKP Fier dhe të zyrës së Punës Lushnjë, përkatësisht z. x dhe z.x e specialists znj. x

➤ Nga auditimi pranë **DRSHKP-Fier** rezultoi se:

* **Gjatë vitit 2018** sipas VKM-së nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, janë miratuar 12 projekte, shuma e konfirmimit është në vlerën prej 16,670,127 lekë, nga këto subvencion në vlerën prej 10,193,500 lekë. Pra vetëm subvencion është 61 % e vlerës totale të projektit.

* **Gjatë vitit 2019** për projektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, nuk ka asnjë miratim por janë të mbartura prej vitit 2018, te 12 projektet dhe shuma e konfirmimit është në vlerën prej 18,081,491 lekë, nga këto subvencion në vlerën prej 10,817,044 lekë. Pra vetëm subvencion është 60 % e vlerës totale të projektit.

Në lidhje me dosjet e verifikuara të subjekteve/ përfituese, paraqesim në vijim problematikat e konstatuara :



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

1. Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k, me nipt-L22925402C, me aktivitet ndërtim, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/51 datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 28 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 6,011,310 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 28 persona x 5.8 muaj) e barasvlefshme me **3,085,600 lekë**, pra rreth 51 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me **nr.prot.1643, datë 30.07.2018**. Subjekti sipas këtij vërtetimi rezulton me detyrime për TVSH-në në vlerën 1,979,608 lekë. Bashkëlidhur këtij vërtetimi është akt-marrëveshja me nr.prot.13247/1, datë 27.07.2018 në lidhje me pageësn totale të këtij detyrimi brenda 6-muajve, pra brenda datës 24.01.2019, me një datë pagese për çdo datë 24 të muajit, të vlerës prej 196,000 lekë .

-Vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot.T00460996, datë 30.07.2018, i cili figuron pa detyrime dhe me një numër punonjësish për muajin qershor 2018, prej 120 persona.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 14. Nga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qenë efektiv pasi kanë qenë të punësuar mesatarisht 12-13 pu.pa.

Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k, me nipt-L22925402C, me aktivitet ndërtim, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/50 datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,790,965 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5.8 muaj) e barasvlefshme me **1,432,000 lekë**, pra rreth 51 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00429310, datë 18.07.2018, si dhe nr.prot.T00429313, datë 18.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Në dosje është raporti përfundimtar i kontrollit i mbajtur në datë 28.10.2019 , i cili raporton mbi ecurinë e projektit gjatë periudhës së trajnimit si dhe gjatë periudhës me kusht . Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 6-7. Nga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qenë efektiv pasi kanë qenë të punësuar mesatarisht 6 pu.pa.

3. Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k,me nipt-..., me aktivitet ndërtim, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/47 datë 11.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,790,965 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5.8 muaj) e barasvlefshme me **1,432,000 lekë**, pra rreth 51 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00440082, datë 23.07.2018, si dhe nr.prot.T00440089, datë 23.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Në dosje është raporti përfundimtar i kontrollit me nr.prot.280/81, i mbajtur në datë 28.10.2019 , i cili raporton mbi ecurinë e projektit gjatë periudhës së trajnimit si dhe gjatë periudhës me kusht . Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 6-7. Nga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qenë efektiv pasi kanë qenë të punësuar mesatarisht 6 pu.pa.

4. Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k,me nipt-..., me aktivitet Rrobaqepësi-fason, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/45 datë 11.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 6 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,260,219 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **1,235,000 lekë**, pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00449745, datë 25.07.2018, si dhe nr.prot.T00449756, datë 25.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime.

Ajo që konstatohet në vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është se subjekti ka një lëvizje të madhe të numrit të punonjësve sidomos në muajt maj –qershor të vitit 2018, dhe konkretisht në muajin maj ka pasur të siguruar 71 punonjës dhe në muajin qershor ka larguar nga skema një numër prej 61 punonjësish. **Kjo është e papranueshme dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi është object i një tatimpaguesi i cili në cdo moment mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore dhe njëkohësisht nuk duhet të ishte përfitues i projektit të nxitjes së punëmarrësve pasi ky projekt konsiston në rritje të fuqisë punëtore dhe jo në ulje të saj.**Nga ana tjetër subjekti në planin e biznesit të paraqitur shprehet se ka shumë nevojë për rritje të fuqisë punëtore, rritje të qarkullimit total të eksporteve e rrjedhimisht edhe të fitimit që do të realizojë duke dhënë “garanci”, që punonjësit që do të punësojë sipas këtij projekti do të jenë në vazhdimësi të siguruar e të punësuar. Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit subjekti nuk rezulton të ketë qenë i suksesshëm. Në verifikimin e listëpagesave të deklaruara on –line gjatë periudhës mars –shtator 2019, ky subjekt ka të punësuar përkatësisht: Mars- 22 punonjës, prill-8 punonjës, maj-8 punonjës, qershor-8 punonjës, korrik; gusht; shtator **vetëm 2 punonjës**. Pra subjekti nuk ka qenë efektiv dhe sikurse konstatohet nuk ka mbajtur as për periudhën 6-mujore numrin 50% të punonjësve të miratuar për t’i siguruar në listëpagesë. Ndërkohë specialistët shprehen në raportin përfundimtar që programi ka qenë efektiv ashtu sikurse shprehen për të gjithë subjektet! Pra subjekti nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe ky projekt nuk i ka shërbyer qëllimit që ka :

Nxitjen dhe rritjen e numrit të fuqisë punëtore në subjektet përfitues.

Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Miratimit të Projekteve në SHKP, Drejtori i Përgjithshëm , Drejtori i DRSHKP Fier , specialistët përkatës, pasi nuk kanë kryer një verifikim të hollësishëm të ecurisë së këtij subjekti i cili është regjistrim i vitit 2017, pra një subject rishtaz i regjistruar pa një historik tatimor dhe rrjedhimisht një arsye më tepër për monitorimin e tij rigoroz në përfitimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit. **Vlera prej 2,260,219 lekë nga Buxheti i Shtetit është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.**

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020, dërguar nga AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 3/Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve negative..., ju shpreheni se: Nga informacioni që kemi marrë nga **DRP Fier: Gjatë zbatimit të programit, subjekti ka lajmëruar **DRP Fier** për vështirësi në aktivitetin e vet. Për të mos ndërprerë programin, subjekti nuk ka larguar asnjë nga**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

pjesëmarrësit në programit. Përsa i përket largimeve të evidentuara për punonjësit e vet, subjekti ka paraqitur arsyen e largimeve si pasojë e problemeve të nënkontraktorit, pra largimi i punonjësve ka qënë për shkaqe të arsyeshme. Në muajin shkurt 2019, muaji i fundit i zbatimit të programit, subjekti ka pasur të punësuar 11 punonjës nga programi dhe 27 punonjës në total. Më datë 18/02/2019 ka depozituar pranë DRSHKP Fier 6 kontrata individuale pune per punonjesit e mbajtur në kushtin e punësimit. Për shkakt të problemeve të prishjeve të kontratave me klientët subjekti e ka patur të pamundur të mbajë punonjësit më tej.

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

*Observacioni juaj në lidhje me subjektin **x”sh.p.k,me nipt-..., nuk pranohet pasi e ritheksojmë: Ajo që kemi konstatuar në vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është se subjekti ka një lëvizje të madhe të numrit të punonjësve sidomos në muajt **maj –qershor të vitit 2018**, dhe konkretisht në muajin maj ka pasur të siguruar 71 punonjës dhe në muajin qershor ka larguar nga skema një numër prej **61 punonjësish**. Atëherë ku qëndron efektiviteti i këtij projekti në nxitjen e punësimit?! Sikurse edhe ju shkruani në observacion subjekti gjatë muajve me kusht arrin në një mesatare prej 8 punonjësish që tregon që ky subjekt për llojin e aktivitetit që ka është inefficent dhe rrjedhimisht projekti për të cilin është klasifikuar ka rezultuar joefektiv.***

5. Subjekti/përfitues **“x”sh.p.k,me nipt-...,** me aktivitet Prodhim mobilie, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/44 datë 11.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,260,219 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **1,235,000 lekë**, pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00461246, datë 30.07.2018, si dhe nr.prot.T00461254, datë 30.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Në dosje është raporti përfundimtar kontrollit me 01.11.2019, i cili raporton mbi ecurinë e projektit gjatë periudhës së trajnimit si dhe gjatë periudhës me kusht . Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 6-7. Nga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qënë efektiv pasi kanë qënë të punësuar mesatarisht 7 pu.pa.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

6. Subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt-... me aktivitet Fasoneri e adresë Cermë –Divjakë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/95 datë 06.09.2018, ka përfutuar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 10 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 1,724,050 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 10 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **950,000 lekë**, pra rreth 55 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

*Përsa i përket zbatimit të rregullores së zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

a) Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me **nr.prot.1691, datë 03.08.2018**, në të cilin subjekti figuron me detyrime në vlerën 64,674 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në TVSH në vlerën 11,084 lekë, në Tatim Fitimi në vlerën 620,788 lekë pra në total subjekti ka detyrime në vlerën 696,546 lekë. Në vërtetim, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve nuk shprehet që për këto detyrime subjekti ka akt marrëveshje me DRT Fier, por në dosje është akt-marrëveshja e lidhur me DRT Fier me nr.prot.6493/1, datë 20.04.2018, sipas të cilës në datën 20.04.2018, subjekti ka 1,019,923 lekë detyrime. Vlera mujore e këstit sipas të cilit subjekti duhet të bëjë pagesën brenda datës 19 të cdo muaji deri më 19.12.2018, është 96,240 lekë, vlerë e cila në qoftë se nuk paguhet atëherë subjekti i zgjidhet akt marrëveshja sipas Kreut XI, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008. i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”.

b) Dy Vërtetime të pagesës dhe deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përkatësisht me nr.prot T00499262, datë 16.08.2018 me detyrime 258,318 lekë dhe vërtetimi me nr.prot T00440792, datë 23.07.2018 me detyrime 314,218 lekë.

Pra nga sa më sipër subjekti është vazhdimisht me detyrime dhe ajo që paraqitet shqetësuese është mosaftësia e likuiditetit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi kryesor i cili tregon një subjekt me risk të lartë në besueshmërinë e pagesës së detyrimeve.

Nga shkresat e dërguara **bashkëlidhur observacionit** rezultonin pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por jo brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe në ligjin e procedurave tatimore, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017, ku citohet se:

Ndjekja e ecurisë së projektit dhe mbyllja e tij / Subjekti dorëzon pranë punonjësve të nxitjes së punësimit, dokumentat si më poshtë (për muajin paraardhës): Listëprezencën e pjesëmarrësve në program (për projektet në zbatim të VKM-ve 47, 64 dhe 199 për periudhën e trajnimit nëpërmjet punës listëprezenca do të firmoset edhe nga trajnuesi); listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, i printuar nga Sistemi i Tatimeve dhe i vulosur nga subjekti; dokumentin përkatës bankar që konfirmon derdhjen e pagës dhe kontributeve sipas pikës b). Ky dokumentacion duhet të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

dorëzohet mundësisht para dates 18 të çdo muaji në mënyrë që brenda datës 20 specialistët e nxitjes në bashkëpunim me ata të financës të përgatisin dokumentacionin financiar që paraqiten pastaj për likuidim në institucionet e thesarit të shtetit. Në rast se subjekti dorëzon dokumentat e lartëpërmendura, në datën 20 e deri në 2 muaj më pas atëherë përgjegjësia për penalitetet përkatëse të parashikuara nga legjislacioni tatimor është e subjektit. Pas kalimit të afatit prej 2 muaj fillojnë procedurat e ndërprejes së financimit për programin. Në të gjitha rastet ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme si dhe Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka përgjegjësi në monitorimin e zyrës vendore për çdo rajon, veçanërisht në rastet kur subjekti i cili përfiton nga projektet e nxitjes së punësimit, rezulton me detyrime pranë administratës tatimore, në momentin e lidhjes së kontratës. Si rrjedhim vlera prej **1,724,050 lekë** nga Buxhetit i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x” sh.p.k, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 3/Kapitulli “Masa shperblimi dëmi” ju shpreheni se:

Në mbështetje të Rregullores “Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit” neni 10, ju bëjmë edhe njëherë me dije se për projektet e miratuara, **Kontrat TIP nënshkruhet ndërmjet Zyrës përkatëse të Punësimit dhe Punëdhënësit dhe jo nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKP dhe është përgjegjësi e Zyrës së Punës ndjekja zbatimit të kësaj kontrate.**

Në zbatim të të gjitha VKM-ve, Komisioni i Miratimit të Projekteve e ka detyrim ligjor miratimin e subjekteve me detyrime tatimore, por që kanë të lidhur një akt-marrëveshje me DT. SHKP është institucion ekzekutiv/ zbatues dhe jo interpretues.

Për të gjitha subjektet aplikuese, që kanë patur nja akt marrëveshje të lidhur më shumë se një muaj para aplikimit, këstet e paguara prej tyre janë bërë pjesë e dosjes së projektit të shqyrtuar nga ky komision. Ndërsa gjatë zbatimit të projektit të gjitha këstet e paguara janë mbledhur nga specialistët përgjegjës për programet në Zyrat e Punësimit dhe janë pjesë e dosjes së projektit. **Si në të gjitha rastet e ngjashme edhe subjekti “x”, ka patur në dosje këste të paguara në momentin e miratimit (Bashkëngjitur këstet e paguara të detyrimit për subjektin në fjalë përpara miratimit të projektit).**

Në mbështetje të Rregullores neni 11.2, konfirmimi i fondit për projektet fituese të miratuara në SHKP, kryhet nga sektori i financës dhe fondi kalon në Drejtorinë Rajonale të Punësimit. Kjo e fundit bën financimin mujor për cdo project në bazë të dokumentave të paraqitura nga Zyra Vendore e Punësimit. **Pra, lëvrimi i fondeve për subjektin “x” është totalisht përgjegjësi e DRP Fier.**

Kujtojmë që, sipas nenit 12, të Rregullores “Për zbatimin e programeve të nxitjes së Punësimit”, miratuar me Vendimin Qarkullues nr.1 datë 25.06.2018, subjekti dorëzon pranë punonjësve të nxitjes së punësimit në zyrë vendore, dokumentat e nevojshme për financim. Ky dokumentacion duhet të dorëzohet mundësisht para dates 18 të çdo muaji në mënyrë që brenda datës 20 specialistët e nxitjes në bashkëpunim me ata të financës të përgatisin dokumentacionin financiar që paraqiten pastaj për likuidim në institucionet e thesarit të shtetit. **Në rast se subjekti dorëzon dokumentat e lartëpërmendura, në datën 20 e deri në 2 muaj më pas atëherë përgjegjësia për penalitetet përkatëse të parashikuara nga legjislacioni tatimor**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

është e subjektit. Pas kalimit të afatit prej 2 muaj fillojnë procedurat e ndërprerjes së financimit për programin. Në të gjitha rastet ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

Pra, nga sa më sipër, në asnjë rast nuk është përgjegjësi e administratës së SHKP, evidentimi dhe marrja e masave ndaj subjektit pa u bërë present dhe paraqitur në formë shkresore nga Zyra Vendore e Punësimit.

Në nenin 12.3 të Rregullores për Zbatimin e Programeve, citohet se ecuria mujore mbahet nga cdo Zyrë Punësimi dhe niset në Drejtorinë e Përgjithshme SHKP brenda datës 10 të muajit pasardhës. Në këtë tabelë, Zyra Vendore e Punësimit Lushnjë, nuk ka paraqitur asnjëherë asnjë problematikë në lidhje me pagesat me vonesë që ka kryer subjekti. Në referencë të Rregullores “Për zbatimin e programeve të nxitjes së Punësimit”, miratuar me Vendimin Qarkullues nr.1 datë 25.06.2018, ku thuhet që ZP duhet të evidentojnë dhe paraqesin cdo element apo problematikë në zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, ***Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk ka asnjë përgjegjësi për problematika të cilat nuk janë bërë prezent prej saj.***

Nga informacioni që kemi marrë nga ZP Lushnje: Subjekti e ka përfunduar formimin nëpërmjet punës në muajin shkurt 2019, kohë e cila verifikohet nga vetë Zyra e Punësimit. Pas kësaj periudhe i vetmi dokument që subjekti ka detyrim ligjor të dorëzojë pranë Zyrës së Punësimit është listëpagesa e sigurimeve shoqërore ku verifikohet nëse po zbatohet kushti i punësimit, dmth që subjekti është duke vazhduar marrëdhënien e punës. Pas gushtit 2019, Zyra e Punësimit nuk ka patur asnjë detyrim të kerkojë dokumentacion nga ky subjekt pasi programi ka përfunduar. Këto verifikime i takojnë Drejtorisë Tatimore, i cila ka përgjegjësi dhe funksion primar ndjekjen ligjore të rasteve të subjekteve me detyrime tatimore të papaguara.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar SHKP,(AKPA), dërguar me shkresë nr. **183/54 date 04.06.2020**, **lidhur me gjetjen nr. 3/Kapitulli “Masa shperblimi dëmi, pranohet pjesërisht observacioni, duke hequr dëmin ekonomik, nisur nga situata aktuale e detyrimeve të subjektit e cila rezulton të jetë 0 lekë, por nuk mund të pranohet që fondi i buxhetit të shtetit është përdorur nga administrata e SHKP në nivel qendror dhe rajonal me ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë. Pasi vazhdimisht ka munguar monitorimi dhe ndikimi i administratës gjatë përfitimit të këtyre fondeve. Pranimi pjesor i observacionit është reflektuar në material.**

7.Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k, me nipt-.... me aktivitet ndërtim, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/98 datë 06.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 25 punonjës me kohë zgjatje prej 5,8 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 5,112,075 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 25 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **2,755,000 lekë** pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit.
- Formularët F1 dhe F2.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-Plain i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00455240, datë 26.07.2018, si dhe nr.prot.T00455296, datë 26.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Në dosje është raporti përfundimtar i kontrollit i cili raporton mbi ecurinë e projektit gjatë periudhës së trajnimit si dhe gjatë periudhës me kusht .

Pavarësisht që subjekti ka rezultuar i rregullt në kryerjen e pagesave sispas detyrimeve kontraktuale me SHKP-në, konstatojmë se në momentin e nënshkrimit të kontratës pra shtator 2019, ka një lëvizje të konsiderueshme të numrit të punonjësve pikërisht atëherë kur i kërkohet që ky numër jo vetëm mos të zvogëlohet por të rritet më shume me punonjësit që do të përfitojnë në bazë të VKM nr.47. Konkretisht po japim një tabelë sesi ka variuar ky numër për periudhën prill- dhjetor 2018.

Tabela me numrat e punonjësve në momentin e aplikimit për projektin si dhe në vazhdimësi:

Nr	Periudha tatimore	Numri I Kontribuesve	Diferenca
1	1804	146	
2	1805	106	40
3	1806	88	18
4	1807	95	-7
5	1808	92	3
6	1809	128	-36
7	1810	137	-2
8	1811	139	-2
9	1812	138	1

Pra nga sa më sipër konstatohet që për periudhën prill-qershor subjekti ka kryer një largim prej 58 punonjësish, kur në planin e biznesit që paraqet shprehet për rritje të fuqisë punëtore cka nuk rezulton reale dhe për më tepër nuk konstatohet as nga zyra e punës Lushnjë dhe as nga Komisioni i Miratimit të projekteve në SHKP.

Përsa i përket muajve me kusht, subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 1ëNga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se kanë qenë të punësuar mesatarisht 12 pu.pa, por numri i të punësuarve për periudhën mars –gusht 2019 ka qenë mesatarisht 128 punonjës (marrë nga deklarimet on line në sistemin tatimor). **Pra konstatohet që edhe pas përfundimit të projektit nuk ka rritje të numrit të punonjësve mbi mesataren që ky subjekt ka vazhdimisht.**

8. Subjekti/përfitues “x”sh.p.k,me nipt-... me aktivitet ndërtim, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/91 datë 06.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 32 punonjës me kohë zgjatje prej 5,8 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 6,543,456 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 32 persona x



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

5,8 muaj) e barasvlefshme me **3,526,400 lekë** pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë.

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore si dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore përkatësisht me nr.prot.T00455112, datë 26.07.2018, si dhe nr.prot.T00455127, datë 26.07.2018 sipas të cilave subjekti nuk kishte detyrime. Subjekti ka një mesatare prej 207 punonjësish për një periudhë 6-mujore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Fier, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . Në dosje është raporti përfundimtar i kontrollit me nr.prot.195/7 i mbajtur në datë 06.11.2019, i cili raporton mbi ecurinë e projektit gjatë periudhës së trajnimit si dhe gjatë periudhës me kusht . Përsa i përket muajve me kusht subjekti sipas VKM nr.47, duhet të mbajë në skemën e sigurimeve shoqërore 50 % të numrit total të pu.pa, që në rastin konkret duhet të jetë 16. Nga verifikimi i listëpagesave online për periudhën mars –gusht 2019, u konstatua se programi në këtë pikë ka qenë efektiv pasi kanë qenë të punësuar mesatarisht 26 pu.pa

Përveç problematikave të cilësuar për secilin subjekt, ajo që konstatojmë është mungesa e gjurmës së auditimit në dosjet e subjekteve përfitues *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to*, konkretisht:

1-Mosparaqitjen me hollësi të cdo elementi që kontrollohet në zbatim të rregullores dhe detyrimeve kontraktuale ,në proces-verbalin që specialistët e nxitjes së punësimit mbajnë cdo muaj në subjektet përkatës si dhe mungesa e një formati standart të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm në monitorimin dhe ecurinë e projektit. Në dosjet e audituara në disa rajone u konstatua se process verbalet ishin të ndryshëm në përmbajtje dhe rrjedhimisht mungonte transparencja e veprimeve duke krijuar vështirësi për ne si auditues të jashtëm në nxjerrjen e një konkluzioni të saktë në certifikimin e këtyre praktikave. Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e njësisë pra nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues si dhe janë në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, si dhe manualin për MFK-në.

2- Raporti i kontrollit Përfundimtar edhe pse është *standart* ka shumë element që i mungojnë pasi :

a)Raporti është i përgjithshëm duke u shprehur vetëm me një fjali tip dhe të njëjtë për të gjithë ecurinë prej afër 11 muaj të efikasitetit të një programi duke mos dhënë asnjë siguri për punën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

e kryer nga specialistët e nxitjes së punësimit si dhe efektivitetin e këtyre financimeve. Sikurse është pasqyruar për cdo rast si për subjektet që kanë mangësi në aspektin procedural të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së ashtu edhe për përfitues që nuk janë konstatuar parregullsi, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit shprehen në të njëjtën mënyrë duke cituar se:

Programi është realizuar mjaft mirë dhe ka pasur një ecuri shumë të mirë.

c)Raporti për cdo rast është i firmosur vetëm nga Drejtori Rajonal, shpeshherë mbahet me shkrim dore si dhe mungon emri dhe firma e konceptuesit.

- Në kuadër të kryerjes së auditimit, u vendosën në dispozicion Dosjet e miratimit të projekteve për përfituesit që kanë rezultuar me akt-marrëveshje me Drejtorinë Tatimore në momentin e nënshkrimit të kontratave, të dorëzuara nga zyrat rajonale të punësimit për vitet 2018-2019 në formë shkresore dhe elektronike, kontratat e miratuara nga Komisioni i Projekteve, urdhër xhirimet, listëpagesat e subjekteve, vendimet e KAT, etj.

Në lidhje me dosjet e verifikuara të subjekteve/përfituese, paraqesim në vijim problematikat e konstatuara :

Drejtoria Rajonale e Punësimit, Gjirokastrë.

1.Subjekti/përfitues “x ”person fizik, me nipt-L52624601S, me aktivitet Tavernë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 448 datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, për 1 punonjës ku DRP/ZVP financon punëdhënësin në lidhje me secilin punëmarrës me rrogë të barabartë me pagën minimale për muajin 1 deri në të 12 (paga 24,000 lekë), dhe për gjashtë muajt e dytë të punësimit do të financojë me 50% të pagës minimale në masën 12,000 lekë, në vlerën 277,795 lekë.

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

a)Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me **nr.prot.T00467176, datë 01.08.2018**, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018 është 7 punonjës. Në dosje mungon vërtetimi tip mbi shumën e detyrimeve të të gjithë llojeve të tatimeve, një nga dokumentet kryesorë që duhet të ishte paraqitur nga subjekti. Ky tatimpagues ka lidhur akt marrëveshje me DRT Gjirokastrë me **nr.prot.132, datë 09.01.2018**, sipas të cilës ka këto detyrime dhe gjoba:

Tabela. Nr.6.

Nr	Lloji I tatimit	Detyrim kryesor	Gjoba	Kamatëvonesa	Totali
1	TVSH	34,122	555	160	34,837
2	Tatim në Burim	6000	36	10	6,046
3	Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	94,656			94,656
4	Global		50,000		50,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Totali	134,778	50,591	170	185,539
---------------	----------------	---------------	------------	----------------

Pra në total ka 185,539 lekë dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj është **17,276 lekë** deri në fund të vitit 2018. Mosekzistenca e vërtetimit për shumën totale të detyrimeve në datën 01.08.2018 është mungesë transparence si e tatimpaguesit por edhe e Drejtorisë Rajonale të Punës në Gjirokastrë e cila ka pranuar këtë fakt duke lënë hapsira për dyshime dhe për mosnjohje të ecurisë së pagesës që ky tatimpagues ka pasur gjatë vitit 2018.

Në lidhje me sa më sipër DRT Gjirokastrë me shkresën me nr.prot.5059/1, datë 20.08.2018 informon se subjekti ka detyrime në sistemin tatimor në vlerë **206,419 lekë** (pra akoma më shumë se në tabelën nr.6), dhe nuk përmend asnjë element ku të tregojë nëse ky tatimpagues ka respektuar aktmarrëveshjen e lidhur në datën **09.01.2018** e për rrjedhojë, vlera e detyrimeve duhet të ishte ulur pasi kanë kaluar 8 muaj nga lidhja e kësaj aktmarrëveshje. Nisur nga sa më sipër si dhe sipas Ligjit 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Administrata tatimore ka lidhur akt-marrëveshje në kundërshtim me nenin 77, pika 7, ku citohet se:

7. Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore, si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të këtij ligji, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi.

Pavarësisht sa më sipër, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, për detyrim tatimor mbi të ardhurat, të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, i cili është llogaritur ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.

Në rastin konkret sikurse shprehet qartë në tabelë akt marrëveshja është lidhur pikërisht për detyrim tatimor mbi tatim të mbajtur në burim dhe të **vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.**

Gjithashtu në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrën e Punës Gjirokastrë, në datë **12.09.2018**, subjekti rezulton me detyrime dhe pa akt-marrëveshje.

Pra nga sa më sipër është vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, ku citohet se:

*Bëjnë përjashtim nga ky rregull personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por në momentin e aplikimit në këtë program:i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;ii) kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat;iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore. **Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.***

Nga sa më sipër Komisioni i Miratimit të projekteve nuk duhet të kishte miratuar lidhjen e kontratës me këtë subject pasi subjekti rezulton me detyrime dhe nuk ekziston asnjë document, urdhërpagese apo konfirmim periodic mujor që të vërtetojë që subjekti ka respektuar kushtet e kontratës duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”.Për këtë mbajnë përgjegjësi Drejtori i Zyrës së Punës Gjirokastrë, z.x, Komisioni i Miratimit të Projekteve duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 277,795 lekë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 4/Kapitulli “Masa shperblimi dëmi” ju shpreheni se:

Nga informacioni që kemi marrë nga DRP Gjirokastrë: Në datën 01.08.2018, nga DRP Gjirokastrë është marrë një vërtetim që vërtetonte se subjekti nuk kishte detyrime në sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Diferencën që ju konstatooni, ju kujtojmë se subjekti është person fizik dhe deklarimet apo pagesat i kryen një herë në tre muaj. DRP Gjirokastrë ka ndjekur pagesën e kësteve sipas kësaj akt marrëveshjeje. Në muajin qershor 2019, kohë në të cilën programi nuk kishte përfunduar, subjekti rezultoi pa asnjë detyrim tatimor nga Akt Marrëveshja e vitit 2018.

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x” person fizik, me nipt-... nuk pranohet pasi megjithë shkresat që ju keni dërguar të cilat janë kontrolluar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me shumë korrektësi, pavarësisht që në dosjet e marra nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme është kërkuar që të ishin të gjithë dokumentet përbërëse të një dosjeje të arkivuar, risqarojmë:

Ne jemi duke audituar periudhën në të cilën subjektin i miratohet një projekt sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar” dhe në këtë moment ai duhet të jetë pa detyrime ose të ketë lidhur akt-marrëveshje e cila duhet të jetë respektuar nga tatimpaguesi sipas grafikut të përcaktuar nga DRT përkatëse. Ju keni bashkëlidhur urdhërpagesa të cilat nuk janë periodike dhe në asnjë moment në shkresat e nxjerra nga DRT Gjirokastrë nuk shprehen në lidhje me zbatimin e akt-marrëveshjes por shprehen vetëm për detyrimet në kohë reale të tatimpaguesit. Është e vërtetë që ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të një akt-marrëveshjeje nuk është detyra dhe përgjegjësi juaj, gjë për të cilën jemi shprehur qartë por duke qenë që subjektin i miratohet një projekt i cili ka disa kritere në këtë drejtim ju detyron ju si Zyrë Pune të jeni kërkuar dhe bashkëpunues me DRT për të vërtetuar që subjekti ka qenë i rregullt me pagesat si dhe që fondi i marrë nga Buxheti I Shtetit për këtë projekt ti jepet një subjekti që nuk paraqet risk dhe që plotëson kushtet sipas VKM të sipërcituar.

Zyra vendore e SHKP, Delvinë.

2.Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Përpunim i ullirit, import-export”, dhe adresë kryesore të zhvillimit të aktivitetit në Jorgucat-Gjirokastrë, si dhe nipt sekondar Delvinë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 453, datë 12.09.2018, ka përfutuar sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë nga grupet e veçanta“ për 44 punonjës me kohë zgjatje për 1 vit. Për këtë VKM, Zyra përkatëse e punësimit financon:

a)Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b)Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Vlera e financimit për këtë subjekt ka qenë në total (pra për 30 punonjës në Zyrën e Punës/ Gjirokastrë si dhe për 14 punonjës në Zyrën e Punës /Delvinë), 6,820,896 lekë .

*Përsa i përket zbatimit për VKM nr.48 datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë nga grupet e veçanta”, si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, rezulton se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-Kontratat dhe deklaratat individuale për secilin punonjës.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me **nr.prot.345, datë 17.08.2018** sipas të cilit subjekti ka detyrime në vlerën **502,557 lekë** në Tatim Fitimi dhe ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Gjirokastër me nr.prot. 4674, datë 23.07.2018. Sipas akt marrëveshjes subjekti ka kryer pagesën prej 101,500 lekë në datë 23.07.2018 dhe për pjesën e mbetur prej 406,971 lekë, pagesa do të kryhet në dy këste përkatësisht:

i) Kësti I –vlera 203,500 lekë, datë 23.09.2018

ii) Kësti II-vlera 203,741 lekë, datë 23.12.2018.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me **nr.prot.T00467292, datë 01.08.2018**, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është 160 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Gjirokastër, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji . **Nuk ka në dosjen e përfituesit asnjë dokument apo urdhërpagesë ku subjekti të konfirmojë që ka qenë konform ligjit në kryerjen e pagesave të detyrimeve që ka sipas akt-marrëveshjes (të cituara më sipër).**

Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Gjirokastër/sectorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit, sectorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe Komisionin e miratimit të Projekteve për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrat e Punës.

Gjithashtu SHKP/Drejtorja e Përgjithshme duhet të kryejnë një monitorim periodik të hollësishëm si dhe të kontaktojnë shkresërisht me Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse për të ndjekur ecurinë e pagesave për detyrimet e prapambetura.veprime këto të pakryera në asnjë rast për subjektet me detyrime dhe përfitues të projekteve të nxitjes së punësimit. Si rrjedhim vlera prej **6,820,896 lekë lekë** nga Buxhetit i Shtetit, e përfituar nga subjekti “**x**”sh.p.k, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 4 /Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve negative.., ju shpreheni se: Subjekti x në momentin e aplikimit ka qenë me dosje të rregullt dhe te plote konform te gjithe kerkesave të bazës ligjore ne fuqi. Ky subjekt ka patur të lidhur Akt Marrëveshjen me tatimet, më datë 23.07.2018, marrëveshje konform VKM të programit të nxitjes së punësimit. Duke parë datën e lidhjes së marrëveshjes, ju kujtojmë se pagesa e këstit të parë korespondon pas miratimit të projektit dhe nuk mund të ishte pjesë e dosjes së aplikimit të programit.

Në zbatim të të gjitha VKM-ve, Komisioni i Miratimit të Projekteve e ka detyrim ligjor miratimin e subjekteve me detyrime tatimore, por që kanë të lidhur një akt-marrëveshje me DT. SHKP eshte institucion ekzekutiv dhe jo interpretues.

Nga informacioni që kemi marrë nga DRP Gjirokastër: Gjatë zbatimit të projektit të gjitha këstet e paguara janë mbledhur nga specialisti përgjegjës për programet në DRP Gjirokastër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

dhe janë pjesë e dosjes së projektit. Në muajin dhjetor 2018 subjekti rezulton pa asnjë detyrim tatimor nga Akt Marrëveshja dhe është konform gjithë bazës ligjore

1-Komente dhe shpjegime të SHKP-së, dërguar me shkresë me nr.prot 183/31; datë 23.04.2020 dhe protokolluar me KLSH nr 65/3 datë 27.04.2020, në lidhje me akt-konstatimin nr.4

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x”sh.p.k,me nipt-...., nuk pranohet pasi megjithë shkresat që ju keni dërguar të cilat janë kontrolluar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me shumë korrektësi, pavarësisht që në dosjet e marra nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme është kërkuar që të ishin të gjithë dokumentet përbërëse të një dosjeje të arkivuar, risqarojmë:

1-Ju keni paraqitur një statement bankar ndërkohë që nuk është detyra joën të verifikojmë dhe të dallojmë cilat janë pagesat e kryera nga ky subject kundrejt këstit të akt-marrëveshjes . Ju duhet të dergoni urdherpagesat origjinale ose të njehsuara me origjinalin për vërtetimin e sa më sipër.

2-Ju keni dërguar formularë të rimbursimit të Tatim Fitimit me tepricën kreditore të tvsh, veprime të aprovuara në sistemin C@TS në datë 13.03.2019, ndërkohë që në akt marrëveshje citohet qartë që detyrimi total duhej të likuidohej brenda datës 23.12.2018.

Nga sa mësipër subjekti nuk ka qenë i rregullt në likuidim dhe rrjedhimisht nuk ka zbatuar dhe plotësuar detyrimet kontraktuale sipas Kontratës Tip me nr.prot 453, datë 12.09.2018.

Zyra vendore e SHKP, Has.

3.Subjekti/përfitues “x”sh.p.k,me nipt-...., me aktivitet “Ndërtim”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 421, datë 03.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 20 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj, me një vlerë financimi 3,736,960 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 20 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **2,204,000 lekë** ose 59 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 03.09.2018 deri në 24.02.2019.

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.

-amendament kontrate me nr.prot.421/1, datë 03.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.

-vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale me nr.prot.398, datë **25.07.2018** marrë nga DRT Kukës, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën **659,283 lekë** në tatim fitimi dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. 399, datë 25.07.2018.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Kukës me nr.prot.1333, datë **05.04.2018**.Sipas akt marrëveshjes subjekti ka një shumë detyrimesh të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

mbetur për të paguar në vlerën **607,513 lekë** për një periudhë 20 mujore pra më shumë se 1 vit , sipas planit të pagesës me këste mujorë në vlerën 30,375 lekë .

Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 30,375 lekë, sipas akt-marrëveshjes.

Në dosje gjenden listëpagesat , procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to* si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip FëMungojnë urdhërpagesat me vulën e bankës të cilët konfirmojnë derdhjen e detyrimeve mujore në sistemin tatimor. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017, ku citohet se:

Ndjekja e ecurisë së projektit dhe mbyllja e tij / Subjekti dorëzon pranë punonjësve të nxitjes së punësimit, dokumentat si më poshtë (për muajin paraardhës): dokumentin përkatës bankar që konfirmon derdhjen e pagës dhe kontributeve sipas pikës b).Ky dokumentacion duhet të dorëzohet mundësisht para dates 18 të çdo muaji në mënyrë që brenda datës 20 specialistët e nxitjes në bashkëpunim me ata te financës te përgatisin dokumentacionin financiar që paraqiten pastaj për likuidim në institucionet e thesarit të shtetit.Në rast se subjekti dorëzon dokumentat e lartpërmendura, në datën 20 e deri në 2 muaj më pas atëherë përgjegjësia për penalitetet përkatëse të parashikuara nga legjislacioni tatimor është e subjektit. Pas kalimit të afatit prej 2 muaj fillojnë procedurat e ndërprejes së financimit për programin. Në të gjitha rastet ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

Mungon Raporti i kontrollit përfundimtar i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku në rastin konkret subjekti duhet të ketë të punësuar një numër prej 10 persona.

Këto veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin “, si dhe manualin për MFK-në, ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Has /sektorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit , Drejtorin rajonal të DRSHKP Kukës , z.x, sektorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme, Komisionin e miratimit të Projekteve si dhe Drejtorin e Përgjithshëm për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrat e Punës.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 5 /Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve negative..,

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x”sh.p.k,me nipt-..., nuk pranohet pasi raporti që ju keni dërguar nuk përmban elementet bazë të vërtetësisë së një shkrese dalë nga Zyra e Punësimit Has si dhe në lidhje me urdhërpagesat e dërguara, vazhdojmë të kemi të njëjtin qëndrim të shprehur edhe në projekt raport.

Zyra vendore e SHKP, Dibër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

4. Subjekti/përfitues “x ”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Fast-Food, Picëri e bar-kafe”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 71, datë 30.08.2018, ka përfutuar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 2 punonjës me kohë zgjatje për 5 muaj me një vlerë financimi **312,732 lekë** dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 2 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **190,000 lekë** ose 61 % e vlerës totale të financuar. Gjithashtu subjekti ka përfutuar edhe një projekt të dytë sipas VKM nr.248, datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 70, datë 30.08.2018, për 1 punonjës me vlerë financimi **276,768 lekë**.

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores së zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit se ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.

-amendament kontrate me nr.prot.327, datë 11.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.47 dhe VKM nr.248.

-Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.170, datë 27.09.2019 i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku në rastin konkret subjekti duhet të ketë të punësuar 1 person.

-vërtetimi i detyrimeve në kohë reale me nr.prot.362, datë **31.07.2018** marrë nga DRT Dibër, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën **154,309 lekë** të pacilësuar së në afarë lloj tatimi duke vepruar në kundërshtim me vërtetimet tip të aprovuara nga DPT .

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00476838, datë 06.08.2018, i cili gjithashtu është me detyrime , gjoba dhe kamatëvonesa në vlerën 102,777 lekë.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Dibër me nr.prot.2940, datë **31.07.2018**, sipas të cilës ka këto detyrime dhe gjoba:

Tabela. Nr.7.

Nr	Lloji I tatimit	Detyrim kryesor	Gjoba	Kamatëvonesa	Totali
1	Të Tjera		50,000		50,000
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	71,558	58,339	9,176	139,073
3	Tatim I Thjeshtuar I Fitimit		10,236	8,676	18,912
	Totali	71,558	118,575	17,852	207,985

Pra në total subjekti ka **207,985** lekë detyrime dhe kësti mujor që duhet të paguajë çdo muaj sipas akt-marrëveshjes është **20,000 lekë** deri në fund të vitit 2018 i përlllogaritur nga Drejtoria e Mbledhjes në DRT Dibër.

Nisur nga sa më sipër si dhe sipas Ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”, Administrata tatimore/DRT Dibër ka lidhur akt-marrëveshje në kundërshtim me nenin 77, pika 7, ku citohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

7. Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore, si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të këtij ligji, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi.

Pavarësisht sa më sipër, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, për detyrim tatimor mbi të ardhurat, të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, i cili është llogaritur ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.

Në rastin konkret sikurse shprehet qartë në tabelën nr.7 subjekti ka detyrime dhe gjopa në vlerën 139,073 lekë dhe kjo përbën 67 % të borxhit në total, pra zë peshën kryesore në këtë vlerë dhe akt marrëveshja është lidhur pikërisht për këtë detyrim tatimor **të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi.**

Gjithashtu akt-marrëveshja është dokumenti bazë i cili duhet të ndihmojë dhe të jetë objekt-monitorimi i SHKP-së, për të ndjekur ecurinë e pagesave dhe respektimin e afatit në derdhjen e tyre të këtij tatimpaguesi i cili është përfitues i dy projekteve me një vlerë financimi nga buxheti i shtetit, në total prej 589,500 lekë. Por SHKP ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.47, ku citohet se:

Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program :

i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii) kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjopat;

iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore. Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.

Si dhe në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullore së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017, ku citohet se:

*Ndjekja e ecurisë së projektit dhe mbyllja e tij / Subjekti dorëzon pranë punonjësve të nxitjes së punësimit, dokumentat si më poshtë (për muajin paraardhës): Listëprezencën e pjesëmarrësve në program (për projektet në zbatim të VKM-ve 47, 64 dhe 199 për periudhën e trajnimit nëpërmjet punës listprezenca do të firmoset edhe nga trajnuesi); listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, i printuar nga Sistemi i Tatimeve dhe i vulosur nga subjekti; **dokumentin përkatës bankar që konfirmon derdhjen e pagës dhe kontributeve sipas pikës b).**Ky dokumentacion duhet të dorëzohet mundësisht para dates 18 të çdo muaji në mënyrë që brenda datës 20 specialistët e nxitjes në bashkëpunim me ata të financës të përgatisin dokumentacionin financiar që paraqiten pastaj për likuidim në institucionet e thesarit të shtetit.Në rast se subjekti dorëzon dokumentat e lartpërmendura, në datën 20 e deri në 2 muaj më pas atëherë përgjegjësia për penalitetet përkatëse të parashikuara nga legjislacioni tatimor është e subjektit. Pas kalimit të afatit prej 2 muaj fillojnë procedurat e ndërprejes së financimit për programin. Në të gjitha rastet ky proces duhet të jetë i dokumentuar.*

Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej **20,000 lekë** , sipas akt-marrëveshjes.

Në dosje gjenden listëpagesat , procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip F2

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtori i Zyrës së Punësimit Bulqizë z. x, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit, Komisioni i miratimit të Projekteve, Drejtori i

Përgjithshëm i cili nuk duhet të kishte miratuar dhënien e këtyre projekteve subjektivit i cili ka detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ku për asnjë rast nuk ka të konfirmuar pagesa mujore kusht ky i detyrueshëm për t'u ndjekur nga kjo administratë dhe për të qenë pjesë e dosjes si gjurmë auditimi. Si përfundim fondi prej **589,500 lekë** i buxhetit të shtetit është përdorur pa efektivitet, ekonomikitet e efikasitet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 5 /Kapitulli “Masa për eliminimin e efekteve negative..,

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x”sh.p.k, me nipt-..., nuk pranohet për argumentet ligjorë të cituar qartë në project –raport.

Zyra vendore e SHKP, Pukë.

5. Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Fabrikim, prodhim e tregtim të ujit natyral e mineral”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.200, datë 11.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta“ për 5 punonjës me kohë zgjatje për I vit. Për këtë VKM, Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Vlera e financimit për këtë subject ka qenë në total 722,148 lekë .

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.48 datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektivit rezultuan të ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-amendament kontrate me nr.prot.200/1, datë 04.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.48.

- Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.276, datë 28.11.2019, i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 4 pu.pa pas përfundimit të programit.

-Situatë e detyrimeve në kohë reale printuar nga sistemi C@ts ku subjekti deri në datë 16.08.2018 ka detyrime në vlerën totale prej **511,161 lekë**.

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00469161, datë 01.08.2018, i cili gjithashtu është me gjobë në vlerën **200,000 lekë**.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Shkodër me nr.prot.4819/1, datë **21.05.2018**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Pukë, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pagesa e kështit sipas akt-marrëveshjes janë kryer korrekt brenda datës 20 të cdo muaji .

Zyra vendore e SHKP, Shkodër.

6.Subjekti/përfitues “**x**”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Shërbime telefonike”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.415, datë 12.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta“ për 37 punonjës me kohë zgjatje për 1 vit. Për këtë VKM, Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Njëkohësisht subjekti ka përfitur edhe sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar” për 1 punonjës.

Vlera e financimit e planifikuar për këtë subjekt, për të dy projektet ka qenë përkatësisht 5,532,216 lekë (VKM 48), dhe 206,094 lekë (VKM 248) **dhe vlera e realizuar 1,674,117 lekë (VKM 48) e 88,692 (VKM 248), pasi sikurse do të trajtohet në vijim projekti është ndërprerë në mars të vitit 2019.**

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.48 datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta”, VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar” si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan të ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

-amendament kontrate me nr.prot.11, datë 07.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.48.

-Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.569, datë 27.12.2019 i cili konfirmon **joefektivitetin** e këtij projekti i cili është ndërprerë në mars 2019 pasi subjekti nuk ka dorëzuar pagesat për cdo muaj të likujdimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

-Shkresë e DRT Shkodër me nr.prot.6330/1, datë 04.07.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime tatimore në vlerën **2,739,148 lekë**.

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00456577, datë 27.07.2018, i cili gjithashtu është me detyrime në vlerën 1,129,132 lekë.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Shkodër me nr.prot.3546/1, datë **18.04.2018**, sipas së cilës kësti mujor për tu paguar është **208,223 lekë** për një periudhë 20-mujore duke filluar nga maj 2018 deri në dhjetor 2019.

Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës për periudhën shtator 2018- dhjetor 2018 si dhe janar- mars 2019. Subjekti që në muajt e parë të zbatimit të projektit nuk ka qenë korrekt pasi nuk ka dorëzuar në menyrë periodike, brenda datës 20 të cdo muaji listëpagesën, urdhërpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, urdhërpagesën e kështit mujor për akt-marrëveshjen etj, sipas nenit 12, të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me Vendim të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.1, datë 15.06.2018, si dhe kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, e cila ka fuqi ligjore.

Konstatohet se në asnjë rast nuk ka një korrespondencë shkresore ndërmjet DRSHKP Shkodër apo SHKP/Drejtori e Përgjithshme me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën mars – shtator 2019 për të cilën subjekti nuk iu është përgjigjur detyrimeve kontraktuale, duke e lënë në këtë mënyrë “në mëshirë të fatit, ecurinë e këtyre dy projekteve të përfituara nga ky subjekt dhe duke bërë një raport përfundimtar mbi “*efektivitetin*” e ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit, me vonesë në dhjetor të vitit 2019.

Sipas rregullores, Zyra përkatëse e Punësimit dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit brenda dates 10 të muajit pasardhës *Tabelën e Ecurisë së Projekteve* me fond të konfirmuar nga punonjësi i financës sipas situacionit buxhetor. Nuk ka masa administrative të ndërmarra nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga subjekti **përgjatë vitit 2019, për fillimin e procedurave për dëmshpërblimin e vlerës së përfituar nga subjekti për periudhën shtator-mars 2019**. Nga administrata e SHKP-së është vepruar në kundërshtim me nenin 9 të kontratës **Zgjidhja e Kontratës**, ku citohet se:

DRP ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë me efekt të menjëhershëm në rast se punëdhënësi , gjatë kohëzgjatjes së projektit :

-zgjidh pa shkaqe të arsyeshme në kuptim të nenit 146 të Kodit të Punës dhe menjëherë , të gjitha apo secilën nga kontrata e punës lidhur ndërmjet Punëdhënësit dhe Punëmarrësve punëkërkues të rekrutuar sipas projektit.

-Në kuptim të saj DRP ka të drejtë t'i kërkojë punëdhënësit një dëmshpërblim të barabartë me vlerën e financimit të marrë nga ky i fundit që nga data e lëvrimit së bashku me kamatat ligjore sipas pikës 9.2

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtori i Zyrës së Punësimit Shkodër znj x, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit, Komisioni i Miratimit të Projekteve, si dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. x, për mosveprim në zbatim të detyrimeve kontraktuale ndaj përfituesit. Vlera e përfituar padrejtësisht nga subjekti prej **1,762,809 konsiderohet dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të fillojnë menjëherë procedurat për**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

dëmshtëpërblimin e kësaj vlere. Gjithashtu e gjithë vlere totale e përfituar nga ky subjekt prej 5,532,216 lekë sipas Kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm, konsiderohet të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, pasi janë përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficientë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 5 /Kapitulli “Masa shpërblimi dëmi” ju shpreheni se:

Nga informacioni që kemi marrë nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër: kjo zyrë me anë të shkresës Nr. 416 Prot, datë 03.10.2019 ka njoftuar subjektin për nisjen e procedurave të ndërprerjes së financimit si pasojë e moszbatimit të detyrimeve kontraktuale. Në datë 14.11.2019 Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër ka rikujtuar subjektin për kthimin e shumës së përfituar nga programet e nxitjes së punësimit. Në datë 06.12.2019 subjekti ka kërkuar kohë me argumentin se ndërtesa në të cilës zhvillonte aktivitetin kishte pësuar dëmtime të rënda në strukturë dhe infrastrukturë, dhe për këtë arsye ju kishte shprehur vullnetin se do të paraqitej në DRP Shkodër sapo të riparonte dëmtimet dhe të rifillonte punën. Në datë 20.12.2019 DRP Shkodër ka paralajmëruar për fillimin e procedurave ligjore. Pasi subjekti nuk i është përgjigjur as këtij paralajmërimi, DRP Shkodër ka vazhduar me procedurën ligjore deri në ndjekje në rrugë gjyqësore.

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x”sh.p.k, me nipt-..., nuk pranohet për argumente ligjorë të cituar qartë në project –raport.

Zyra vendore e SHKP, Malësi e Madhe.

7.Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-..., me aktivitet “Projekt dhe zbatim i veprave ndërtimore”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.126/1, datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 7 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj me një vlerë financimi **1,231,947 lekë** dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 7 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **771,400 lekë** ose 63 % e vlerës totale të financuar.

*Përsa i përket zbatimit të VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, si dhe rregullores se zbatimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, datë 25.06.2018, u konstatua se:

Në dosjen e nxitjes së subjektit rezultuan të ishin të depozituara dokumentat e mëposhtëm:

-Formulari i aplikimit.

-Formularët F1 dhe F2.

-Plani i Biznesit.

-Ekstrakti Historik i kompanisë.

-kontratat individuale të punës midis punëdhënësit sipas modelit të përcaktuar.

-amendament kontrate me nr.prot.22, datë 10.01.2019 objekt i së cilës është vazhdimi i projektit sipas VKM nr.47.

- Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.165, datë 30.12.2019, i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 4 pu.pa pas përfundimit të programit, i firmosur dhe i konfirmuar nga Drejtori i Zyrës së punës në M.Madhe z. x.

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00467000, datë 01.08.2018, i cili rezulton pa detyrime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Mungon vërtetimi tip për situatën e detyrimeve në kohë reale marrë nga sistemi tatimor i cili konfirmon gjendjen e detyrimeve në të gjitha llojet e tatimeve, dokument ky i detyrueshëm për t'u paraqitur në dosje dhe për t'u verifikuar më pas nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP për miratimin ose jo të kërkesës së subjektit për të qenë përfitues.

Gjithashtu në dosje është akt-marrëveshja e lidhur nga DRT Shkodër me nr.prot.(e korrigjuar), 4426/1, datë 14.05.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime në vlerë **1,419,192 lekë**, të cilat duhet t'i shlyejë në mënyrë periodike mujore me një kësht të përcaktuar prej 60,484 lekë deri në dhjetor të vitit 2019.

Në asnjë muaj edhe për më tepër në muajin shtator (dt 11.09.2018) që është kryer miratimi i kontratës për këtë subjekt nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP dhe Drejtori i Përgjithshëm nuk ka asnjë urdhërpagesë që të konfirmojë rregullsinë e këtij tatimpaguesi në derdhjen e detyrimeve, veprim që nuk e ka “*penguar*” SHKP të kryejë miratimin duke i dhënë fonde padrejtësisht nga Buxheti i Shtetit në vlerën **1,231,947 lekë, një subjekti debitor.**

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, neni 10, pika d), ku citohet se:

Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit, ku ai zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:

d) vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më shumë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit. Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë, se në momentin e aplikimit në këtë program: -kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre; kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat; kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.

Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.”

Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Miratimit të Projekteve në SHKP, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i ZVP Malësi e madhe, z.x, specialistët përkatës, pasi nuk kanë kryer një verifikim të hollësishëm të ecurisë së këtij subjekti duke bërë një kqyrje formale të dokumenteve pa i kushtuar rëndësi subjekteve debitorë të cilët paraqesin risk të vazhdueshëm dhe duhet të jenë objekt monitorimi për të dy institucionet (DRT dhe SHKP), pasi janë përfitues të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

Si rrjedhim vlera prej **1,231,947 lekë** nga Buxheti i Shtetit, konsiderohen të ardhura të munguara të përfituara padrejtësisht nga subjekti “**x**”sh.p.k, dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të cituar më sipër nga SHKP, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, lidhur me gjetjen nr. 7 /Kapitulli “Masa shperblimi dëmi” ju shpreheni se:

1-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Theksojmë që ne si grup auditimi i KLSH-së kemi të njëjtin qëndrim duke mos marrë parasysh fotokopje të urdhërpagesave të pakonfirmuara nga DRT përkatëse. Pavarësisht kësaj, dokumentet që ju keni nisur janë verifikuar edhe nga ky fakt. Observacioni juaj në lidhje me subjektin “x”sh.p.k, me nipt-..., nuk pranohet pasi nisur nga shkresa e DRT Shkodër me nr.prot.7332/1, datë 01.08.2018, subjekti rezultoi me detyrime në vlerën 1,128,112 lekë, dhe lind nevoja e verifikimit të pagesave pas kësaj date dhe jo urdhërpagesat që ju keni sjellë të cilat janë përgjatë gjithë vitit 2018. Konkretisht nga shtatori 2018 e në vijim janë vetëm tre pagesa të kryera në vlerë secila prej 60,500 lekë të cilat përsëri nuk justifikojnë dhe nuk përmbushin detyrimin e mësipërm. hërpagesave të pakonfirmuara nga DRT përkatëse.

1-Komente dhe shpjegime të ZV/Drejtorit të Përgjithshëm të SHKP, dërguar me shkresë me nr.prot 183/21, datë ,23.04.2020 dhe protokolluar me KLSH nr 65/3 datë 27.04.2020.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

1-Në lidhje me pikën 1, pranohet observacioni ku DP nuk nënshkruan kontratën, por për vendosjen e emrit të Titullarit të Përgjithshëm është sqaruar roli dhe përgjegjësia që ka në institucionin e trajtuar në projekt-raport.

2-Në lidhje me subjektet me akt-marrëveshje, KMP nuk duhet të kryente miratimin e projekteve pa kryer një verifikim korrekt dhe pa komunikuar shkresërisht me Drejtorite Tatimore përkatëse për shkak të riskut që kanë subjektet me detyrime.

Sqarime të hollësishme nga grupi i auditimit janë dhënë për çdo rast të trajtuar në projekt raport si dhe për pikat e tjera të observuara nga ju janë sqaruar sipas çdo dosjeje të projekteve të audituar në projekt raport.

Titulli i Gjetjes: 1	Mungesa e një analize të hollësishme nga SHKP në planifikimin e nevojave për mbështetje me programe të nxitjes së punësimit.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, është se asnjë parashikim i kryer për tregun e punës nga zyrat e punës rajonale dhe vendore nuk është i dokumentuar me shkresë përcjellëse duke krijuar një situatë jokorrekte nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme të cilët shprehen se për detajimin e buxhetit janë nisur nga analiza e të gjithë targeteve të punëkërkuesve të papunë të rregjistruar. Pra SHKP nuk ka përmirësuar dhe nuk ka ndryshuar mënyrën e të punuarit për procedurën e shpërndarjes së fondeve të Buxhetit të Shtetit, për detajimin e saktë dhe transparent të tij në përputhje me nevojat e parashikuara nga Zyrat e Punësimit sipas grupeve të veçanta që synuan të mbështesin.
Kriteri :	Rregulloren nr.1789/2 datë 25.06.2018, miratuar dhe ndryshuar nga KAT (Këshilli Administrativ Trepalësh) me vendim nr.1, dt 25.06.2018, neni 1, pika 1.2.
Ndikimi/Efekti	Mungesë transparence në shpërndarjen e fondeve në programet e nxitjes së punësimit.
Shkaku:	Mungesa e paketës ligjore e cila duhet të ishte miratuar nga Ministri përgjegjës (Ministria e Financës dhe Ekonomisë) për programet e nxitjes së punësimit veprime këto që çenojnë Misionin dhe veprimtarinë e SHKP-së,
Rëndësia	E Mesme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Titulli i Gjetjes : 2	Realizimi i aplikimeve dhe miratimi i projekteve për nxitjen e punësimit sipas VKM nr.47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar; me vonesë, në gjashtëmuajorin II të vitit 2018, duke sjellë realizim të ulët të programeve për “Nxitje Punësimi”, për periudhën në auditim.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, -Afati i aplikimeve për vitin 2018 ka qenë në intervalin e datave : 03.07.2018 deri në datë 03.08.2018 . Gjatë muajit gusht janë shqyrtuar dosjet e paraqitura nga subjektet dhe është bërë miratimi i tyre nga Komisioni i Miratimit të Projekteve të nxitjes së punësimit i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën me nr.prot 2062, datë 05.07.2018 ku është mbajtur proces-verbali nr.1 me nr.prot 2778/3, datë 29.08.2018. Ky komision ka shqyrtuar projektet për subjektet sipas sistemit të pikëzimit si dhe ka për detyrë të monitorojë zbatimin e të gjitha projekteve të nxitjes së punësimit që janë në zbatim . Ajo që konstatohet është se afati i aplikimeve është realizuar në <i>gjashtëmuajorin e dytë të vitit buxhetor</i> dhe rrjedhimisht miratimi ka dashur për afërsisht 1 muaj kohë duke sjellë që për të gjithë subjektet përfitues të miratohen dhe të lëvrohen fondet në shtator të vitit buxhetor në rastin konkret për vitin 2018. Ndërkohë sipas VKM nr. 47 , datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar : <i>Kohëzgjatja e programit të trajnimit është më shumë se 6 muaj për të gjitha profesionet, fakt ky që sjell në shtrirjen e të gjithë projekteve përtej vitit buxhetor, kur paralelisht në planifikimin e buxhetit është përcaktuar që këto projekte duhet të përfundojnë me buxhetin e vitit 2018. Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve është e vlefshme deri në 31 dhjetor , afati i të cilës korrespondon me mbylljen e vitit buxhetor</i> . Ky është veprim i përsëritur nga SHKP, pasi i njëjti problem shfaqet për një periudhe tre-vjeçare 2017-2018-2019, dhe konkretisht: -Për vitin 2018, për programin “Nxitje Punësimi” shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 258 mln lekë lekë, ose në masën 52,7 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe 92% kundrejt buxhetit të rishikuar prej 281 mln lekë, pra me një diferencë prej -22,6 milionë lekë. -Për vitin 2019, për programin “Nxitje Punësimi” shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 345,9 mln lekë, ose në masën 70 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe 86 % kundrejt buxhetit të rishikuar prej 403 mln lekë, pra me një diferencë prej -57 milionë lekë.
Kriteri :	Mungesa e informacioneve shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshme në raportet e monitorimit për 8- muajor deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar. Pika 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, Anekset e raporteve nuk janë të firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Gjithashtu mungon publikimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	raporteve të monitorimit në faqen zyrtare
Ndikimi/Efekti	Për periudhën objekt auditimi (2018-2019), konstatohet një realizim i ulët i programeve për “ <i>Nxitje Punësimi</i> ” përkatësisht me një diferencë prej -22 mln lekë për vitin 2018 dhe diferencë prej 57 mln lekë për vitin 2019, në krahasim kjo me buxhetin e rishikuar, pasi me atë të planifikuar nga SHKP diferenca e mosrealizimit është shumë e madhe.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga nëpunësi autorizues znj x si dhe <i>Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të programit</i> të cilët raportojnë përpara nëpunësit autorizues, për hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 3	Mungesa e financimeve për projektet e nxitjes së punësimit sipas VKM nr.47 dhe VKM nr.48 për vitin 2019 të cilët kanë qenë vendimet me rëndësinë më të madhe në politikat e nxitjes së punësimit të SHKP-së.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se ka një rritje e realizimit në vlerë për programet e nxitjes së punësimit për vitin 2019 në masën 345,9 mln lekë, dhe në vazhdimësi vlerat më të larta në financim janë për VKM nr.47 dhe VKM nr.48 përkatësisht 98 mln dhe 170,9 mln .Gjithashtu financimet e kryera për VKM nr.47 dhe VKM nr.48 janë të miratuara ose të mbartura nga viti 2018 pasi për vitin 2019 nuk ka asnjë projekt të nxitjes së punësimit përsa i përket këtyre dy vendimeve të cilët kanë qenë vendimet me rëndësinë më të madhe në politikat e nxitjes së punësimit të SHKP-së. Ligji i ri krijon Këshillin Konsultativ për Punësimin me tagër e funksion këshillimor në vend të Këshillit Administrativ Trepalësh që sipas legjislacionit të mëparshëm, ishte organi administrativ më i lartë me tagër vendimarrës. Ndërkaq për sa i përket rolit të Këshillave Vendore Trepalësh për vendimmarrje në procesin e programeve të nxitjes së punësimit Ligji i Ri “Për nxitjen e punësimit” nuk ka asnjë referencë ligjore. Pra për vitin 2019 nuk ka pasur Këshill Administrativ Trepalësh dhe si rrjedhim nuk është kryer dhe ushtruar asnjë nga detyrat dhe kompetencat e tij, përgjatë vitit 2019, që konsistojnë në: a)Shqyrtimin e projekteve e akteve ligjore a nenligjore qe do te propozohen ne lidhje me me veprimtarine e SHKP dhe zbatimin e legjislacionit te punesimit, punes dhe formimit profesional, si dhe rregullore te tjera per veprimtarine e SHKP; b)Miratimin e rregulloreve të organizmit dhe funksionimit dhe rregulloren financiare, c)Miratimin e bilancit, raportit vjetor, projektbuxhetit per vitin ne vazhdim , d)Vendosjen për investimet e fondeve, e)Vendosjen per kontrata dhe marrëveshje më të rëndësishme të SHKP sipas rregullores përkatëse etj.
Kriteri :	Ligjit Nr. 15/2019, datë 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Ndikimi/Efekti	Si rezultat i vakumit ligjor, SHKP ka ulur maksimalisht numrin e programeve të nxitjes së punësimit, për vitin 2019 dhe rrjedhimisht edhe për vitin 2020, duke mos përmbushur objektivat e saj që janë: <i>Të zbatohen politikat shtetërore të punësimit nëpërmjet :zgjerimit të gamës së programeve të nxitjes së punësimit, zhvillimit të sistemit të formimit profesional në nivel kombëtar, rajonal/vendor me synim kualifikimin dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës; si dhe mbështetjen e tyre me të ardhura.</i>
Shkaku:	Mungesë e akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse nga MFE për një periudhë 1-vjecare nga hyrja e ligjit në fuqi.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 4	Mungesa e kontrollit të brendshëm nga Drejtoria e Programeve e Integritit të Tregut të Punës , Drejtorit të Përgjithshëm në monitorimin dhe ecurinë e projekteve të nxitjes së punësimit.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se për periudhën në auditim është kryer vetëm një kontroll nga Drejtoria e Integritit të Tregut të Punës sipas Urdhrit të DP. Nr.09,datë 25.06.2019, në referencë të rregullores për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në datë 25.06.2018. Nga kontrolli i kryer është mbajtur akt konstatimi me nr.prot.1999/1, datë 15.10.2019 për 79 subjekte përfitues në gjithë territorin. Mangësitë e konstatuara nga grupi i punës në zyrat e punës, konsistojnë në targetimin e punëkërkuësve të papunë (pu.pa) të përzgjedhur në program, për mënyrën e financimit dhe dokumentacionin e paraqitur si dhe në plotësimin e dosjeve të programeve të nxitjes së punësimit.</p> <p>a)Ajo që ne konstatojmë si grup auditimi është se në këtë akt konstatimi shkruhet në <i>përgjithësi</i> ndërkohë që fusha e shtrirjes së kontrollit ka qenë e madhe dhe numri i subjekteve të kontrolluara 79, dhe nuk ka për asnjë rast të konstatuar fillim të procedurave për ndërprerjen e financimit të programeve edhe pse në mangësitë e cituara shprehen që mungojnë dokumentet justifikues për pagesën e kontributeve mujore, veprime në kundërshtim me nenin 12, të rregullores me nr.prot.1789/2, datë 25.06.2018,</p> <p>b)Nga ky aktkonstatimi nuk jepet asnjë element konkret për asnjë subjekt përfitues, ku të përshkruhen hollësisht hapat e ndjekur që në momentin e miratimit të projekteve dhe në monitorimin që zyrat përkatëse kanë kryer sipas rregullores të sipërcituar për çdo muaj.</p> <p>c)Nuk është trajtuar në akt-konstatim për asnjë rast problematikat që kanë subjektet me akt-marrëveshje, pra subjektet që kanë pasur detyrime pranë organit tatimor në momentin e miratimit të projektit nga Komisioni i projekteve në SHKP. Monitorimi i kryerjes së pagesave ndaj detyrimeve të prapambetura dhe atyre koherente nga</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>subjektet të cilat janë me akt-marrëveshje duhet të ishte i dokumentuar në Drejtorinë e përgjithshme për çdo muaj dhe jo të monitorohej vetëm nga zyrat e punës, pasi këta përfitues paraqesin risk të vazhdueshëm dhe nuk zbatojnë kushtet e akt-marrëveshjeve.</p> <p>d)Nuk trajtohet konkretisht se sa efektivë kanë qenë këto programe dhe konkretisht sipas VKM nr.47, detyrim i subjektit aplikues është që pas përfundimit të formimit në punë , ka për detyrë të realizojë punësimin e 50% të punëkërkesve të papunë, me kontratë të rregullt pune për një periudhë 6-mujore. Ky fakt shoqërohet vetëm me një raport përfundimtar nga zyrat e punës në të cilin shkruhet që ky detyrim është plotësuar dhe nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës që është listëpagesa e subjektit e deklaruar on-line në sistemin C@TS brenda datës 20 të çdo muaji e cila vërteton se sa nga pu.pa janë të punësuar nga subjekti përfitues.</p>
Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në datë 25.06.2018; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 si dhe nenin 24.
Ndikimi/Efekti	Mosgarantimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të njërive të sektorit publik në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe i shpërndarjes në mënyrë korrekte të fondeve të përfituara nga subjektet sipas programeve të nxitjes së punësimit.
Shkaku:	<i>Mungesa e “kontrollit të brendshëm”</i> i cili ka rëndësi maksimale pasi garanton se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njërive të sektorit publik është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të njërive publike.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 5	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit prej 134,710,345 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2018 sipas VKM-së nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar , janë miratuar 94 projekte, shuma e konfirmimit është në vlerën prej 108,364,387 lekë, nga të cilat <u>subvencion në vlerën prej 73,515,806 lekë.</u> Pra vetëm subvencion është 68 % e vlerës totale të projektit.</p> <p>-Gjatë vitit 2019 për projektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar,nuk ka asnjë miratim por janë të mbartura prej vitit 2018, 87 projekte shuma e konfirmimit është në vlerën prej 98,225,273 lekë, nga këto <u>subvencion në vlerën prej 61,194,539lekë.</u> Pra vetëm subvencion është 62 % e vlerës totale të projektit.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>Për të kuptuar qartë termin subvencion sqarojmë se sipas VKM-së nr. 47, datë 16.01.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë” i ndryshuar, është përcaktuar se përfitues të këtij programi janë punëkërkuar të papunë, të cilëve SHKP, nëpërmjet zyrave rajonale të punësimit, u financon, përveç pagesave, edhe shumën 19.000 lekë si tarifë me bazë koston për çdo muaj trajnimi deri në 6 muaj.</p> <p>Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm është konstatuar ky fenomen ku shumica e subvencionit zë peshën specifike në vlerën totale të projektit dhe është lënë rekomandimi që : <i>SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit, nuk ka rezultuar të ketë ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej 134,710,345 lekë kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan në drejtoritë/zyrat rajonale, faturat e blerjes me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Gjithashtu këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkuar të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej <i>134,710,345 lekë</i> pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.</i></p>
Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24
Ndikimi/Efekti	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit prej <i>134,710,345 lekë</i> pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP në mënyrë të vazhdueshme sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit të vlerës prej <i>134,710,345 lekë</i> pa ekonomikitet, efektivitet dhe efencë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Rëndësia	E Lartë.
Titulli i Gjetjes: 6	Mungesa e gjurmës së auditimit në raportet e kontrollit përfundimtarë të subjekteve përfitues të programeve të nxitjes së punësimit.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet mungesa e gjurmës së auditimit në dosjet e subjekteve përfitues <i>e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to</i>, konkretisht:</p> <p>1-Mosparaqitjen me hollësi të cdo elementi që kontrollohet në zbatim të rregullores dhe detyrimeve kontraktuale ,në proces-verbalin që specialistët e nxitjes së punësimit mbajnë cdo muaj në subjektet përkatës si dhe mungesa e një formati standart të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm në monitorimin dhe ecurinë e projektit. Në dosjet e audituara në disa rajone u konstatua se process verbalet ishin të ndryshëm në përmbajtje dhe rrjedhimisht mungonte transparencja e veprimeve duke krijuar vështirësi për ne si auditues të jashtëm në nxjerrjen e një konkluzioni të saktë në certifikimin e këtyre praktikave. Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e njësisë pra nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues</p> <p>2- Raporti i kontrollit Përfundimtar edhe pse është <i>standart</i> ka shumë element që i mungojnë si :</p> <p>a)Raporti është i përgjithshëm duke u shprehur vetëm me një fjali tip dhe të njëjtë për të gjithë ecurinë prej afër 11 muaj, të efikasitetit të një programi duke mos dhënë asnjë siguri për punën e kryer nga specialistët e nxitjes së punësimit si dhe efektivitetin e këtyre financimeve. Sikurse është pasqyruar për cdo rast si për subjektet që kanë mangësi në aspektin procedural të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së ashtu edhe për përfitues që nuk janë konstatuar parregullsi, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit shprehen në të njëjtën mënyrë duke cituar se:</p> <p><i>Programi është realizuar mjaft mirë dhe ka pasur një ecuri shumë të mirë.</i></p> <p>c)Raporti për cdo rast është i firmosur vetëm nga Drejtori Rajonal, shpeshherë mbahet me shkrim dore si dhe mungon emri dhe firma e konceptuesit.</p>
Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Ndikimi/Efekti	Përdorim i fondeve të buxhetit të shtetit pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë.
Shkaku:	Mungesa e <i>gjurmës së auditimit e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to</i> . Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 7	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit prej 17,368,576 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë, për subjektet Inert e Dine Group.
Situata:	<p>1)Nga auditimi konstatohet subjekti x, shpk me nipt ..., me aktivitet në fushën e ndërtimit- në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 944/3 datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 83 punonjës me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, një vlerë financimi prej 15,108,357 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 83 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 9,146,600 lekë ose 61 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 01.09.2018. deri në 20.03.2019. Nga verifikimi i dosjes gjatë periudhës së formim /trajnitimit prej 5,8 muaj u konstatua se subjekti ka kryer një largim masiv të punonjësve për periudhën korrik-gusht të vitit 2018, pasi nga numri i punonjësve 116 që kishte para fillimit të projektit normalisht numri i punonjësve në shtator duhet të varioje në: 116+83 (VKM nr.47)= 199 punonjës, por nga verifikimi i listëpagesës në shtator 2018 subjekti ka 132 punonjës të përfshirë ku nga këta 83 punonjës janë nga skema e pu.pa sipas VKM nr.47, pra subjekti ka bërë largim të punonjësve rreth 67 nga punonjësit ekzistentë.</p> <p>Ky largim <i>i pajustificueshëm</i> tregon për një tatimpagues që paraqet risk, dhe për këtë DRSHKP e Tiranës duhet menjëherë të njoftonte DRT Tiranë dhe të bashkëpunonte me sektorin e zbatimit në DRT për një monitorim të subjektit dhe të punonjësve të larguar nga ky subjekt me qëllim sigurimin dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficencë të fondeve që ky tatimpagues do të përfitonte në vijimësi nga buxheti i shtetit për këtë projekt. Kjo është <i>e papranueshme</i> dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi ky tatimpagues me largime masive të punonjësve brenda një muaji në periudhën që është duke përfituar projekte të nxitjes së punësimit, mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore si dhe nuk paraqet besueshmëri për plotësimin e objektivit kryesor që këto projekte kanë :Rritjen e numrit të fuqisë punëtore. Pra pavarësisht treguesve të tjerë në dosje ky element është</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>bazë për të vërtetuar efikasitetin e një projekti në kuadër të nxitjes së punëmarrësve. Si rrjedhim fondi prej 15,108,357 lekë është përdorur pa pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë</p> <p>2- Subjekti/përfitues “x”sh.p.k,me nipt-..., me aktivitet Rrobaqepësi-fason, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/45 datë 11.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 6 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,260,219 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me 1,235,000 lekë, pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Sikurse jemi shprehur edhe pse në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj këto ishin në funksion të aktivitetit dhe nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e mësipërme e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë. Ajo që konstatohet në vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është se subjekti ka një lëvizje të madhe të numrit të punonjësve sidomos në muajt maj –qershor të vitit 2018, dhe konkretisht në muajin maj ka pasur të siguruar 71 punonjës dhe në muajin qershor ka larguar nga skema një numër prej 61 punonjësish. Kjo është e papranueshme dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi është ky tatimpagues në cdo moment mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore dhe njëkohësisht nuk duhet të ishte përfitues i projektit të nxitjes së punëmarrësve pasi ky projekt konsiston në rritje të fuqisë punëtore dhe jo në ulje të saj.Nga ana tjetër subjekti në planin e biznesit të paraqitur shprehet se ka shumë nevojë për rritje të fuqisë punëtore, rritje të qarkullimit total të eksporteve e rrjedhimisht edhe të fitimit që do të realizojë duke dhënë “garanci”, që punonjësit që do të punësojë sipas këtij projekti do të jenë në vazhdimësi të siguruar e të punësuar. Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit subjekti nuk rezulton të ketë qenë i suksesshëm. Në verifikimin e listëpagesave të deklaruara on –line gjatë periudhës mars –shtator 2019, ky subjekt ka të punësuar përkatësisht: Mars- 22 punonjës, prill-8 punonjës, maj-8 punonjës, qershor-8 punonjës, korrik; gusht; shtator vetëm 2 punonjës. Pra subjekti nuk ka qenë efektiv dhe sikurse konstatohet nuk ka mbajtur as për periudhën 6-mujore numrin 50% të punonjësve të miratuar për t’i siguruar në listëpagesë. Ndërkohë specialistët shprehen në raportin përfundimtar që programi ka qenë efektiv ashtu sikurse shprehen për të gjithë subjektet! Pra subjekti nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe ky projekt nuk i ka shërbyer qëllimit që ka :</p> <p>Nxitjen dhe rritjen e numrit të fuqisë punëtore në subjektet përfitues. Si rrjedhim fondi prej 2,260,219 lekë është përdorur pa pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë.</p>
Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

	24
Ndikimi/Efekti	Përdorim i fondeve të buxhetit të shtetit pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 8	Përdorim i fondeve të buxhetit të Shtetit pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë, në vlerën prej 1,724,050 lekë nga subjekti “x”sh.p.k.
Situata:	<p>Subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt, me aktivitet Fasoneri e adresë Cermë –Divjakë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/95 datë 06.09.2018 ka përfitur sipas VKM nr. 47, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, për 10 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 1,724,050 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 10 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me 950,000 lekë, pra rreth 55 % e vlerës totale të financimit. Në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj të cilat ishin në funksion të aktivitetit, por nuk kishte asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e kostos së trajnimit prej 950,000 lekë, e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.</p> <p>Në dosje rezultuan këto dokumentë: a)Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me nr.prot.1691, datë 03.08.2018 në të cilin subjekti figuron me detyrime në vlerën 64,674 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në TVSH në vlerën 11,084 lekë, në Tatim Fitimi në vlerën 620,788 lekë pra në total subjekti ka detyrime në vlerën 696,546 lekë. Në vërtetim, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve nuk shprehet që për këto detyrime subjekti ka akt marrëveshje me DRT Fier, por në dosje është akt-marrëveshja e lidhur me DRT Fier me nr.prot.6493/1, datë 20.04.2018, sipas të cilës në datën 20.04.2018, subjekti ka 1,019,923 lekë detyrime.Vlera mujore e këstit sipas të cilit subjekti duhet të bëjë pagesën brenda datës 19 të cdo muaji deri më 19.12.2018 është 96,240 lekë, vlerë e cila në qoftë se nuk paguhet atëherë subjekti i zgjidhet akt marrëveshja sipas Kreut XI, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008. i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”.</p> <p>b)Dy Vërtetime të pagesës dhe deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përkatësisht me nr.prot T00499262, datë 16.08.2018 me detyrime 258,318 lekë dhe vërtetimi me nr.prot T00440792, datë 23.07.2018 me detyrime 314,218 lekë.</p> <p>Nga shkresat e dërguara bashkëlidhur observacionit rezultonin pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por jo brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe në ligjin e procedurave tatimore,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së brendshme e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017 Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme si dhe Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka përgjegjësi në monitorimin e zyrës vendore për çdo rajon, veçanërisht në rastet kur subjekti i cili përfiton nga projektet e nxitjes së punësimit, rezulton me detyrime pranë administratës tatimore, në momentin e lidhjes së kontratës. Si rrjedhim vlera prej 1,724,050 lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.</p>
Kriteri :	<p>Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika1,18, si dhe neni 24.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Përdorim i fondeve të buxhetit të Shtetit pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë, në vlerën prej 1,724,050 lekë nga subjekti “x”sh.p.k.</p>
Shkaku:	<p>Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.</p>
Rëndësia	<p>E Lartë.</p>

Titulli i Gjetjes: 9	<p>Dëm ekonomik në vlerën prej 277,795 lekë përfituar padrejtësisht nga subjekti “x”personfizik,me nipt-....</p>
Situata:	<p>Nga audtimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”person fizik, me nipt-..., me aktivitet Tavernë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 448 datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, për 1 punonjës ku DRP/ZVP financon punëdhënësin në lidhje me secilin punëmarrës me rrogë të barabartë me pagën minimale për muajin 1 deri në të 12 (paga 24,000 lekë), dhe për gjashtë muajt e dytë të punësimit do të financojë me 50% të pagës minimale në masën 12,000 lekë, në vlerën <u>277,795 lekë</u>. Në dosjen e nxitjes së subjektit përveç dokumenteve të tjerë rezultuan se ishin të depozituara :</p> <p>a)Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot.T00467176, datë 01.08.2018, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmuajin e parë të vitit 2018 është 7 punonjës. Në dosje mungon vërtetimi tip mbi shumën e detyrimeve të të gjithë llojeve të tatimeve, një nga dokumentet kryesorë që duhet të ishte paraqitur nga subjekti. Ky tatimpagues ka lidhur akt marrëveshje me DRT Gjirokastër me nr.prot.132, datë 09.01.2018, sipas të cilës ka detyrime dhe gjoba:në vlerën 185,539 lekë dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj është <u>17,276 lekë</u> deri në fund të vitit 2018. Mosekzistenca e vërtetimit për shumën totale të detyrimeve në datën</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>01.08.2018 është mungesë transparence si e tatimpaguesit por edhe e Drejtorisë Rajonale të Punës në Gjirokastrë e cila ka pranuar këtë fakt duke lënë hapsira për dyshime dhe për mosnjohje të ecurisë së pagesës që ky tatimpagues ka pasur gjatë vitit 2018.</p> <p>Në lidhje me sa më sipër DRT Gjirokastrë me shkresën me nr.prot.5059/1, datë 20.08.2018 informon se subjekti ka detyrime në sistemin tatimor në vlerë 206,419 lekë (pra akoma më shumë se në tabelën nr.6), dhe nuk përmend asnjë element ku të tregojë nëse ky tatimpagues ka respektuar aktmarrëveshjen e lidhur në datën 09.01.2018 e për rrjedhojë, vlera e detyrimeve duhet të ishte ulur pasi kanë kaluar 8 muaj nga lidhja e kësaj aktmarrëveshje. Nisur nga sa më sipër si dhe sipas Ligjit 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, Administrata tatimore ka lidhur akt-marrëveshje në kundërshtim me nenin 77, pika 7. Në rastin konkret akt marrëveshja është lidhur pikërisht për detyrim tatimor mbi tatim të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrime nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.</p> <p>Gjithashtu në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrën e Punës Gjirokastrë, në datë 12.09.2018, subjekti rezulton me detyrime dhe pa akt-marrëveshje.</p> <p><u>Pra nga sa më sipër është vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar”, ku citohet se:</u></p> <p><i>Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.</i></p> <p>Nga sa më sipër Komisioni i Miratimit të projekteve nuk duhet të kishte miratuar lidhjen e kontratës me këtë subject pasi subjekti rezulton me detyrime dhe nuk ekziston asnjë document, urdhërpagese apo konfirmim periodik mujor që të vërtetojë që subjekti ka respektuar kushtet e kontratës duke vepruar në kundërshtim me <u>VKM nr.248</u> datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar. Për këtë mbajnë përgjegjësi Drejtori i Zyrës së Punës Gjirokastrë, z.x, Komisioni i Miratimit të Projekteve dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. x, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 277,795 lekë .</p>
Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24. <u>VKM nr.248</u> datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar”.
Ndikimi/Efekti	Dëm ekonomik në vlerën prej 277,795 lekë përfituar padrejtësisht nga subjekti “x”personfizik,me nipt-....
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Titulli i Gjetjes: 10	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 6,820,896 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë, për subjektin “x”sh.p.k me nipt-
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se Subjekti/përfitues “x”sh.p.k,me nipt-....., me aktivitet “Përpunim i ullirit, import-export, dhe adresë kryesore të zhvillimit të aktivitetit në Jorgucat-Gjirokastrë, si dhe nipt sekondar Delvinë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 453, datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë nga grupet e veçanta“ për 44 punonjës me kohë zgjatje për <i>I vit</i>. Përvec dokumenteve të tjerë në dosje është vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me nr.prot.345, datë 17.08.2018 sipas të cilit subjekti ka detyrime në vlerën 502,557 lekë në Tatim Fitimi dhe ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Gjirokastrë me nr.prot. 4674, datë 23.07.2018. Sipas akt marrëveshjes subjekti ka kryer pagesën prej 101,500 lekë në datë 23.07.2018 dhe për pjesën e mbetur prej 406,971 lekë, pagesa do të kryhet në dy këste përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none">iii) Kësti I –vlera 203,500 lekë, datë 23.09.2018iv) Kësti II-vlera 203,741 lekë, datë 23.12.2018. <p>-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot.T00467292, datë 01.08.2018, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është 160 punonjës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Gjirokastrë, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji. Nuk ka në dosjen e përfituesit asnjë dokument apo urdhërpagesë ku subjekti të konfirmojë që ka qenë konform ligjit në kryerjen e pagesave të detyrimeve që ka sipas akt-marrëveshjes (të cituara më sipër).</p> <p>Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Gjirokastrë/sectorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit, sektorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe Komisionin e miratimit të Projekteve për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrat e Punës.</p> <p>Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme duhet të kryejnë një monitorim periodik të hollësishëm si dhe të kontaktojnë shkresërisht me Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse për të ndjekur ecurinë e pagesave për detyrimet e prapambetura, veprime këto të pakryera në asnjë rast për subjektet me detyrime dhe përfitues të projekteve të nxitjes së punësimit. Si rrjedhim vlera prej 6,820,896 lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Kriteri :	Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24. VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë nga grupet e veçanta“
Ndikimi/Efekti	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 6,820,896 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë, për subjektin “x”sh.p.k me nipt-....
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 11	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 3,736,960 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë, për subjektin “x”sh.p.k me nipt-
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”sh.p.k,me nipt-..., me aktivitet “Ndërtim”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 421, datë 03.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 20 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj; me një vlerë financimi 3,736,960 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 20 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 2,204,000 lekë ose 59 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 03.09.2018 deri në 24.02.2019. -vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale me nr.prot.398, datë 25.07.2018 marrë nga DRT Kukës, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën 659,283 lekë në tatim fitimi dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.</p> <p>-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. 399, datë 25.07.2018.</p> <p>Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Kukës me nr.prot.1333, datë 05.04.2018.Sipas akt marrëveshjes subjekti ka një shumë detyrimesh të mbetur për të paguar në vlerën 607,513 lekë për një periudhë 20 mujore pra më shumë se 1 vit , sipas planit të pagesës me këste mujorë në vlerën 30,375 lekë .</p> <p>Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 30,375 lekë, sipas akt-marrëveshjes.</p> <p>Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit <i>e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to</i> si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip FëMungojnë urdhërpagesat me vulën e bankës të cilët konfirmojnë derdhjen e detyrimeve mujore në sistemin tatimor. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Mungon Raporti i kontrollit përfundimtar i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku në rastin konkret subjekti duhet të ketë të punësuar një numër prej 10 persona.</p> <p>Këto veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin “, si dhe manualin për MFK-në, ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Has /sektorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit , Drejtorin rajonal të DRSHPK Kukës , z.x, sektorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme , Komisionin e miratimit të Projekteve si dhe Drejtorin e Përgjithshëm për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyratë Punës. Si rrjedhim vlera prej 3,736,960 lekë lekë nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k me nipt-, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.</p>
Kriteri :	Nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24. VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.
Ndikimi/Efekti	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 3,736,960 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, për subjektin “x”sh.p.k me nipt-
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 12	Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 589,500 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, për subjektin “x ”sh.p.k,me nipt-....
Situata:	Nga audtimi u konstatua se subjekti/përfitues “ x ”sh.p.k,me nipt-..., me aktivitet “Fast-Food, Piceri e bar-kafe”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 71, datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 2 punonjës me kohë zgjatje për <u>5 muaj</u> me një vlerë financimi 312,732 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 2 persona x 5 muaj) e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

barasvlefshme me **190,000 lekë** ose 61 % e vlerës totale të financuar. Gjithashtu subjekti ka përfituar edhe një projekt të dytë sipas VKM nr.248, datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 70, datë 30.08.2018, për 1 punonjës me vlerë financimi **276,768 lekë**. Në dosje është vërtetimi i detyrimeve në kohë reale me nr.prot.362, datë **31.07.2018** marrë nga DRT Dibër, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën **154,309 lekë** të pacilësuar së në cfarë lloj tatimi duke vepruar në kundërshtim më vërtetimet tip të aprovuara nga DPT . -vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00476838, datë 06.08.2018, i cili gjithashtu është me detyrime , gjoba dhe kamatëvonesa në vlerën 102,777 lekë. Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Dibër me nr.prot.2940, datë **31.07.2018**, sipas të cilës detyrime dhe gjoba në total në vlerën **207,985 lekë** dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj sipas akt-marrëveshjes është **20,000 lekë** deri në fund të vitit 2018 i përlogaritur nga Drejtoria e Mbledhjes në DRT Dibër.

Nisur nga sa më sipër si dhe sipas Ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”, Administrata tatimore/DRT Dibër ka lidhur akt-marrëveshje në kundërshtim me nenin 77, pika 7. Në rastin konkret subjekti ka detyrime dhe gjoba në vlerën 139,073 lekë në sigurime shoqërore e shëndetësore dhe kjo përbën 67 % të borxhit në total, pra zë peshën kryesore në këtë vlerë dhe akt marrëveshja është lidhur pikërisht për këtë detyrim tatimor **të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi**.

Gjithashtu respektimi i akt-marrëveshjes nëpërmjet kryerjes së pagesave nga subjekti sipas grafikut të përcaktuar nga DRT është dokumenti bazë i cili duhet të ndihmojë dhe të jetë objekt-monitorimi i SHKP-së, për të ndjekur ecurinë e pagesave dhe respektimin e afatit në derdhjen e tyre të këtij tatimpaguesi i cili është përfitues i dy projekteve me një vlerë financimi nga buxheti i shtetit, në total prej 589,500 lekë. Por SHKP ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.47 Si dhe në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullore së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej **20,000 lekë** , sipas akt-marrëveshjes.

Në dosje gjenden listëpagesat , procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit e **cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to** si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip Fë

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtori i Zyrës së Punësimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>Bulqizë z. x, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit, Komisioni i miratimit të Projekteve, Drejtori i Përgjithshëm i cili nuk duhet të kishte miratuar dhënien e këtyre projekteve subjektit i cili ka detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ku për asnjë rast nuk ka të konfirmuar pagesa mujore kusht ky i detyrueshëm për t’u ndjekur nga kjo administratë dhe për të qenë pjesë e dosjes si gjurmë auditimi. Si përfundim fondi prej 589,500 lekë i buxhetit të shtetit është përdorur pa efektivitet, ekonomikitet e eficencë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.</p>
Kriteri :	<p>Nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24. VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 589,500 lekë pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë, për subjektin “x ”sh.p.k,me nipt-.....</p>
Shkaku:	<p>Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.</p>
Rëndësia	<p>E Lartë.</p>

Titulli i Gjetjes: 13	<p>Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 1,762,809 lekë përfituar padrejtësisht nga subjekti “x ”sh.p.k, me nipt.....</p>
Situata:	<p>Nga audtimi u konstatua se subjekti/përfitues “x, me nipt...., me aktivitet “Shërbime telefonike”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.415, datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta“ për 37 punonjës me kohë zgjatje për <u>I vit</u>. Njëkohësisht subjekti ka përfituar edhe sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar” për <u>I punonjës</u>.</p> <p>Vlera e financimit e planifikuar për këtë subjekt, për të dy projektet ka qenë përkatësisht 5,532,216 lekë (VKM 48), dhe 206,094 lekë (VKM 248) dhe vlera e realizuar 1,674,117 lekë (VKM 48) e 88,692 (VKM 248), pasi sikurse do të trajtohet në vijim projekti është ndërprerë në mars të vitit 2019. Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.569, datë 27.12.2019 i cili konfirmon <u>ioefektivitetin</u> e këtij projekti i cili është ndërprerë në mars 2019 pasi subjekti nuk ka dorëzuar pagesat për cdo muaj të likujdimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.</p> <p>-Shkresë e DRT Shkodër me nr.prot.6330/1, datë 04.07.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime tatimore në vlerën 2,739,148 lekë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	<p>-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00456577, datë 27.07.2018, i cili gjithashtu është me detyrime në vlerën 1,129,132 lekë.</p> <p>Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Shkodër me nr.prot.3546/1, datë 18.04.2018, sipas së cilës kësti mujor për tu paguar është 208,223 lekë për një periudhë 20-mujore duke filluar nga maj 2018 deri në dhjetor 2019.</p> <p>Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës për periudhën shtator 2018- dhjetor 2018 si dhe janar- mars 2019. Subjekti që në muajt e parë të zbatimit të projektit nuk ka qenë korrekt pasi nuk ka dorëzuar në menyrë periodike, brenda datës 20 të cdo muaji listëpagesën, urdhërpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, urdhërpagesën e këstit mujor për akt-marrëveshjen etj, sipas nenit 12, të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me Vendim të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.1, datë 15.06.2018, si dhe kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, e cila ka fuqi ligjore.</p> <p>Konstatohet se në asnjë rast nuk ka një korrespondencë shkresore ndërmjet DRSHKP Shkodër apo SHKP/Drejtori e Përgjithshme me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën mars – shtator 2019 për të cilën subjekti nuk iu është përgjigjur detyrimeve kontraktuale, duke e lënë në këtë mënyrë “në mëshirë të fatit”, ecurinë e këtyre dy projekteve të përfituara nga ky subjekt dhe duke bërë një raport përfundimtar mbi “<i>efektivitetin</i>” e ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit, me vonesë në dhjetor të vitit 2019.</p> <p>Sipas rregullores, Zyra përkatëse e Punësimit dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit brenda dates 10 të muajit pasardhës <i>Tabelën e Ecurisë së Projekteve</i> me fond të konfirmuar nga punonjësi i financës sipas situacionit buxhetor.Nuk ka masa administrative të ndërmarra nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit në lidhje me mospërmblidhjen e detyrimeve kontraktuale nga subjekti përgjatë vitit 2019, për fillimin e procedurave për dëmshpërblimin e vlerës 1,762,809 lekë të përfituar nga subjekti për periudhën shtator-mars 2019. Nga administrata e SHKP-së është vepruar në kundërshtim me nenin 9 të kontratës Zgjidhja e Kontratës” Vlera e përfituar padrejtësisht nga subjekti prej 1,762,809 konsiderohet dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të kishin filluar menjëherë procedurat për dëmshpërblimin e kësaj vlere. Gjithashtu e gjithë vlera totale e përfituar nga ky subjekt prej 5,532,216 lekë sipas Kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm, konsiderohet të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, pasi janë përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficencë.</p>
Kriteri :	Nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; neni 9, i Kontratës Tip me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	nr.prot.415, datë 12.09.2018 lidhur me SHKP dhe miratuar nga KMP. VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta“ Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24.
Ndikimi/Efekti	Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 1,762,809 lekë përfituar padrejtësisht nga subjekti “x ”sh.p.k, me nipt-....
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.

Titulli i Gjetjes: 14	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën 1,231,947 lekë e të përfituara padrejtësisht nga subjekti “x”sh.p.k, dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të SHKP-së, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt..., me aktivitet “Projekt dhe zbatim i veprave ndërtimore”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.126/1, datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 7 punonjës me kohë zgjatje për <u>5,8 muaj</u> me një vlerë financimi 1,231,947 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 7 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 771,400 lekë ose 63 % e vlerës totale të financuar. Mungon vërtetimi tip për situatën e detyrimeve në kohë reale marrë nga sistemi tatimor i cili konfirmon gjendjen e detyrimeve në të gjitha llojet e tatimeve, dokument ky i detyrueshëm për t’u paraqitur në dosje dhe për t’u verifikuar më pas nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP për miratimin ose jo të kërkesës së subjektit për të qenë përfitues.</p> <p>Gjithashtu në dosjë është akt-marrëveshja e lidhur nga DRT Shkodër me nr.prot.(e korrigjuar), 4426/1, datë 14.05.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime në vlerë 1,419,192 lekë, të cilat duhet t’i shlyejë në mënyrë periodike mujore me një kësht të përcaktuar prej 60,484 lekë deri në dhjetor të vitit 2019.</p> <p>Në asnjë muaj edhe për më tepër në muajin shtator (dt 11.09.2018) që është kryer miratimi i kontratës për këtë subjekt nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP dhe Drejtori i Përgjithshëm nuk ka asnjë urdhërpagesë që të konfirmojë rregullsinë e këtij tatimpaguesi në derdhjen e detyrimeve, veprim që nuk e ka “<i>penguar</i>” SHKP të kryejë miratimin duke i dhënë fonde padrejtësisht nga Buxheti i Shtetit në vlerën 1,231,947 lekë, një subjekti debitor. Si rrjedhim vlera prej 1,231,947 lekë nga Buxhetit i Shtetit, konsiderohen të ardhura të munguara të përfituara padrejtësisht nga subjekti “x”sh.p.k, dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të cituar më sipër nga SHKP, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe efincencë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Kriteri :	Nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017.Rregullorja për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në date,25.06.2018; VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” Ligji nr.10296,datë 8.7.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18 , si dhe neni 24.
Ndikimi/Efekti	Të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën 1,231,947 lekë e të përfituara padrejtësisht nga subjekti “ x ”sh.p.k, dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të SHKP-së, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit jo vetëm nga drejtoritë/rajonale por edhe nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme.
Rëndësia	E Lartë.

6. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM.

Referuar pikës nr.6 mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga grupi I auditimit të KLSH-së, me , nr. Prot.679/1, datë 08.06.2018 , është realizuar akt-verifikimi nga KLSH me nr.prot 450, datë 26.06.2019 ku ka rezultuar si më poshtë:

a)Masa për Përmirësimin Ligjor: lënë **1** e cila, është pranuar dhe zbatuar;

b)Masa Organizative: janë lënë **12** rekomandime nga të cilat 11 janë pranuar, 7 janë zbatuar, 4 janë në proces, 1 e papranuar dhe e pazbatuar;

c)Masa për Mosmenaxhim me ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë lënë **2** , nga këto 1 pranuar dhe zbatuar, 1 e papranuar dhe e pazbatuar.

Grupi i auditimit i kërkoi drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të cilat ishin në proces.

Në vijimësi nga SHKP nuk u kthye asnjë përgjigje si elektronikisht apo në rrugë shkresore për informacionin e kërkuar disa herë nga grupi i auditimit të KLSH-së.

7. VLERËSIMI I AKTIVITETIT TË NJËSISË SË AUDITIT TË BRENDSHËM

Në zbatim të pikës nr. 7, të Programit të Auditimit “Auditim Përputhshmërie në Shërbimin Kombëtar të Punësimit” (SHKP këtu e në vazhdim), me nr. Prot 65/2, i ndryshuar, datë 18.03.2020 u shqyrtuan pranë kësaj Drejtorie dokumentacionet përkatëse:

- ✓ Plani Auditimit dhe realizimit për periudhën 2018-2019.
- ✓ Raporti vjetor 2018-2019 dhe pasqyrat e miratuara.
- ✓ Dosja e auditimit e kryer në DRP Tiranë për vitin 2018.

ku nga shqyrtimi i të cilave konstatohet sa më poshtë:

Statusi ligjor në të cilën bazohet veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm është në përputhje me:

-Standartet Ndërkombëtare për praktikat profesionale të Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik te pranuar per zbatim ne RSH.

-Kartën e auditimit te brendshëm te miratuar nga titullari i njesise.

-Ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

-Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdherin nr.100 date 25.10.2016 te Ministrit te Financave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

- Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të AB në SHKP.
- Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2018-2020 dhe 2019-2021
- Planin vjetor të auditimit për vitin 2018 dhe atë të ndryshuar.
- Planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dhe atë të ndryshuar.
- Kodin e Etikës së audituesve të brendshëm.

Organika e miratuar për SAB në SHKP, paraqitet si vijon:

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish (fakt) 01.04.2018.	Nr. Punonjësish (fakt) 31.12.2019
1	Specialist Auditit	3	3	3
Total		3	3	3

Me Urdhërin e Kryeministrit nr.111 datë 31.07.2018, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së SHKP" për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 91 datë 28.10.2011, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit" skema 1, sektori i auditimit në SHKP varet nga Drejtori i Përgjithshëm, ndërsa sipas skemës 2, sektori i auditimit përbëhet nga tre specialistë por pa drejtues njësie apo përgjegjës sektori.

Struktura në fakt e personelit specialist është:

- Ekonomistë 3 auditues ose 100% e stafit. Përvoja e tyre si auditues varion nga 6-10 vjet.
- Të tre specialistët janë të certifikuar si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik

Për vitin 2019 u konstatua se nga 3 punonjës që kanë në strukturë vetëm 2 punonjës kanë qënë të angazhuar në punë gjatë gjithë periudhës, pasi një nga punonjësit ka qënë i shkëputur nga puna për një periudhë 4 mujore. Konstatohen dobësi dhe parregullsi si në kompozimin, ashtu dhe në organizimin e Strukturës së Auditimit të Brendshëm në SHKP. Struktura është aktualisht në nivel sektori dhe sipas organigramës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.111 datë 31.07.2018,, është me tre punonjës dhe pa drejtues. në kundërshtim me pikën nr.22, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimën e organizimit të brendshëm", ku përcaktohet se: " *Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjës, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës* "

Gjthashtu mungesa e pozicionit të përgjegjës të sektorit pengon procesin e menaxhimit të sektorit, miratimit të planeve dhe programeve të angazhimit si dhe pengon kontrollin e cilësisë, veprime në kundërshtim me Standardet Profesionale të Auditimit të Brendshëm Publik si dhe në shkëlqje të pikës nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se, " *Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.*

Mungesa e drejtuesit të njësisë përveç kohës së pamjaftueshme në dispozicion për hartimin e shkresave raporteve analizave, si dhe për fluksin e shkëmbimit periodik të informacionit me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

menaxherët dhe menaxhimin e larte, ngarkon specialistët e sektorit me detyrat funksionale të tij, duke sjellë rrjedhimisht mangësi në kryerjen e proceseve dhe uljen e efektivitetit në auditimet e kryera, të detajuara në vijim:

- organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.
- percaktimin e nevojave audituese për kohën, burime dhe personel.
- angazhimet e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar.
- komunikimin periodik me titullarin e njësise.
- hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm (pasqyrat shoqëruese) dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike.
- përgatitjen e raportit të konsoliduar vjetor dhe (pasqyrave shoqëruese), i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.
- shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse.
- vlerësimin e sistemeve të kontrollit brendshëm brenda njësisë publike dhe rekomandimet për përmirësim.
- rishikimin e cilësisë së punës së auditimit nga drejtuesi i njësisë.
- veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.
- hartimin e Kartës së Auditimit, kodit të etikës, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, si dhe dërgimin e tyre për administrim në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pas miratimit nga titullari i njësisë publike.
- marrëdhëniet me Komitetin e Auditimit në organin epror etj.

Nga auditimi konstatohet cungimi i strukturës së njësisë së auditimit që ka sjellë mungesë të linjës së raportimit të auditimit të brendshëm, veprim në kundërshtim me Standardin 1110 - Pavarësia Organizative Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të raportojë tek një nivel brenda organizatës i tillë që t'i japë mundësi aktivitetit të auditimit të brendshëm të përmbushë përgjegjësitë e tij. Mungesa e strukturës së SAB sipas standardeve ka sjellë mungesën e kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të operacioneve. prandaj nga vlerësimi i punës së kësaj strukture gjatë periudhës objekt auditimi rezulton **me një performancë ulët.**

Planifikimi dhe Raportimi i Veprimtarisë së Njësisë.

Viti 2018

Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2018 është përgatitur “Plani vjetor 2018 dhe Strategjik për zhvillimin e auditit për vitet 2018-2020”.

Plani vjetor dhe strategjik është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe me **shkresë nr. 2902 prot, datë 20.10.2017**, është dërguar në Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, pra 5 ditë me vonë në kundërshtim me Kapitullin II, pika 2.3, ku citohet se:

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njesite e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dergohen jo me vone se data 15 tetor e çdo viti prane NjQH/AB. brenda afatit ligjor.

Plani Strategjik për periudhën 2018 – 2020, përbëhet nga :

Pasqyra Nr .1- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2018-2020.

Pasqyra Nr.2 - Plani I Angazhimeve të SAB për vitin 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Pasqyra Nr.3- Planifikimi vjetor I nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2018.

Pasqyra Nr.4 – Planifikimi vjetor I buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2018.

Pasqyra Nr.5 – Vlerësimi I nivelit të riskut për subjektet për vitin 2018

Në planin e parë vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar të pasqyruara në “Formatin nr. 2” të planit. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar gjithsej 17 auditime nga të cilat,:

- 4 auditime të plota, në Drejtoritë Rajonale Dibër, Gjirokastrë, Berat, dhe DRQFPP – Elbasan, në tremujorin I.
- 4 auditime të plota në Drejtoritë Rajonale Elbasan, Korçë, Lezhë dhe DRQFPP Gjirokastrë në tremujorin II.
- 4 auditime të plota në zyrat vendore Përmet, Mirditë, Bulqizë dhe Tropojë, në tremujorin III.
- 5 auditime financiare në Drejtoritë Rajonale Kukës, Shkodër, Tepelenë dhe zyra vendore Gramsh dhe Skrapar, në tremujorin IV.

Pra janë parashikuar për auditim rreth 47 % e të gjithë objekteve që SHKP ka në rang vendi.

Në objektivat vjetorë janë vlerësuar 10 njësi me risk të lartë (DRP-të), 3 njësi me risk të mesëm, (ZVP Tepelenë dhe QFPP-GJR dhe Elbasan) dhe 4 njësi me risk të ulët. Si dhe vihet re SHKP ka parashikuar një nivel të ulët realizimit të auditimeve të plota dhe atje ku janë parashikuar, rezultojnë ende të papërfunduar ose në proces .

Në zbatim të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015, ”Për auditimin e Brendshëm në sektorin Publik”, si dhe manualin e auditit të brendshëm , kapitulli III, pika 3.5, është bërë rishikimi i planit vjetor për vitin 2018 miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm **me nr.prot 3698, datë 17.10.2018** por shkresa nuk përmban elementët bazë të saj :Kujt i drejtohet dhe lëndën pra përmbajtjen .

Në planin e rishikuar kemi një ndryshim pothuajse total të planit vjetor fillestar, veprim *ky i papranueshëm* i Titullarit, i kryer afër mbarimit të vitit, duke sjellë një ineficencë totale të këtij sektori dhe duke ndryshuar rreth 70% të përmbajtjes. Lind pyetja:

1-Kur do të kryhen këto auditime për vitin 2018 ?!, pasi ndryshimi është kryer në mesin e muajit tetor ?!

2-Çfarë ka bërë SAB në 9-mujorin e parë të vitit në lidhje me planin që ka pasur të miratuar nga DHQ në MFE?!

Për të ilustruar sa më lart plani **i rishikuar dhe i miratuar** nga Titullari, zj.Elira Demiraj, ka në total 12 auditime nga 17 të planifikuara, pra 5 më pak , por ajo që është shqetësuese është ndryshimi total në objektet që duhet të auditohen dhe konkretisht:

Tabela 1.

Nr	Tremujori I /Plani I i miratuar	Tremujori I /Plani i rishikuar	Tremujori II /Plani I i miratuar	Tremujori II /Plani i rishikuar	Tremujori III /Plani I i miratuar	Tremujori III /Plani i rishikuar	Tremujori IV/Plani I i miratuar	Tremujori IV /Plani i rishikuar
1	DRP Dibër	DRFPP Tiranë	DRP Elbasan	DRFPP Gjirokastrë	Z/vendore Permet	Z/vendore Has	DRP Kukës	DRP Diber
2	DRP Gjirokastrë	Z/vendore PG	DRP Korçe	DRFPP Q L TR	Z/vendore Mirdite		DRP Shkoder	Z/vendore Bulqizë
3	DRP Berat		DRP Lezhë	DRFPP Vlore	Z/vendore Bulqize		DRP Tepelenë	Z/vendore Librazhd
4	DRFPP Elbasan			Z/vendore LU	Z/vendore Tropoje		Z/vendore Gramsh	
5				DRP Tirane			Z/vendore Skrapar	
6				DRFPP Tirane				



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Pra sipas planit fillestar, sektori i auditit deri me 17.10.2018, që është tremujori i fundit i vitit duhet të kishte mbaruar auditimet për tre tremujorët e parë të vitit, ndërkohë që plani I rishikuar sikurse konstatohet qartë në tabelë nuk përputhet dhe ka një ndryshim total duke përfshirë këtu dhe tremujorët e parë.

Këto veprime dhe mospveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 9, ku citohet se:

9. "Përgjegjshmëria menaxheriale" është **detyrimi i menaxherëve të njësisë**, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera.

Për këtë mban përgjegjësi Titullari i institucionit/ Znj x.

Viti 2019

Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2019 është përgatitur “Plani vjetor 2019 dhe Strategjik për zhvillimin e auditit për vitet 2019-2021”.

Plani vjetor dhe strategjik është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe me shkresë nr.3699 prot, datë 17.10.2018, është dërguar në Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, pra 2 ditë me vonesë në kundërshtim me Kapitullin II, pika 2.3, ku citohet se:

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njesite e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dergohen jo me vone se data 15 tetor e çdo viti prane NjQH/AB. brenda afatit ligjor.

Në planin e parë vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar të pasqyruara në “Formatin nr. 2” të planit. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar gjithsej 16 auditime nga të cilat,:

- 4 auditime të plota, në Drejtorinë Rajonale Kolonjë, zyrat vendore Gramsh, Tropojë dhe DRFPP Tiranë në tremujorin I.
- 2 auditime të plota në Drejtorinë Rajonale Korçë dhe zyrën vendore Pogradec në tremujorin II.
- 1 auditime të plota DRFPP Gjirokastër në tremujorin III.
- 1 auditime të plota në zyrën vendore Mirditë në tremujorin IV.
- 8 auditime të tjera 1 në tremujorin II, 3 në tremujorin III dhe 3 në tremujorin IV si dhe një zbatim rekomandimesh DRFPP në tremujorin II.

Pra janë parashikuar për auditim rreth 36 % e të gjithë objekteve që SHKP ka në rang vendi.

Në objektivat vjetorë janë vlerësuar 6 njësi me risk të lartë, 6 njësi me risk të mesëm dhe 4 njësi me risk të ulët..

Në zbatim të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015, ”Për auditimin e Brendshëm në sektorin Publik”, si dhe manualin e auditit të brendshëm , kapitulli III, pika 3.5, është bërë rishikimi i planit vjetor për vitin 2019 miratuar nga Drejtori I Përgjithshëm me nr.prot 620, datë 26.02.2019.

Nga njësia është bërë përsëri rishikimi i planit të auditimit me nr.prot 2939, datë 3.09.2019, ku nga 19 subjekte duke përfshirë dhe zbatimin e rekomandimeve janë reduktuar numri i subjekteve për tu audituar në 9 subjekte, nga të cilat 5 Zbatim rekomandimesh dhe 5 auditime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

të plota në subjekte, të cilat janë *vlerësuar me risk të mesëm dhe duke shmangur auditimin e subjekteve të vlerësuara me risk të lartë.*

Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm janë arsyetuar me shkrim me argumentin se është prioritet zbatimi i rekomandimeve të subjekteve të audituara në 2018 si dhe përfshirja e disa subjekteve të cilat kanë një periudhë kohe 3 dhe 5 vjet pa u audituar, duke marrë parasysh dhe stafi i cunguar i audituesve në dispozicion për të realizuar këto auditime.

Nga realizimi planit të auditimit rezulton se kanë përfunduar 4 auditime zbatim rekomandimesh (një në tremujorin e I, një në tremujorin e II dhe dy në tremujorin e III), dhe dy auditime të plota në tremujorin e fundit, të cilat janë deri në fazën e projekt raportit. Nga auditimi u konstatua se janë nisur në tremujorin e fundit dhe dy auditime të kombinuara për DRP Shkodër dhe ZVP Lushnje jashtë planit të auditimit për të cilat nuk është dhënë asnjë sqarim shpjegues *se nga kush është bërë inicimi i këtyre auditimeve.*

Nga plani fillestar deri në angazhimin për auditim kemi një ndryshim total duke sjellë një ineffiçencë të këtij sektori dhe mos përmbusjen e Planit të angazhimeve si dhe të Planifikimit të buxhetit dhe shpërndarjes së burimeve të NjAB.

Nga grupi i auditimit për të dy vitet objekt auditimi 2018- 2019 u konstatua se as në Planet Strategjike dhe as në Planet Vjetore nuk planifikohet dhe rrjedhimisht nuk auditohet nga auditi i brendshëm, njësia qendrore ose Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së, megjithëse në nivelin e vlerësimit të riskut kjo njësi parashikohet me risk të lartë.

Moskryerja e auditimit të brendshëm të njësisë qendrore e cila është boshti kryesor për mbarëvajtjen dhe përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të njësisë të tjera në varësi është në kundërshtim me Nenin 6 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 114/2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, ku citohet se:

Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë: a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar Neni 12, pika a), c),ç, Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë publike, citohet se.....:

- a) Titullarët e njësisë publike janë përgjegjës për: a) sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;
- c) miratimin me urdhër të Kartës së Auditimit;
- ç) miratimin e planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm;

Sipas të dhënave të analizuarra për të dy vitet objekt auditimi vihen re shmangie të angazhimeve të auditimit nga planifikimi. Analiza e veprimtarisë tregon se shmangiet më të mëdha lidhen me llojet e auditimeve të kryera. Në lidhje me këtë, nga analiza e të dhënave rezulton se kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas); Në subjekte në të cilat risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve, duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Ndërhyrja e titullarëve në zbatimin e planeve të auditimit, duke kërkuar auditime të rëndësishme së veçantë jashtë planeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB. Një fenomen i tillë vlerësohet të ketë sjellë vonesa në kryerjen dhe përfundimin e misionëve të auditimit brenda afateve të caktuar

Faktorët e trajtuar më sipër, që kanë ndikuar në ndryshimin e planit të auditimit, të merren në konsideratë dhe të trajtohen nga NJAB-të me synimin e minimizimit të impaktit negativ që ato kanë në ushtrimin normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë audituese.

Rishikimi dhe vlerësimi brendshëm i cilësisë për materialet e auditimit duhet të realizohet nga audituesit me përvojë ose nga drejtuesi i NJAB, konform kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Manualin e auditimit të brendshëm, gjë e cila nuk është realizuar nga institucioni pasi nuk ka një drejtues ose përgjegjës të njësisë audituese.

- **Dosja e auditimit e kryer në DRP Tiranë për vitin 2018**

Grupi i auditimit të KLSH-së përzgjedhi si dosje për tu audituar Raportin e Auditimit të Drejtorisë Rajonale e Punësimit Tirane për të analizuar cdo pikë të trajtuar në këtë material duke përfshirë dhe ankesën drejtuar KLSH-së me nr. 131, datë 28.1.2020 nga punonjësja zj. x me detyrë specialiste në Sektorin e Ofertave dhe Shërbimeve për Punëdhënësit, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë ku shprehet se në Raportin Final të Auditimit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë **nr.1169/5 prot datë 09.07.2018** nga grupi i auditimit SHKP (protokolluar në DRSHKP me nr.732/3, datë 09.07.2018), është konstatuar se emërimi i saj në detyrë me datë 30.08.2016 në postin e Përgjegjës së Sektorit të Nxitjes së Punësimit, Programeve për të rinjtë dhe Formimit në punë është bere në kundërshtim me VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nepunësve civile/nëpunësve”, pikën 12, “Kategoritë e pagave të nepunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni”. Grupi i auditimit të SHKP-së ka lënë si rekomandim që pasi te analizohet nga menaxhimi i larte i DRP, SHKP-se dhe sektori juridik te percaktohet konkretisht pergjegjësia per demin ekonomik të shkaktuar buxhetit te shtetit, **si dhe** te nise menjehere puna per kthimin mbrapsht dhe arketimin e tyre ne buxhetin e shtetit.

Zj x shprehet se i është ngarkuar asaj si përgjegjësi për kthimin e dëmit të konstatuar dhe me datën 02.10.2019 i është komunikuar akt-marrëveshja për shlyerjen e detyrimit dhe arkëtimin e shumës së përfituar nga mospërmbushja e pozicionit me arsim, të cilën e ka kundërshtuar.

Nga verifikimi dosjes së auditimit nga grupi i KLSH është konstatuar se punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë janë të punësuar në bazë të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi I Punës së republikës së Shqipërisë” dhe nuk janë të punësuar në bazë të ligjit të nepunësit civil dhe VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nepunësve civile/nëpunësve”, pikën 12, “Kategoritë e pagave të nepunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, **ku auditimi i brendshëm nuk është shprehur në asnjë paragraf të raportit final për këtë fakt.**

Në bazë të nenit 110, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi I Punës së republikës së Shqipërisë” citohet se”Punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale", **neni 94** (Paga) pika 1 thuhet se "... KM përcakton kriteret e përlllogaritjes së kësaj pike.”

Përgjegjësia që DRSHKP Tiranë i ka ngarkuar zj.x për të shlyerjen e detyrimit, e lënë si rekomandim nga grupi i auditimit të brendshëm është në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe **të ligjit** nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar **neni 27** “Përgjegjësia e Punëmarrësit, pika 1 ku citohet se...”Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për demin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale”. Në këtë rast nuk kemi shkelje të kushteve të kontratës.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime” dhe Manualit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Menaxhimit Financiar me urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016, në kopmponetin e MFK-së ”Mjedisi i kontrollit” citohet se ...” Struktura e njësisë duhet të përfshijë: Rregulla të qarta që përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë. Cka do të thotë se në bazë të rregullores së brendshme të cdo institucioni janë të mirë përcaktuar pozicionet dhe përgjegjësitë për cdo pozicion.

Manualin për MFK në pikën “*Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore*” përcakton se Burimet njerëzore lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë: Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit..

Burimeve njerëzore janë përgjegjëse për vendosjen e kriteve për marrjen në punë të personelit, për caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; Janë burimet njerëzore të cilat disponojnë dosjet e personelit dhe janë përgjegjës për të verifikuar nëse janë në përputhje me VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nepunësve civile/nëpunësve “, pikën 12, “Kategoritë e pagave të nepunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar institucioni” apo me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi I Punës së republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu në Vendim nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit” i ndryshuar, Neni 16 citon se.....”Drejtori i përgjithshëm ka kompetenca për të emëruar personel të niveleve të tjera të SHKP-së.”

Gjithashtu vërehet se Raporti Final i Auditimit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë mban datën **09.07.2018**, ndërsa punonjësja është njoftuar për përmbushje detyrimi nga DRSH-P-Tiranë me shkresën nr.409 prot, datë 08.02.2019, ku thuhet se “..detyroheni të ktheni shumën prej 171,914 lekë të përfutur nga ju në pozicionin e përgjegjës së Sektorit të nxitjes së Punësimit Programeve për të Rinjtë dhe Formimit në Punë për mospërputhje të pozicionit të punës me nivelin e arsimit., si dhe për arkëtimin e detyrimeve të dëmit të konstatuar me datën 02.10.2019, ku është bërë një akt-marrëveshja për shlyerjen e detyrimit dhe arkëtimin e shumës, veprime në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, Neni 12 “Përgjegjësitë e drejtuesve të subjekteve publike për auditimin e brendshëm” pika b ku citohet se....“Hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm apo drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, **brenda 30 ditëve** nga dorëzimi i raportit përfundimtar.

- Nga auditimi i Raportin Final të Auditimit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë, në trajtimin e kësaj pike grupi i auditimit në asnjë rast nuk ka cituar punonjësën si shkaktare e dëmit por strukturat përgjegjëse që e kanë shkaktuar atë.

Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, shpreheni se:

Subjekti Shërbimi Kombëtar i Punësimit: Përsa i përket "Strukturës sëraportimit SAB" ju bejme me dije grupit te auditimit se ne zbatim korrekt per sektorin e auditimit tërekomandimeve tëlëna nëauditimet e mëparshëm, gjate vitit 2018-2019 ka qene investimi i titullarit te AKPA Znj.x që ka propozuar dhe ështëmiratuar ne zbatim te percaktimeve ligjore të VKM nr.83, datë 3.2.2016 ndryshuar, Urdhri nr. 172 datë24.12.2019 "Për miratimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” sipas të cilit sektori i auditimit është bërë drejtori i auditimit me 1 drejtues njesie dhe 4 auditues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit të KLSH-së: Deri në momentin e auditimit në terren struktura ishte e pa plotësuar dhe grupi të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument për të cilën subjekti pretendon.. Mbashtetur dhe në komentet e dhëna nga subjekti mbi observacionet e lënë në institucion ku shprehen se “Nuk është përgjegjësi e SAB mungesa e organikës së kësaj strukture, pasi këto organe janë miratuar nga organet e qeverisë qendrore” të dy qëndrimet bien në kundërshtim me njëra tjetrën, çka do të thotë se struktura nuk është iniciuar dhe plotësuar ende. Nëse kjo strukturë do të ishte iniciuar për tu plotësuar do të ishte observuar me observacionet e dërguara mbi akt- konstatimet.

Observacioni nuk merret parasysht

II.Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, shpreheni se :Ju bëjme me dije grupit te auditimit se ;edhe në planin strategjik dhe vjetor 2018-2020 të titullarit te SHKP nr.2902 datë 20.10.2017 të dërguar në NJQH ne MFE të cilin ju e dispononi bashkangjitur akt-kundërshtimit, drejtoria e përgjithshme e SHKP është planifikuar për tu audituar në vitin 2019, por edhe sipas shkresës Urdhrit nr.11 datë 10.07.2019 nr. 2806 te titullarit te SHKP, Urdher “Për ngritjen e misionit të auditimit te Shërbimit Kombëtar i Punësimit”, është planifikuar misioni i auditimit për drejtorinë e përgjithshme të SHKP. Në të dyja rastet këto auditime të planifikuara janë anuluar (shtyrë) nga titullarët për faktin se per dy vite 2018-2020, SHKP ne nje menyre qe nuk eshte ne perputhje me percaktimet ligjore per numrin dhe frekuencen e ketyre auditimeve, eshte audituar 3 here rresht nga audituesit shtetore te KLSH respektivisht.

Qëndrimi i Grupit të auditimit të KLSH-së:

Ky arsyetim nuk merret parasysht, pasi Planet Strategjike dhe Vjetore që disponojmë për vitin 2019 të cilat janë dërguar dhe në rrugë elektronike me datë 09.04.2020, nuk është vënë subjekt auditimi Institucioni qendror, Në momentin që SAB bën planifikimin strategjik nuk ka informacion nëse ky subjekt do të kontrollohet apo jo nga KLSH- ja. Gjithashtu nga SAB-ja mund të realizohen dhe auditime tematike ndaj institucionit, duke qënë në nivelin e vlerësimit e riskut nga ana juaj njësis qendrore është vlerësuar me risk të lartë, SAB duhet ti japi një vlerësim të njëjërëndësi në nivel më të lartë pasi njësis qendrore është boshti kryesor për mbarëvajtjen dhe përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të njësisve të tjera në varësi.

III.Trajtimi i observacionit pas Projekt Raportit të Auditimit të Përputhshmërisë të dërguar nga grupi i auditimit të KLSH-së, me nr.65/4 datë 05.05.2020 protokolluar ne AKPA me nr.183/54 date 04.06.2020, shpreheni se

*Në zbatim të raportit final të auditimit nr.1774/1 datë 25.06.2019 të mbajtur nga NJAB me objekt auditimi (ndjekje rekomandimesh në DRP Tiranë) të cilin **grupi i auditimit KLSH e posedon bashkëngjitur akt-kundërshtimit nr.183/18 datë 22.04.2020**, ne faqen 3-4 te raportit eshte percaktuar se ;*

*Titullari i SHKP sipas shkresës nr.3352/1 date 17.10.2018 drejtuar DRP Tirane ka urdhëruar arkëtimin e detyrimit sipas planit të masave të rekomanduara nga sektori i auditimit pikës 1 dhe 4, dhe sipas shkresës nr.1589 datë 17.10.2018 (kartela shoqeruese e praktikës, **me prioritet 5 dite**) titullari i DRP Tirane ka percjelle shkresën për tu trajtuar nga (**Sektorit te Personel Shërbimeve, dhe Juristit të drejtorisë**) detyrë që nga auditimi rezulton se nuk është*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

zbatuar prej tyre Mbetet ne autoritetin e titullarit DRP Tiranë që të vlerësoje pse kanë dështuar dhe nuk kanë funksionuar sistemet e kontrollit te brendshem të kesaj drejtorie, të percaktoje me dokumentacion shkresor emrat e personave shkaktare përgjegjës (dhe arsyet e mos zbatimit te urdhrimit) qëe me veprimet dhe mos veprimet e tyre, ne mos përmbushje të detyrave të tyre funksionale, për mos zbatim të urdhrimit të Drejtorit te Pergjithshëm te SHKP nr.3352/1 datë 17.10.2018, për mos hartimin e Urdhrit administrativ dhe tejkalim te afateve te njoftimit, kanë pamundësuar ligjerisht arketimin e shumës 171.914 leke rezultuar si kundervajtje administrative, vlerësuar nga auditimi si detyrim debitor për llogari te, dhe për sa percaktohet nga baza ligjore ne fuqi te kerkoje nga personat shkaktare përgjegjës që kanë pamundësuar arkëtimin në rruge ligjore te shumës, në përputhje me procedurat ligjore, zhdemtimin e detyrimit 171.914 lekerezultuar si kundervajtje administrative ne dem te buxhetit te shtetit.

Pra rezulton e percaktuar qarte se "Sektori i Personel Sherbimeve, dhe Juristi i drejtorise" ne DRP Tirane, nuk kane zbatuar urdhrin e titullarit te SHKP.

Qëndrimi i Grupit të auditimit të KLSH-Grupi i auditimit sqaron se përgjegjësia për zhdemtimin e detyrimit nuk i është ngarkuar personave përgjegjës të cilët e kanë shkaktuar. Pasi siç është theksuar dhe në material se përgjegjësi në emërimin e një punonjësi në detyrë bëhet pas verifikimit të kriterëve të përcaktuara nga burimet njerëzore "Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë: Kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit" dhe në Vendim nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit" i ndryshuar, Neni 16 citon se....."Drejtori i pergjithshem ka kompetenca për të emëruar personel të niveleve të tjera të SHKP-së." Punonjësja nuk është vetë-emëruar.

Nuk është lënë përgjegjësi SAB pse është ngarkuar punonjësja me përgjegjësi, po është lënë si rekomandim, që ju si grup i auditimit të cilët keni lënë një rekomandim (ku dhe ju keni theksuar në observimin në raportin final të DRP Tiranë se nuk është ngarkuar me përgjegjësi ish-punonjësi, për detyrimin e konstatuar). në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të DRP Tiranë të rishikoni zbatimin e rekomandimit dhe të ngarkohen me përgjegjësi personat të cilët realisht kanë shkaktuar detyrimin e konstatuar në raportin final të DPR Tiranë.

Titulli i Gjetjes 1:	Strukturat e raportimit SAB
Situata:	Nga auditimi u konstatuan dobësi dhe parregullsi si në kompozimin, ashtu dhe në organizimin e Strukturës së Auditimit të Brendshëm në SHKP. Struktura është aktualisht në nivel sektori dhe sipas organigramës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.111 datë 31.07.2018, është me tre punonjës dhe pa drejtues. Gjithashtu mungesa e pozicionit të përgjegjës të sektorit ka sjellë mungesë të linjës së raportimit të auditimit të brendshëm duke cunuar procesin e menaxhimit të sektorit, miratimit të planeve, programeve të angazhimit, mungesë të kontrollit të cilësisë dhe rrjedhimisht performancë të ulët të këtij sektori me shumë rëndësi në institucion.
Kriteri:	VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, pika nr.22, të "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm": Standardet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

	Profesionale të Auditimit të Brendshëm Publik, pika nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik”
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e strukturës së SAB sipas standarteve ka sjellë mungesën e kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të operacioneve, duke sjellë një performancë të ulët të këtij sektori.
Shkaku:	Mungesa e strukturës së Auditit të Brendshëm sipas standarteve dhe ligjeve në fuqi
Rëndësia:	E Lartë.

Titulli i Gjetjes 2:	Mosplanifikim i saktë i objekteve të auditimit sipas riskut të auditimit si Planet Strategjike dhe Planet Vjetorë.
Situata:	Nga grupi i auditimit u konstatua se për të dy vitet objekt auditimi 2018-2019 as në Planet Strategjike dhe as në Planet Vjetore nuk planifikohet dhe rrjedhimisht nuk auditohet nga auditi i brendshëm, njësia qendrore ose Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së, megjithëse në nivelin e vlerësimit të riskut kjo njësi parashikohet me risk të lartë.
Kriteri:	Nenin 6 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 114/2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Moskryerja e auditimit të brendshëm të njësisë qendrore e cila është boshti kryesor riskon mbarëvajtjen dhe përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të njësisë të tjera në varësi
Shkaku:	Mungesa e strukturës së NJAB me burime njerëzore
Rëndësia:	I mesëm

Titulli i Gjetjes 3:	Strukturat e raportimit SAB
Situata:	Nga grupi i auditimit u konstatua se për të dy vitet objekt auditimi ka shmangie të angazhimeve të auditimit nga planifikimi.. Nga SAB nuk është marrë mendimi i Komitetit të Auditimit, për ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm me një ndryshim rrënjësor nga plani fillestar dhe me ulje të subjekteve objekt auditimi, propozuar dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm SHKP-së.
Kriteri:	Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 9. Manuali i AB pika, 3.5 Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizimi i planeve vjetore të miratuara dhe rishikuara Nga plani fillestar deri në angazhimin për auditim duke pasur një ndryshim total ka sjellë një inefikasitet të këtij sektori dhe mos përmbushjen e Planit të angazhimeve si dhe të Planifikimit të buxhetit dhe shpërndarjes së burimeve të NJAB.
Shkaku:	Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB. Ndryshimi i prioritetëve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut. Ndërhyrja e titullarëve në zbatimin e planeve të auditimit.
Rëndësia:	I mesëm



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Titulli i Gjetjes 4:	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në DRSHKP, Tiranë
Situata:	<p>Nga auditimi i Raportit Final të Auditimit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë u konstatua se është lene një rekomandim në lidhje me emërimin në detyrë në datën 30.08.2016 i Znj.x ne postin e Përgjegjës së Sektorit të Nxitjes së Punësimit, Programeve për të Rinjtë dhe Formimit në Punë ku citohet :</p> <p><i>‘Nga SHKP te behet zevendesimi dhe plotesimi i postit te Pergjegjesit te Sektorit te Nxitjes se Punesimit Programeve per te Rinjte dhe Formimit ne Pune te DRP Tirane, me punonjes qe zoterojne arsimin perkates, diplome e integruar e nivelit te dyte DN....., ‘ ‘Pasi te analizohet nga menaxhimi i larte i DRP, SHKP-se dhe sektori juridik, si dhe te percaktohet konkretisht pergjegjësia per demin ekonomik shkaktuar buxhetit te shtetit ne sektorin e nxitjes per shumen 171.914 leke, te nise menjehere puna per kthimin mbrapsht dhe arketimin e tyre ne buxhetin e shtetit‘.</i></p> <p>Grupi i punës i ngritur për ndjekjen e rekomandimeve në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë ka ngarkuar me përgjegjësi për kthimin e shumës të konstatuar si dëm ekonomik Znj.x Nga sektori i AB është bërë auditimi i zbatimit të rekomandimeve dhe nuk e ka konstatuar se ngarkimi i znj .xme përgjegjësi është në kundërshtim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar neni 27 “Përgjegjësia e Punëmarrësit, pika 1 ku citohet se...”Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale”, ku në këtë rast nuk kemi shkelje të kushteve të kontratës nga punëmarrësi. Vendimit nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit” i ndryshuar, Neni 16 citon se.....”Drejtori i pergjithshem ka kompetenca për të emëruar personel të niveleve të tjera të SHKP-së.” të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”</p> <p>Gjithashtu u konstatua se marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve nga njësia nuk janë marrë brenda afatit kohor (brenda 30 ditëve) nga dorëzimi i raportit përfundimtar.</p>
Kriteri:	Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi I Punës së republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; Vendimit nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
Ndikimi/Efekti:	Ngarkimi me përgjegjësi i personave të cilët nuk kanë shkatuar dëmin, duke shmangur përgjegjësinë e personave të cilët janë përgjegjës për dëmin e konstatuar.
Shkaku:	Mos funksionimi i sistemi i kontrollit te brendshëm për sektorin e burimeve njerëzore
Rëndësia:	I mesëm



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

8. PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT

ii. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në SHKP. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Në bazë të ligjit organik, Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom me statusin e një administrate shtetërore qendrore, që përgjigjet para ministrit.

SHKP është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të gjithë strukturave të varësisë dhe drejtoisë së përgjithshme të SHKP hartohet nga institucioni dhe miratohet nga Ministria e linjës, e cila vë në dispozicion fondin e akorduar.

Për periudhën objekt auditimi 2018 dhe 2019 rezultoi se:

-Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b”, që përcakton se “Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë”, nga ana e këtij institucioni janë hartuar dhe publikuar dy dokumente strategjike lidhur me funksionin e SHKP mbi nxitjen e punësimit. Nga ana e drejtorit të SHKP këto dokumente duhen ndjekur e analizuar sipas një plani aktivitetesh për zbatimin e këtyre strategjive sektoriale, detajuar sipas drejtorive dhe afateve kohore.

-Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në varësi direkt të Drejtorit të Institucionit. Gjithashtu në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Konstatohet se, është emëruar nëpunës zbatues, përgjegjësja e sektorit të financës znj. x.

Nga auditimi u konstatua se, në përcaktimin e nëpunësit zbatues nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, ku cilësohet se, “Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë. Nga auditimi konstatohet se, nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues pasi në strukturën e miratuar përgjegjësi i sektorit të financës përgjigjet përpara drejtorit të shërbimeve mbështetëse gjithashtu dhe zv/ drejtor i Shkp, i cili nga ana e tij përgjigjet dhe raporton para drejtorit të SHKP. Referuar strukturës organike dhe organigramës së miratuar nga Kryeministri me Urdhrin nr. 111 , datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në Urdhërin Nr.9, datë 28.10.2011 të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së SHKP” të ndryshuar, nëpunësi zbatues është në varësi direkt nga nëpunësi autorizues, (Drejtori i SHKP).

Sipas kërkesave të pikës nr.1, të nenit 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”. Për këtë, grupi i auditimit konstatoi se, për vitin 2018-2019 nga ana e strukturave drejtuese të SHKP-së janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e linjës pyetësorët e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për vitin 2018, rezulton mesatarja e përgjithshme e vlerësimeve prej 3.74 pikë për gjithë komponentet e kontrollit të brendshëm.

Konstatohet se SHKP funksionon sipas rregullores së brendshme miratuar nga Këshilli Administrativ Tre palësh me vendimin nr. 29, datë 30.01.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 31, datë 14.02.2017. Rregullorja është miratuar nga kryetari i KAT, ministri x . Sa sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 29 pika 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku thuhet se, “Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.”

-Nga ana e Drejtorit të SHKP, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, duke vepruar me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për MFK”.

-Evidentohet se janë përmbushur detyrimet, në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për hartimin e regjistrit të riskut për vitin 2019, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.Ky dokument duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

- U konstatua që Grupi i Menaxhimit Strategjik është mbledhur vetëm dy herë gjatë një viti për vitin 2019 periudhë auditimi, nga ku është mbajtur një proces-verbal nga sekretari i caktuar për mbledhjen e GMS, i cili nuk është firmosur nga titullari dhe as nga anëtarët e GMS.

-Lidhur me Strategjinë për Menaxhimin e Rrisqeve, detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të titullarit të institucionit, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave. Në kundërshtim me nenin 21, pika 2: “Menaxhimi i riskut”: ku citohet: “Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, miraton një strategji e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”, nuk ka një strategji të riskut për minimizimin e rreziqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave.

-Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në SHKP janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fusha të ndryshme të cilat lidhen me veprimtarinë e punës së secilit sektor.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve, etj.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” nga ana e institucionit SHKP është hartuar “Rregullorja në zbatim të Kodit të Etikës” me shkresën nr. 1466 prot. datë 21.05.2018, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit. Nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Nga drejtuesi i institucionit, sigurohet mbikëqyrja e monitorimi të punës për secilin punonjës, nëpërmjet raporteve periodike nga drejtuesit e drejtorive dhe sektoret, në mënyrë që të sigurohet si duhet realizimi i objektivave për çdo pozicion punësimi si dhe garantimi i integritetit personal dhe etika profesionale. Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), është niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm. Në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës përgjigjet dhe mbulon funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të SHKP, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

▣ Konstatohen dobësi dhe parregullsi si në kompozimin, ashtu dhe në organizimin e Strukturës së Auditimit të Brendshëm në SHKP. Struktura është aktualisht në nivel sektori dhe sipas organigramës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 128, datë 14.6.2010, është me tre punonjës dhe pa drejtues. **Mungesa e pozicionit të përgjegjësit të sektorit pengon procesin e menaxhimit të sektorit, miratimit të planeve dhe programeve të angazhimit si dhe pengon kontrollin e cilësisë. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me Standardet Profesionale të Auditimit të Brendshëm Publik si dhe në shkelje të pikës nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016** “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku citohet se,

*“Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, **përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.** Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”*

Në periudhën e auditimit kjo strukturë ka në përbërje tre punonjës, por nuk ka përgjegjës të sektorit, në kundërshtim me pikën nr.22, të **VKM Nr. 893, datë 17.12.2014** “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, ku përcaktohet se:

“ Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe menaxherët e tjerë të institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, institucioni ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, si dhe raste të delegimit të autoritetit tek niveli më poshtë, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë që të gjithë punonjësit të mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga drejtuesit dhe struktura aktuale për mangësitë e hallkave të monitorimit të programeve të nxitjes së punësimit nuk është plotësisht e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë caktuar normat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave / drejtorive dhe zyrave të varësisë, etj. Konstatohet se, nga ana e drejtuesve sipas niveleve (eporët e drejtëpërdrejtë), janë kryer vlerësimet vjetore dhe periodike të performancës në punë për çdo punonjës, sipas përcaktimeve në dispozitat e shërbimit civil dhe akteve të dala në zbatim të tij.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në SHKP janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme për sektorin publik.

▣ **Konstatim:** Dosjet e personelit për punonjësit e SHKP nuk përmbajnë në çdo rast dokumentacion të plotë, një pjesë e këtyre dokumenteve janë fotokopje të pa noterizuara. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, (lidhja nr.1, pikat 2, 3a, 4 dhe 5).

1. Menaxhimi i riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, në këtë institucion për periudhën objekt auditimi (viti 2018), mungojnë regjistrat e riskut. Regjistrin e riskut për institucionin për vitin 2019, dokument i cili është miratohet nga nëpunësi autorizues, nuk ka një shkresë zyrtare, dërguar Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 16, si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-se”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”.

Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së, ku kompjuterët janë të lidhur me serverin qendror. Kontrolli i sistemit realizohet kryesisht për të siguruar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

mirëfunksionimin e këtyre elementeve kryesor dhe të gjithë elementeve të tjerë që lidhen me to.

4. Informimi dhe komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është kryer në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar përmbushjes së detyrave dhe të përgjegjësive. Drejtuesit e SHKP zotërojnë informacion te mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. *Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre.* Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore/ zyrtare dhe SHKP ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

5. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullarët e njësisë publike (NA), janë përgjegjës për ngritjen dhe zbatimin e një sistemi për monitorimin e MFK-së, me qëllim vlerësimin e funksionimit të tij në mënyrën e duhur, si dhe rifreskimin e tij në kohën e duhur kur ndryshojnë rrethanat. Monitorimi i kontrollit të brendshëm duhet të garantojë se të gjitha problemet e identifikuara, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen, por edhe se rezultatet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së linjës merren në konsideratë dhe analizohen nga ana e titullarit. Për të mbështetur monitorimin e rregullt, drejtuesit e njësisë duhet të ngrënë një sistem më efektiv të raportimit të brendshëm mbi risqet e identifikuara, nën drejtimin e Koordinatorit të Risqeve, duke garantuar një raportim në afat, të shpeshtë (*p.sh. në bazë tremujore*) dhe gjithëpërfshirës.

1-Komente dhe shpjegime të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKP, dërguar me shkresë me nr.prot 183/43, datë ,23.04.2020 dhe protokolluar me KLSH nr 65/3 datë 27.04.2020.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së.

1-Observacionet tuaja si institucion kanë ardhur jashtë afati 7 –ditor të cituar në procedurë, megjithatë nisur nga situata COVID-19, ne si grup auditimi I KLSH-së I kemi marrë parasysh dhe i kemi trajtuar me korrektësi.

2-Nga punonjësit e Institucioni tuaj na janë vënë në dispozicion të gjithë dokumentet e kërkuar në rrugë shkresore apo elektronike dhe komunikimi jonë prej fillimit të punës audituese në 22.01.2020 në subject deri në përfundim, ka qenë efektiv dhe korrekt.

3-Kemi kontaktuar me të gjithë personat përgjegjës sipas funksionit dhe detyrave që ata kanë sipas rregullores vazhdimisht dhe në cdo kohë duke përfshirë ZV/Drejtorin e Përgjithshëm, Përgjegjësen e Sektorit të Financës, Specialistët e NJAB, punonjësit e sektorit të burimeve njerëzore, Drejtorinë e Programeve dhe Integritimit në Tregun e Punës, sektorin e prokurimit, jurist etj.

4-Me nxjerrjen e aktit normativ të Këshillit të Ministrave NR.3, datë 15.03.2020”Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, puna jonë në terren u kufizua si për cdo institucion dhe komunikimi i grupit të auditimit të KLSH-së, është kryer nëpërmjet e-mailit apo telefonave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Gjithashtu aktet e konstatimit nuk janë dorëzuar on-line por janë dorëzuar fizikisht në protokoll në datën 15.04.2020, sipas afatit të përcaktuar sipas program auditimitnr 65/2, datë 18.03.2020, i ndryshuar.

5-Për sa ju pretendoni për takimin përmbyllës i cili nuk u zhvillua për arsyet e cituara më sipër , sqarojmë gjithashtu se në bazë të nenit 26, pika 1, të Rregullores së procedurave të auditimit në KLSH miratuar me Vendim nr.107 , datë 08.09.2017, citohet se:

Akt Konstatimi është dokumenti në të cilin audituesi evidenton gjetje specifike të auditimit. Akt konstatimi është një dokument i njëanshëm i audituesit në të cilin evidentohet shkresërisht se çfarë ka konstatuar audituesi gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nuk kërkon domosdoshmërisht prezencën e subjektit të auditimit. a. Akt konstatimi është një dokument i cili përfaqëson të gjithë punën hulumtuese të audituesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e vënë në dispozicion. b. Akt konstatimi mund të përfundojë me një opinion pozitiv apo negativ të audituesit në lidhje me atë çka audituesi ka konstatuar. Ekzistenca e konkluzioneve negative (ndryshe nga ato pozitive) kërkon plotësimin nga audituesi të bazës ligjore që është shkelur nga ana e subjektit të audituar, evidentimin e dëmit të shkaktuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës.

Pra nga sa më sipër ne përveçse punonjësit tuaj që I kemi vënë në dukje cdo shkelje të konstatuar në mnëyrë permanente, e kemi kryer këtë detyrë edhe nëpërmjet akteve të konstatimit.

6-Në lidhje me pretendimin tuaj për vendosjen e emrit tuaj në cdo akt konstatim nga grupi I auditimit të KLSH-së, sqarojmë se :Sipas rregullores së Brendshme me nr.prot 828/1, datë 17.03.2017, neni 6 citon se:

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutivdhe e përfaqëson atë në çdo nivel organizimi dhe drejtimi. Ai siguron realizimin e objektivave dhe përgjigjet para Ministrit.

Pra është detyra jonë që nëpërmjet Akteve të Konstatimit, t'ju vinim në dijeni për shkeljet e konstauara në Institucionin që ju drejtoni.

Për çdo pikë tjetër të trajtuar në observacionin tuaj jemi përgjigjur sipas pikave në projekt-raport dhe rasteve specifike ndaj personave me përgjegjësi direkte

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 1418 Prot. Hyrës në SHKP datë 06.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, ka sjellë për zbatim “Mbi dokumentimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, me anë të të cilit kërkohet të përgatiten kërkesat buxhetore së hartimit të PBA për **fazën strategjike (I)** duke përdorur sistemin AFMIS sipas formateve që i bashkëngjiten shkresës. Institucioni nuk i ka përcjellë kërkesat buxhetore për hartimin e PBA 2020-2022 **faza I**, në rrugë shkresore, në kundërshtim me pikën 8/3 të Udhëzimi nr. 8 datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1. të Program Auditimit në faqet nr. 20-42 të Raportit të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

1.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit të marrin masa, që fazat e hartimit të PBA të dërgohen gjithmonë në drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë në mënyrë shkresore.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në raportet e monitorimit mungon relacioni shpjegues që tregon mospërputhjen e treguesve të realizuar me planin, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

- Në raportet e monitorimit për 8- mujor mungojnë informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet por edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

- Raportet e Monitorimit për vitet objekt auditimi nuk janë të publikuar në faqen zyrtare të SHKP, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1. të Program Auditimit në faqet nr. 20-42 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Shërbimin Kombëtar i Punësimit të marrë masa në vazhdimësi, që në përpilimin e raporteve të monitorimit 4, 8, 12 mujore, të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vazhdimësi

2.2 Rekomandimi: Në raportet e monitorimit për 8- mujor të jepen informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar.

Në vazhdimësi

2.3 Rekomandimi: SHKP të marra masat në vazhdimësi, që Raporti i Monitorimit të publikohen në faqen zyrtare të tyre në Web

Në vazhdimësi

2.4. Rekomandimi: Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, institucioni të vërë në dispozicion të publikut, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, janë paguar nga buxheti i shtetit shuma prej 7,903,037 lekë. Për 9 raste, detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore nuk janë paguar vullnetarisht, por ekzekutimi i tyre është kryer në mënyrë të detyruar përmes përmbaruesit gjyqësor privat duke rënduar buxhetin e shtetit me kosto shtesë për tarifatat përmbarimore në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

shumën prej 535,561 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1. të Program Auditimit në faqet nr. 20-42 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: AKPA, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos të lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Emërimi i Drejtoreshës së Përgjithshme të SHKP-së është bërë në bazë të urdhërit të Kryeministrit Nr.65, datë 13.04.2018 “ Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në mbështetje të nenit 17, të ligjit 7995, datë 20.09.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Në dosjet e personelit marrë nga sektori i burimeve njerëzore u konstatua se Drejtori i Përgjithshëm nuk ka qenë pjesë e TND-së, ku data e fillimit të marrëdhënieve të punës është **13.04.2018**, dhe data e marrjes së statusit të **Nëpunësit Civil është 21.01.2020**. Nga sa më sipër Titullari i Përgjithshëm ka vazhduar të ushtrorë detyrën e tij për një periudhë afër 2-vjeçare pa statusin e nëpunësit civil, në kundërshtim me Ligjin Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndryshuar me Ligjin Nr.178/2014, datë 18.12.2014, neni 28, pika 1,2,3,4 e 5 dhe neni 30 i këtij ligji, i cili shpreh qartë se cdo emërim i kategorisë së lartë drejtuese, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, është absolutisht i pavlefshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, të Program Auditimit në faqet nr. 42-50 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit t’i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si institucioni përgjegjës të verifikojë nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit për emërimin si Drejtor i Përgjithshëm i SHKP-së dhe vlefshmërinë e të gjitha veprimeve juridike të kryera nga Titullari për periudhën dy vjeçare gjatë së cilës ai nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil si anëtar i TND-së.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: a)Nga auditimi u konstatua se me ristrukturimin e ministrive, SHKP është në varësi të MFE-së, ndërkohë Rregullorja e Brendshme e SHKP-së, “Për organizimin ,funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së SHKP-së, miratuar me vendimin nr.29, datë 31.01.2015 të Këshillit Trepalësh Administrativ, e ndryshuar me vendimin nr.3, datë 14.02.2017 të Këshillit Trepalësh Administrativ nuk është përditësuar dhe nuk i është përshtatur ndryshimeve. Sipas rregullores së brendshme aktuale, SHKP vazhdon të jetë në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

b)Sipas rregullores aktuale, në nenin 9 të saj, ka të parashikuar funksione për “përgjegjës sektori, por në strukturën ekzistuese (për periudhën në auditim) nuk ka një pozicion pune të specifikuar për “përgjegjës të sektorit”, duke veçuar vetëm “sektorin e Financës”, i cili e ka një pozicion të tillë pune, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave në cdo drejtori duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe joefikasitet në punën e kryer, në kundërshtim me VKM nr.893, datë 17.12.2014 , pika 3 si dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, të Program Auditimit në faqet nr. 42-50 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit t’i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për krijimin sa më parë të **Këshillit Konsultativ për Punësimin si**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

organi këshillimor që ngrihet pranë SHKP-së për punësimin dhe aftësitë, i cili kryesohet nga Ministri i MFE-së dhe të marrë masa për përgatitjen e rregullores së re “Për organizimin, funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës e AKPA (SHKP) ” duke mirëpërcaktuar funksionet dhe reflektuar ndryshimet si pasojë e implementimit të Ligjit të ri 15/2019, datë 13.03.2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi u konstatua se për procesin e inventarizimit komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, dhe të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve. Për kushtet e ruajtjes së tyre së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, ky komision duhej t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b) Nga auditimi u konstatua se para fillimit të inventarit nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe i fletë daljes nëpërmjet një procesverbali, i cili mbahet midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

c) Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit ka nxjerrë një vlerë totale dhe jo një listë të detajuar, mbi gjendjen fizike të institucionit, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj. sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74, 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

-Procesi i inventarizimit ka kaluar afatet e përcaktuara mbi 17 ditë kalendrike pa justifikim apo miratim përkatës nga NA i SHKP.

d) Gjatë kqyrjes së kartelave të inventarit, kartela e aktiveve afatgjata me vlerë kontabile 19,190, 942 lekë, në përgjegjësi materiale të nëpunësve Elvis Rexha dhe Agron Pullumbi rezulton e pa firmosur nga këta nëpunës, fakt i cili nuk është reflektuar apo arsyetuar në raportin drejtuar titullarit të SHKP. Kartela e zyrës së IT në përgjegjësi të x dhe x me vlerë kontabile 678,483 lekë rezulton e parregullt pasi këta punonjës nuk janë pjesë e organikës së SHKP, duke ju referuar listëpagesave dhe emrave të nëpunësve paraqitur nga zyra e burimeve njerëzore.

-(Më hollësisht trajtuar në pikën 3. të Program Auditimit në faqet nr. 50-88 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Komisioni i inventarizimit, i cili ngrihet çdo vit nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacion, me qëllim verifikimin real të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.

Në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

6.2.Rekomandimi: Përgjegjësi i sektorit të Financës të kryejë rregullimin e kartelave rast pas rasti për punonjësit aktual dhe ata të larguar duke dokumentuar saktë lëvizjet e brendshme të cdo aktiviteti sipas personave, të cilëve u ngarkohet dhe vendodhjen e tyre (sipas zyrave).

-Pajisjet e zyrave të paraqiten në cdo kartelë me llojin, tipin, numrin serial të secilës pajisje në mënyrë që lëvizja, nxjerrja jashtë përdorimit apo të ndonjë procesi tjetër, me qëllim verifikimin lehtësisht në cdo proces kontrolli nga auditi i brendshëm ose i jashtëm.

Në vazhdimësi

6.3.Rekomandimi: Sektori i Financës të monitorjë firmosjen e kartelave nga të gjithë nëpunësit gjatë procesit të inventarizimit duke i dhënë rëndësinë e duhur që mbart procesi i inventarizimit dhe përgjegjësia që bie mbi secilin anëtar apo nëpunës i cili ka aktive në ngarkim. Procesi i asgjësimit të shoqërohet me fotot përkatëse të aktiveve në gjendje fillestare e përfundimtare, duke e faktuar asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit dhe eliminimin e dyshimeve të arsyeshme mbi kryerjen e këtij procesi.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në disa procedura prokurimi të zhvilluara gjatë vitit 2018 dhe 2019 për kontrata pune, në DST janë vendosur kritere të veçanta në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Kontrata për punë publike” pika 5, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga AK është kërkuar që Operatorët Ekonomikë duhet të disponojnë një mjek të përgjithshëm, në zbatim të pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001”, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”.

Konstatohet se në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, *shfuqizohet*.

Duke qenë se VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rezulton të jetë e shfuqizuar nga Vendimi Nr. 632, datë 15.7.2015”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4. të Program Auditimit në faqet nr. 88-128 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdim, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 4 procedurave të prokurimit të punëve për vitin 2018, u konstatua se është shpallur fitues OE “x” shpk, me ofertë ekonomike më të ulët, por ky operator ka ofertuar paralelisht në disa procedura tenderimi dhe ka pas punë në proces në vetë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Autoritetin Kontraktor. Procedurat ku ky operator ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues janë:

1. Rikonstruksion i ZVP Pogradec, me fond limit 5,445,467 lekë pa TVSH, ku data e hapjes së tenderit është 10.09.2018, me afat të zbatimit të kontratës 60 ditë. Sipas DST kërkoheshin 20 punonjës, nga ku 1 specialistë ndërtimi, 2 elektrikistë, 1 murator, 1 bojaxhi, 2 hidraulik. Nga vërtetimi për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore x, konstatohet se ky OE ka 35 punonjës, ku ka paraqitur dokumentet për cdo specialist dhe cdo mjet. Data e lidhjes së kontratës është **08.10.2018** me vlerë 3,919,092 lekë me TVSH.

2. Rikonstruksion i ZVP Tropojë, me fond limit 4,293,000 lekë pa TVSH, ku data e hapjes së tenderit është 08.10.2018, me afat të zbatimit të kontratës 30 ditë. Sipas DST kërkoheshin 15 punonjës, nga ku 1 specialistë ndërtimi, 1 elektrikistë, 1 murator, 1 bojaxhi, 1 hidraulik. Nga vërtetimi për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore E-SIG, konstatohet se ky OE ka 35 punonjës, ku ka paraqitur të njëjtat dokumentete mbi specialistët dhe të njëjta dokumente mbi mjetet. Data e lidhjes së kontratës është **30.10.2018** me vlerë 3,109,204 lekë me TVSH.

3. Rikonstruksion i DRSHKP Kukës, me fond limit 4,293,000 lekë pa TVSH, ku data e hapjes së tenderit është 12.10.2018, me afat të zbatimit të kontratës 30 ditë. Sipas DST kërkoheshin 20 punonjës, nga ku 1 specialistë ndërtimi, 1 elektrikistë, 1 bojaxhi, 1 hidraulik. Konstatohet se OE “x” ka 35 punonjës, ku ka paraqitur të njëjtat dokumentete mbi specialistët dhe të njëjta dokumente mbi mjetet. Data e lidhjes së kontratës është **08.11.2018** me vlerë 4,353,210 lekë me TVSH.

4. Rikonstruksion i ZVP Kucovë, me fond limit 4,326,933 lekë pa TVSH, ku data e hapjes së tenderit është 19.10.2018, me afat të zbatimit të kontratës 30 ditë. Sipas DST kërkoheshin 15 punonjës, nga ku 1 specialistë ndërtimi, 1 elektrikistë, 1 murator, 1 bojaxhi, 1 hidraulik. Konstatohet se OE “x” ka 35 punonjës, ku ka paraqitur të njëjtat dokumentete mbi specialistët dhe të njëjta dokumente mbi mjetet. Data e lidhjes së kontratës është **14.11.2018** me vlerë 3,370,141 lekë me TVSH.

Gjithashtu ky OE, në të 4 procedurat prokuruese, ka deklaruar të njëjtat shtojca, shtojcën 9 “*Deklarata e disponueshmërisë së makinerive*” dhe Shtojca 10 “*Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces*”, të cilat kanë si qëllim, plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/ kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Kontratat e rikonstruksionit, janë të shpërndara në hapësira gjeografike të largëta (në Kukës, Pogradec, Kucovë, Tropojë), me të njëjtin dokumentacion financiar, teknik me të njëjtin staf dhe mjete, kontrata që është në proces apo fillim pune. Pra, nga shpallja fitues e këtij operatori ekonomik në shumë kontrata edhe pse është me cmimin më të mirë ekonomik, riskoheshet realizimi i punimeve. Nga AK, OE “x” shpk duhej të s’kualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë, të njëjtin dokumentacion, për rikonstruksione punimesh në hapësira të largëta gjeografike dhe të njëjta deklarata si ajo mbi kontratat e lidhura apo në proces, si deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku nuk plotësohet asnjëra prej tyre, pasi mjetet janë të angazhuara në kontratën e rikonstruksionit të ZVP Pogradec dhe në mënyrë akumulative”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 4. të Program Auditimit në faqet nr. 88-128 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Sektori i Prokurimit të marrë masa që në vlerësimet e procedurave të cilat do të zhvillohen në vijimësi, të analizohen ofertat që paraqet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

cdo operator ekonomik në disa tendera, pasi mund të riskohet realizimi i punimeve dhe koha e përcaktuar sipas grafikut të punimeve.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka të dokumentuar në rrugë shkresore parashikim të kryer për tregun e punës nga zyrat e punës rajonale dhe vendore duke krijuar një situatë jokorrekte nga SHKP/Drejtoria e Përgjithshme të cilët shprehen se për detajimin e buxhetit janë nisur nga analiza e të gjithë targeteve të punëkërkuësve të papunë (pu.pa) të rregjistruar. Pra SHKP nuk ka përmirësuar dhe nuk ka ndryshuar mënyrën e të punuarit për procedurën e shpërndarjes së fondeve të Buxhetit të Shtetit, për detajimin e saktë dhe transparent të tij në përputhje me nevojat e parashikuara nga Zyrat e Punësimit sipas grupeve të veçanta që synojnë të mbështesin. Kjo konstatohet edhe nga analiza e shpenzimeve të buxhetit për këtë program, për vitin 2019 të cilat rezultojnë me mosrealizim në vlerën prej 57 milion lekë. Disa njësi rajonale të cilët paraqiten me tregues më të dobët në realizimin e fondeve të tilla si: DRSHKP Berat me nivel realizimi 79%, DRSHKP Elbasan me nivel realizimi 83%, DRSHKP Fier me nivel realizimi 76%, DRSHKP Gjirokastrë me nivel realizimi 87%, DRSHKP Lezhë me nivel realizimi 75%, DRSHKP Shkodër me nivel realizimi 83%, DRSHKP Vlorë me nivel realizimi 61%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm si Nëpunës Autorizues, Drejtoria e Integritit dhe nxitjes së punësimit në bashkëpunim me Ekipin e menaxhimit Strategjik, të analizojnë me detaje shpërndarjen e fondeve të buxhetit të Shtetit për projektet e nxitjes së punësimit duke dokumentuar shkresërisht cdo informacion të ardhur nga Drejtoritë Rajonale për të kryer një planifikim të saktë dhe realizim të shpenzimeve sipas këtij planifikimi.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, afati i aplikimeve të subjekteve për programet e nxitjes së punësimit për vitin 2018 ka qenë në intervalin e datave: **03.07.2018 deri në datë 03.08.2018**. Gjatë muajit gusht janë shqyrtuar dosjet e paraqitura nga subjektet dhe është bërë miratimi i tyre nga Komisioni i Miratimit të Projekteve të nxitjes së punësimit i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën me nr.prot 2062, datë 05.07.2018 ku është mbajtur proces-verbali nr.1 me nr.prot 2778/3, datë 29.08.2018. Ky komision ka shqyrtuar projektet për subjektet sipas sistemit të pikëzimit si dhe ka për detyrë të monitorojë zbatimin e të gjitha projekteve të nxitjes së punësimit që janë në zbatim. Ajo që konstatohet është se afati i aplikimeve është realizuar në *gjashtëmuajorin e dytë të vitit buxhetor* dhe rrjedhimisht miratimi ka dashur përafërsisht 1 muaj kohë duke sjellë që për të gjithë subjektet përfitues të miratohen dhe të lëvrohen fondet në shtator të vitit buxhetor në rastin konkret për vitin 2018. Ndërkohë sipas **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar: *Kohëzgjatja e programit të trajnimit është më shumë se 6 muaj për të gjitha profesionet, fakt ky që sjell në shtrirjen e të gjithë projekteve përtej vitit buxhetor, kur paralelisht në planifikimin e buxhetit është përcaktuar që këto projekte duhet të përfundojnë me buxhetin e vitit 2018. Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve është e vlefshme deri në 31 dhjetor , afati i të cilës korrespondon me mbylljen e vitit buxhetor.* Ky është veprim i përsëritur nga SHKP, pasi i njëjti problem shfaqet për një periudhe tre-vjeçare 2017-2018-2019, dhe konkretisht:

-Për vitin 2018, **për programin “Nxitje Punësimi”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 258 mln lekë lekë, ose në masën 52,7 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

92% kundrejt buxhetit të rishikuar prej 281 mln lekë, pra me një diferencë prej -22,6 milionë lekë.

-Për vitin 2019, **për programin “Nxitje Punësimi”** shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën 345,9 mln lekë, ose në masën 70 % kundrejt planit fillestar (490mln lekë) dhe 86 % kundrejt buxhetit të rishikuar prej 403 mln lekë, pra me një diferencë prej -57 milionë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandimi:Drejtori i Përgjithshëm i SHKP dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA-së dhe në planifikimin vjetor, mënyrat e llogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar me atë të realizuar.

Në vazhdimësi

10.2.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në bazë të rolit që ka sipas ligjit për nxitjen e punësimit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për aplikimin e programeve të nxitjes së punësimit që në tremujorin I të vitit me qëllim planifikimin sa më të saktë të PBA-ve dhe realizimin e tyre me korrektësi.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se ka një rritje të realizimit në vlerë për programet e nxitjes së punësimit për vitin 2019 në masën 345,9 mln lekë, dhe në vazhdimësi vlerat më të larta në financimin e projekteve të nxitjes së punësimit janë sipas **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë” VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarëve të papunë nga grupet e veçanta“përkatesisht 98 mln dhe 170,9 mln .Gjithashtu financimet e kryera për projektet e nxitjes së punësimit sipas VKM të cituara më sipër janë të miratuara ose të mbartura nga viti 2018 pasi për vitin 2019 nuk ka asnjë projekt të nxitjes së punësimit përse i përket këtyre dy vendimeve të cilët kanë qenë vendimet me rëndësinë më të madhe në politikën e nxitjes së punësimit të SHKP-së. Ligji i ri **Nr. 15/2019, datë 13.03.2019** “Për Nxitjen e Punësimit” krijon Këshillin Konsultativ për Punësimin me tagër e funksion këshillimor në vend të Këshillit Administrativ Trepalësh që sipas legjislacionit të mëparshëm, ishte organi administrativ më i lartë me tagër vendimarrës.Ky Këshill nuk është krijuar për vitin 2019 e si rrjedhojë nuk është kryer dhe ushtruar asnjë nga detyrat dhe kompetencat e tij, që konsistojnë në: **a)**Shqyrtimin e projekteve e akteve ligjore a nenligjore qe do te propozohen ne lidhje me me veprimtarine e SHKP dhe zbatimin e legjislacionit të punësimit, punës dhe formimit profesional, si dhe rregullore të tjera për veprimtarinë e SHKP; **b)**Miratimin e rregulloreve të organizmit dhe funksionimit dhe rregulloren financiare, **c)**Miratimin e bilancit, raportit vjetor, projektbuxhetit per vitin ne vazhdim , **d)**Vendosjen për investimet e fondeve, **e)**Vendosjen per kontrata dhe marrëveshje më të rëndësishme, të gjitha këto nga mungesa e akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse nga MFE për një periudhë 1-vjecare nga hyrja e ligjit në fuqi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr.129-191 të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit t’i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrin masa për krijimin e menjëhershëm të Këshillit Konsultativ për Punësimin për të ushtruar detyrat dhe kompetencat që ia përcakton ligji, të munguara gjatë vitit 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim është kryer vetëm një kontroll nga Drejtoria e Integritimit të Tregut të Punës sipas Urdhrit të DP. Nr.09, datë 25.06.2019, në referencë të rregullores për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, miratuar me vendim nr.1 të KAT, në datë 25.06.2018. Nga kontrolli i kryer është mbajtur akt konstatimi me nr.prot.1999/1, datë 15.10.2019 për 79 subjekte përfitues në gjithë territorin.

Mangësitë e konstatuara nga grupi i punës në zyrat e punës, konsistojnë në targetimin e punëkërkesve të papunë të përzgjedhur në program, për mënyrën e financimit dhe dokumentacionin e paraqitur si dhe në plotësimin e dosjeve të programeve të nxitjes së punësimit.

a)Konstatohet se, në akt konstatimin e mbajtur nga kjo drejtori shkruhet në *përgjithësi*, ndërkohë që fusha e shtrirjes së kontrollit ka qenë e gjerë dhe numri i subjekteve të kontrolluara 79, dhe nuk ka për asnjë rast të konstatuar fillim të procedurave për ndërprerjen e financimit të programeve edhe pse në mangësitë e cituara shprehen që mungojnë dokumentet justifikues për pagesën e kontributeve mujore, veprime në kundërshtim me nenin 12, të rregullores me nr.prot.1789/2, datë 25.06.2018,

b)Nga ky aktkonstatimi nuk jepet asnjë element konkret për asnjë subjekt përfitues, ku të përshkruhen hollësisht hapat e ndjekur që në momentin e miratimit të projekteve dhe në monitorimin që zyrat përkatëse kanë kryer sipas rregullores të sipërcituar për çdo muaj.

c)Nuk është trajtuar në akt-konstatim për asnjë rast problematikat që kanë subjektet me akt-marrëveshje, pra subjektet që kanë pasur detyrime pranë organit tatimor në momentin e miratimit të projektit nga Komisioni i projekteve në SHKP. Monitorimi i kryerjes së pagesave ndaj detyrimeve të prapambetura dhe atyre koherente nga subjektet, të cilat janë me akt-marrëveshje duhet të ishte i dokumentuar në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së, për çdo muaj dhe jo të monitorohej vetëm nga zyrat e punës, pasi këta përfitues paraqesin risk të vazhdueshëm dhe nuk zbatojnë kushtet e akt-marrëveshjeve, *në kundërshtim me pikën 4 të nenit 14 të Rregulloresse brendshme me nr.prot.828/1, datë 17.03.2017.*

d)Nuk trajtohet konkretisht se sa efektive kanë qenë këto programe dhe sipas **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, pika 4, detyrim i subjektit aplikues është që pas përfundimit të formimit në punë ka për detyrë të realizojë punësimin e 50% të punëkërkesve të papunë, me kontratë të rregullt pune për një periudhë 6-mujore. Ky fakt shoqërohet vetëm me një raport përfundimtar nga zyrat e punës në të cilin shkruhet që ky detyrim është plotësuar dhe nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës që është listëpagesa e subjektit e deklaruar on-line në sistemin C@TS brenda datës 20 të çdo muaji e cila vërteton se sa nga punëkërkesit e papunë (pu.pa) janë të punësuar nga subjekti përfitues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi:AKPA (ish-SHKP) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pas krijimit të Këshillit Konsultativ për Punësim të marrë masa për kryerjen e monitorimit rigoroz të projekteve të nxitjes së punësimit të përfituara sipas VKM në fuqi, duke u bazuar në një plan pune vjetor të mirëdetajuar për të garantuar siguri në menaxhimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.

Në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

12.2. Rekomandimi: AKPA të monitorjë në mënyrë të veçantë dhe periodike subjektet të cilët në momentin e miartimit dhe përfitimit të projekteve të nxitjes së punësimit, rezultojnë me detyrime tatimore dhe akt-marrëveshje në organin tatimor, duke marrë konfirmim shkresor të rregullt nga Drejtoritë Rajonale tatimore përkatëse për zbatimin dhe derdhjen e detyrimeve që ata kanë.

Në vazhdimësi

12.3. Rekomandimi: AKPA (ish-SHKP) të marrë masa që për subjektet e cituara në raportin e auditimit, të cilët kanë rezultuar me akt-marrëveshje në momentin e përfitimit të projekteve të nxitjes së punësimit nga Komisioni i Miratimit të Projekteve, sipas konstatimeve të kryera nga grupi i auditimit të KLSH-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të kryejnë verifikimin e vlefshmërisë ligjore për cdo akt-marrëveshje të dorëzuar nga këta subjekte.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet mungesa e gjurmës së auditimit në dosjet e subjekteve përfitues *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to*, konkretisht:

a. Mosparaqitjen me hollësi të cdo elementi në zbatim të rregullores dhe detyrimeve kontraktuale, në proces-verbalin që specialistët e nxitjes së punësimit mbajnë cdo muaj në subjektet përkatës si dhe mungesa e një formati standart të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm në monitorimin dhe ecurinë e projektit. Në dosjet e audituara në disa rajone u konstatua se proces verbalet ishin të ndryshëm në përmbajtje dhe rrjedhimisht mungonte transparencja e veprimeve duke krijuar vështirësi për ne si auditues të jashtëm në nxjerrjen e një konkluzioni të saktë në certifikimin e këtyre praktikave. Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese (struktura që mund të jenë brenda ose jashtë njësisë), si dhe të burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e njësisë pra nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues

b. Raporti i kontrollit edhe pse është *standart* ka shumë element që i mungojnë si:

a) Raporti është i përgjithshëm duke u shprehur vetëm me një fjali tip dhe të njëjtë për të gjithë ecurinë prej afër 11 muaj, të efikasitetit të një programi duke mos dhënë asnjë siguri për punën e kryer nga specialistët e nxitjes së punësimit si dhe efektivitetin e këtyre financimeve. Sikurse është pasqyruar për cdo rast si për subjektet që kanë mangësi në aspektin procedural të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së ashtu edhe për përfitues që nuk janë konstatuar parregullsi, specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit shprehen në të njëjtën mënyrë duke cituar se..... “”Programi është realizuar mjaft mirë dhe ka pasur një ecuri shumë të mirë.

c) Raporti për cdo rast është i firmosur vetëm nga Drejtori Rajonal, shpeshherë mbahet me shkrim dore si dhe mungon emri dhe firma e konceptuesi” veprime në kundërshtim me Rregulloren për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me nr.prot 1789/2, datë 25.06.2018, Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 4, pika 1, 18, si dhe neni 24.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

13.1. Rekomandimi: AKPA (Këshilli Konsultativ për Punësim) të rishikojë formatimin e “Raportit Përfundimtar tip” që mbahet nga specialistët e sektorit të nxitjes së punësimit në Drejtorinë Rajonale apo zyrat vendore të punës, duke krijuar një standart në cilin mos të mungojë gjurma e auditimit e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to. Raportimi të hartohet në kompjuter duke përshkruar qartë dhe në mënyrë të përmbledhur ecurinë e mbarëvajtjes apo jo të projektit të përfutur për nxitjen e punësimit si dhe të ketë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin shoqërues që vërteton punën e kryer nga specialistët përkatës.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit u konstatuan dobësi dhe parregullsi si në kompozimin, ashtu dhe në organizimin e Strukturës së Auditimit të Brendshëm në SHKP. Struktura është aktualisht në nivel sektori dhe sipas organigramës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.111 datë 31.07.2018,, është me tre punonjës dhe pa drejtues në kundërshtim me pikën nr. 22, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe

funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimën e organizimit të brendshëm”, ku përcaktohet se: “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës*”. . Gjthashtu mungesa e pozicionit të përgjegjësit të sektorit pengon procesin e menaxhimit të sektorit, miratimit të planeve dhe programeve të angazhimit si dhe pengon kontrollin e cilësisë, veprime në kundërshtim me Standardet Profesionale të Auditimit të Brendshëm Publik si dhe në shkelje të pikës nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, “*Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7. të Program Auditimit në faqet nr. 192-203 të Raportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit të marrë masa të menjëhershme që në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të propozojnë korigjimin e organikës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të SHKP, të miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr.111 datë 31.07.2018, duke plotësuar organikën e SAB me pozicionin e drejtuesit të njësisë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Për të dy vitet objekt auditimi 2018 dhe 2019, në Planet Strategjike dhe në Planet Vjetore të SAB nuk planifikohet dhe rrjedhimisht nuk auditohet, njësia qendrore ose Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së, megjithëse në nivelin e vlerësimit të riskut kjo njësi parashikohet me risk të lartë.

Moskryerja e auditimit të brendshëm të njësisë qendrore e cila është boshti kryesor për mbarëvajtjen dhe përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të njësive të tjera në varësi është në kundërshtim me nenin 6 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 114/2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin public” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7. të Program Auditimit në faqet nr. 192-203 të Raportit të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

15.1. Rekomandimi: Sektori i Aditimit të Brendshëm pranë SHKP të marrë masa që në Planet Strategjike dhe në Planet Vjetore të planifikojë si subjekt auditimi Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së, duke u bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.

Në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për të dy vitet objekt auditimi ka shmangie të angazhimeve të auditimit nga planifikimi. Nga SAB nuk është marrë mendimi i Komitetit të Auditimit, për ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm me një ndryshim rrënjësor nga planet fillestare dhe me ulje të subjekteve objekt auditimi. duke sjellë një inefiçencë të këtij sektori, mos përmbushjen e Planit të angazhimeve si dhe të Planifikimit të buxhetit dhe shpërndarjes së burimeve të NjAB. veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 9. Manuali i AB pika, 3.5 Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm dhe Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7. të Program Auditimit në faqet nr. 192-203 të Raportit të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Sektori i Auditimit të Brendshëm pranë SHKP-së të marrë masa që në vashdimësi Planifikim Vjetor ta formulojë duke u mbështetur në analizën e riskut si dhe të burimet reale që ka në strukturë ky sektor.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Raportit Final të Auditimit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë nr.1169/5, datë 09.07.2018 u konstatua se nga SAB pranë SHKP-së është lënë një rekomandim në lidhje me emërimin në detyrë të Znj.x ne postin e Pergjegjeses se Sektorit te Nxitjes se Punesimit, Programeve për të Rinjtë dhe Formimit në Punë ku thuhet se.....: *‘Nga SHKP te behet zevendësimi dhe plotësimi i postit te Përgjegjësit te Sektorit të Nxitjes se Punësimit Programeve për të Rinjtë dhe Formimit ne Pune te DRP Tirane, me punonjes qe zoterojne arsimin perkates, diplome e integruar e nivelit te dyte DN“ si dhe “Pasi te analizohet nga menaxhimi i larte i DRP, SHKP-se dhe sektori juridik, si dhe te percaktohet konkretisht pergjegjësia per demin ekonomik shkaktuar buxhetit te shtetit ne sektorin e nxitjes per shumen 171.914 leke, te nise menjehere puna per kthimin mbrapsht dhe arketimin e tyre ne buxhetin e shtetit“.* Grupi i punës i ngritur për ndjekjen e rekomandimeve në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë ka ngarkuar me përgjegjësi për kthimin e shumës të konstatuar si dëm ekonomik Znj.x. *Nga sektori i AB është bërë auditimi i zbatimit të rekomandimeve dhe nuk ka evidentuar se ngarkimi i znj. Tusha me përgjegjësi është në kundërshtim të ligjit nr.7961,datë 12.07.1995, i ndryshuar neni 27 “Përgjegjësia e Punëmarrësit, pika 1 ku citohet se....”Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale”, ku në këtë rast nuk kemi shkelje të kushteve të kontratës nga punëmarrësi, Vendimit nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit” i ndryshuar, Neni 16 citon se.....”Drejtori i pergjithshem ka kompetenca për të emëruar personel të niveleve të tjera të SHKP-së.” si dhe të Manualit të Menahimit Financiar me urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016, në kopmponetin e MFK-së ”Mjedisi i kontrollit”. Gjithashtu u konstatua se marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve nga njesia nuk janë marrë brenda afatit kohor **(brenda 30 ditëve)** nga dorëzimi i raportit përfundimtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7. të Program Auditimit në faqet nr. 192-203 të Raportit të Auditimit).**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

17.1. Rekomandimi: Sektori i auditimit të SHKP-së në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e personave përgjegjës, të cilët kanë shkaktuar realisht dëmin ekonomik.

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve me objekt dieta e udhëtime të brendshme u konstatua se për 23 raste në shumën 557,000 lekë për vitin 2018 dhe 20 raste në shumën 726,000 lekë për vitin 2019, këto shpenzime ishin të pajustificuara. Dokumentacioni shoqërues nuk përmban elementët bazë për vërtetësinë e shërbimeve të kryera si: nënshkrimet e çdo punonjësi që ka kryer shërbimin, përfshirjen në një faturë tatimore mbi një person dhe në raste të përsëritura deri në 13 persona. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me: pikën 36 të UMF nr.11 datë.27.12.2011, pikën 3 të Nenit 12 të Ligjit 10296 datë.08.07.2010, dhe VKM 997 dt.10.12.2010 pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3. të Program Auditimit në faqet nr. 50-88 të Raportit të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Sektori i Finances në SHKP të marrë masat që në çdo praktikë urdhër-pagesa për shërbime dieta, fatura tatimore të jetë individuale për çdo punonjës dhe të firmosur nga personi përfitues e gjithë praktika shoqëruese.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Rikonstruksioni i DRSHKP Shkodër*”, konstatohet s’kualifikim i padrejtë i OE “x” shpk, i cili ka patur kapacitete të plota ekonomike dhe teknike, ku duhej të kualifikohej për realizimin e kontratës, e cila ka patur çmimin më të ulët në zbatim të nenit 55 të LPP “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” pika 1/b, ku citohet se oferta fituese duhet të jetë, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese. Neni 53 pika 4 citon se Ak vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT. Arsyeja e s’kualifikimit pasi nuk plotësonte 1 murator me IQT, nga operatori ekonomik nuk do të cënonte objektin e prokurimit pasi rinovimi i certifikimit është thjesht marëdhënie e OE me kompaninë certifikuese, jo se specialistët nuk e realizojnë punën e tyre, të kryer edhe më parë, përbën s’kualifikim diskriminues. Kontrahetohet se OE “x”, ka mjaftueshëm punë të ngjashme me nxhinierë ndërtimi, ku puna sipas preventivit me 35 m³ “*Mur me tullë të lehtësuara dopio deri 3m me llaç përzier M25*”, do të realizohej lehtësisht.

Në lidhje me pretendimin e KVO, se mungon deklarata mbi tokëzimin dhe nulifikimin e pajisjeve elektrike, sqarohet se ky OE ka paraqitur deklaratën që do u përmbahet specifikimeve teknike dhe projektit, pjesë e së cilës është dhe tokëzimi dhe nulifikimi i pajisjeve elektrike. Po ashtu OE ka paraqitur edhe një plan organizimi të punës, ku përfshihen në brendësi se ky proces pune do kryhet nga ana tyre. Ofertat më e leverdishme e “x” shpk me vlerë 6,901,741 Lekë pa TVSH, kanë qenë më efikase për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, në përputhje me parimet e economicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët dhe Ligjit Prokurimit Publik neni 53, 55. Pra nëse autoriteti kontraktor do të kishte vlerësuar bazuar çmimit më të ulët dhe Ligjit të Prokurimit Publik, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët. Diferenca e vlerës prej



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

1,396,030 lekë me TVSH (8,065,100 lekë - 6,901,741 lekë = 1,163,359 lekë x 20%), midis ofertës së “x” sh.p.k dhe ofertën fituese të “x. shpk, përbën dëm ekonomik, të shkaktuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me Urdhërin nr.1488/1 datë 22.05.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4. të Program Auditimit ë faqet nr. 88-128 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa që të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën **1,396,030 lekë**.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x” person fizik, me nipt...., me aktivitet Tavernë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 448 datë 12.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, për 1 punonjës ku DRP/ZVP financon punëdhënësin në lidhje me secilin punëmarrës me rrogë të barabartë me pagën minimale për muajin 1 deri në të 12 (paga 24,000 lekë), dhe për gjashtë muajt e dytë të punësimit do të financojë me 50% të pagës minimale në masën 12,000 lekë, në vlerën 277,795 lekë. Në dosjen e nxitjes së subjektit përveç dokumenteve të tjerë rezultuan se ishin të depozituara:

a) Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot.T00467176, datë 01.08.2018, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018 është 7 punonjës. Në dosje mungon vërtetimi tip mbi shumën e detyrimeve të të gjithë llojeve të tatimeve, një nga dokumentet kryesorë që duhet të ishte paraqitur nga subjekti. Ky tatimpagues ka lidhur akt marrëveshje me DRT Gjirokastër me nr. prot.132, datë 09.01.2018, sipas të cilës ka detyrime dhe gjoba:në vlerën 185,539 lekë dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj është 17,276 lekë deri në fund të vitit 2018. Mosekzistenca e vërtetimit për shumën totale të detyrimeve në datën 01.08.2018 është mungesë transparence si e tatimpaguesit, por edhe e Drejtorisë Rajonale të Punës në Gjirokastër, e cila ka pranuar këtë fakt duke lënë hapsira për dyshime dhe për mosnjohje të ecurisë së pagesës që ky tatimpagues ka pasur gjatë vitit 2018.

Në lidhje me sa më sipër DRT Gjirokastër me shkresën me nr.prot.5059/1, datë 20.08.2018 informon se subjekti ka detyrime në sistemin tatimor në vlerë 206,419 lekë dhe nuk përmend asnjë element, ku të tregojë nëse ky tatimpagues ka respektuar aktmarrëveshjen e lidhur në datën 09.01.2018 e për rrjedhojë, vlera e detyrimeve duhet të ishte ulur pasi kanë kaluar 8 muaj nga lidhja e kësaj aktmarrëveshje. Nisur nga sa më sipër si dhe sipas Ligjit 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore ne RSH”,

Administrata tatimore ka lidhur akt-marrëveshje në kundërshtim me nenin 77, pika 7. Në rastin konkret akt marrëveshja është lidhur pikërisht për detyrim tatimor mbi tatim të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi si dhe për detyrime nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Gjithashtu në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrën e Punës Gjirokastër, në datë 12.09.2018, subjekti rezulton me detyrime dhe me akt-marrëveshje të pavlefshme juridikisht.

Pra nga sa më sipër është vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar”, ku Komisioni i Miratimit të projekteve nuk duhet të kishte miratuar lidhjen e kontratës me këtë subjekt pasi subjekti rezulton me detyrime dhe nuk ekziston asnjë dokument, urdhërpaguese apo konfirmim periodik mujor që të vërtetojë që subjekti ka respektuar kushtet e kontratës duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar. Për sa më sipër, me veprimet dhe mosveprimet SHKP i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 277,795 lekë. (Më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa e të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 277,795 lekë, nga subjekti “x” person fizik, me nipt x.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x” sh.p.k, me nipt...., me aktivitet “Shërbime telefonike”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot. 415, datë 12.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë nga grupet e veçanta“ për 37 punonjës me kohë zgjatje për I vit. Njëkohësisht subjekti ka përfitur edhe sipas VKM nr.248 datë 09.07.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave më aftësi të kufizuar” për I punonjës.

Vlera e financimit e planifikuar për këtë subjekt, për të dy projektet ka qenë përkatësisht 5,532,216 lekë (VKM 48), dhe 206,094 lekë (VKM 248) dhe vlera e realizuar nga këto dy projekte ka qenë 1,674,117 lekë (sipas VKM 48) dhe 88,692 lekë (sipas VKM 248), pasi sikurse do të trajtohet në vijim projekti është ndërprerë në mars të vitit 2019. Raporti i kontrollit përfundimtar me nr.prot.569, datë 27.12.2019 konfirmon joefektivitetin e këtij projekti i cili është ndërprerë në mars 2019, pasi subjekti nuk ka dorëzuar pagesat për cdo muaj të likuidimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore mbështetur në:

-Shkresën e DRT Shkodër me nr.prot.6330/1, datë 04.07.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime tatimore në vlerën 2,739,148 lekë.

-vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00456577, datë 27.07.2018, i cili gjithashtu është me detyrime në vlerën 1,129,132 lekë.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Shkodër me nr.prot.3546/1, datë 18.04.2018, sipas së cilës kësti mujor për tu paguar është 208,223 lekë për një periudhë 20-mujore duke filluar nga maj 2018 deri në dhjetor 2019.

Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës për periudhën shtator 2018- dhjetor 2018 si dhe janar- mars 2019. Subjekti që në muajt e parë të zbatimit të projektit nuk ka qenë korrekt pasi nuk ka dorëzuar në menyrë periodike, brenda datës 20 të cdo muaji listëpagesën, urdhërpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, urdhërpagesën e kështit mujor për akt-marrëveshjen etj, sipas nenit 12, të Rregullores së brendshme të miratuar me Vendim të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.1, datë 15.06.2018, si dhe kontratës së lidhur me DRSHKP Shkodër, me nr.prot.415, datë 12.09.2018, e cila ka fuqi ligjore.

Konstatohet se në asnjë rast nuk ka një korrespondencë shkresore ndërmjet DRSHKP Shkodër apo SHKP/Drejtori e Përgjithshme me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën mars – shtator 2019 për të cilën subjekti nuk iu është përgjigjur detyrimeve kontraktuale, duke mos zbatuar detyrat funksionale dhe detyrimet kontraktuale në ecurinë e këtyre dy projekteve të përfituara nga ky subjekt dhe duke bërë një raport përfundimtar mbi “*efektivitetin*” e ecurisë së projekteve të nxitjes së punësimit, *me vonesë në dhjetor të vitit 2019*.

Sipas rregullores, Zyra përkatëse e Punësimit dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit brenda dates 10 të muajit pasardhës *Tabelën e Ecurisë së Projekteve* me fond të konfirmuar nga punonjësi i financës sipas situacionit buxhetor. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit nuk ka masa administrative të ndërmarra në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga subjekti përgjatë vitit 2019, për fillimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

procedurave për **dëmshpërblimin e vlerës 1,762,809 lekë** të përfituar nga subjekti për periudhën shtator-mars 2019. Nga administrata e SHKP-së është vepruar në kundërshtim me nenin 9 të kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018 “Zgjidhja e Kontratës” Vlera e përfituar padrejtësisht nga subjekti prej **1,762,809 lekë** konsiderohet dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të kishin filluar menjëherë procedurat për dëmshpërblimin e kësaj vlere. Gjithashtu e gjithë vlera totale e përfituar nga ky subjekt prej 5,532,216 lekë sipas Kontratës me nr.prot.415, datë 12.09.2018, firmosur nga Drejtori i DRSHKP Shkodër konsiderohen të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, pasi janë përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të marrë masa e të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 1,762,809 lekë nga subjekti “x” sh.p.k, me nipt-x.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas raportimit periodik në MFE për detyrimet e prapambetura të SHKP-së, deri në datë 31.12.2019, nga SHKP u paraqit shkresa me prot 2191/1, datë 11.07.2019 me lëndë “Mbi Raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura”. Në këtë shkresë sektori i buxhetit në SHKP vë në dijeni MFE për detyrimet që SHKP ka ndaj furnitorit “x” lidhur me kontratën për ndërtimin e Qendrës së Formimit Profesional (QFP) –Berat. Sipas kësaj shkrese SHKP ka detyrime të pashlyera ndaj “x”shpk, në vlerën prej **67,211,269 lekë**. Nisur nga vlera e madhe e detyrimit ku SHKP është debitor dhe nga shpjegimi shumë sipërfaqësor nga sektori i financës, u paraqit domosdoshmëria e auditimit në një periudhë relativisht të gjatë që daton me datën e lidhjes së kontratës për ndërtimin e QFP Berat, datë 07.12.2006. Si rrjedhim u kërkua informacion për dosjen e prokurimit për këtë objekt si dhe arsyet e krijimit të këtij detyrimi të pashlyer ende. Kontrata nr. 3742/1, datë 07.12.2016 midis MMSR, i autorizuari SHKP dhe “x” shpk me objekt “Ndërtim i ri i DFP, Berat. Zbatimi i punimeve ka patur probleme me truallin, gjë që ka sjellë mosmarrjen e lejes së ndërtimit megjithëse është aplikuar dy herë nga ana e projektuesit dhe si rezultat kemi pezullimin e punimeve nga Bashkia Berat. Për këtë fakt, mospajjsja me leje zhvillimore dhe ndërtimore, ku kanë qenë në dijeni institucionet shtetërore, tregon një papërgjegjshmëri nga MMSR, por edhe nga i autorizuari në rastin konkret SHKP për zbatimin e kontratës, duke vazhduar një korrespondencë shkresore të gjatë veprim konkret. Bashkia Berat me shkresën nr.6081/6 datë 20.12.2018 ka dhënë lejen e ndërtimit për zhvilluesin SHKP, në të cilën lejon ndërtimin e objektit QFP Berat. MMSR dhe SHKP nuk kanë siguruar lejen zhvillimore dhe të ndërtimit para nënshkrimit të kontratës dhe para dorëzimit të sheshit të ndërtimit, veprime të cilat kanë sjellë pasoja me efekte negative financiare si për subjektin ashtu edhe për buxhetin e shtetit. Ndërkohë, në vitin 2016 është realizuar likuidimi pjesor I situacionit nr.1 në shumën 11,844,004 lekë. Në vitin 2017, fondi i çelur për këtë objekt ka qenë vetën 18 mln lekë më të cilin është likuiduar pjesërisht situacioni nr.ëNë vitin 2018 është është parashikuar në PBA, fondi për likuidim të këtij objekti, por si pasojë e procedurës tekniko-ligjore për pajisjen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi, nuk është kryer asnjë likuidim situacionesh të përfunduara. Është paguar 3,043,194 lekë dhe subjekti është pajisur me leje ndërtimi. Me Akt Normativ/2 është kryer pakësimi i fondit të planifikuar për këtë objekt prej 65 mln lekë, dhe si përfundim detyrimi ndaj furnitorit është 96,097,617 - 29,844,004 = **66,253,613 lekë** dhe detyrimi ndaj mbikqyrësit është **958,800 lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

Më datë 18.04.2017, dërgohet në SHKP, relacioni dhe projekt-preventivi për punime shtesë, për zgjidhjet teknike të projektit. Mbikëqyrësi në bashkëpunim me projektuesin, kanë hartuar tabelën e levizjeve të punimeve nga librezat e masave mbi llogaritjet faktite të veprës. Në bashkëpunim me studion projektuese, përveç projektit konstruktiv të themeleve të hartuar nga shoqëria “x”, që në muajin janar 2017 është dhënë zgjidhje konstruktive e planit të themeleve, u hartuan dhe projektet përkatëse për punimet shtesë për sistemin e ambienteve të jashtme, mbledhjen e ujrave të bardha, punimet hidrosanitare dhe elektrike. Kryerja e punimeve të mesipërme bën që objekti të jetë me parametra teknik të nevojshëm dhe funksionalë. Për volumet e këtyre punimeve u hartua preventivi për punimet shtesë, që arrin vlerën prej **19,032,382 lekë me tvsh**, të cilat kërkojnë burime financimi shtesë për funksionimin normal të objekti. Pra, AK nuk ka shlyer në vazhdimësi operatorin ekonomik edhe pse nga MFE është çelur fondi për likuidimin e punimeve të kryera, veprim që është në kundërshtim me Kontratën e punimeve me nr. Prot. 3742/1 dt 07.12.2016, *Neni 29.5*, kushtet e pagesës, sipas *nenit 30*: Vonesa në bërjen e pagesës dhe në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare" Neni 5: “Llogaritja e Kamatëvonesës”. Mosmarrja në dorëzim e objektit, moslikuidimi dhe mosngritja e grupit të marrjes në dorëzim apo përpjekjes nga Institucioni për të arritur përfundimin e këtij objekti, trajtohet edhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në *Neni 87*ë Shërbimin Kombëtar të Punësimit nuk ka marrë masa për shlyerjen e detyrimeve dhe finalizimin e këtij objekti me rëndësi për zbatimin e politikave shtetërore në fushën e tregut të punës. E njëjta situatë vlen edhe për kontratën e mbikëqyrjes nr. 3742/3 Prot datë 13.12.2016 për shërbimin e mbikëqyrjes. Ky institucion në bashkëpunim me MMSR, ka çuar në ineficencën e një objekti të papërfunduar dhe të pavendosur në funksion të objektivit kryesor që SHKP ka si qendër formimi profesional, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej **29,844,004 lekë** (vlera e paguar e dy situacioneve, pa llogaritur edhe amortizimin e veprës e cila nuk është vënë në funksion). (Më hollësisht trajtuar në pikën 4. të Program Auditimit në faqet nr. 88-128 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me MFE të marrin masa me mbikëqyrësin e punimeve, të azhurnojnë gjendjen aktuale të objektit (pasi është i braktisur prej më shumë se 2 vitesh), duke rakorduar zërat e punimeve, volumet e cdo zëri punimi dhe cdo specifikim tjetër që nevojitet për përfundimin e investimit.

4.2.Rekomandimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me MFE, të marrë masa të menjëhershme që të planifikojë buxhetin për shlyerjen e situacioneve të kontratës së punimeve dhe atë të mbikëqyrjes, si dhe të sigurojë fonde shtesë për shtesën e kontratës në vlerën 19,032,382 lekë për përfundimin sa më shpejt të veprës, me parametra teknik të nevojshëm dhe funksional. Mosmarrja e masave nga SHKP dhe MFE për moskollaudimin e objektit, sjell që shuma prej **29,844,004 lekë** të përbëjë dëm ekonomik të parikuperueshëm ndaj buxhetit të shtetit, pa përfshirë këtu dëmet ekonomike që i janë shkaktuar operatorit ekonomik, i cili i është dashur të paguajë detyrimet tatimore për situacionet e deklaruara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 sipas VKM-së nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, janë miratuar 94



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

projekte në vlerën prej 108,364,387 lekë, nga të cilat *subvencion në vlerën prej 73,515,806 lekë*. Pra vetëm subvencion është 68 % e vlerës totale të projektit.

- **Gjatë vitit 2019** për projektet sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, nuk ka asnjë miratim por janë të mbartura prej vitit 2018, **87 projekte** në vlerën prej 98,225,273 lekë, nga këto *subvencion në vlerën prej 61,194,539 lekë* ose thënë ndryshe 62 % e vlerës totale të projektit.

Megjithëse nga grupi i auditimit të KLSH-së në auditimin e mëparshëm është konstatuar ky fenomen ku shuma e subvencionit zë peshën specifike të vlerës totale të projektit është lënë rekomandimi që *:SHKP të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfutimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19,000 lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit*, nga grupi I auditimit u konstatua se **nuk ka** ndryshim në legjislacion edhe për periudhën në vazhdim duke sjellë në këtë mënyrë përsëri një vlerë në total për dy vitet në auditim prej **134,710,345 lekë** kosto e pajustificuar nga asnjë subjekt përfitues pasi edhe në dosjet e projekteve të përfituara, që u verifikuan nga grupi I auditimit të KLSH-së, në drejtoritë/zyrat rajonale, faturat e blerjes me tvsh që subjektet paraqesin janë blerje në funksion të aktivitetit që ata kryejnë dhe nuk ka në to asnjë indikator matje që këto blerje janë kryer për kostot e trajnimit të pu.pa sikurse është dashur të konsiderohen. Këto subjekte e kreditojnë TVSH-në e blerjeve duke bërë rimbursimin e TVSH-së në shitje të deklaruar në sistemin tatimor, dhe nga ana tjetër për të njëjtat fatura blerjeje të tvsh-së marrin subvencion në vlerë 19,000 lekë për secilin punëkërkuar të papunë të përfshirë në listëpagesën e sigurimeve, nga Buxheti i Shtetit. Nga sa më sipër, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP, mungesa e gjurmës së auditimit në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes i pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në rastin konkret të vlerës prej *134,710,345 lekë* pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: SHKP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si ministria përgjegjëse për nxitjen e punësimit dhe që ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për fushën e përgjegjësisë shtetërore, të marrin masa të menjëhershme në përmirësim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, ku të gjejë rregullim fakti që, kostot e subvencioneve shtetërore për blerjen e lëndës së parë të cilat subjekti privat përfitues do t’ia ofrojë punëkërkuarëve, gjatë praktikave trajnuese, duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, transparente dhe të specifikuara, sipas elementeve përbërës të saj.

1.2. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të subvencionit prej **134,710,345 lekë** nga fondet e buxhetit të shtetit pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se subjekti x, shpk me nipt ..., me aktivitet në fushën e ndërtimit- në vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 944/3 datë 30.08.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” të ndryshuar, **për 83 punonjës** me kohë zgjatje prej 5.8 muaj, një vlerë financimi prej 15,108,357 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 83 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **9,146,600 lekë** ose 61 % e vlerës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 01.09.2018. deri në 20.03.2019. Nga verifikimi i dosjes gjatë periudhës së formim /trajnitimit prej 5,8 muaj u konstatua se subjekti ka kryer një largim masiv të punonjësve për periudhën korrik-gusht të vitit 2018, pasi nga numri i punonjësve 116 që kishte para fillimit të projektit normalisht numri i punonjësve në shtator duhet të varionte në: $116+83$ (VKM nr.47)= 199 punonjës, por nga verifikimi i listëpagesës në shtator 2018 subjekti ka 132 punonjës të përfshirë ku nga këta 83 punonjës janë nga skema e pu.pa sipas VKM nr.47, pra subjekti ka bërë largim të punonjësve rreth **67 nga punonjësit ekzistentë**.

Ky largim *i pajustificueshëm* tregon për një tatimpagues që paraqet risk dhe për këtë DRSHKP e Tiranës duhet menjëherë të njoftonte DRT Tiranë dhe të bashkëpunonte me sektorin e zbatimit në DRT për një monitorim të subjektit dhe të punonjësve të larguar nga ky subjekt me qëllim sigurimin dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve që ky tatimpagues do të përfitonte në vijimësi nga buxheti i shtetit për këtë projekt. Kjo është *e papranueshme* dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi ky tatimpagues me largime masive të punonjësve brenda një muaji në periudhën që është duke përfituar projekte të nxitjes së punësimit, mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore si dhe nuk paraqet besueshmëri për plotësimin e objektivit kryesor që këto projekte kanë **:Rritjen e numrit të fuqisë punëtore**. Pra pavarësisht treguesve të tjerë në dosje ky element është bazë për të vërtetuar efikasitetin e një projekti në kuadër të nxitjes së punëmarrësve. Si rrjedhim fondi prej 15,108,357 lekë është përdorur **pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet**

2-Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt-....., me aktivitet Rrobaqepësi-fason, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 280/45 datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008, për 13 punonjës me kohë zgjatje prej 6 muaj, dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 2,260,219 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 13 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **1,235,000 lekë**, pra rreth 54 % e vlerës totale të financimit. Në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj, të cilat ishin në funksion të aktivitetit, por nuk ka asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën prej **1,235,000 lekë**, e përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. Ajo që konstatohet në vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është se subjekti ka një lëvizje të madhe të numrit të punonjësve sidomos në muajt maj –qershor të vitit 2018, **dhe konkretisht në muajin maj ka pasur të siguruar 71 punonjës dhe në muajin qershor ka larguar nga skema një numër prej 61 punonjësish**. Kjo është e papranueshme dhe tregon një subject me risk të lartë si për Drejtorinë Tatimore ashtu edhe për Zyrën e Punës, pasi është ky tatimpagues në cdo moment mund të shfaqë aftësi të ulëta likuidimi të detyrimeve tatimore dhe njëkohësisht nuk duhet të ishte përfitues i projektit të nxitjes së punëmarrësve pasi ky projekt konsiston në rritje të fuqisë punëtore dhe jo në ulje të saj. Nga ana tjetër subjekti në planin e biznesit të paraqitur shprehet se ka shumë nevojë për rritje të fuqisë punëtore, rritje të qarkullimit total të eksporteve e rrjedhimisht edhe të fitimit që do të realizojë duke dhënë “garanci”, që punonjësit që do të punësojë sipas këtij projekti do të jenë në vazhdimësi të siguruar e të punësuar. Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit subjekti nuk rezulton të ketë qenë i suksesshëm. Në verifikimin e listëpagesave të deklaruara on –line gjatë periudhës mars –shtator 2019, ky subjekt ka të punësuar përkatësisht: Mars- 22 punonjës, prill-8 punonjës, maj-8 punonjës, qershor-8 punonjës, korrik; gusht; shtator **vetëm 2 punonjës**. Pra subjekti nuk ka qenë efektiv dhe sikurse konstatohet nuk ka mbajtur as për periudhën 6-mujore numrin 50% të punonjësve të miratuar për t’i siguruar në listëpagesë. Ndërkohë specialistët shprehen në raportin përfundimtar që programi ka qenë efektiv ashtu sikurse shprehen për të gjithë subjektet! Pra subjekti nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe ky projekt nuk i ka shërbyer qëllimit që ka :



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Nxitjen dhe rritjen e numrit të fuqisë punëtore në subjektet përfitues. Si rrjedhim fondi prej 2,260,219 lekë është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **15,108,357 lekë** e për subjektin x me nipt ..., të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **2,260,219 lekë**, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt..., me aktivitet “Përpunim i ullirit, import-export, dhe adresë kryesore të zhvillimit të aktivitetit në Jorgucat-Gjirokastër, si dhe nipt sekondar Delvinë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 453, datë 12.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.48 datë 16.01.2008,” Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta“ për 44 punonjës me kohë zgjatje për 1 vit. Përveç dokumenteve të tjerë në dosje është vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me **nr.prot.345, datë 17.08.2018**, sipas të cilit subjekti ka detyrime në vlerën **502,557 lekë** në Tatim Fitimi dhe ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Gjirokastër me nr.prot. 4674, datë 23.07.2018. Sipas akt marrëveshjes subjekti ka kryer pagesën prej 101,500 lekë në datë 23.07.2018 dhe për pjesën e mbetur prej 406,971 lekë, pagesa do të kryhet në dy këste përkatësisht:

v) Kësti I –vlera 203,500 lekë, datë 23.09.2018

vi) Kësti II-vlera 203,741 lekë, datë 23.12.2018.

-Vërtetimi i kompanisë për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me **nr.prot.T00467292, datë 01.08.2018**, në të cilin subjekti nuk rezulton me detyrime. Numri mesatar i punonjësve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është 160 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar cdo muaj pranë Zyrës së Punës Gjirokastër, si dhe procesit të monitorimit të kryer nga specialistët përkatës rezultoi se listëpagesat, listëprezencat si dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë kryer brenda datës 20 të cdo muaji. Në dosjen e përfituesit nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë ku subjekti të konfirmojë që ka qenë konform ligjit në kryerjen e pagesave të detyrimeve që ka sipas akt-marrëveshjes (të cituara më sipër).

Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi zyrën e Punës Gjirokastër/sectorin e nxitjes së punësimit për moskryerjen e monitorimit, sectorin e nxitjes së punësimit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe Komisionin e miratimit të Projekteve për subjektet që kanë pasur detyrime në momentin e lidhjes së kontratës me Zyrat e Punës.

Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme duhet të kryejnë një monitorim periodik të hollësishtë si dhe të kontaktojnë shkresërisht me Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse për të ndjekur ecurinë e pagesave për detyrimet e prapambetura, veprime këto të pakryera në asnjë rast për subjektet me detyrime dhe përfitues të projekteve të nxitjes së punësimit. Si rrjedhim vlera prej **6,820,896 lekë** nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **6,820,896 lekë** për subjektin “x”sh.p.k, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt...., me aktivitet “Ndërtim”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 421, datë 03.09.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 20 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj; me një vlerë financimi **3,736,960 lekë** dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 20 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me 2,204,000 lekë ose 59 % e vlerës totale të financuar. Kohëzgjatja e projektit është nga 03.09.2018 deri në 24.02.2019.

-vërtetimi i gjendjes së detyrimeve në kohë reale me nr.prot.398, datë **25.07.2018** marrë nga DRT Kukës, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën **659,283 lekë** në tatim fitimi dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. 399, datë 25.07.2018.

Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Kukës me nr.prot.1333, datë **05.04.2018**. Sipas akt marrëveshjes subjekti ka një shumë detyrimesh të mbetur për të paguar në vlerën **607,513 lekë** për një periudhë 20 mujore pra më shumë se 1 vit , sipas planit të pagesës me këste mujorë në vlerën 30,375 lekë .

Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 30,375 lekë, sipas akt-marrëveshjes.

Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to* si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip FëMungojnë urdhërpagesat me vulën e bankës të cilët konfirmojnë derdhjen e detyrimeve mujore në sistemin tatimor. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Mungon Raporti i kontrollit përfundimtar i cili konfirmon efektivitetin e këtij projekti dhe konkretisht në verifikimin e punësimit të 50% të pu.pa, për një periudhë 6-mujore ku në rastin konkret subjekti duhet të ketë të punësuar një numër prej 10 persona.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin “, si dhe manualin për MFK-në. Si rrjedhim vlera prej **3,736,960 lekë** nga Buxheti i Shtetit, e përfitur nga subjekti “x”sh.p.k me nipt...., është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **3,736,960 lekë** për subjektin “x”sh.p.k me nipt..., pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjekti/përfitues “x”, me nipt-....., me aktivitet “Fast-Food, Piceri e bar-kafe”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 71, datë 30.08.2018, ka përfitur sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 2 punonjës me kohë zgjatje për 5 muaj me një vlerë financimi **312,732 lekë** dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 2 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **190,000 lekë** ose 61 % e vlerës totale të financuar. Gjithashtu subjekti ka përfituar edhe një projekt të dytë sipas VKM nr.248, datë 09.07.2014, ”Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 70, datë 30.08.2018, për 1 punonjës me vlerë financimi **276,768 lekë**.

Në dosje është vërtetimi i detyrimeve në kohë reale me nr.prot.362, datë **31.07.2018** marrë nga DRT Dibër, sipas të cilit subjekti kishte detyrime në vlerën **154,309 lekë** të pacilësuar së në cfarë lloj tatimi duke vepruar në kundërshtim më vërtetimet tip të aprovuara nga DPT .

-vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me nr.prot. T00476838, datë 06.08.2018, i cili gjithashtu është me detyrime , gjoba dhe kamatëvonesa në vlerën 102,777 lekë.Për detyrimet e mësipërme subjekti ka lidhur akt-marrëveshje me DRT Dibër me nr.prot.2940, datë **31.07.2018**, sipas të cilës detyrime dhe gjoba në total në vlerën **207,985 lekë** dhe kësti mujor që duhet të paguajë cdo muaj sipas akt-marrëveshjes është **20,000 lekë** deri në fund të vitit 2018 i përllogaritur nga Drejtoria e Mbledhjes në DRT Dibër.

Gjithashtu respektimi i akt-marrëveshjes nëpërmjet kryerjes së pagesave nga subjekti sipas grafikut të përcaktuar nga DRT është dokumenti bazë i cili duhet të ndihmojë dhe të jetë objekt-monitorimi i SHKP-së, për të ndjekur ecurinë e pagesave dhe respektimin e afatit në derdhjen e tyre të këtij tatimpaguesi i cili është përfitues i dy projekteve me një vlerë financimi nga buxheti i shtetit, në total prej 589,500 lekë. Por SHKP ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.47 Si dhe në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores rregullore së brendshme e cila është miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017. Nuk ka asnjë dokument apo urdhërpagesë për pagesën e detyrimeve mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të cdo muaji si dhe pagesës së detyrimit mujor prej 20,000 lekë , sipas akt-marrëveshjes.

Në dosje gjenden listëpagesat, procesverbalet e mbajtur nga specialistët përkatës të cilët nuk kanë asnjë element të gjurmës së auditimit *e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to* si dhe në bazë të së cilës ne si auditues të jashtëm të përcaktojmë nëse janë respektuar kushtet e kontratës në lidhje me punonjësit e miratuar sipas formularit tip Fë

Për sa më sipër Komisioni i miratimit të Projekteve e Drejtori i Përgjithshëm nuk duhet të kishin miratuar dhënien e këtyre projekteve subjektit i cili ka detyrime në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ku për asnjë rast nuk ka të konfirmuar pagesat mujore kusht ky i detyrueshëm për t’u ndjekur nga kjo administratë dhe për të qenë pjesë e dosjes si gjurmë auditimi. Si përfundim fondi prej **589,500 lekë** i buxhetit të shtetit është përdorur pa efektivitet, ekonomikitet e eficientë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 129-191 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **589,500 lekë** për subjektin “x”sh.p.k, me nipt...., pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Subjekti/përfitues “x”sh.p.k, me nipt...., me aktivitet “Projekt dhe zbatim i veprave ndërtimore”, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot.126/1, datë 11.09.2018, ka përfituar sipas VKM nr.47 datë 16.01.2008 “Për programin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” për 7 punonjës me kohë zgjatje për 5,8 muaj me një vlerë financimi **1,231,947 lekë** dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 7 persona x 5,8 muaj) e barasvlefshme me **771,400 lekë** ose 63 % e vlerës totale të financuar. Në dosje ***mungon vërtetimi tip*** për situatën e detyrimeve në kohë reale që marret nga sistemi tatimor, i cili konfirmon gjendjen e detyrimeve në të gjitha llojet e tatimeve, dokument ky i detyrueshëm për t’u paraqitur në dosje dhe për t’u verifikuar më pas nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP për miratimin ose jo të kërkesës së subjektit për të qenë përfitues.

Gjithashtu në dosjë është akt-marrëveshja e lidhur nga DRT Shkodër me nr.prot.(e korigjuar), 4426/1, datë 14.05.2018, e cila konfirmon që subjekti ka detyrime në vlerë **1,419,192 lekë**, të cilat duhet t’i shlyejë në mënyrë periodike mujore me një kësht të përcaktuar prej 60,484 lekë deri në dhjetor të vitit 2019.

Në asnjë muaj edhe për më tepër në muajin shtator (dt 11.09.2018) që është kryer miratimi i kontratës për këtë subject nga Komisioni i Miratimit të Projekteve në SHKP dhe Drejtori i Përgjithshëm nuk ka asnjë urdhërpagesë që të konfirmojë rregullsinë e këtij tatimpaguesi në derdhjen e detyrimeve, veprim që nuk e ka “*penguar*” SHKP të kryejë **miratimin duke** i dhënë fonde padrejtësisht nga Buxheti i Shtetit në vlerën **1,231,947 lekë, një subjekti debitor**. Si rrjedhim vlera prej **1,231,947 lekë** nga Buxheti i Shtetit, konsiderohen të ardhura të munguara të përfituara padrejtësisht nga subjekti “**x**”sh.p.k, dhe të miratuara në kundërshtim me bazën ligjore të cituar më sipër nga SHKP, duke sjellë përdorimin e tyre pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë. .

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 121-191 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **1,231,947 lekë** për subjektin “**x**”sh.p.k, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Subjekti/përfitues “**x**” sh.p.k, me nipt, me aktivitet Fasoneri e adresë Cermë –Divjakë, për vitin buxhetor 2018, në bazë të Kontratës Tip me nr.prot 157/95 datë 06.09.2018 ka përfituar sipas **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”, për 10 punonjës me kohë zgjatje prej 5 muaj dhe me një vlerë financimi të konfirmuar prej 1,724,050 lekë dhe vlerë subvencioni prej (19,000 lekë/muaj x 10 persona x 5 muaj) e barasvlefshme me **950,000 lekë**, pra rreth 55 % e vlerës totale të financimit. Në dosje gjendeshin fatura të blerjes për çdo muaj të cilat ishin në funksion të aktivitetit, por nuk kishte asnjë indikator matës për të justifikuar vlerën e kostos së trajnimit prej **950,000 lekë**, e cila është një shumë e marrë nga buxheti i shtetit dhe e përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficientë.

Në dosje rezultuan këto dokumentë: a)Vërtetimi i kompanisë për pagesën e detyrimeve tatimore me **nr.prot.1691, datë 03.08.2018** në të cilin subjekti figuron me detyrime në vlerën 64,674 lekë në kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në TVSH në vlerën 11,084 lekë, në Tatim Fitimi në vlerën 620,788 lekë pra në total subjekti ka detyrime në vlerën **696,546 lekë**. Në vërtetim, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve nuk shprehet që për këto detyrime subjekti ka akt marrëveshje me DRT Fier, por në dosje është akt-marrëveshja e lidhur me DRT Fier me nr.prot.6493/1, datë 20.04.2018, sipas të cilës në datën 20.04.2018, subjekti ka 1,019,923 lekë

detyrime. Vlera mujore e kështit sipas të cilit subjekti duhet të bëjë pagesën brenda datës 19 të cdo muaji deri më 19.12.2018 është 96,240 lekë, vlerë e cila në qoftë se nuk paguhet atëherë



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

subjekti i zgjidhet akt marrëveshja sipas Kreut XI, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008. i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”.

b) Dy Vërtetime të pagesës dhe deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përkatësisht me nr.prot T00499262, datë 16.08.2018 me detyrime 258,318 lekë dhe vërtetimi me nr.prot T00440792, datë 23.07.2018 me detyrime 314,218 lekë.

Nga shkresat e dërguara bashkëlidhur observacionit rezultonin pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por jo brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe në ligjin e procedurave tatimore, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së brendshme e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ Trepalësh nr. 29, datë 30.01.2015, e ndryshuar me vendim Të Këshillit, Administrativ Trepalësh nr.31, datë 14.02.2017 Gjithashtu SHKP/Drejtoria e Përgjithshme si dhe Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka përgjegjësi në monitorimin e zyrës vendore për çdo rajon, veçanërisht në rastet kur subjekti i cili përfiton nga projektet e nxitjes së punësimit, rezulton me detyrime pranë administratës tatimore, në momentin e lidhjes së kontratës. Si rrjedhim vlera prej **1,724,050 lekë** nga Buxheti i Shtetit, e përfituar nga subjekti “x”sh.p.k, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5. të Program Auditimit në faqet nr. 121-191 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: SHKP/ Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit të fondeve të buxhetit të Shtetit në vlerën **1,724,050 lekë** për subjektin “x”sh.p.k, pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Menjëherë

V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP), sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon veprimtarinë e tij dhe programet e nxitjes së punësimit (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë**²

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² ISSAI 4000 – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

³ Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt ose një refuzim të opinionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e SHKP-së, rezultoi se, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi të cilat kryesisht konsistojnë: në shkelje të ligjshmërisë në Programet e nxitjes së punësimit, në organizimin dhe funksionimin e strukturës në Drejtorinë e Përgjithshme, kontroll i brendshëm joefektiv, në Prokurimin Publik etj.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. E.Ll. përgjegjës grupi;
2. R.L.
3. V.S.
4. A. K.
5. K.F.
6. E.B.
7. J.G.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
B.A

VI. ANEKSI 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me rezerve. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

1. Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI II



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë procesit të planifikimit, janë mblidhur informacion për subjektin në mënyrë që të vlerësohet risku dhe të përcaktohen nivelet e materialitetit për hartimin e procedurave të auditimit. Evidencat e mbledhura më pas janë vlerësuar si një bazë për formimin e përfundimeve dhe për qëllime raportimi. Materialiteti është i rëndësishëm për këtë vlerësim. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 2% ku niveli i precizionit pranohet në vlerën **14,949,820** lekë për vitin 2018 dhe **18,703,393** lekë për vitin 2018.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan: teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Emërtimi i shpenzimeve 2018	Vlera e popullates	Faktori i Riskut 0.7	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	179,212,003	0.7	8
Sigurime Shoqërore (601)	29,751,732	0.7	1
Mallra e Shërbime (602)	58,211,185	0.7	8
Të tjera transf. korrente të brend. (606)	309,162	0.7	0
Pagesa Nxitje punesimi	258,371,265	2	35
Të tjera transf. korrente të brend. (606) pagesa papunesie	334,784,437	2	45
Investime të brend. (230-231)	62,188,614	2	8
Total	922,828,398		
Materialiteti në përqindje	2%		
Materialiteti në vlerë	18,456,568		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,845,657		
Nëntotali	16,610,911		
Pozicioni I planifikuar (80 - 90%)	90%		
Vlera e pozicionit	14,949,820		

Emërtimi i shpenzimeve 2019	Vlera e popullates	Faktori i Riskut 0.7	Çështje për tu shqyrtua
Paga (600)	181,754,715	0.7	7
Sigurime Shoqërore (601)	30,289,734	0.7	1
Mallra e Shërbime (602)	69,942,562	0.7	7
Të tjera transf. korrente të brend. (606)	568,650	0.7	0
Pagesa Nxitje punesimi	345,954,482	2	37



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Të tjera transf. korrente të brend. (606) pagesa papunesie	504,163,033	2	54
Investime të brend. (230-231)	21,857,257	2	2
Total	1,154,530,433		
Materialiteti në përqindje	2%		
Materialiteti në vlerë	23,090,609		
Gabimi I lejuar (10%-20%)	2,309,061		
Nëntotali	20,781,548		
Pozicioni I planifikuar (80 - 90%)	90%		
Vlera e pozicionit	18,703,393		

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “efektiv”;
- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%, në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “pjesërisht efektiv” ose “jo efektiv”.

Përzgjedhjen e urdhër shpenzime (sipas aneksit bashkëngjitur) është bërë duke parë brenda kontekstit të natyrës specifike të shpenzimeve, të cilat mbartin risk, duke marrë në konsideratë dhe faktorët si:

- vlerat e pagesës
- ngjarje apo transaksione të rëndësishme si kontrata të rëndësishme prokurimi, kontrata për investime afatgjatë, të cilat mund të jenë shkas për ndonjë risk më të lartë.
- afati kohor që nga data e urdhër shpenzimit me datën e faturës së lëshuar për kryerjen e shërbimit, për të analizuar arsyen e këtyre vonesave në ekzekutim, duke kaluar afatin 30 ditore të parashikuar në legjislacion.
- ekzekutimi i pagesave në lidhje me vendimet e formës së prerë duke marrë parasysh afatin e zgjatjes së pagesës nga vendimi deri në ekzekutimin e pagesës nga institucioni..
- urdhër shpenzime dieta

Mbulimi me shpenzim i prokurimeve në shumë totale 40,000,000 lekë dhe numer dosjesh të realizuara janë 12 për vitin 2018, dhe dosje të audituara për prokurimet në rikonstruksion për vitin 2019 janë 3, me vlerë shpenzimesh 32,000,0000 lekë.

Sa i takon auditimit të projekteve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e tyre u realizua nisur nga pesha specifike e secilës prej tyre ndaj totalit të vlerës vjetore të projekteve të realizuara: **Mbulimi me auditim i projekteve që kanë të bëjnë me nxitjen për punësim për vitin 2018 në vlerën 258,371,265 dhe 2019 në vlerën 345,954,482** u audituan 19 dosje të projekteve të nxitjes së punësimit për periudhën në auditim.

ANEKSI III:

Transaksionet e SHKP--së.

Urdhër Shpenzimet e mëposhtëm u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Urdhër shpenzimet Viti 2018			Viti 2019		
<i>Ush. Nr</i>	<i>Dt.Pagesës</i>	<i>Shuma/lek</i>	<i>Ush. Nr</i>	<i>Dt.Pagesës</i>	<i>Shuma/lek</i>
239	02.10.2018	270,820	12	29.01.2019	180,500
268	22.10.2018	209,000	27	14.02.2019	66,000
149	22.06.2018	19,500	28	14.02.2019	11,000
150	22.06.2018	6,500	45	07.03.2018	11,000
151	22.06.2018	3,000	46	07.03.2019	11,000
122	29.05.2018	21,500	65	02.04.2019	297,000
112	14.05.2018	16,500	93	03.05.2019	22,000
222	13.09.2018	11,000	94	03.05.2019	55,000
230	21.09.2018	11,000	111	30.05.2019	440,000
231	21.09.2018	11,000	112	30.05.2019	44,000
232	21.09.2018	11,000	113	30.05.2019	22,000
241	02.10.2018	11,000	114	30.05.2019	88,000
252	09.10.2018	21,000	124	07.06.2019	27,500
253	09.10.2018	21,000	159	22.07.2019	55,000
291	09.11.2018	192,500	160	22.07.2019	178,640
292	14.11.2018	11,000	161	22.07.2019	11,000
293	14.11.2018	77,000	162	22.07.2019	33,000
305	21.11.2018	16,500	172	15.08.2019	132,000
306	21.11.2018	308,000	173	15.08.2019	22,000
352	24.12.2018	39,000	217	08.10.2019	33,000
353	24.12.2018	21,000	218	08.10.2019	99,000
355	24.12.2018	244,000	245	07.11.2019	137,500

ANEKSI IV

PROGRAMET E NXITJES SE PUNESIMIT 2018

Nr.	Zyra e punesimit	Fondi i konfirmuar per vitin buxhetor	Financimi ne fakt sipas situacioneve te konfirmuara nga thesari	Fond i konfirmuar VKM 48	Financimi ne fakt VKM 48	Fond i konfirmuar VKM 47	Financimi ne fakt VKM 47	Fond i konfirmuar Subvencion 47
1	BERAT	813,110	792,077	112,872	103,661	338,078	326,256	204,682
2	KUCOVE	578,160	490,621					
3	SKRAPAR	216,432	211,331	216,432	211,331			
4	DIBER	2,184,672	2,166,238	384,624	384,624	1,211,808	1,211,808	741,000
5	BULQIZE	3,810,840	3,748,696	108,216	108,216	2,330,400	2,268,256	1,425,000
6	MAT	783,720	783,720	240,480	240,480			
7	DURRES	12,263,001	11,827,626	1,807,127	1,578,140	9,135,168	8,967,826	5,586,000
8	KRUJE	3,206,016	3,181,144	228,456	227,728	2,796,480	2,796,480	1,710,000
9	ELBASAN	7,324,304	6,562,447	324,648	319,207	4,754,016	4,110,057	2,907,000
10	GRAMSH	1,976,400	1,793,721			1,398,240	1,283,887	855,000
11	LIBRAZHD	674,784	634,793	312,624	312,624			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

12	PEQIN	711,720	675,504	132,264	132,264			
13	FIER	19,202,513	15,409,727	909,233	798,635	16,670,127	13,291,946	10,193,500
14	LUSHNJE	14,985,862	12,301,670	705,084	678,218	13,735,236	11,150,288	8,398,864
15	MALLAKASTER	760,487	698,558	315,906	275,093			
16	GJIROKASTER	3,652,593	3,505,592	1,136,669	1,067,948	1,432,368	1,398,888	875,520
17	TEPELENE	2,474,641	2,357,983	349,497	330,842	1,759,136	1,666,546	1,054,400
18	PERMET	180,840	180,840	60,120	60,120			
19	KORCE	5,328,551	4,642,461	76,954	72,144	4,474,368	3,808,906	2,736,000
20	DEVOLL	484,042	476,503	149,098	142,105			
21	KOLONJE	676,022	667,122	80,962	78,336			
22	POGRADEC	3,942,441	3,093,623	244,288	197,126	3,635,424	2,850,132	2,223,000
23	KUKES	3,591,279	3,477,340	600,399	571,140	2,387,280	2,330,400	1,459,200
24	HAS	2,469,992	2,345,100			1,926,752	1,877,100	1,178,000
25	TROPOJE	576,667	367,044	93,787	90,180			
26	LEZHE	2,037,458	1,866,930	493,786	376,931	372,864	362,977	228,000
27	LAC	855,096	831,387	505,008	481,227			
28	MIRDITE	506,832	501,521	192,384	187,649			
29	SHKODER	12,949,408	10,657,443	1,111,178	701,072	9,669,616	8,444,737	5,910,520
30	M.MADHE	3,807,915	3,387,940	281,763	262,524	2,982,912	2,610,048	1,824,000
31	PUKE	497,308	306,204	135,148	102,204			
32	TIRANE	40,646,702	39,516,240	2,342,436	2,176,344	35,252,256	34,572,038	21,555,120
33	KAVAJE	308,476	234,307	108,216	96,480	186,432	124,000	114,000
34	VLORE	6,251,831	4,735,588	486,972	351,180	3,821,856	2,911,811	2,337,000
35	DELVINE	148,697	145,379	148,697	145,379			
36	SARANDE	36,216	36,216					
	Projektet 2018	160,915,028	144,610,636	14,395,328	12,861,152	120,270,817	108,364,387	73,515,806

Aneksi V

PROGRAMET E NXITJES SE PUNESIMIT 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

Nr.	Zyra e punësimit	Fondi i konfirmuar per vitin buxhetor	Financimi ne fakt sipas situacioneve te konfirmuara nga thesari	Fond i konfirmuar VKM 48	Financimi ne fakt VKM 48	Fond i konfirmuar VKM 47	Financimi ne fakt VKM 47	Fond i konfirmuar Subvencion 47
1	BERAT	3340494	3208689	1302527	1290024	141891	141333	85500
2	KUCOVE	2179094	1916590					
3	SKRAPAR	3223390	3176061	2922496	2882511			
4	DIBER	8120667	7844899	4567808	4489756	760374	820950	494000
5	BULQIZE	6115494	6026370	1284696	1284696	2030560	2012522	1216629
6	MAT	3718028	3619902	2854880	2854880			
7	DURRES	30865743	29749320	21906615	21211601	5241450	5194243	3154000
8	KRUJE	4375813	4330109	2713121	2690033	1317096	1317096	798000
9	ELBASAN	15987920	14815495	3854088	3846022	3031200	2691898	1824000
10	GRAMSH	1956920	1524512			820950	820950	494000
11	LIBRAZHD	5424956	5284742	3711344	3641248			
12	PEQIN	3182360	3145447	1570184	1565258			
13	FIER	36249211	32508810	12796382	11877548	18081491	16179904	10817044
14	LUSHNJE	25954887	24268937	9674537	9489392	12108420	11468331	7234301
15	MALLAKASTER	5322164	4664704	4348209	3804604			
16	GJIROKASTER	19087809	18988511	14723683	14723683	1344565	1344565	807120
17	TEPELENE	8318129	8063079	4424373	4415138	1775273	1775273	1064000
18	PERMET	1341464	1269257	713720	713325			
19	KORCE	12152948	10692044	1012234	993487	3704838	3698338	2223000
20	DEVOLL	3327380	3059676	2026832	1965955			
21	KOLONJE	1384258	1341402	1005720	1005715			
22	POGRADEC	9371887	7852738	3382978	2382094	4120694	4120694	2463954
23	KUKES	13166890	12992114	8417929	8417929	3029910	3029685	1805000
24	HAS	2517715	2485040			2223460	2171860	1330000
25	TROPOJE	2173161	1975336	1307241	1307241			
26	LEZHE	9490045	7939264	6646551	5318535	252600	252600	152000
27	LAC	7126255	7176524	6486439	6535772			
28	MIRDITE	3089550	2952526	2439674	2407982			
29	SHKODER	29028135	27423850	9463887	9441323	9272217	9338662	5608747
30	M.MADHE	6855268	6648744	3777106	3755929	2345794	2335791	1407900
31	PUKE	1498046	1496756	1387172	1387172			
32	TIRANE	64251855	61737733	27696678	26558915	28258505	28003560	16967691
33	KAVAJE	1991777	1905200	1296720	1262435	188444	188444	114000
34	VLORE	14471737	11737648	6488595	5359304	1871618	1318574	1133653
35	DELVINE	2024750	2023306	2024750	2023306			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “ Drejtorinë e Shërbimit
Kombëtar të Punësimit”

36	SARANDE	109174	109147					
	GJITHSEJ	368,795,374	345,954,482	178,229,169	170,902,813	101,921,350	98,225,273	61,194,539